



**CIKLI I TRETË I STUDIMEVE**

**Programi:** Gjuhë dhe letërsi shqipe

Tema e disertacionit të doktoratës:

**DIVERSITETI LINGUISTIK DHE EDUKIMI PLURILINGUAL NË GOSTIVAR -  
BILINGUIZMI TE SHQIPTARËT, MAQEDONASIT DHE TURQIT**

KANDIDATI:

*Mr. Merita Banjica*

MENTORI

*Prof. dr. Mustafa Ibrahim*

Qershor 2017, Tetovë

KOMISIONI:

Prof. dr. Mustafa Ibrahimi - mentor

Prof. dr. Zeqir Kadriu – kryetar Komisioni

Prof. dr. Gëzim Xhaferi - anëtar

Prof. dr. Vebi Bexheti - anëtar

Prof. dr. Begzad Baliu – anëtar i jashtëm

DEKLARATË

Vërtetoj se unë jam autori origjinal i këtij punimi

Mr.Merita Banjica

---

## PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	3
Lista e figurave.....	5
Lista e tabelave.....	7
Abstract.....	8
Abstrakti.....	9
<i>Disa fjalë për autorin</i> .....	10
Bibliografia e autores Merita Banjica.....	11
<i>Falënderimi</i> .....	13
 I - PJESA TEORIKE .....	14
 HYRJA.....	14
Struktura e punimit .....	15
<i>I-Pjesa teorike: Konceptet për gjuhën</i> .....	15
<i>II- Metodologjia e hulumtimit</i> .....	15
<i>III- Hulumtimi empirik</i> .....	15
 KREU I.....	16
 1. VLERA E GJUHËVE .....	16
1. 1. Vlera e gjuhëve si mjet komunikimi .....	16
1. 2. Përdorimi i gjuhës në komunikimin shoqëror .....	19
 KREU II .....	22
 2. ORGJINA E GJUHËVE DHE ZHVILLIMI I TYRE .....	22
2.1. Vlerësime teorike për origjinën e gjuhëve.....	22
2. 2. Ekspansioni gjuhësor .....	24
2.3. Shtresimet dhe kryqëzimet e gjuhëve .....	25
2.4. Vitaliteti i gjuhës dhe llojet e gjuhëve .....	26
 KREU III.....	27
 3. DIVERSITETI LINGUISTIK .....	27
3.1. Diversiteti linguistik ose variacioni gjuhësor në botë.....	27
3.2. Krijimi i gjuhëve kombëtare standarde dhe mbrojtja e tyre .....	30
3.3. Vizioni evropian për vlerën e diversitetit linguistik .....	31
 KREU IV.....	34
 4. BASHKËSIA SHOQËRORE MULTIKULTURORE .....	34
4.1. Bashkësia shoqërore multikulturore dhe bashkësia gjuhësore.....	34
4.2. Bashkësia gjuhësore, individualizmi dhe konformizmi .....	35
4.3. Multikulturalizmi – kultura .....	36
4. 4. Bilinguizmi dhe multilinguizmi .....	39
4. 5. Moshë të përvetësuarit të gjuhëve .....	41

KREU V.....	44
5.EDUKIMI PLURILINGUAL DHE PLURILINGUALIZMI .....	44
5.1. <i>Edukimi plurilingual</i> .....	44
5.2. <i>Plurilingualizmi</i> .....	47
5.3. <i>Lehtësimi i mësimit të gjuhëve me korrelacion të njësive gjuhësore</i> .....	50
5.4. <i>Parimet e mësimdhënies së gjuhëve</i> .....	52
KREU VI.....	54
6. KOMPETENCAT KOMUNIKATIVE .....	54
6.1. <i>Gjuhët përbërës themelorë të kompetencave komunikative</i> .....	54
6.2. <i>Motivimi i individit për arritjen e kompetencave komunikative</i> .....	55
II-PJESA DYTË.....	56
KREU I.....	56
1. METODOLOGJA E HULUMTIMIT .....	56
1.1. <i>Objekti dhe qëllimi i hulumtimit</i> .....	56
1.2. <i>Zbatimi i hulumtimit</i> .....	56
1.3. <i>Hipoteza</i> .....	57
1.4. <i>Variablat e hulumtimit</i> .....	58
1.5. <i>Metodat, teknikat dhe instrumentet e hulumtimit</i> .....	58
1.6. <i>Popullacioni dhe mostra</i> .....	58
1.7. <i>Interpretimi, analiza, rezultatet, përfundimet dhe rekomandimet</i> .....	59
III. PJESA EMPIRIKE.....	60
KREU I .....	60
1. INTERPRETIMI STATISTIKOR I TË DHËNAVE DYTËSORE .....	60
1.1. <i>Pozita e qytetit të Gostivarit</i> .....	60
1.2. <i>Demografia e popullsisë në Gostivar</i> .....	60
1.3. <i>Etimologjia e emërtimit të Gostivarit</i> .....	61
1.4. <i>Ndikimi i faktorit ekonomik në zhvillimin e gjuhëve</i> .....	62
1.5. <i>Diversiteti linguistik në bashkësinë shoqërore të Gostivarit</i> .....	62
1.6. <i>Varietet gjuhësore-gjeografike në Maqedoni</i> .....	63
1.7. <i>Standardizimi i disa gjuhëve ballkanike</i> .....	65
1.8. <i>Zhvillimi i gjuhëve në institucionar arsimore në qytetin e Gostivarit</i> .....	66
1.9. <i>Gjuha shqipe në shkollat filllore në nënprefekturën e Gostivarit (1941-1944)</i> .....	67
1.10. <i>Familjet e përziera prodhues të bilinguizmit gjenetik në Gostivar</i> .....	69
1.12. <i>Ndikimi i medieve në ngritjen multikulturore të qytetarëve të Gostivarit</i> .....	72
1.13. <i>Ndikimi i faktorëve kombëtar dhe ndërkombëtar në përmirësimin e raporteve multikulturore të qytetarëve të Gostivarit</i> .....	72
1.14. <i>Ndikimi i faktorëve të brendshëm politik në zhvillimin e gjuhëve</i> .....	74
KREU II .....	75
2. MULTILINGUIZMI NË KOMUNËN E GOSTIVARIT MË 2015 .....	75
2.1. Sistemimi i nxënësve në shkollat filllore të Gostivarit 2015.....	75
2.2 Sistemimi i nxënësve në shkollat e mesme të Gostivarit 2015 .....	80
2.3. Arsimimi plurilingual fillor në Republikën e Maqedonisë 2014/2015.....	82
2.4. Arsimimi plurilingual në kurrikulat mësimore në Gostivar në Republikën e Maqedonisë.....	83

KREU III.....	85
<b>3. HULUMTIME EMPIRIKE NËPËR SHKOLLA .....</b>	<b>85</b>
3.1. Shkollat ku u zhvilluan hulumtimet.....	85
3.1.2. Gjetjet në pyetësorët-a të drejtoreve të shkollave fillore dhe të mesme.....	86
4.1.3. Përfundimet nga pyetësorët e drejtoreve të shkollave fillore dhe të mesme .....	92
3.2. Pyetësori B-Gjetjet në pyetësorët e nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme .....	92
3. 3. 1. Përfundimet nga pyetësorët e nxënësve të shkollave fillore.....	129
3.3.2. Përfundime nga pyetësorët e nxënësve të shkollave të mesme .....	130
3.4. Pyetësori C- Gjetjet në pyetësorët e arsimtarëve .....	131
10. Në pyetjen e 10 janë shprehur ide për përmirësimin e të mësuarit e gjuhëve.....	137
3.4.1. Përfundimet e përgjithësuara nga diskutimet në fokus grupe .....	138
3.5. Pyetësori D- Gjetjet në pyetësorët e të punësuarëve të veprimtarive të ndryshme.....	138
35.1. Përfundime nga pyetësorët e të punësuarve .....	147
3.6. Përdorimi i teksteve shkollore në arsimimin fillor në Gostivar.....	149
3.6.1.1. Gjuhë angleze - Njësitë mësimore të përkthyera në gjuhën shqipe.....	153
3.6.1.2. Gjuhë maqedonase-Njësitë mësimore përkthyer në gjuhën shqipe .....	156
3.6.1.4. Gjuhë frëngje -Njësitë mësimore të përkthyera në gjuhën shqipe .....	159
3.6.1.4. Mungesa e pjesëve të ligjëratastës në librin e gjuhës shqipe VII-të ( i përdorur në klasë të VIII-të më 2015 ) .....	159
3.6.1.5. Përfundime nga analiza e teksteve shkollore .....	161
<b>4.PËRGJITHËSIME TË PËRFUNDIMEVE NË BAZË TË KORNIZAVE JURIDIKE .....</b>	<b>162</b>
REKOMANDIME .....	165
PËRFUNDIM.....	166
FJALORI .....	167
<b>LITERATURA .....</b>	<b>171</b>
Tekste profesionale .....	171
Fjalor dhe leksikone gjuhësore.....	173
Tekstet shkollore të gjuhëve në arsimin fillor 2015-2016 .....	173
Dokumente zyrtare .....	174
Literaturë dhe të dhëna zyrtare të shfrytëzuara nga interneti .....	174
<b>Lista e figurave</b>	
Figura 2.1. Nevojat e njerëzve të klasifikuara nga Maslov (1970) në hierarki.....	23
Figura 4.1. Kulturat dhe qytetërimet pranohen në gjysmën e dytë të shekullit XIX .....	38
Figura nr.1. Demografja në qytetin e Gostivarit sipas Regjistrimit të vitit 2002 .....	61
Figura.1.9.1.Fotografia e shkollës së parë shqipe pesëvjeçare në Gostivar .....	68
Figura 1.5. Plurilingualizmi përceptohet prej në moshë të foshnjërisë nga mjetet teknike teknologjike-ekonomike dhe zhvillohet në mjadise shoqërore arsimore.....	72
Figura 1.12. Plurilingualët në manifestim kulturor në qytetin e Gostivarit .....	73
Figura 2. Respektimi i katër gjuhëve zyrtare në mbishkrimin e komunës së Gostivarit.....	75
Figura A-1 Shkolla fillore dhe të mesme .....	86
Figura A-2 Shkolla fillore dhe të mesme .....	87
Figura A-3 Shkolla fillore dhe të mesme .....	87
Figura A-4 Shkolla fillore dhe të mesme .....	88
Figura A-5 Shkolla fillore dhe të mesme .....	88
Figura A-6 Shkolla fillore dhe të mesme .....	88
Figura A-7 Shkolla fillore dhe të mesme .....	89

---

Figura A-8 Shkolla fillore dhe t� mesme .....	89
Figura A-9 Shkolla fillore dhe t� mesme .....	90
Figura A-10 Shkolla fillore dhe t� mesme .....	90
Figura A-11 Shkolla fillore dhe t� mesme .....	91
Figura A-12 Shkolla fillore dhe t� mesme .....	91
Figura B-1 Shkolla fillore .....	93
Figura B-1 Shkolla t� mesme .....	94
Figura B-2 Shkolla fillore .....	95
Figura B-2 Shkolla t� mesme .....	95
Figura B-3 Shkolla fillore .....	96
Figura B-3 Shkolla t� mesme .....	97
Figura B-4 Shkolla fillore .....	98
Figura B-4 Shkolla t� mesme .....	99
Figura B-5 Shkolla fillore .....	100
Figura B-5 Shkolla t� mesme .....	101
Figura B-6 Shkolla fillore .....	102
Figura B-6 Shkolla t� mesme .....	103
Figura B-7 Shkolla t� mesme .....	104
Figura B-8 Shkolla fillore .....	105
Figura B-8 Shkolla t� mesme .....	106
Figura B-9 Shkolla fillore .....	107
Figura B-9 Shkolla t� mesme .....	107
Figura B-10 Shkolla fillore .....	108
Figura B-10 Shkolla t� mesme .....	109
Figura B-11 Shkolla fillore .....	110
Figura B-11 Shkolla t� mesme .....	111
Figura B-12 Shkolla fillore .....	112
Figura B-12 Shkolla t� mesme .....	113
Figura B-13 Shkolla fillore .....	114
Figura B-13 Shkolla t� mesme .....	115
Figura B-14 Shkolla fillore .....	116
Figura B-14 Shkolla t� mesme .....	117
Figura B-15 Shkolla fillore .....	118
Figura B-15 Shkolla t� mesme .....	119
Figura B-16 Shkolla fillore .....	120
Figura B-17 Shkolla fillore .....	122
Figura B-17 Shkolla t� mesme .....	123
Figura B-18 Shkolla fillore .....	124
Figura B-18 Shkolla t� mesme .....	125
Figura B-19 Shkolla fillore .....	125
Figura B-19 Shkolla t� mesme .....	126
Figura B-20 Shkolla fillore .....	127
Figura B-20 Shkolla t� mesme .....	128
Figura C-1 Opinionet e arsimtar�ve dhe profesor�ve .....	131
Figura C-2 Opinionet e profesor�ve dhe arsimtar�ve .....	132
Figura C-3 Opinionet e arsimtar�ve dhe profesor�ve .....	132
Figura C-4 Opinionet e arsimtar�ve dhe profesor�ve .....	133
Figura C-5 Opinionet e arsimtar�ve dhe profesor�ve .....	134
Figura C-6 Opinionet e arsimtar�ve dhe profesor�ve .....	135
Figura C-7 Opinionet e arsimtar�ve dhe profesor�ve .....	136
Figura C-8 Opinionet e arsimtar�ve dhe profesor�ve .....	136
Figura C-9 Opinionet e arsimtar�ve dhe profesor�ve .....	137
Figura D-1. Opinionet i t� pun�suarve p�r p�erdorimin e gjuh�ve t� huaja n� Gostivar .....	140

<i>Figura D-2. Opinion i të punësuarve për vlerësimin e gjuhëve për të mësuarit e pavarur.....</i>	141
<i>Figura D-3. Opinion i të punësuarve për zbatueshmërinë e gjuhës angleze në Gostivar.....</i>	142
<i>Figura D-5. Opinion i të punësuarëve për vlerësimin e gjuhëve si pasuri individuale .....</i>	143
<i>Figura D-6. Opinion i të punësuarëve për të ardhmen, se të rintjtë do të qëndrojnë në Gostivar .....</i>	144
<i>Figura D-7. Opinion i të punësuarve për të ardhmen se të rintjtë do të largohen nga Gostivari.....</i>	144
<i>Figura D-8. Opinion i të punësuarve se përdorimi i më tepër gjuhëve zhduk urjetjen .....</i>	145
<i>Figura D-9. Opinion i të punësuarve për gjuhën më të nevojshme për komunikim shoqëror në Gostivar.....</i>	146
<i>Figura D-10. Opinion i të punësuarve për zotërimin e gjuhëve ose plurilingualizmin.....</i>	147

## **Listë e tabelave**

<i>Tabela 1.1.3. Tabelë krahasimtare e funksionimit të gjuhës në akte komunikuese sipas teorive të gjuhëtarëve dhe sociolinguistëve.....</i>	18
<i>Tabela.1. Demografja në qytetin e Gostivarit sipas Regjistrimit të vitit 2002.....</i>	60
<i>Tabela 2.1. Shkurtësat e përdorura .....</i>	75
<i>Tabela 2.1.1. SH. F. "Ismail Qemali"-GOSTIVAR .....</i>	76
<i>Tabela 2.1.2. SH. F. "Bashkimi "- GOSTIVAR .....</i>	76
<i>Tabela 2.1.3. SH. F. "Goce Delçev "- GOSTIVAR .....</i>	77
<i>Tabela 2.1.4. SH. F. "Mustafa Qemal Ataturk"- GOSTIVAR .....</i>	77
<i>TABELA 2.1.5. SH. F. "LIRIA"-fshati Vërtok, rrëthi i GOSTIVARIT.....</i>	78
<i>TABELA 2.1.6. SH. F. " PËRPARIM"- fshati ÇEGRAN, rrëthi i GOSTIVARIT .....</i>	78
<i>TABELA 2.1.7. SH. F. " ÇAJLË "- fshati ÇAJLË , rrëthi i GOSTIVARIT .....</i>	78
<i>TABELA 2.1.8. SH. F. "FAIK KONICA "- fshati DEBRESH , rrëthi i GOSTIVARIT .....</i>	79
<i>TABELA 2.1.9. SH. F. "GJON BUZUKU"- fshati SËRMNOVË , rrëthi i GOSTIVARIT .....</i>	79
<i>TABELA 2.1.10. SH. F. "FORINË"- fshati FORINË , rrëthi i GOSTIVARIT.....</i>	79
<i>TABELA 2.1.11. Numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollat filllore të Gostivarit 2014/2015.....</i>	79
<i>TABELA 2.1.12. Numri i nxënësve në shkollën filllore të muzikës në Gostivar 2014/2015 .....</i>	80
<i>Tabela. 2.2.1. Numri i nxënësve në SH. M. K. "GOSTIVAR"-GOSTIVAR .....</i>	80
<i>Tabela. 2.2.2. Numri i nxënësve në SH. M. K. M. "GOSTIVAR"-GOSTIVAR.....</i>	81
<i>Tabela. 2.2.3. Numri i nxënësve në SH. M. T. K. "GOSTIVAR"-GOSTIVAR .....</i>	81
<i>Tabela. 2.2.4. Numri i nxënësve në SH.M. E. K. "GOSTIVAR"-GOSTIVAR .....</i>	81
<i>Tabela. 2.4.1. Statusi i gjuhëve në programet mësimore të mesme të shqiptarëve, turqve dhe maqedonasve në SHMK "GOSTIVAR" 2014/2014.....</i>	83
<i>Tabela. 2.4.2. Statusi i gjuhëve në programet mësimore të mesme të shqiptarëve, turqve dhe maqedonasve në SHMTK "GOSTIVAR" 2014/2015.....</i>	84
<i>Tabela.2.3. Statusi i gjuhëve në kurrikullën mësimore të shqiptarëve, turqve dhe maqedonasve.....</i>	82
<i>Tabela 3.1.2. A. Mostra-Të dhëna për drejtorët e shkollave filllore dhe të mesme të Gostivarit më 2014/2015.....</i>	86
<i>Tabela 1. B – Mostra në shkolla filllore- Numri i nxënësve të anketuar në shkolla filllore .....</i>	92
<i>Tabela1.B-Mostra në shkolla të mesme.....</i>	92
<i>Tabela D. Mostra - Të dhëna për të anketuarit e punësuar në qytetin e Gostivarit .....</i>	139
<i>Tabela3.6.1. Tabela krahasimtare për realizimit të njësive mësimore të gjuhëve në klasën VIII/1 në SH.F. "Ismail Qemali" 2014/2015 parë nga e-ditari.....</i>	150
<i>Tabela 3.6.1.1Tabela e materialit gjuhësorë në lëndët e gjuhës angleze.....</i>	153
<i>Tabela 3.6.1.2. Tabela e materialit gjuhësorë të gjuhës maqedonase .....</i>	157
<i>Tabela 3.6.1.3. Tabela e materialit gjuhësorë e gjuhës frëngje.....</i>	159
<i>Tabela 4.1-Tabela pasqyruese e 206 të anketuarit për gjuhën më të nevojshme në Gostivar.....</i>	163
<i>Tabela 4.2-Tabela pasqyruese për 206 të anketuarit për zotërimin e shumëgjuhësisë në Gostivar.</i>	164

**Abstract**

Bilingualism and plurilingualism are the speakers ability to speak two or more languages. This capability is achieved by the individual speakers, where besides the mother tongue (L1) learns different languages on a parallel basis or gradually, indifferent times and places, creating different language competence, which memorizes in his cognitive and uses the self-actualization in the process of instruction in the language required in compliance with contextual communication situation.

Linguistic diversity reflected in multicultural social community enables all individuals to develop bilingualism and multilingualism skill ranging from family environment with mixed marriages and social environment with formal education systems, formal and informal education for the achievement of personal and collective ward-processing versatile in every aspect of life.

Achievements of the Individual in ward-processing to multilingual speakers reflected on the enrichment cognitive with different competitive languages , in developing affective achieving empathic on respecting the principle of multicultural democratic society toward psychomotor skills development of oral and written expression in every language, communication towards the provision and acceptance of different messaging and social terms with the facilitation of providing vital existential unemployment challenge in the XXI century.

This project aims to clarify scientific theoretical concepts about bilingualism and plurilingualism and with empirical research to illuminate the current state of bilingualism and plurilingualism which is used by the speakers to provide vital existentiality in everyday life in the city of Gostivar, Republic of Macedonia. In this research shall use combined questionnaires with alternative questions for three groups of bilingual speakers of three ethnic groups albanians, macedonians and turks.

**Keywords:** social community, multiculture and culture, linguistic diversity, multilingualism, bilingualism and plurilingualism, speech act, communicative competence.

## Abstrakti

Dygjuhësia (bilingualizmi) dhe shumëgjuhësia (plurilingualimi) janë aftësi të folësit për të folur në dy ose më tepër gjuhë. Kjo aftësi arrihet te individi folës, kur krahas gjuhës amtare(Gj1) mëson edhe gjuhë të ndryshme në mënyrë paralele ose graduale, në kohë dhe vende të ndryshme duke kriuar kompetenca të ndryshme gjuhësore, që i memorizon në kognitiven e tij dhe i përdor me vetaktualizim në proces të komunikimit në gjuhën e nevojshme në përshtatshmëri me situatën kontekstuale komunikuese.

Diversitet linguistik i reflektoar në bashkësinë shoqërore multikulturore u mundëson të gjithë individëve të zhvillojë aftësitë e dygjuhësise dhe shumëgjuhësise duke filluar nga mjedisi familjar me martesa të përziera dhe në mëdusë sistemeve shoqërore me arsimim formal, arsimim joformal dhe informal për arritje të fisnikërimit vetjak dhe kolektiv të gjithanshëm në çdo aspekt jetësore.

Arritjet e fisnikërimit individual të folësve shumëgjuhësorë reflektohen në drejtim të pasurimit kognitiv me kompetenca gjuhësore të ndryshme, në drejtim të zhvillimit afektiv me arritjen e respektimit të parimit empatik multikulturor në shoqëri demokratike, në drejtim psikomotor me zhvillimin e shkathtësive shprehëse verbale dhe me shkrim në çdo gjuhë, në drejtim komunikuese me dhënie dhe pranim të mesazheve të ndryshme dhe në drejtim social-ekonomik me të lehtësuarit e sigurimit të ekzistencës jetësore në sfidën e papunësisë të shekullit XXI-një.

Ky punim ka për qëllim të sqarojë konceptet teorike shkencore për dygjuhësinë dhe shumëgjuhësinë dhe me hulumtimin empirik të ndriçojë gjendjen aktuale për përdorimin dygjuhësise dhe shumëgjuhësise nga folësit për të siguruar ekzistencën jetësore e në përditshmërinë jetësore në qytetin e Gostivarit të Republikës së Maqedonisë. Në këtë hulumtim u përdorën katër lloje të pyetësorëve me pyetje alternative për tre grupe folësish bilingual të tri etniteteve shqiptarë, maqedonas dhe turq.

**Fjalët kyçe:** bashkësi shoqërore, multikulturalizmi dhe kultura, diversiteti linguistik, multilinguizmi, bilinguizmi, plurilingualizmi, akt i komunikimit, kompetenca kommunikative.

---

## **Disa fjalë për autorin**

### ***Merita Banjica***

Merita Banjica u lind më 01.05.1963 në Tetovë, por jeton dhe punon në Gostivar. Ajo është studiuuese në fushat e “Gjuhës dhe letërsisë shqipe” dhe “Udhëheqjes e menaxhimit në arsim”. Një periudhë të gjatë punon në ciklin fillor si arsimtare në lëndën e Gjuhës shqipe në Gostivar. Ajo merret edhe me përkthime të librave nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe. Gjithashtu është pjesëmarrëse në konferenca vendore dhe ndërkombëtare.

### **Arsimimi**

Arsimimin fillor e mbaroi në Sh.F „Mosha Pijade“- Gostivar (1969-1976), kurse atë të mesëm në gjimnazin „Pançe Popovski“ – Gostivar (1976/77 - 1979/80). Studimin e lartë në SHL “Kliment Ohridski”-Shkup, Gjuhë Shqipe dhe Maqedone dhe Letërsi (1980/81 - 29.10.1986). Studimet universitare në USHT- FSHHA - Tetovë, Gjuhë dhe Letërsi Shqipe (2004/2005-/2006/2007), kurse ato pasuniversitare UEJL -FGJKK drejtimi - Menaxhimi dhe udhëheqja në arsim” me tezën: **“Qëndrimi i drejtoreve aktual ndaj menaxhimit të ndryshimeve në shkollë fillore”** (mori titullin Magjistër i “Menaxhimit dhe udhëheqjes në arsim” (2007 - 2010). Studimet e doktoratës në UEJL-FGJKK, Programi i Doktoratës: Gjuhë dhe letërsi shqipe. Disertacioni i doktoratës: **“Diversiteti lingistik dhe edukimi plurilingual në Gostivar” (Bilinguizmi te shqiptarët, maqedonasit dhe turqit në Gostivar).** (2013- 2017).

### **Përvoja e punës**

Karrierën e fillon në firmën private “Inzhinjering” si punëtore e administratës prej më 1990 – 1995, kurse prej vitit 1995 e deri më sot punon si arsimtare në Sh.F „Ismail Qemali” të Gostivarit.

### **Veprimtaria përkthyese:**

- 1) Zbatueshmëria e Shkencës të Biologjisë së Muskujve dhe Shkencës së Mishit - Min Du Riçard J.Mek Kormik (2009) e përktheu më (2012)-f .327. “Studio- Ars”- Shkup.
- 2) Ligji Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut – Frederik Sudre (2008) e përktheu më (2013) - f.826. “Studio- Ars”- Shkup
- 3) Libër për klasën e parë “Shkencat natyrore” të Qendrës Ndërkombëtare për programe mësimore në arsimin fillor të Kembirxhit (55 faqe) përkthyer më 2014. Studioja Gjuhësore “Janika” -Shkup
- 4) Fletore pune për klasën e parë “Shkencat natyrore” të Qendrës Ndërkombëtare për programe mësimore në arsimin fillor të Kembirxhit.(18 faqe) përkthyer më 2014. Studioja Gjuhësore “Janika” -Shkup
- 5) Përkthim të librit për fëmijë për “Studion Gjuhësore Janika” -Shkup prej gjuhës maqedonase në gjuhën shqipe prej 2014:

### Bibliografia e autores Merita Banjica

#### Botime nëpër revista:

BANJICA, Merita. (2016). *Linguistic diversity and the advantages of bilingualism and multilingualism in municipality of Gostivar, Macedonia*. European Journal of Foreign Language Teaching. Volume1, Issues 1, 2016.

<http://oapub.org/edu/index.php/ejfl/article/view/338>

BANJICA, Merita. (2016). *Interracial marriages a product of bilingualism*. European Journal of Social Sciences Studies. Volume1, Issues 2, 2016.

<http://oapub.org/soc/index.php/EJSSS/article/view/45/>

BANJICA, Merita. (2014). *Formative assessment diagnostician achievements of the pupil and the reflection of teacher's work*, ICRAE2014 Conference Proceedings ISSN: 2308-0825

[http://konferanca.unishk.edu.al/icrae2014/cd/pdfdoc/578.pdf/ 2015](http://konferanca.unishk.edu.al/icrae2014/cd/pdfdoc/578.pdf)

BANJICA, Merita. (2015). *“Current principals attitude on leadership and modern management in elementary schools.” 2nd Albania International Conference on Education (AICE)*. European dimension within national context. Tirana, Albania.

[Http://www.cde.edu.al/sites/default/files/Proceedings%20Book%202015.pdf/ 2015](Http://www.cde.edu.al/sites/default/files/Proceedings%20Book%202015.pdf)

BANJICA, Merita. (2015) *Diversiteti gjuhësor dhe përparësitë e shumëgjuhësisë në komunën e Gostivarit*. Në revistën “Zeri i Pelagonisë”, nr.9-10. Shkup. Fq.69-77. (ISSN 1857-5560)

<Http://C:/Users/User00014/Downloads/Zeri%20i%20Pelagonise%20nr.9-10%20-%202015.pdf>

#### Pjesëmarrje nëpër konferenca :

BANJICA, Merita. (2015) *“Formative assessment diagnostician achievements of the pupil and reflection of the teacher work’s”* (“Vlerësimi formativ diagnostikues i të arriturave të nxënësit dhe reflektim i punës së arsimtarit”). Konferencën Internacionale të II-të “Research and education-Challenges Towards the Future”–ICRAE 2014- Universiteti “Luigj Gurakuqi”- Shkodër-FSHE më 30-31.05.2014.

BANJICA, Merita. (2015). *“Current principals attitude on leadership and modern management in elementary schools”* (“Qëndrimi i drejtoreve aktual për udhëheqjen dhe menaxhimin modern në shkolla fillore”). Konferencën Internacionale të II-të “Second Interenational Conference of Albanina Education, 14-nëntor 2014 në Tiranë.

BANJICA, Merita. (2015). *Linguistic diversity and the advantages of bilingualism and multilingualism in municipality of Gostivar ( Diversiteti gjuhësorë dhe përparësitë e dygjuhësisë dhe shumëgjuhësisë në komunën e Gostivarit)*. Takimi X Vjetor Ndërkombëtar i Institutit Alb-Shkenca - Bashkëpunimi shkencor mbarëkombëtar në funksion të përparimit e të mirëkuptimit ndërkombëtar mbajtur më 28 - 30 gusht 2015 në Shkup.

BANJICA, Merita. (2015). *Multilinguizmi dhe edukimi plurilingual në shkollat fillore të Gostivarit*. Seminari IX Ndërkombëtar i Albanologjisë “Lokalja dhe universalja në kulturën shqiptare”. Organizuar nga Universiteti Shtetëror i Tetovës, mbajtur më **02 tetor 2015**.

BANJICA, Merita. (2015). *Martesat e përziera prodhues të bilinguizmit*. Konferencën e 3-të Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës- “*Bashkëpunimi brendakulturor shqiptar*” mbajtur më 22-23.04.2016, Tetovë , Republika e Maqedonisë

BANJICA, Merita. (2017). *Language development in the educational institutions in Gostivar*, (Zhvillimi i gjuhëve në institucionet arsimore të Gostivarit) në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Arsimi në botën shqiptare: historia, e sotmja, perspektiva” në 130 vjetorin e mësonjëtores së parë. (1887 - 7 mars - 2017). Durrës.

BANJICA, Merita. (2017). *Korrelacioni i njësive mësimore gjuhësore në tekstet shkollore të gjuhëve*. Në takimin e parë Shkencor i Albanologëve të rinj “Sfidat e studimeve albanologjike në fillim të shek.XXI”. Katedra e Gjuhës, Kulturës dhe Letërsisë Shqipe, UEJL, Tetovë, 21.04.2017.

## Falënderimi

Falënderim i veçantë për realizimin e disertacionit të doktoratës i takon mentorit tim, prof. dr. Mustafa Ibrahim, që e mbështeti idenë time duke pranuar përgjegjësinë e mentorimit gjatë këtij studimi shkencor. Orientimi për përzgjedhjen e literaturës shkencore nga ana e tij u bë në kohën e duhur, që më mundësoi në kohë ta realizojë anketimin në institucionet e Gostivarit. Përkushtimi i tij në procesin e mentorimit u reflektua me durim dhe gatishmëri për konsultime dhe korrigjime të punimit. Vërejtjet e tija pozitive ndikuan përfinalizimin e disertacionit të doktoratës.

Falënderimi u takon edhe të gjithë profesorëve të ciklit të tretë të studimeve të doktoratës, që na ligjëruan dhe bashkëpunuan me ne gjatë këtij procesi studimor të qëllimshëm përfisnikërim individual. Motivimi im për studime të doktoratës u realizua me një motivacion të pandërprerë në disa “rrugë avanturueske shkencore” përfshirë zbuluar koncepte të ndryshme përf multilingualizmin dhe plurilingualizmin, që u përdorën përf lidhshmëri të bilinguizmit të realitetit jetësor dhe diversitetit linguistik në Gostivar.

Falënderimi i veçantë u takon prof.dr.Begzat Baliu dhe prof.dr.Myrvete Baliu përmikpritjen e tyre, që ma ofruan gjatë periudhës së kryerjes së mobilitetit tim në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”– Prishtinë. Ata më mundësuan të jem e pranishme në mesin e studentëve në ligjëratat e ciklit pasuniversitar të magjistraturës dhe më ofruan literaturë shkencore individuale të tyre, syllabuse, programe mësimore dhe modele të listave evidentuese.

Falënderimi për realizimin e këtij hulumtimi i takon anëtarëve të institucionit komunal - Sektori përf Veprimtari Publike dhe kryetarit të komunës z. Nevzat Bejta, që më mundësuan të shfrytëzoj të dhënat statistikore të periudhës tetëvjeçare përf numrin e nxënësve të shkollave filllore dhe të mesme në qytetin e Gostivarit. Gjithashtu falënderoj edhe qytetarët e mi përf kohën, që e ndan përf plotësimin e pyetësorëve të ndryshëm dhe përf intervistat.

Falënderoj edhe familjen time përf mirëkuptimin, që reflektoi gjatë këtij procesi studimor, bashkëshortin tim, Hajati Banjica dhe të dy djemtë e mi me familjet, Bekim Banjica me bashkëshorten Dafinën dhe fëmijët Altinin, Ronin dhe Redonin dhe Visar Banjica me bashkëshorten Elifin dhe djalin Diarin, nipin tim të katërt, që më dha vullnet përf jetë përf t'i rikthyer punës shkencore dhe mbesës sime të sapolinduar, Sara. Të dy kanë gjasa të bëhen plurilingual i pesë gjuhëve: shqipe, turke, maqedonase, angleze dhe suedeze.

Falënderoj edhe miken time Ismije Beshiri, që më motivoi t'i vazhdoj studimet e doktoratës me reflektimin e humanizmit dhe kulturës qytetare të saj. Falënderoj edhe Belma Salbu, Jehona Salbu, Marina Saveska, Laureta Osmani, Emir Lokan, arsimtarët e gjuhëve, Shkëndije Zendeli (anglisht), Nuredin Aliu (gjermanisht), Fetie Dalipi (frëngjisht) dhe firmën private “Ove-Group” dhe vozitësin e tyre Kujtim Miftari, që më mundësuan të jem e pranishme në konfrençat e ndryshme shkencore. Faleminderit të gjithëve!

## I-PJESA TEORIKE

### HYRJA

Ky punim ofron shqyrtime teorike për diversitetin lingistik dhe edukimin plurilingual, ndërsa në pjesën empirike ndriçon gjendjen e diversitetit linguistik, multiliguizmit, edukimit plurilingual dhe dukurinë e plurilingualizmit në Gostivar. Përvetësimi i gjuhëve të ndryshme arrihet gjatë procesit jetësore të individit me të mësuarit e gjuhëve në mëdise familjare dhe shoqërore. Të gjithë gjuhët nuk e kanë pasur të njëjtin fat të mbështeten nga institucionet e politikave arsimore në mënyrë të barabartë dhe të zhvillohen në mënyrë paralele.

Gjuhë botërore është të mësuarit e gjuhës angleze, mirëpo në rajonet dhe shkollat e përziera të Republikës së Maqedonisë nxënësi ka mundësi të përcaktohet edhe për lëndë zgjedhore të gjuhëve tjera, zakonisht gjuhëve, që e rrethojnë. Individ sa më tepër gjuhë di, aq më tepër kompetenca gjuhësore ka, gjë që i mundësojnë komunikime shoqërore “multilinguale” dhe zhvillim të plurilingualizmit individual. Përdorimi i disa gjuhëve konsiderohet si pjesë e pandarë e çdo aktiviteti njerëzor në bashkësitë multikulturore, prandaj edhe gjuhët janë studiuar nga shumë aspekte të teorive shkencore:

- *Aspekti gjuhësorë* e konsideron gjuhën si mjet substancial me sistemim të elementeve gjuhësore të mbështetura në norma standarde, që përdoren për të emërtuar çdo gjë statike, të lëvizshme, të imagjinuar, të zbukuruar, të përjetuarit vetjak, të vepruarit në kohë të ndryshme, të vepruarit në mëdise të ndryshme etj.
- *Aspekti antropologjik* gjuhën e konsideron si mjet ekzistencial të njeriut.
- *Aspekti social* gjuhën e konsideron si mjet shoqërizimi raporte të mira në mes individëve me ndërkëmbime vetjake të ndërsjella për bashkëveprim në nivel lokal, shtetëror dhe global.
- *Aspekti sociolingistik*, gjuhët dhe varietetet gjuhësore i konsideron si mjete funksionale të ndryshme për komunikim shoqëror ose mjete “makrosociolingustike”.
- *Aspekti pedagogjik –didaktik* gjuhën e konsideron si mjet arsimor për të zhvilluar kompetenca kognitive, afektive, psikomotore dhe sociale të individëve.
- *Aspekti psikologjik* gjuhën e konsideron si mjet pragmatik për të ndikuar në zhvillimin e sjelljeve shoqërore të njerëzve dhe në formimin e personalitetit të çdo individi.

## Struktura e punimit

### I-Pjesa teorike: Konceptet për gjuhën

Në pjesën e I-Pjesa teorike ofrohen sqarime për konceptet shkencore. Në kreun e I-rë sqarohen konceptet për vlerën e gjuhës për jetën e njeriut, gjuha si mjet thelbësor dhe shoqëror, tipat dhe llojet e komunikimit, gjuhët si mjet thelbësore të komunikimit shoqëror, përdorimi i gjuhës në komunikimin shoqërore, rregullat dhe veprimet gjatë komunikimit shoqëror, rregullat e interpretimit komunikues.

Në kreun e II-të sqarohen vlerësimet teorike për origjinën e gjuhës, ekspansioni gjuhësor, shtresimet dhe kryqëzimet e gjuhëve, vitaliteti i gjuhëve dhe llojet e gjuhëve.

Në kreun e III-të sqarohen konceptet e diversitetit linguistik, krijimi i gjuhëve kombëtare standarde dhe mbrojta e tyre si dhe vizioni evropian për vlerën e gjuhëve.

Në kreun e IV-të sqarohen konceptet për bashkësinë shoqërore multikulturore, për bashkësinë gjuhësore, individualizmin dhe konformizmi, multikulturalizmi-kultura, normat kulturore, bilinguizmi dhe multilinguizmi, mosha e përvetësimit të gjuhëve etj.

Në kreun e V-të sqarohen konceptet e edukimit plurilingual dhe plurilingualizmit, lehtësimi për të mësuarit e gjuhëve dhe parimet e mësimdhënies së gjuhëve.

Në kreun e VI-të sqarohen konceptet gjuha si përbërës themelor i kompetencave komunikuese dhe motivimi i individit për arritje të kompetencave plurilinguale.

### II- Metodologja e hulumtimit

Në pjesën e II-Metodologja e hulumtimit ofrohen sqarime për metodologjinë e hulumtimit sipas procesit në vijim: objekti dhe qëllimi i hulumtimit, detyrat e hulumtimit, zbatimi i anketimit, hipoteza e përgjithshme dhe ndihmëse, variablat e hulumtimit, metodat, teknikat dhe instrumentet e hulumtimit, populacioni dhe mostra dhe interpretimi i të dhënave.

### III- Hulumtimi empirik

Në pjesën e III-Hulumtimi empirik, ofrohen sqarime për realizimin e hulumtimit në institucionet relevante të qytetit të Gostivarit sipas procesit në vijim, paraqitja e të dhënave dytësore dhe të dhënave parësore nga zbatimi i anketimit, gjetjet dhe analiza e tyre, përfundimet dhe rekomandimet.

## KREU I

### 1. VLERA E GJUHËVE

#### 1. 1. Vlera e gjuhëve si mjet komunikimi

Gjuhët kanë lindur me paraqitjen e vet njeriut, gjatë procesit të krijimit të shoqërive njerëzore, me anë të të menduarit të njerëzve dhe me dëshirën për t'i kumtuar mendimet e të tjerëve. Ky proces është bërë përmes aktivizimit të gjuhës në aktin e të folurit. Gjuha është mjet shprehës i *identitetit vetjak të folësit*, por ajo shpreh *edhe identitetin kolektiv të një grupi të njerëzve*, që e flasin atë gjuhë.

Gjuhët janë krijuar nga njerëzit për të treguar çdo gjë, që është perceptuar, është imagjinuar dhe është përjetuar gjatë punës së tyre individuale në çdo vend dhe në çdo kohë. Gjuhët u krijuan për nevojat jetësore të njerëzve, për t'i emërtuar sendet, për t'i treguar karakteristikat e tyre, për t'i treguar veprimet e tyre, për t'i treguar kohët, për t'i sqaruar ndryshimet, për t'i treguar emocionet, për të shprehur ide, për t'i treguar përvojat e mjeshtërise, për tu dhënë këshilla të rinxje etj.

Gjuha si mjet komunikimi përfaqëson tërësinë e mjeteve shprehëse gjuhësore, që i përdor një bashkësi gjuhësore në një bashkësi shoqërore përmes komunikuar me të tjerë sipas normave të saja. Gjuha është mjet shprehës i përsosur dhe i pavdekshëm, që mbartet me anë të *shkrimeve të ndryshme nga poetë, nga shkrimtarë, nga shkencëtarë, nga politikanë etj*. Gjuha përmes veprave arrin në çdo vend të botës, në duart e secilit njeri dhe depërton në mendjen e secilit.

Gjuha vitalitetin e saj e gjen në komunikimin në mes folësve të grupit të vet ose të gupeve të përziera, që jetojnë në bashkësi shoqërore multikulturore. Gjuhët janë përcjellë prej brezi në brez, mirëpo ndonjë gjuhë është zhdukur dhe nuk flitet më, për shkak se nuk është folur nga folësit e vet. Çdo gjuhë është pjesë përbërëse *identifikuese e kulturës së saj* dhe ka vlerën e vet, prandaj duhet të flitet nga folësit e vet ose nga folës të tjerë për ta ruajtur *gjallërinë dhe vlerën e vet*.

Gjuha në vazhdimësi ka qenë në varshmëri nga mbështetja institucionale e politikave arsimore, por edhe nga perceptimet individuale të njerëzve si “*gjuhë e mirë*” dhe “*gjuhë e keqe*”, “*gjuhë e dëmshme*” ose “*gjuhë e dobishme*”. *Të gjithë gjuhët janë të vlefshme dhe me vlerë përfituese për njerëzit, prandaj njerëzit duhet të vetëdijesohen dhe vullnetarisht të mësojnë më tepër gjuhë, sidomos gjuhët e vendit, që vazhdimisht i perceptojnë në mënyra të ndryshme në çdo hapësirë dhe i përjetojnë individualisht në çdo kohë.*

### 1.1.2. Gjuha si mjet individual dhe shoqërorë


Gjuha është mjet substancial individual (vetjak) dhe kolektiv (shoqërorë). Gjuha është material i qëndrueshëm në kognitiven e individit, që vetaktualizohet përmes aktit e të folurit në përshtatshmëri me situatat komunikuese. Ajo është edhe *mjet kumtimi i opinioneve individuale të folësve* për dhënie të informacioneve motivuese në drejtim të bashkëbiseduesit me qëllim nxitës për vetaktualizimin e tij në komunikim.

Gjuha është mjet gjuhësor statik (sinkronik) individual i folësit e akumuluar në memorie të folësit, që vetaktualizohet *në procese gjuhësore të vullnetshëm ose në akte të ligjërimit* për riprodhimin e thënieve kuptimplota për të realizuar komunikimin shoqëror. Ky proces gjuhësor që mund të jetë *dinamik ose funksional individual dhe social*, është i njohur si *Dikotomia Sosyriane*. Tiparet e gjuhës janë:

- Çdo gjuhë është *substancë gjuhësore statike* (sinkronike) me *sistem shenjash dhe konceptesh*, çdo gjuhë *memorizohet dhe qëndron pasive* në kognitiven e folësve, çdo gjuhë është *dukuri shoqërore e krijuar për nevojat e njerëzve*, çdo gjuhë e ka *formën e saj dalluese nga gjuhët tjera*, çdo gjuhë *kapet vetëm në sinkroni dhe i ka normat e saja*.
- Çdo gjuhë *aktivizohet* *në procese dinamike (diakronike)* ose *akte gjuhësore* të *ligjerimit* për të *realizuar funksionet e veta*: çdo gjuhë (*kod*) aktualizohet nga *folësi sipas nevojës aktuale komunikuese*, fillohet me aktin e ligjërimit, me *organizimin e shenjave* në *frazë gjuhësore*, ku *substanca gjuhësore* vihet *në lëvizshmëri* *sipas situatës komunikuese*. (Shkurtaj 2009:261; Rrokaj 2000:67). Komunikimi gjuhësor është kombinim kompleks i shumë faktorëve dhe mund ta paraqesim me shumën e faktorëve në vijim:

Komunikimi gjuhësor = Gjuha (substancë gjuhësore) + Ligjërimi (akt gjuhësor pragmatik) + Situata komunikuese (zyrtare ose jozyrtare) + Konteksti referues (tema e bisedës) +

Identiteti shoqëror i folësit dhe bashkëfolësít



**Figura1. 1. 2. Zbatimi i Dikotomisë Sosyriane (gjuhës dhe ligjërimit) në komunikim shoqëror është në varshmëri nga faktorët jashtëgjuhësorë**

Gjuha sipas përvojave të ligjërimit, përpunohet në tri akte, edhe atë:

- *Akti lokutiv* (në norma gjuhësore)
- *Akti ilokutiv* (në përbajtjen e thënies ose çfarë thuhet?)
- *Akti perlokutiv* (akti i ligjërimit në përshtatshmëri me situatën, kontekstin dhe bashkëfolësin). (Rrokaj 2000: 46 ).

### 1.1.3. Tipat dhe llojet e komunikimit

Gjuha aktualizohet në proces të aktit të komunikimit nëpërmjet tre tipeve të komunikimit:

- *Intrapersonal* ( gjuha e folësit përfaqëson vetveten),
- *Interpersonal* (në mes dy individëve),
- *Komunikim në grup* (në familje ose shoqëri). ( Poloska, 2007:53).

Gjuha në komunikimit bisedor ose referuese përdoret në tri lloje funksionesh njëkohësisht:

- *Funksioni ekspresiv* (gjuha përdoret nga folësi për të reflektuar vetveten, personaliteti i tij)
- *Funksioni apelativ* (gjuha përdoret nga folësi për t'u kuptuar nga marrësi i mesazhit)
- *Funksioni reprezentativ* (gjuha strukturohet në thënie pragmatike).( Poloska, 2002:161).

Në bazë të thënieve të lartëpërmenduara te folësit plurilingual përdorimi i gjuhës së nevojshme për aktin e komunikimit ose Dikotomia Sosyriane është në varshmëri nga faktorët jashtëgjuhësore, ashtu që vërtaktualizohet në akte të komunikimit pragmatike të folësit ajo gjuhë, që është në përshtatshmëri me situatën e komunikimit, kontekstit referues dhe identitetit shoqëror të folësit me atë të bashkëfolësit.

Gjuha në aktin e komunikimit funksional aktivizohen elementet në vijim	Gjuha aktivizohet në komunikim në varshmëri nga faktorët jashtëgjuhësore
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Dërguesi i mesazhit</i> (folës ose shkrues);</li> <li>• <i>Kodi</i> në komunikim (gjuha e përdorur);</li> <li>• <i>Mesazhi</i> (shkëmbim i fjalive të qarta në mes bashkëbiseduesve);</li> <li>• <i>Konteksti</i> (tema, për të cilën flitet);</li> <li>• <i>Situata</i> (biseda zyrtare ose jozyrtare e bashkëbiseduesve dhe vendi, larg ose afër);</li> <li>• <i>Kanali</i> (mjeti, me të cilin realizohet komunikimi me gojë ose me shkrim);</li> <li>• <i>Dekodimi i mesazhit nga pranuesi</i>. (Poloska, 2007:53; Poloska, 2002:138; Poloska, 2001:119; Rrokaj, 2000:48)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Mjedisi fizik</i> (zyrë, shtëpi, ndërmarrje, shitore etj.)</li> <li>• <i>Faktorë jashtëgjuhësorë të ndërveprimit midis njerëzve gjatë aktit gjuhësor nga pjesëmarrësit në bisedë(seksi,mosha,profesioni,pozita:udhëheqës-vartës).</i></li> <li>• <i>Konteksti</i> (akti gjuhësor, tema, mesazhi, funksionet e ndërveprimit</li> <li>• <i>Situata</i> (respekti, familjariteti, nënolerësimi, lakmia për karrierë, dëshira për prestigj, etj.)</li> <li>• <i>Forma e komunikimit</i>(me gojë apo me shkrim)</li> <li>• <i>Statusi i folësit dhe bashkëfolësit, identiteti shoqëror</i> i të dyve. (Shkurtaj, 2009: 275).</li> </ul>

**Tabela 1.1.3.** Tabelë krahasimtare e funksionimit të gjuhës në akte komunikuese sipas teorive të gjuhëtarëve dhe sociolinguistëve

### 1.1.4. Gjuhët si mjet thelbësore i komunikimit shoqëror

Gjuhët vlerën sociale e arrijnë me anë të funksionalitetit të tyre, që e shprehin në çdo aktivitet të njerëzve si në mjediset familjare, ashtu edhe në veprimitari të ndryshme shoqërore, *publike ose private*. Gjuha si element social funksional është i përbërë nga një sistem i ndërlikuar mjetesh komunikative, që përdoren në kolektive të dhënë për të gjithë format e komunikimit. (Ibrahim, 2012:99).

Fjala komunikim rrjedh nga latinishtja e vjetër ose mbiemri “Communicativus”, që në shqip ka domethënien “ i përshtatshëm për deklaratat, për ligjërimet”. Më vonë kjo fjalë përdoret edhe në gjuhën frëngje si “comunicatif”, që më vitin 1282 pohohet se kjo fjalë është me orgjinë latine. Le Robert (1998:8) dëshmon se në një botim të vitit 1370, qysh në atë kohë, fjala komunikim është përcaktuar si mjet i parapëlqyer për krijimin e marrëdhënieve shoqërore. (Shkurtaj, 2009:99). Në librin e latinishtes (Batosava dhe Çadikovska, 2000:154) fjala latine “commodus” është e sqaruar në shqip si mbiemr “i përshtatshëm”, “i qëlluar”, kurse fjala “communis” në shqip do të thotë “i përbashkët ose shoqëror”.

Komunikimi shoqëror është akt gjuhësor individual dhe kolektiv i individëve. Gjuha me përbërësit e saj ( fjalët, togfjalëshat dhe fjalitë) dhe elementet jogjuhësore ( gjeste, mimika, britma etj.), vetaktualizohet në proces gjuhësorë nga folësi dhe orientohet qëllimisht në drejtim pragmatik drejt bashkëfolësit për të realizuar *një akt komunikimi të qëllimshëm* dhe për ta nxitur bashkëbiseduesin të reagojë me aktin e të folurit me kthimin e mesazhit të tij në drejtim të folësit. (Shkurtaj, 2009:100). Sipas Shkurtaj, komunikimi shoqëror realizohet me qëllim të:

- *shkëmbimit të informacioneve, përshëndetjeve, falënderimeve, mesazheve...;*
- *dhënes së informacioneve të reja në drejtim pragmatik drejt bashkëfolësve;*
- *krijimit të marrëdhënieve shoqërore të mira ose sjellje qytetëruese në mes njerëzve.*

## 1.2. Përdorimi i gjuhës në komunikimin shoqëror

Sferat shoqërore janë mjeshtëse pune, ku individi e zhvillon veten duke krijuar përvojë vetjake dhe duke kontribuar për të mirën e vetes dhe të tjerëve në shoqëri. Ato janë mjeshtëse pune publike, fetare, familjare, miqësore, profesionale, ku zhvillohen komunikime shoqërore të individëve me ndërveprime të roleve sipas statuseve të ndryshme. (Shkurtaj, 2009: 135).

Sjellja gjuhësore është veprim dhe reagim gjuhësor verbal ose me shkrim të individëve, që buron nga sjellja shoqërore, duke e pasqyruar atë. (Shkurtaj, 2009:23). Sjellja gjuhësore e folësit plurilingual në aktin i komunikimit orientohet sipas nevojës së përdorimit të gjuhës në sferën shoqërore, që është në varshmëri nga faktorët jashtëgjuhësorë nga vendi (mjeshti fizik), situata e aktit komunikues, kontekstit (qëllimi ndaj objektit të bisedës) dhe ndërvepruesit në komunikim ose identitetit shoqëror të bashkëbiseduesve (seksit, moshës, profesionit, pozitës) ose sipas marrëdhënieve të varësisë së individëve (udhëheqës-vartës, i arsimuar - i paarsimuar, i rritur –fëmijë).

### 1.2.1. Rregullat dhe veprimet gjatë komunikimit shoqëror

Në çdo sferë shoqërore ekzistojnë rregulla të caktuar, që disiplinojnë marrëdhëniet e njerëzve sipas statusit dhe rolit përkatës. (Shkurtaj, 2009: 135), Goodenough (1565:5-7).

Për realizimin e detyrave të folësit në përzgjedhjen e identiteteve (roleve) shoqërore gjatë komunikimi shoqëror përcaktohen tre veprime:

- *Përndarja e ndërsjellë e identiteteve sociale në lidhje me rolin.*
- *Lidhja e roleve me çastin ose veprimtarinë.*
- *Përputhja e rolit me karakteristikat e një personi social koherent. (shih: Shkurtaj, 2009:132).*

Gumprez (1966) dallon dy lloje të ndërveprimeve gjuhësore:

- *Personale* (situata gjuhësore formale ose gjuha profesionale e sferave shoqërore);
- *Transaksionale* (situata gjuhësore joformale në komunikim familjar në varietete). (shih: Shkurtaj, 2009:300).

*Identiteti shoqëror i folësit* është reflektim i sjelljes gjuhësore të individit në varshmëri nga ndërveprimi i *statusit dhe rolit*, që gjëzon anëtari i strukturës së grüpuit shoqëror në bashkësinë shoqërore. Identiteti shoqëror i folësit e obligon individin, që komunikimi shoqëror (në familje dhe shoqëri) të sillet me përgjegjshmëri ndaj përgjegjësisë së përcaktuar në bazë të statusit të vet dhe statusit të njerëzve të tjerë. Prandaj ai në komunikim shoqëror vazhdimesht duhet të jetë pragmatik.

Statusi është aspekti pozicional shoqëror i individit ose grupeve të individëve në strukturën sociale ose në tërësinë e të mirave dhe cilësive, që u mundësohen atyre nga organizimi shoqëror i dhënë sipas atij pozicioni. Vlerësimi subjektiv i pozicioneve në një sistem shtresimi social, që lidhet me pozicionin e vet në hierarkinë e statuseve (të prestigjit). Statusi përfshin *ndërgjegjen subjektive të vlerësimit vetjak, në mbështetje të organizimit objektiv të detyrimeve dhe privilegjeve*, të cilat në raste të shumta garantohen nga ligji dhe shteti. (Marshall, 2014:403).

*Roli* është aspekti dinamik i *statusit social*, që reflektohet me tërësinë e sjelljeve të shfaqura nga ana e anëtarëve të bashkësisë shoqërore lidhur me një pozicion të dhënë. (Shkurtaj 2009:128). Përdorimi i gjuhëve gjatë të folurit në vazhdimësi ndryshohet nga një folës plurilingual i njëjtë në përshtatshmëri të situatave komunikuese në çdo veprimtar si “*ekologji gjuhësore*” sipas Shkurtaj (2009: 65) ose “*relativiteti gjuhësor*” i Worfit (1940). Statusi i mirë ose “*rangu me prestigj*” i nxit individët në konkurrencë për përparim, por edhe në konflikt.

Përdorimi i gjuhës në komunikimet shoqërore është në varshmëri nga *identiteti i folësit dhe bashkëfolësit, ku ndërlidhen rolet e tyre*. Në bazë të *statusit vepruar* të tyre në shoqëri, të gjithë individët, që veprojnë në sfera shoqërore janë edhe anëtarë të familjeve, prandaj reflektohen edhe me identitetet shoqërore të ndryshme. Këto identitetet mund të reflektohen në mëdis institucional ose familjar, me çiftëzimin e roleve në përdorimin e gjuhës ose “*person social i veshur me role të ndryshme*”. ( Shkurtaj 2009:132).

- Shfaqja e identitetit shoqëror të folësit nuk e ka çdoherë të njëjtën formë, por është i kushtëzuar nga faktorët jashtëgjuhësorë nga *roli funksional i statusit si rasti* (përse flet), *konteksti* (për çfarë flet), *moshën (me kë flet)*, *gjininë (kujt i drejtohet)*, *kohën (kur kryhet komunikimi)* dhe *vendi* (ku ai flet në institucion ose në familje). Identitetet shoqërore të një individi sipas Shkurtaj (2009:128) klasifikohen si:
- *identitet shoqërore institucionale ose i fituar* (i mjekut, i udhëheqësit, i profesorit, i burrit) p.sh. mjek-mjek, mjek-pacient, mjek-infermieri; burrë-grua, burrë-djalë etj.)
- *identitet shoqëror familjar të parashikuar* (i babit, i djalit të madh,..etj).

### **1.2.2. Rregullat e interpretimit komunikues**

Rregullat e interpretimit komunikues kategorizohen si:

- *Rregulla e koherencës shprehet me përdorimin e gjuhës në role sipas lidhjes kategoriale sipas statusit të folësit me një bashkëfolës ose grup folësish të një bashkësie shoqërore ose tërësisë së përkatësisë p.sh. Familja (babai/nëna, bir/bijë); Profesioni (mjeku,..); Besimi fetar (mysliman..); Parti politike (socialist.); Kombësia (shqiptar..); Gjuha (shqipe..)etj.*
- *Rregulla e ekonomisë* është përdorimi i gjuhës në komunikim sipas kategorizimit të anëtarëve, sipas një kategorie të thjeshtë të grupimit shoqëror, kur një fjalë e vetme mund të merret si referim për një person të caktuar. (Saks, 1972a:34)., p.sh. *kur e dëgjojmë fjalën edukatore na kujtohet fjala fëmijë, fjalën nxënës na kujtohet fjala mësues, burrë-grua, i fejuar e fejuara.* (Shkurtaj, 2009:132).

## KREU II

### 2. ORGJINA E GJUHËVE DHE ZHVILLIMI I TYRE

#### 2.1. Vlerësime teorike për origjinën e gjuhëve

Teoritë filozofike dhe antropologjike paraqitjen e gjuhës e konsiderojnë si faktor i nevojshëm për plotësimin e nevojave të njerëzve për të mbijetuar sfidat jetësore me komunikim të ndërsjellë. Antropologët për dallim nga gjuhëtarët, por ngashëm me sociolinguistët të folurit e gjuhëve kurrë nuk e kanë konceptuar të shkëputur nga jeta shoqërore e kulturore, por e kanë ngulmuar ndërvarësinë e tij me strukturat shoqërore dhe kulturore. Për përdorimin e gjuhëve sipas roleve funksionale dallohen dy dukuri (Shkurtaj, 2009:53):

- Gjuhët e njëjta përdoren në role funksionale, në bashkësi ose shtete të ndryshme;
- Gjuhët e ndryshme përdoren në role funksionale në bashkësi të njëjtë ose në një shtet.

Në periudha të lashta, gjuha është bërë objekt studimi i çdo populli dhe në atë periudhë janë krijuar mite dhe legjenda të ndryshme për të. (Ibrahim 2012 :31; Poloska, 2001: 9). Gjuha është konsideruar si një dhuratë nga fuqitë e mbinatyrrshme ose si një kriesë e njerëzve të ditur, që detyrë e kanë pasur t'i krijonin fjalët. Origjina e gjuhës trajtohet në fillim në Lindjen e Afërt të Egjiptit, e më vonë në Greqinë e vjetër, ku gjuha është trajtuar nga dy ide kundërthënëse:


- *Objekt studimi i idesë së materializimit* (nga aktiviteti njerëzor dhe nevoja për të komunikuar);
- *Objekt studimi i idesë së idealizmit* (fuqi hyjnore-pikëpamje pagane).

Në Greqinë e vjetër zhvillohen debate midis filozofëve të Greqisë Antike me *pikëpamje materialiste* dhe *me pikëpamje idealiste*, të cilët janë përpjekur të jalin sqarime për emërtimin e sendeve, pse e kanë atë emër dhe nuk kanë ndonjë emër tjetër? Filozofët materialist kanë pohuar se emërtimi i sendeve është përcaktuar nga vullneti i njerëzve (*teoria thesis*), ndërsa filozofët idealistë kanë pohuar se emërtimet e sendeve janë përcaktuar nga natyra, që i jepen njeriut nga lart, nga një fuqi hyjnore (*teoria phusei*). (Poloska, 2001: 10).

Demokriti, filozof me pikëpamje materialiste, kundërshtoi pikëpamjet *idealiste* se emërtimet e sendeve i përcaktonte natyra me “fuqitë hyjnore” duke thënë se atëherë në të gjithë gjuhët sendet e njëjta do të kishin emërtime të njëjta. Lukreci, filozof i Romës me pikëpamje materialiste për emërtimin e sendeve u shpreh “*Utilitas expresit nomin rerum*”, që në shqip domethënë “*Nevoja u vuri emrat sendeve*”. (Poloska, 2001: 11).]

Nevojat e njerëzve sipas Maslov (1970) klasifikohen në pesë kategori themelore:

- *nevojat fiziologjike* (për të emërtuar nevojat fiziologjike ujë, ushqim);
- *nevojat për siguri* (mbrojtje, stabilitet, liria nga frika dhe ankthi, siguria nga varësia);
- *nevojat e përkatësisë dhe dashurisë* (nevoja sociale për t'u shoqërizuar me të tjerë, nevoja personale se i takon një grupei të caktuar siç është familja, fisi, bashkësia gjuhësore etj.).
- *nevojat për vlerësim* (nevoja për respektë *është nevoja e nivelit të lartë psikik*, që shpreh konsideratë në raporte të mendimit të subjektit për vjetvete dhe mendimin e të tjerëve përseset dhe vlerat e subjektit, nevoja për të vënë në shprehje vlerat e respektit të ndërsjellë);
- *nevojat për vetaktualizim* (*nevoja për vetaktualizim* *është shkallë më e lartë e hierarkisë* së nevojave, kur individi arrin të vetëdijesohet për potencialet e veta dhe reflektohet në moshën e pjekurisë). (Zajazi, 2003 :754; Jovanoski, 2000:56).



**Figura 2.1.** Nevojat e njerëzve të klasifikuara nga Maslov (1970) në hierarki

Në shekullin XX-të u shfaq mendimi se gjuha lind nga gjestet me “Teorinë e gjesteve” (Haideri, Vundi Ginekeni, dhe Marri ), por kjo teori nuk u mbështet nga shkencëtarë tjerë, për shkak se gjestet nuk emërtojnë sende dhe nuk mund të shprehin nocione. Gjuhët çdo herë kanë qenë dhe ende janë objekt konceptimi edhe i mjeteve jogjuhësore (*kod i shkallës së dytë*): të lëvizjeve trupore (gjestet, mimikat) dhe të gjuhës emocionale (qarje, qeshje, dhimbje, etj.). (Poloska, 2001: 11; Rrokaj, 2010:10).

Në gjysmën e dytë të shekullit XX-të u paraqit shkenca e sociolinguistikës, si kërkim ndërdisiplinor, që gjuhët i studion si *mjete thelbësore funksionale ndërlidhëse* i të folurit të njerëzve dhe shoqërisë për komunikime në bashkësi shoqërore. Sociolinguistika është disiplinë gjuhësore, që ka si objekt studimi bashkëlarminë sistematike të strukturave gjuhësore dhe strukturave shoqërore në varshmëri nga katër variabilitet kryesore: hapësirës, kohës, shtresave të ndryshme shoqërore dhe situatave konkrete. (Shkurtaj, 2009:18-21).

## 2. 2. Ekspansioni gjuhësor

*Ekspansioni gjuhësor* konsiderohet dukuria e procesit të përhapjes së gjuhëve, ku një gjuhë ose varietet gjuhësorë (gjuhë) synon zgjerimin e fushës së funksioneve shoqërore dhe vazhdimesht bëhet në dëm të një varieteti tjeter, me qëllim të lindjes së situatave të diglosisë ose dygjuhësisë për të ndryshuar natyrën e gjuhës. (Rrokaj 2000:149) theksoi disa faktorë të ekspansionit gjuhësorë:

- *Faktori gjuhësor* (ndodh në gjuhët me afri gjenetike me reflektim të vogël ndjeshmërie);
- *Faktori ekonomik* (përhapjen e gjuhës në komunikimin gjithëpërfshirës, si anglishtja);
- *Faktori i politikës ndërkombëtare* (interesimi aktual për anglishten dhe gjermanishten në Evropë);
- *Faktori i politikës së brendshme të shteteve* (mbështetja institucionale të gjuhëve të vendit);
- *Faktori psikologjik e sociologjik* (marrëdhëniet historike-kulturore të popujve në konflikt).
- *Faktori demografik* (lëvizjen e njerëzve për arsyen ekonomike, politike, fetare apo pushtuese).

Ekspansioni gjuhësor shkaktohet sipas mënyrave në vijim:

- *Migrimi i njerëzve* (emigrimet, kolonizimet, etj.) dhe lëvizja e produkteve (të administrimit, të konsumit, të teknologjisë);
- *Varietete legitime* (përhapja lirë e produkteve), kurse jolegitime (zhvendosja e njerëzve);
- *Përkoħshméri gjuhësore përmes ekspansionit* (përdorimi i pérkohshém i varieteteve gjuhësore).

Gjatë ekspansionit dallohen katër dukuri kryesore:

- *Ngulitja* (kur një gjuhë mbizotëron në një hapësirë të rëndësishme, ku bëhet gjuhë e parë (amtare) e folësve vendas p.sh. *anglishtja* në SHBA, portugalishtja në Brazil etj.);
- *Importimi* (kur një gjuhë përhapet në një territor tjeter dhe krijon “ishuj gjuhësorë” diglosia);
- *Mbishtresimi* (përdorimi i një gjuhe tjeter në shtet tjeter si gjuhë standarde dominuese, duke shkaktuar diglosi në gjuhën tjeter p. sh. si *frëngjishtja*, *anglishtja*, *portugalishtja* në vende të Afrikës ose *sllavishtja* apo *turqishtja* në gjuhët e Ballkanit);
- *Rrezatimi* (kur një gjuhë përhapet në shumë territorë tjetra dhe *përdoret me vullnet dhe kënaqësi nga folësit e huaj*, por jo si gjuhë zyrtare).

Multilinguizmi dhe diglosia krijohen nga kontaktet midis gjuhëve duke krijuar shtresime kolektive, që ndikojnë në ndryshimin e sistemit të gjuhëve vendase.

## 2.3. Shtresimet dhe kryqëzimet e gjuhëve

Zhvillimi i gjuhëve është kushtëzuar nga dy probleme:

- 1) *Ndryshimet shoqërore,*
- 2) *Kontaktet midis gjuhëve.*

Gjuhët kanë reflektuar dy forma të kryqëzimeve të gjuhëve:

- *Margjinalë*, kryqëzim i gjuhëve fqinje në territorë të veçanta,
- *Brenda territoriale*, kryqëzim të gjuhëve ku njëra gjuhë është dominuese. (Rrokaj, 2000:153:161).

Kryqëzimet e gjuhëve kanë shkaktuar dukuri gjuhësore të ndryshme:

- *Substrat* ( gjurmët e gjuhës vendase reflektohen në gjuhën e ardhësve).
- *Superstrat* ( ku gjurmët e gjuhës së pushtuesve reflektohen në gjuhën e vendasve).
- *Adstrat* (*kur dy gjuhë me raport paralel me status institucional të barabartë*).

Gjuhët kanë status dhe mund të jenë :

- *Gjuhë të privilegjuara me status zyrtar.*
- *Gjuhë të paprivilegjuara pa status zyrtar.*

Zhvillimi i gjuhëve arrihet me ekspozimin e tyre në kontekste dhe mënyra të ndryshme:

- *Konteksti referues*, përdorimi i gjuhës në komunikim pragmatik me bashkëfolësin;
- *Konteksti instrumental, përdorimi i gjuhëve në mjetet e komunikimit masiv* (televizioni, celulari, kompjuteri me rrjetin e internetit) mundësan zhvillimin e gjuhëve me transmetimin e informacioneve në disa gjuhë, në çdo vend të botës);
- *Konteksti shoqëror është ngritja e vetëdijes së individëve për vlerat e edukimit plurilingual*, që mundëson përparim më të shpejt në çdo fushë jetësore.

Gjuhët përdoren në dy mënyra nga folësit e vet dhe të tjerë:

- *në afërsi,*
- *në largësi.*

Çdo gjuhë mund të përhapet në çdo vend në dy forma:

- *verbale,*
- *grafike.*

Gjuhët përdoren ndaj individëve të tjerë me solidaritet dhe pushtet:

- *Solidariteti i gjuhës* reflektohet me respektin e folësit ndaj bashkëfolësit në rapport afërsie ose miqësie, p.sh. i dashur, oj motër, o shok, me përshëndetje “tungjatjeta”.
- *Pushteti i gjuhës* reflektohet me respektin e folësit, kur i drejtohet një personi të respektueshëm ose pushtetmbajtës. p.sh. zotëri, më falni. (Hudson 2002: 127).

## 2.4. Vitaliteti i gjuhës dhe llojet e gjuhëve

Çdo gjuhë vlerësohet dhe çmohet nga folësit e bashkësisë së vet gjuhësore dhe të tjerëve. Gjuha dhe të folurit kanë funksion social, qoftë si mjet komunikimi në mes njerëzve, qoftë edhe si mënyrë identifikimi i grupeve sociale ose bashkësive gjuhësore. Gjuha dhe të folurit janë mënyra e vepruarit me vlerë aktive në shoqëri, që ndikon për të ndryshuar diçka.

Gjuha është *përfaqësuese e identitetit kulturor* dhe mjet funksional i grupeve të njerëzve, që duhet zhvilluar e kontrolluar për të bërë edhe ndryshime pozitive në shoqëri, mirëpo nëse zhvillimi dhe kontrollimi i asaj pengohet ajo mund të zhduket bashkë me *identitetin kulturor të saj*. (Shkurtaj, 2009:27). Vitaliteti i gjuhës arrihet me të folurit nga folësit e vet ose folësit shumëgjuhësorë të tjerë në komunikime shoqërore të ndryshme, që ndikojnë edhe në përcjelljen e saj prej një brezi në brez. Ato mund të jenë:

- *Gjuhë të vdekura* janë gjuhët, që janë folur më parë, por gjatë zhvillimit të shoqërisë njerëzore janë ndërprenë së foluri dhe janë zhdukur. Tani njihen si *gjuhë të vdekura*.
- *Gjuhë të gjalla* janë gjuhët, që fliten nga folësit e vet si gjuhë natyrale (kombëtare).
- *Gjuhë artificiale* janë gjuhët specifike, që janë krijuar qëllimisht për komunikim ndërkombëtar, prej të cilave dallohen gjuha *esperanto* dhe *volapuk*. (Ibrahim, 2012:31).
- *Gjuhë standarde* janë gjuhët e krijuara sipas normave standarde dhe janë unike për folësit e vet.

Vitaliteti i gjuhës varet nga:

- *Variabla demografike* (rritura dhe rënia e numrit të anëtarëve të grupit të vet).
- *Variabla pozicionale* (statusi i gjuhës me prestigj, dominimi ekonomik dhe politik i bashkësisë gjuhësore dhe historia e saj).
- *Mbështetja institucionale* (gjuhët në media, arsim, administratë, kulturë).

## KREU III

### 3. DIVERSITETI LINGUISTIK

#### 3.1. Diversiteti linguistik ose variacioni gjuhësor në botë

Diversiteti linguistik paraqet shumëlojshmérinë e gjuhëve të përdoruara nga disa bashkësi njerëzish, që jetojnë në territorë të caktuara, në kohë të caktuara duke bashkëvepruar në raporte të caktuara në komunikime shoqërore të ndryshme. Rol të rëndësishëm për zhvillimin e gjuhëve luajnë faktorët e jashtëm si dhe rrëthanat, ku ato përdoren, në cilën kohë përdoren dhe si përdoren. Diversiteti linguistik në botë reflektohet me rreth 6000-7000 gjuhë në botë, të folura nga 7 miliardë njerëz në 189 shtete të pavarura, të klasifikuara në 12 familje gjuhësore. Çdo gjuhë përmban rreth 50 000 fjalë në fjalorët e vet, por në biseda të përditshme njerëzit përdorin vetëm qindra fjalë.

Në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian janë 24 gjuhë zyrtare, por si gjuhë pune në përditshmëri përdoren brenda institucioneve vetëm tri gjuhë: anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht. Gjuhë më e përhapur në çdo vend është anglishtja, gjuha amtare më e folur në BE është gjermanishtja, por frëngjishtja është gjuhë zyrtare në tri qytetet, ku ndodhen institucionet politike të BE-së: Bruksel(Belgikë), Stasburg (Francë), Luksenburg (Luksenburg). Nga të dhënat vërehet se në BE për komunikim përdoren gjuhët e kontaktit. (<https://sq.wikipedia.org/wiki/25.03.2017>).

Shprehja diversitet linguistik është e përbërë nga fjala latine “diversitet”, që në shqip do të thotë dallueshmëri, larmi, të përziera, diversitet, shumëlojshmëri dhe “fjala franceze “linguistique”, që do të thotë në shqip shkenca e gjuhës. Shkencë analitike e teorive të filologjisë, analizë e gjithanshme për të vërtetuar shkaqet e lidhjeve të gjuhëve dhe për të zbuluar ligjshmëritë e përgjithshme për zhvillimin e gjuhëve. (Vujaklia, 1972:222).

Variacionet gjuhësore janë dukuri gjuhësore, që reflektohen në proceset e të folurit si gjuhë ose kode gjuhësore të ndryshme dhe mund të jenë në takim të menjëhershëm me njëra tjetrën (kontakt imediat). Gjuhët e tjera me rrezatimin e vet kanë depërtuar në të folurit e vendave, ashtu që si ndërkombëtarizma reflektohen në të gjithë gjuhët tjera.

Në vijim ofrojmë sqarimin e dy shprehjeve gjuhësore, për të larguar konfuzionin për përdorimin e tyre. Shprehjet “diversiteti linguistik” dhe “variacione gjuhësore” të përdoruar nga gjuhëtarët dhe socilinguistët shqiptarë në forma gjuhësore të ndryshme në fakt janë sinonime, që kanë kuptim të njëjtë, të cilave në gjuhën shqipe u përshtatet shprehja “larmia e gjuhëve dhe larmia gjuhësore”.

Titulli i këtij punimi është i formuluar qëllimisht me ndërkombetarizma, për shkak se janë më të dëshiruara për të gjithë palët e shoqërive multikulturore. “*Diversiteti linguistik dhe edukimi plurilingual*”, që në shqip do të thotë “*Larmia e gjuhëve dhe edukimi shumëgjuhësorë* ( kultura ose sjellja shumëgjuhësore)”, por përsëri fjalët edukatë dhe kulturë janë ndërkombetarizma të vjetra të shtresuara në shqip. Në vijim japim sqarimin e fjalëve sipas fjalorëve të gjuhëve:

- Fjala “diversity” në fjalorin e gjuhës angleze do të thotë ndryshueshmëri, pangashmëri, larmi, shumëllojshmëri (Stefanlari, 1996:306; Dajkoviç, 1986:3838; Hysa, 2002).
- Fjala diversitet me prejardhje latine “diversitet” në shqip do të thotë dallueshmëri, larmi, diversitet, shumëllojshmëri. (Batosava dhe Çadikovska, 2000:173).
- Fjala “linguistic” në fjalorin e gjuhës angleze do të thotë gjuhësor. (Stefanlari, 1996:220).
- Fjala “lingua” në fjalorin e gjuhës latine do të thotë gjuhë. (Batosova 2000 :173).
- Fjala “varius” në fjalorin latinisht do të thotë i ndryshueshëm, larmi, (Batosova, 2000:173).

Gjuha kombëtare është sistem i përgjithshëm i ndërlikuar i të gjithë mjeteve komunikative, kurse dialektet dhe nënndarjet tjera si varietete janë vetëm një pjesë e sistemit gjuhësor kombëtar, që janë të dallueshme nga tre aspekte:

- *Në aspektin gjeografik dhe shoqëror* (Gjuha i takon gjithë territorit, ku vepron një popullnjë, komb).
- *Në aspektin funksional* (Gjuha ka funksione të shumta, kurse dialekti ka funksione të kufizuara).
- *Në aspektin strukturor* (Në dialekte apo varietete krahinore, ekzistojnë fjalë të veçanta, që s'përfshihen në gjuhën e shkrimit).

Në çdo gjuhë përjetohet një veprim i ndërsjellë midis dy forcave të kundërtë të varieteteve:

- *Forcat centrifuge* ( larmia- gjuha dialektore, nëndialektore dhe të folmet krahinore);
- *Forcat centripete* ( njësimi- gjuha standarde). (Rrokaj, 2000:135)

Larmia gjuhësore (variacioni gjuhësore) krijohet nga katër faktorë kryesorë:

- *Variacione të hapësirës* (varueshmëri diatopike ose topolektore)- vlerësimi i varietetit më të mirë të gjuhës të bazuar në hapësirë gjeografike dhe shoqërore p.sh. shqipja e Tiranës;
- *Variacione shoqërore* (varueshmëri diastratike) dominimin e gjuhës së privilegjuar;
- *Variacione kohore* (varueshmëri diakronike) varacione gjuhësore si pasojë historike;
- *Variacione të situatës* ( varacione të dalë nga situata konkrete).(Shkurtaj, 2009:68).

Çdo gjuhë është prodhim i shoqërisë, ku flitet dhe e njëjtë gjuhë është në gjendje të ndikojë mbi shoqerinë, që e lind. Raporti i gjuhëve me shoqerinë vërehet në 4 pikëlidhje:

- *Grupe të ndryshme shoqërore përdorin gjuhë (kode) ose varietete të ndryshme gjuhe.*
- *Përdorimi i gjuhës së njëjtë dhe varieteteve të sajë nga të njëjtët individ në situata të ndryshme.*
- *Gjuha është pasqyrim i shoqërisë, ku është përdorur.*
- *Gjuha është formuese e shoqërisë, ku është përdorur.* (Shkurtaj, 2009:68).

Në reflektimin e varacioneve gjuhësore ndikojnë shumë çështje:

- Situata e trysnisë shoqërore-politike me efekt modifikues mbi strukturat gjuhësore.
- Modifikimet gjuhësore përfshihen në vet rr Ethanat gjuhësore dhe jashtëgjuhësore.
- Kalimi nga një stad gjuhësore në një tjetër.
- Vlerësimi i varianeve gjuhësore nga pikëpamja e prestigjit. (Shkurtaj, 2009:68).

Variacionet mund të klasifikohen në pesë grupe:

1) *Varieteti i gjuhës standarde* (unike për të gjithë anëtarët e bashkësisë gjuhësore).

2) *Varietete funksionale-kontekstuale*, që janë të dy llojeve:

- *Varietete të nënkopit të gjuhës* janë funksionale në kontekste referenciale si gjuhë speciale apo gjuhë teknike-profesionale (gjuha e mjekësisë: diabet, pediatri, etj.).

- *Varietete të regjistrat të gjuhës* janë stile gjuhësore funksionale pragmatike të situatave kontekstuale: regjistri libror, regjistri i zakonshëm dhe regjistri familjar.

3) *Varietete gjeografike*:

- *Varieteti dialektor* (të folurit dialektor).
- *Varieteti nëndialektor* (të folurit nëndialektore).
- *Varieteti krahinor* (të folmet e vendeve të ndryshme).

4) *Varietete shoqërore ose sociolekti* (sjellja gjuhësore karakteristike e një grupi shoqëror të caktuar, përkatësisht i një kompetencë të një gru皮 shoqëror të caktuar):

- *Varieteti i gjuhës popullore* (gjuha e njerëzve të thjeshtë popullore e përditshme).
- *Varieteti i gjuhëve të fshehta* (të folme shoqërore apo argotë).

5) *Varieteti i ideolektit* reflektohet me sjellja gjuhësore individuale, që ndryshon nga një individ tek tjetri në bazë të faktorëve social, psikologjik dhe emocional, që shprehë si:

- *Variteti i intergjuhës ose ndërveprim gjuhësorë fillestar i folësit* në një gjuhe të re, që reflekton fjalë të padëgjuara më parë në atë gjuhë, përpjekja e tij për lidhshmëri të fjalëve në bazë të rregullave gramatikore të gjuhës të parë (GJ1).

- *Varieteti pas fossilizimit* të njërsës gjuhë (gjuha në heshtje) është periudha e ndërprerjes së përdorimit të njërsës gjuhë në ndonjë nga fazat e zhvillimit jetësor të individit.

- *Varieteti i lirë i gjuhës tek folësit fillestar* të gjuhës së re të huaj të papërvetësuar plotësisht si pasojë e faktorit social, kur folësi shpreh fjalë të reja të ndryshme nga ato të folësve të gjuhës amtare dhe bën përzierjen e fjalëve të dy gjuhëve.

- *Varieteti sistematik paraqitet tek folësi plurilingual*, kur ndodhet në situatë të re kontekstuale gjuhësore si pasojë e faktorit psikologjik-shoqëror, kur vëmendja e folësit përqendrohet në situatën komunikuese dhe në kohën e planifikuar me të shpejtuarit gjatë të folurit, që çdo gjë të flitet në kohë, qartë dhe saktë. Kjo dukuri paraqitet edhe si pasojë e faktorit emocional, kur folësi ndodhet në situatë të vështirë (para një provimi formal) me paraqitjen e ndryshimeve në përdorimin e theksit gjatë drejtshqiptimit dhe krijimit të fjalëve të reja aty për aty "ad hoc".

### 3.2. Krijimi i gjuhëve kombëtare standarde dhe mbrojtja e tyre

Gjuha kombëtare standarde ose gjuhë të përpunuar në bazë të normave standarde gjuhësore u krijuar si mjet për unifikimin e të folurit të folësve të një bashkësie gjuhësore, që në vazhdimësi të përhapet dhe institucionalizohet si gjuhë kombëtare e përbashkët për t'u folur edhe nga folës tjerë si gjuhë zyrtare. Formimi i gjuhëve unike standarde u mundëson të gjithë folësve të një kombi të komunikojnë në një varietet gjuhësor, qoftë në nivel territorial brendashtetëror ose jashtë territoreve të tij.

Disa gjuhë standarde edhe pse nuk kanë qenë gjuhë kombëtare të vendit, në shumë shtete janë bërë gjuhë zyrtare si gjuha angleze në disa vende të botës. Disa gjuhë të tjera standarde u shtresuan si superstrate mbi gjuhët vendase, pastaj u bënë gjuhë zyrtare. Gjuhët fitojnë edhe privilegji në bazë të përkatësisë kombëtare të një etniteti, i cili konsiderohet si më i privilegjuar se qeverisin me shtetin kombëtar, kurse shumica e folësve janë të detyruar të flasin në atë gjuhë zyrtare të përcaktuar në atë shtet dhe në atë vend, ku jeton. ( Ibrahimi, 2012 : 101; Shkurtaj, 2006 : 106; Hudson, 2002 : 44 ).

Gjuhët kombëtare standarde ose “*gjuhë të vërtete*” sipas Hudson (2002:43) janë ato, që ka kaluar nëpër procedurat vijuese:

- *Përzgjedha e një varietetit ose kombinim i varietetave për të kultivuar një gjuhë standarde.*
- *Kodifikimi i gjuhës kombëtare standarde* arrihet me përdorim e saj disa vite me radhë në çdo institucion shkollor për t'u përvetësuar nga të gjithë folësit në çdo vend.
- *Kultivimi i funksionimit të varietetit standard* arrihet me përdorim të varietetit në formë të folur ose shkruar në të gjitha funksionet e lidhura me qeverinë qendrore.
- *Pranimi i varietetit standard* arrihet, kur varieteti i zgjedhur pranohet nga popullsia si varieteti i vetëm i bashkësisë gjuhësore si forcë e fuqishme unifikuese të kombit.

Në çdo shtet ka komisione të përbërë nga anëtarë të specializuar për fushën e sociolinguistikës për mbrojtjen e gjuhës, që në kohë i vërejnë shmanget e folësve nga normat standarde dhe të merren masa mbrojtëse për ruajtjen e gjuhës. Kriteret për mbrojtjen e gjuhës, që u përcaktuan nga Jespersen (1970:83) :

- *Kriteri i autoritetit* vlerësim mbarëkombëtar për vlerën e gjuhës (gjuha angleze).
- *Kriteri gjeografik* bazohet në të folurit e gjuhës letrare sipas territoreve ku banojnë folësit.
- *Kriteri letrar* mbështetet në hartimin e veprave artistike të shkrimitarëve tanë të famshëm.
- *Kriteri klasor* përdorimi i gjuhës sipas pjesëtarëve të shtresave të ndryshme shoqërore.
- *Kriteri demokratik*, paraqet barazinë e vlerave gjuhësore ( mbrojtjen dhe zhvillimin e tyre).
- *Kriteri logjik* lidhet me lidhshmërinë e gjuhës në përshtatshmëri pragmatike komunikuese.
- *Kriteri psikologjik* perceptimi i një gjuhë të njëjtë me vlerësime të ndryshme si kod i kufizuar i klasës së ulët dhe kod i zhvilluar i klasës së mesme. (Ibrahimi, 2012 : 99).

### 3.3. Vizioni evropian për vlerën e diversitetit linguistik

Në Evropë reflektohen 225 gjuhë vendase, por ka edhe gjuhë joevropiane. Shumë shtete evropiane kanë një numër të caktuar gjuhësh rajonale ose minoritare, ku disa prej të cilave kanë marrë status zyrtar. Shumica e gjuhëve evropiane janë të tri grupeve të mëdha: gjermanike, romane dhe sllave, por në territorin Evropian sot fliten edhe shumë gjuhë joevropiane (gjuhët arabike, kineze dhe hindu). Vetëm në Londër fliten rreth 300 gjuhë joevropiane si pasojë e fluksit të madh të emigrantëve dhe refugjatëve. (<http://edl.ecml.at/2017>). Aktualisht edhe gjuha shqipe reflektohet në çdo vend evropian, për shkak se shqiptarë ka në çdo vend evropian.

Gjuha angleze luan rolin e “gjuhës së dytë amtare të folësve në botë” duke krijuar një lidhje në mes “globales” dhe “lokales” (Bugarski, 2009:16). Rrezatimi gjuhësor anglezo-amerikane në çdo vend të botës, nuk ndikon negativisht për t'u zhdukur kulturat rajonale dhe lokale, por ky rrezatim ndikon në ndërgjegjësimin për vlerat e kulturave vendase se janë dukuri shoqërore të globalizimit, ku shfaqet nevoja për të mësuarit e gjuhëve ose “Glokalizim”. (<http://www.dadalos.org/> 26.03.2015).

Vizioni i globalizimit pati si qëllim zhvillimet e shpejta ekonomike dhe politike, ku si objektiv kishte përcaktuar përhapjen e shpejt të *gjuhës angleze kudo në botë*. Kjo gjuhë, falë zhvillimit të teknologjisë së informacionit u bë shumë e famshme dhe e fuqishme në botë, u bë gjuha udhëheqëse në botë, që nga gjuhë ndërkombëtare u bë gjuhë globale. Mendohet se aktualisht në botë ka 3 herë më tepër njohës të gjuhës angleze joburimore prej atyre burimore. (Crystal,2003:69).

Folësit evropian të gjuhëve të ndryshme në fjalorin e tyre me vetëdëshirë përdorin shumë fjalë të gjuhës angleze, gjegjësisht ndërkombëtarizma angleze. Imazhi i saj botëror si përfaqësuese e kulturës së civilizimit njerëzor, eksposozhet në çdo vend. Kjo gjuhë është shumë e nevojshme për individin si nevojë për ta siguruar ekzistencën jetësore në çdo profesion, çdo vend dhe në çdo kohë, prandaj u bë gjuha më e dëshiruar për të gjithë njerëzit dhe i motivon të gjithë ta mësojnë me vullnet.

Këshilli i Evropës në Strasburg në vitin *26 shtator të vitit 2001* promovoi qëllimin e vet për vlerën e gjuhëve në tërë botën dhe për ruajtjen e vitaliteti gjuhësor të tyre. Aty u vendos “*26 shtatori-Dita Evropiane e Gjuhëve*” të njihet dhe të festohet nga të gjithë në botë. Qëllimi ishte se “*diversiteti gjuhësor është një mjet për të arritur mirëkuptime më të mëdha ndërkulturore dhe një element kyç në trashëgiminë e pasur kulturore të kontinentit tonë*.” ([www.ibp-kosovo.org/](http://www.ibp-kosovo.org/) parë më 19.02.2015).

Vizioni i ri për ruajtjen e vitalitetit gjuhësorë i të gjithë gjuhëve në çdo shtet të Evropës u miratua *nga Këshilli i Evropës më 2007 në Strasburg*, ku theksohet që Politika Sociale Evropiane të nxis zhvillimin e Politikës për Edukim Gjuhësor nga të gjithë shtetet evropiane. Qëllimi ishte ndryshimi i qëndrimit të tyre ndaj vlerësimit të perceptuarit e gjuhëve në bazë *të prestigjit* të gjuhës dominuese në një shtet.

Politikat e edukimit gjuhësorë në Evropë u ofrojnë mundësi të gjithë individëve të bëhen plurilingual me ruajtjen e plurilinguizmit zotërues me zhvillimin e bilinguizmit vendor, që shërben si material gjuhësor i gatshëm për zhvillimin e plurilinguizmit. Të gjithë politikat sociale të shteteve evropiane duhet të arrijnë realizimin e tri objektivave të edukimit gjuhësorë:

- *Politika sociale të nxisë zvogëlimin e diversitetit linguistik ose dallueshmërinë e gjuhëve*
- *Politika sociale të nxis promovimin e diversitetit kulturore dhe gjuhësore*
- *Politika sociale të nxis ruajtjen e vitalitetit gjuhësor të diversitetit si vlera shumë të vlefshme për të komunikuarit shoqëror në nivel lokal dhe universal.*([www.ibp-kosovo.org/](http://www.ibp-kosovo.org/) parë më 19.02.2015).

Në Konventën Kulturore Evropiane më 9 dhjetor 2014 në Bruksel, Këshilli i Gjuhëve Evropiane i Politikave Arsimore promovoi "studimin e gjuhëve, historisë dhe qytetërimit të vendeve të tjera evropiane". Qytetërimi është i përbashkët për të gjithë, prandaj duhet të zhvillohet duke i edukuar njerëzit t'i shkëmbejnë vlerat dhe identitetet kulturore mes njërit-tjetrit. Zhvillimi i diversitetit të gjuhëve përforcon besueshmërinë e ndërsjellë me bindjen ndaj përkatësisë së *identitetit Evropian*.

Në Konventën Kulturore Evropiane më 9 dhjetor 2014 në Bruksel u vendosën nga Këshilli i Gjuhëve Evropiane i Politikave Arsimore (K.G.J.E.P.A) këto objektiva:

- *Plurilingualizmi* të promovohet te të gjithë etnitetet për të zhvilluar të mësuarit e gjuhëve të nevojshme për të lehtësur të jetuarit e individëve në vendin e tyre.
- *Diversiteti gjuhësorë* evropian duhet të mbështet nga të gjitha politikat sociale, për shkak se të gjithë gjuhët e folura në Evropë janë të tërësisë evropiane dhe mbrohen me Konventat Kulturore Evropiane.
- *Mirëkuptimi i ndërsjellë* në të mësuarit e gjuhës së tjetrit është kusht thelbësor për komunikimin ndërkulturor dhe pranimin e dallimeve kulturore.
- *Pjesëmarrja* në shtet demokratik në proceset demokratike dhe sociale në shoqëri shumëgjuhëshe lehtësohet nga kompetenca shumëgjuhësore të individëve.
- *Barazia* në kohezionin social mundësi për zhvillim personal, arsimim, punësim, lëvizshmëri, qasje në informata dhe pasurimin kulturor me qasje në të mësuarit e gjuhës gjatë gjithë jetës. ([www.coe.int/t/dg4/linguistic/Division\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dg4/linguistic/Division_en.asp)/ parë më: 28.09.2015 dhe 16.03.2017).

Parlamenti Evropian më 2015 çështjen e të mësuarit të gjuhës së huaj *e vlerësoi si vlerë e nevojshme për të siguruar ekzistencën e jetës për çdo individ në Evropë, prandaj si strategji u miratua "Agjenda për aftësitë e reja dhe punësimin", ndërsa me moton "Rinia për lëvizje" rininë e identifikoi si prioritet për gjuhën dhe shumëgjuhësinë.* (<http://eurospeak.al/sociale/312-politikat-gjuhesore/> 2015).

*Strategjia "Edukimi dhe trajnimi 2020",* të mësuarit e disa gjuhëve u identifikua si prioritet kryesor për komunikim dhe nevojë për të përmirësuar cilësinë dhe efektivitetin e edukimit dhe trajnimit, si bazë për meditim dhe për kuptim ndërkulturor. Edukimi plurilingual paraqet kulturën për vlerësimin e gjuhëve, si vlera të çmueshme gjuhësore për çdo njeri. (<http://eurospeak.al/sociale/312-politikat-gjuhesore/> parë më 28.09.2015).

## KREU IV

### 4. BASHKËSIA SHOQËRORE MULTIKULTURORE

#### 4.1. Bashkësia shoqërore multikulturore dhe bashkësia gjuhësore

*Bashkësi shoqërore* paraqet vendin në një territor të caktuar, ku jetojnë disa grupe njerëzish, që kryejnë aktivitete të përditshme në raporte të mira komunikuese të ndërsjella në mes veti. Në këto bashkësi kusht i domosdoshëm për të ekzistuar ka qenë zhvillimi i gjuhëve të ndryshme si mjete funksionale për komunikim. (Shkurtaj, 2006:109).

*Bashkësitë shoqërore multikulturore* reflektohen në një territor me lidhshmëri të organizimit shoqëror dhe kulturor si sistem vlerash gjuhësore të krijuara nga situatat e gjuhëve në kontakt, me bashkëjetesën e qëllimshme të një tërësie të individëve të kulturave të ndryshme, që flasin në gjuhë prototipi të trashëguar nga bashkësitë gjuhësore të veta.

*Bashkësitë multikulturore* i mundësojnë çdo bashkësie gjuhësore të kultivojë gjuhën e vet në komunikim me të gjithë pjesëtarët e bashkësisë gjuhësore të tyre, por edhe me folës të bashkësive gjuhësore të tjera, ku jetojnë dhe veprojnë në një bashkësi të përbashkët shoqërore. Bashkësitë gjuhësore krijojen nga grupe njerëzish sipas: ndarjeve gjeografike dialektore, ndarjeve si përdorimit të gjuhës në të folurit si gjuha urbane dhe gjuhë rurale, gjinisë (seksit), moshës gjuha e thjeshtë, gjuhë standarde dhe gjuha profesionale, bindjeve fetare, etnicitetit, hierarkisë së klasave ekonomike-shoqërore, familjeve, lëvizshmërisë shoqërore, sfera shoqërore etj. (Shkurtaj, 2006:109).

Bashkësitë gjuhësore qëndrojnë në kontakte të përditshmërisë jetësore në qëndrueshmëri stabile ose diglosi (Ferguson 1959), por në disa raste qëndrojnë si jostabile, prandaj dallohen dy lloje të bashkësive gjuhësore: a) *Bashkësi dygjuhësore me qëndrueshmëri stabile ( me diglosi) dhe b) Bashkësi dygjuhësore jostabile*. Sipas sferave të ndryshme të veprimtarisë, Fishmani dalloi katër tipa të marrëdhënieve të qëndrueshmërisë së varieteteve gjuhësore:

- *Dygjuhësi dhe diglosi* është situatë e përbërë nga dy gjuhë të qëndrueshme (stabile) në kontakt, ku varieteti i lartë përdoret si gjuhë eprore, ndërsa *varieteti i ulët* përdoret në familje dhe me miqtë.
- *Dygjuhësi pa diglosi* është situata gjuhësore, ku dallohet gjuha e elitës (varieteti i lartë), si gjuhë me prestigj më të lartë se ajo e shtresës së ulët.
- *Diglosi pa dygjuhësi* paraqitet te shtetet me strukturë të popullsisë heteroregjone.
- *As dygjuhësia e as diglosia* nuk janë situata gjuhësore, nëse ka bashkësi folëse të izoluara, të cilët kanë më pak kontakte me jashtë. Ato shoqëri kanë mundësi të zhduken, sepse shoqëritë moderne kërkojnë *harmonizim me ndërveprimin e të gjithëve*. (Fishman, 1971:74).

#### 4.2. Bashkësia gjuhësore, individualizmi dhe konformizmi

*Bashkësia gjuhësore* është *prodhim i gjuhës prototipe të trashëguar nga paraardhësit e folësit, që është përdorur si mjet komunikimi të përbashkët i një grupi individësh.* Kjo bashkësi në vazhdimësi përpunohet si gjuhë *stereotipe e folësit* duke shprehur *identitetin vetjak të tij dhe atë të kolektivitetit.* Gjuha nuk mund të individualizohet në shoqëri, por ajo përshtatet në varietete të ndryshme sipas nevojës së aktit të komunikimit. (Bloomfield, 1933:492; Lyons, 1970:32; Hockett, 1958:8; Shkurtaj, 2006:109).

Gjuha është mjet shprehës i individualizuar dhe mjet shprehës i konformizmit që reflekton dy dukuri gjuhësore, atë të folësit dhe bashkësisë gjuhësore të tij. Çdo njeri prej kur lind ka diçka të veçantë që e dallon nga të tjerët, si nga pamja ashtu edhe në të folur, por ai sado i veçantë të jetë, nuk mund ta realizojë komunikimin e vet në “tregun gjuhësor”. (Shkurtaj, 2009:194; Hudson, 2002:21).

Gjatë akteve të komunikimit dallohen dukuri gjuhësore si :

- Individualizmi i folësit ose ideolekti, i cili reflektohet me të folurit e veçantë të folësit me timbër karakteristik, me theks të ndryshueshëm, me përvojë gjuhësore të dallueshme nga folësit tjerë të së njëjtës gjuhë, por edhe të ngjashme me të folurit e bashkësisë gjuhësore, prej ku e ka mësuar gjuhën.
- Konformizmi i folësit është ngashmëria e të folurit të gjuhës në mes individëve të një bashkësie gjuhësore. Konformizmi konceptohet si përdorimi i gjuhës së fisit, krahinës, kombit dhe shtetit, klasës shoqërore, profesioneve, etj. (Shkurtaj, 2009:194).

Robert la Pege (1985) argumentoi se çdo individ krijon sistemet e sjelljes së tij verbale, në mënyrë të tillë, që ato t'i ngajnjë atyre të grupit, me të cilët mund të identifikohet si:

- Anëtarë i një bashkësie gjuhësore ose të grupit,
- Vëzhgues dhe analizues i sistemeve gjuhësore të tyre dhe të sjelljeve gjuhësore,
- Motivim me gatishmëri për ta përshtatë sjelljen e tij gjuhësore me të tyre.  
(Hudson,2002:37).

Mjedisi i bashkësisë multikulturore ndikon në zhvillimin e individit bilingual sipas motivimit:

- *Integrimi shoqëror* arrihet me shoqërimin e grupeve të përbashkëta me të gjithë individët e bashkësive gjuhësore të tjera.
- *Ndërkomunikimi* arrihet me vullnetin vetjak të qëllimshëm për të mësuar gjuhë të reja.
- *Sjellja për të mësuar gjuhë të reja* arrihet me motivimin nga faktorë të jashtëm shoqëror, ku individi ndjehet i solidarizuar në bashkëveprim me të tjerët në një bashkësi shoqërore. Të mësuarit e gjuhëve për nxënësit është më i dëshirueshëm nëse bëhet jashtë hapësirave shkollore, se në klasa nxënësit e ndjejnë si imponim.
- *Sistemi shoqëror multikulturor* e motivon individin të mësojë gjuhë tjetër në mënyrë të pavarur për t'u integruar në grup. (Ibrahimi, 2012:85).

Gjuhët si kompetenca komplekse gjuhësore të folësit plurilingual, reflektojnë identitetin e vet individual edhe atë kolektiv gjuhësor të një bashkësie të caktuar shoqërore ose të një shteti, në nivel evropian dhe global dhe ndikojnë në ruajtjen e vitalitetit të çdo gjuhe.

### 4.3. Multikulturalizmi – kultura

Multikulturalizmi si term sipas fjalorit enciklopedik të Grant Robertit, për herë të parë është përdorur në vitin 1971, ku theksohet se në një fjalim të kryetarit të atëhershëm *kanadez Pjer Tridua*, i është përdorur thënia: "...termi *bikulturalizëm* nuk e pasqyron sa duhet shoqërinë tonë. Fjala *multikulturalizëm* në këtë aspekt është më preciz". Multikulturalizmi është çmuarja e kulturave si vlera kombëtare të trashëgura nga bashkëveprimi i grupeve njerëzore në një bashkësi shoqërore.

Multikulturalizmi reflekton qëllimin e bashkëjetesës së kulturave të ndryshme në një territor të caktuar. Në thelb, është statik, zakonisht përveç kulturës dominuese pranon edhe shumë kultura të pakicave. Në plan të parë del *mbrojtja e kulturës* dhe *të drejtave të pakicës*. Shembull të tillë kishim në Kosovë, ku kjo mënyrë e trajtimit nuk solli suksese, për dallim nga kjo, Vojvodina, për herë synonte në barazimin e këtyre dy drejtimeve. (Ibrahimi, 2012:51).

Përdorimi vetëm i një gjuhë, si gjuhë zyrtare në një shoqëri multikulturore, sjell padrejtësi për pjesëtarët e gjuhës së nënshtuar, që janë në numër më të vogël, të mos kenë fuqi administrative në strukturat shoqërore ose njëjtë si ata. Gjuha çdo herë është konsideruar si shtyllë në një shoqëri. Gjuhën zyrtare së pari e pranon klasa sunduese, pastaj popullsia qytetare e më pas fshati, kurse atje ku folësit e gjuhës së nënshtuar i kundërvihen gjuhës së privilegjuar atëherë paraqitet dukuria e dygjuhësisë. (Kalve, 1981:100).

Multikulturalizmi në shekullit XXI-një ka rëndësi të madhe për mbajtjen e harmonisë shoqërore, me mbrojtjen e të drejtave e të gjithë kulturave si të kulturës dominues, ashtu edhe kulturave të pakicave dhe mund të shqyrtohet nga tri pikëpamje: a.) planetare, b.) shoqërore dhe c) individuale. (Ibrahimi, 2012:55-56).

Multikulturalizmi reflektohet me respektim të ndërsjellë kulturor të individëve të bashkësive gjuhësore të pranishme në një bashkësi shoqërore multikulturore. Përfaqësimi institucional i gjuhëve në veprimtaritë shoqërore reflekton kulturën e secilit individ, që është përfaqësues i asaj kulture. *Multikulturalizmi* në fushën e politikës është i përqendruar në dy objektiva:

- *Mbajtja e marrëdhënieve të mira midis pakicave të ndryshme etnike*
- *Definimi i raporteve midis shtetit dhe kolektiviteteve etnike.* (Semprini, 1999:147).

untington (2004:18) për këtë çështjen e multikulturalizmit thekson:

"Në këtë botë të re politika lokale është politikë e etnicitet, politika globale është politikë e qytetërimeve. Rivaliteti ndërmjet superfuqive është zëvendësuar nga përplasje e qytetërimeve". ".....kultura është forcë ndarëse, njëkohësisht edhe bashkuese". (Huntington, 2004:18 ).

Dy thënet e lartpërmendura orientojnë bindjen se në çdo shtet duhet të arrihet krijimi i kulturës së re të qytetërimit me vetëdijesim të ri për përparim të përbashkët në çdo sferë të

*jetës, me bashkëpunim dhe respektim të vlerave kulturore-gjuhësore të ndërsjellë në mes të gjithë individëve e të gjithë bashkësive gjuhësore.*

*Vizioni i globalizimit si objektiv kryesor ka ndryshimin e kulturës së individit me ndryshimin e gjithanshëm, përmes procesit social, në drejtim të qytetërimit individual dhe shoqëror. Globalizimi është nxitës i zhvillimit të kulturës njerëzore në çdo aspekt jetësor, por në vazhdimësi është i paarritshëm, për shkak se objektivat e tij ndryshojnë në vazhdimësi, sipas nevojave të njerëzve, duke u nisur nga nivelet lokale e deri tek nivelet globale.*

Kultura individuale arrihet me zhvillimin e individit si proces shoqëror të planifikuar të qëllimshëm, ose pa qëllim shoqëror. Individët e bashkësive gjuhësore të ndryshme bashkëveprojnë me të gjithë individët e tjera të bashkësisë shoqërore, në drejtim “të së mirës universale” ose “për të mirën e të gjithëve”.

Kjo nënkupton rikulturimin dhe zhvillimin e gjithanshëm të individit gjatë gjithë jetës, për shkak se çdo gjë ndryshon me shpejtësi të madhe. Qytetërimi reflektohet me kulturën individuale të individit, që ndikon për mirëqenin e të gjithëve në nivel *lokal, shtetëror* dhe *global*.

Në fushën politike-shoqërore përdoren mjaft terme, që në përbërjen e tyre e kanë fjalën “kulturë”. Ekzistojnë afér 300 sqarime teorike shkencore për fjalën “kulturë”. Sqarimet në vijim mbështeten në teorinë e shkencëtarëve. (Hudson, 2002: 83; Qahili, 2002:42 Rrokaj, 2000 : 49; Kutanariç, 1996:843; Kutanariç, 1982:23).

Fjala “kulturë” në leksikonin e fjalëve (Vujaklia, 1972:493) sqarohet me fjalën latine “*colere*”, që në shqip do të thotë “*të kultivosh, të kujdesesh, të përpunosh, zhvillim, arsimim, përsosje, përpunim, dituri, kulturë etike, ngritja e individit në shoqëri, që të zotërojë ideale: të drejtësisë, të sinqeritetit, të njerëzimit dhe respektit të ndërsjellë*”. Fjala kulturë është me orgjinë latine “*cultus*”, që shqip do të thotë “*mënyra e të jetuarit, respektim i ndërsjellë*”. *Kjo fjalë konceptohet si reflektim i sjelljes së individit ose respektim i ndërsjellë në mes individëve*.(Basatova dhe Çadikovska, 2000:155).

Kultura e bashkësisë shoqërore reflektohet me të arriturat kulturore të gjithë anëtarëve të bashkësisë shoqërore, që jetojnë me raporte të ndërsjella midis grupeve të bashkësive gjuhësore ose ndryshe të quajtura grupe etnike. Në çdo shtet ka kultura të ndryshme me vlera kulturore të ndryshme të trashëguara në gjenerata, që respektohen nga të gjithë palët në shtet.

Kultura e një bashkësie etnike reflektohet me elementet në vijim: *gjuhën, bindjen, zakonet, vlerat, besimet normat, ritet fetare, të organizuarit e ceremonive të gëzimeve, të ceremonive të hidhërimeve, fillimin e arsimimit, veprimtaritë shoqërore, të shfrytëzuarit e kohës së lirë, të folurit e një ose më tepër gjuhëve ose “kulturë ekskluzive dhe elitare”, të arriturat e dijeve shkencore në çdo fushë jetësore etj., që anëtarët e grupit i kanë fituar*

gjatë evoluimit gradual dhe ua kanë lenë gjeneratave të ardhshme si trashëgimi kulturore me vlerë shumë të çmuar.


Kultura e individit është reflektim i njojurive të përvetësuara e të gjithanshme të individit të rikthyera në shprehi pune dhe të reflektuar me sjellje të qytetëruar gjatë kryerjes së obligimeve të tij.

*Kultura përfshin çdo aspekt të zhvillimit njerëzor në një kornizë të një grupi të veçantë, ku krijohet personaliteti i njeriut si individ, që ka njouri të gjëra për shkencën, artet, shoqërinë, që flet në komunikime të ndryshme në një gjuhë apo më tepër gjuhë të huaja ose thënë ndryshe “kulturë ekskluzive dhe elitare”. (Qahili, 2002:42; Hudson, 2002: 83; Rrokaj, 2000 : 49; Kutanariç, 1996 : 843).*

*Kultura e individit është produkt shoqëror me të mësuarit të shumë njojurive në mënyrë vetjake dhe në bashkëpunim me të tjeterët, që përmes procesit të menduarit transferohen në dije dhe reflektohen me të vepruarit e individit në jetën e përditshme, duke kontribuar në përgjithësi për të mirën e përgjithshme njerëzore.*

*Kultura zhvillohet brenda besnikërisë së parimeve, kurse qytetërimi është i përgjithshëm dhe zhvillohet duke mbledhur përvojat individuale. Në gjysmën e dytë të shekullit XIX fillon zhvillimi i kulturës evropiane me vlerësimin i pranimit të kulturave dhe qytetërimeve të ndryshme, që kanë reflektuar kundërvëni kulturore. (Morin, 1990:57).*

Morin (1990:57) thekson se: "Kultura evropiane shprehet nëpërmjet fesë jude-kristiano-greko-latine, kurse qytetërimi nëpërmjet humanizmit, nacionalitetit, shkencës, lirisë". Kultura paraqet veçantinë, subjektivitetin, individualitetin, kurse qytetërimi përcjellshmërinë, objektivitetin, universalitetin. Kjo do të thotë se arrihen të pranohen kulturat dhe qytetërimet e ndryshme nga ato, që ishin pranuar në shekullin XVIII në gjysmën e dytë të shekullit XIX. (Morin, 1990:57).



**Figura 4.1.** Kulturat dhe qytetërimet pranohen në gjysmën e dytë të shekullit XIX

Normat kulturore janë krijuar në çdo popull si rregulla për t'i edukuar anëtarët e vet në ngritjen e vetëdijes së tyre, që sjelljen e tyre t'ua përshtatin normave. Njerëzit janë mësuar se çfarë duhet të bëjnë dhe çfarë nuk duhet të bëjnë si bartës të kulturës, që i takojnë. Shoqëritë dhe normat janë zhvilluar paralelisht duke ndihmuar njëra-tjetrën, normat kanë ndikuar në rregullimin e sjelljeve të njerëzve, kurse sjelljet në zhvillimin e normave. Normat

janë të ndryshme për çdo kulturë dhe janë të bartura si trashëgimi kulturore prej brezi në brez gojarisht ose me shkrim. Normal janë:

1) *Normal ndaluese* ose *tabu* janë konsideruar si urdhra të fuqive të mbinatyrshme, të perëndive. Objekte të shenjat janë përdorur për ta nxitur frikën te njerëzit se do të ndëshkohen nëse i shkelin normal, ashtu që kanë ndikuar në frenimin e nxitjeve instiktive si të rrezikshme për ekzistencën e jetesës kolektive të bashkësive primitive. Ato kanë ndikuar në harmonizimin e marrëdhënieve në mes të anëtarëve të bashkësive.

2) *Norma urdhëruese dhe shoqërore* janë orientues të rregullimit të sjelljeve njerëzore:

- *Normal folkuesje* (kriteret e etikës, të sjelljeve dhe të veshjeve);
- *Normal more* (funkcionimi normal i shoqërisë, me rëndësi jetike, mbështetja e ligjeve).

*Termet politike-shoqërore, që janë krijuar me fjalën kulturë :*

- *Etnokultura*, vlerë kulturore e një bashkësie etnike në një territor të caktuar.
- *Bikulturore*, vlera kulturore e dy bashkësive etnike, që bashkëjetojnë në një territor.
- *Multikulturore*, vlerë kulturore e tri ose më tepër etnive, që jetojnë në një territor.
- *Interkultura*, kultura e individit si bartës i kulturës etnike, bikulturore, multikulturore.
- *Etnocentrizmi*, nënçmim i kulturës etnike tjetër dhe mbivlerësimi i kulturës vetjake.
- *Ksenocentrizmi*, mbivlerësimi i kulturave tjera me nënvlërësim të kulturës vetjake.
- *Relativizëm kulturor*, përshtatshmëria e një kulture me kulturën dominuese.
- *Dialogjika kulturore*, proces i zhvillimit të kundërthënieve kulturore
- *Vetëdijesimi i ri kulturor i shekullit XXI-një* arrihet me arsimimin e individëve, me vetëdijesim për përparim të gjithanshëm kulturor individual dhe shoqëror. (Morin, 1990:57).

#### 4. 4. Bilinguizmi dhe multilinguizmi

Fjalët bilinguizëm dhe multilinguizëm janë fjalë të përngjitur të krijuar nga dy fjalë të tjera, *bi dhe lingua* ose *multi dhe lingua*, ku fjala “*bini*” është me orgjinë latine, që domethënë “*nga dy*” dhe fjala “*multus*” është me orgjinë latine, që në shqip domethënë “*shumë*”, “*i shumënumërt*”, kurse fjala “*lingua*” ëshë me orgjinë latine që shqip domethënë “*gjuhë*” ose “*të folurit*”. (Batosava dhe Çadikovska, 2000 : 163 : 173).

*Bilinguizmi dhe Multilinguizmi* janë dukuri gjuhësore të reflektimit të dy ose më tepër gjuhëve në një territor të caktuar, që janë përpunuar në gjuhë kombëtare dhe janë institucionalizuar për t'u folur nga folësit e vet dhe të tjerë, por mund të jenë me status të barabartë si gjuhë zyrtare ose me status jo të barabartë, ku njëra gjuhë është gjuhë zyrtare, kurse tjetra gjuhë jozyrtare.

Çështja e gjuhës është e lidhur drejtpërdrejt me identitetin e individit, prandaj përdorimi i gjuhëve duhet të rregullohet në atë mënyrë, që bashkësítë gjuhësore ta ndjejnë se edhe ata kontribuojnë si partnerë të barabartë në ndërtimin e komunës së përbashkët. ([www.civicamobilitas.org.mk/2010](http://www.civicamobilitas.org.mk/2010) parë më 26.03.2015).

Në bazë të gjithë teorive sociolinguistike konfuze, bilinguizmi klasifikohet si :

1) Bilinguizmi shoqëror me dy lloje:

- *Bilinguizmi (Multilinguizmi) shoqëror institucional aktiv*, ku dy ose tri gjuhë të kontaktit në një shtet ose bashkësi shoqërore, funksionojnë në mënyrë të barabartë në çdo institucion ose dy gjuhë janë gjuhë zyrtare në një shtet .

- *Bilinguizmi shoqëror (Multilinguizmi) shoqëror institucional joaktiv*, ku njëra gjuhë nuk është gjuhë zyrtare në një shtet ose jashtë kontekstit shoqëror politik të gjuhëve territoriale).

2) Bilinguizmi individual :

- *Bilinguizmi individual aktiv (Bilingualizmi)* është dukuria gjuhësore, kur individi përvetëson në mënyrë institucionale dy ose tri gjuhë të kontaktit (vendit apo të mjedisit, ku ai vepron) si gjuhë standarde, edhe nëse njëra gjuhë nuk është gjuhë zyrtare në një shtet, por të dy gjuhët fliten në vazhdimësi dhe ai përvetëson dhe i flet.

- *Bilinguizmi individual pasiv (Bilingualizmi)* është dukuria gjuhësore, kur njëra gjuhë qëndron në heshtje (fossilizohet) nëse individi shpërndaltet diku tjetër, ku dy gjuhët e vendit ngelin në heshtje.

*Barazia e statusit të dy gjuhëve të kontaktit në nivel institucional* me status të barabartë në një shtet, të gjithë individëve të bashkësive gjuhësore u sjellë harmonizim dhe ndikon në përparimin e gjithanshëm të bashkësive shoqërore multikulturore. Bilinguizmi u ofron mundësi të gjithë individëve të bashkësive gjuhësore të arrijnë përfitime vetjake kulturore për zhvillimin e personalitetit përmes komunikimit shoqëror. Kjo ndikon në krijimin e marrëdhënieve miqësore të ndërsjella në mes tyre me të bashkëvepruarit në aktivitete të veprimtarive të ndryshme.

*Pabarazia në statusin e gjuhëve* në një bashkësi shoqërore multikulturore vazhdimisht sjell kundërvënie dhe konflikte në mes bashkësive gjuhësore. Gjithashtu reflektohen edhe pengesa për zhvillimin e plotë të personalitetit të individëve të çdo bashkësie gjuhësore. (Shkurtaj, 2009:283-294; Poloska, 2002:19; Rrokaj, 2000:147).

Worf (1940) në teorinë e relativitetit shoqëror argumenton se perceptimi i njësive gjuhësore të çdo gjuhe bazohet në konceptimin e figurave të universit nga vëzhgues të ndryshëm në bazë të ngjashmërise, që ekzistojnë në faktet fizike. Të menduarit e individit në çdo gjuhe ndikohet nga gramatika e gjuhës amtare, për shkak se dallimet konceptuale gjuhësore ose gramatika e organizon të folurit sipas rregullave gramatikore. Sistemet gjuhësore të gjuhës amtare të mbështetura në norma standarde duhet të shërbejnë si model për të shprehurit në çdo gjuhë si substancë gjuhësore ose përvojë gjuhësore, që

aktivizon procesin e të menduarit në prodhim të thënieve pragmatike në çdo gjuhë. (Hudson, 2002:110; Shkurtaj, 2006:81).

Bernshtajni (më 1958 e pastaj e rishikuar më 1962) dalloi dy shtresa gjuhësore të shtresave shoqërore: gjuhë publike të shtresës së ulët ose kodi i ngushtë, që ka kapacitet të kufizuar të shprehjes gjuhësore dhe gjuhë formale të shtresës së mesme ose kodi i përpunuar, që posedon organizime gjuhësore relativisht të përpunuara, me shumë informacione dhe vlera që konsiderohet si përcaktues i pabarazisë së mundësive sociale. (Shkurtaj, 2006:81).

Bazil Bernshtajnit (1958-1972 ) në studimin e tij, mungesën e kompetencave gjuhësore e quajti “*deficit gjuhësorë*”, kurse Worf (1956:212) “*relativizëm gjuhësor*” nevojë për përshtatshmëri në nivel lokal për zotërim të kompetencave shumëgjuhësore. Kombinimi i tezave të Bernshtajnit dhe Uorfit për relativizmin gjuhësorë definohet: “*Struktura shoqërore është ajo, që përcakton sjelljen gjuhësore, e cila me një proces qarkullues e riprodhon atë*”.

Në bazë të thënieve të lartpërmendura konkludojmë se sistemet shoqërore vazhdimisht duhet të mundohen t'i japin mundësi individëve të zhvillohen në sistemet arsimore për t'u zhdukur pabarazia e mundësive sociale. Studimet e Bernshtajnit dëshmojnë se *struktura shoqërore përcakton sjelljen gjuhësore dhe kjo riprodhon strukturën shoqërore*.

#### **4. 5. Mosha të përvetësuarit të gjuhëve**

Gjuhët mësohen në çdo moshë, mirëpo të përvetësuarit e gjuhëve janë në varshmëri nga mjedisi, ku rritet fëmija. Bilinguizmi ose Multilinguizmi zhvillohen në mënyrë paralele në kushte harmonizuese, ku në disa gjuhë fëmijës i ofrojnë përfitime të mëdha, si: shqiptimin e fjalëve, orientojnë fëmijën të kuptojë sisteme kulturore të ndryshme, e frymëzojnë fëmijën për qytetërim demokratik dhe i hapin fëmijës një horizont të gjerë për të marrë informacione njohëse në dy gjuhë ose disa gjuhë. (Shkurtaj, 2009: 297).

Bilinguizmi ose Multilinguizmi ndikohen nga faktorë në vijim:

- *Mjedisi familjar bilingual*
- *Mjedisi i emigracionit*
- *Gjendja gjeopolitike (statusi i dygjuhëve me prestigj të njëjtë zyrtar i quajtur adstrat).*
- *Zhvillimi ekonomik i mjeteve tekniko-teknologjike të informacionit.*

Gjuhët përvetësohen në moshë të ndryshme, dhe sipas Chambers (1995:151) klasifikohen si:

- *Bilinguizmi biologjik familjar me prindër të martesave të përziera.*
- *Bilinguizmi i fëmijërisë-nxënës* në mjetëse institucionale arsimore të organizuar.
- *Bilinguizmi i adoleshentëve* në shoqërizim me bashkëmoshatarë të bashkësive tjera.
- *Bilinguizmi i moshës të rritur*, kur individët i mësojnë gjuhët sipas nevojës për sigurimin e ekzistencës jetësore në mjetëse institucionale arsimore (arsimim joformale ose me kurse gjuhësore). (Hudson 2002:25-26).

Përvetësimi i dy gjuhëve ose disa gjuhëve arrihet në mjetëse familjare prej një moshë të vogël, kur vazhdimit foshnja është i shoqërizuar nga individ të rritur familjar ose individ kujdestar. (Woolfok, 2011:55). Gjuhët mësohen njëkohësisht me:

- *Ekspozimin e dy gjuhëve nga mosha më e hershme e fëmijërisë.*
- *Prania më madhe e fëmijës në situata të larmishme gjuhësore.*
- *Të folurit e të dy gjuhëve në vazhdimësi dhe qëndrueshmëri.* (Woolfok, 2011:55).

1) *Mosha e fëmijërisë së hershme* kalon në dy fazat:

*a) Faza paragjuhësore ose sistem komunikimi i rritur-fëmijë, që reflektohet me procesin e shoqërizimit me ndërveprim komunikativ jogjuhësor të rritur-fëmijë, ku i rrituri kryen rolin e burimit dhe stimulimeve dhe të interpretimit të sjelljeve me dërgim të sinjaleve drejt fëmijës me mjetë joverbale: qarje, qeshje dhe sinjale të tjera, që fëmija fillon t'i imitojë në vend të fjalëve për të komunikuar me të rriturit si sistem sinjalizimi *me qarje dhe të qeshura*.*

*b) Faza gjuhësore “baby-talk” paraqitet në moshën katërvore me përpjekjen e fëmijës me buzëqeshje për të simuluar të folurit e të rriturve ose nënës *dhe qesh me të* ose zhvillon dialog “turn-taking. Në moshën tetëmuajore paraqitet aftësia për ndërveprim komunikativ jogjuhësore dhe gjuhësore në partneritet me të rritur, në *rol pasiv* dhe *aktiv*, si karakteristikë e dialogut njerëzor.*

*Vokalicitat ose “tingujt refleksë” shprehen në javët e para (britma, belbëzime), “tinguj vegjetativ” (fishkëllima, kollitje dhe zhurma gjatë gjellitjes), “cooing” (tinguj për kënaqësi dhe mirëqenie), “loja verbale” reflektohet në moshën katërmujore (belbëzime të zgjatura dhe shtatëmuajore me belbëzime të dyzuara, rrokje përsëritëse ba-ba, na-na).*

*Sistemi i sinjalizimeve “komunikimi i natyrës egocentrike” reflektohet me belbëzime për të dhënë mesazhe për “kërkesa” dhe “deklarime” ose me lëvizje të kokës, tërheqje, goditje, mimika. Fëmija është i vetëdijshëm se sjellja e tij ka vlerë komunikatave dhe luan rolin e tërheqjes së vëmendjes së të tjerëve nga vetvetja dhe përdoret për të ndikuar në sjelljen e të tjerëve për të arritur të dëshiruarën. (Wolffolk, 2011:35; Shkurtaj, 2009:87 ).*

c) Faza “*peer groups*” është rreth moshës katër vjeçë, kur fëmija bashkëbisedon me moshatarët e vet. Në këtë moshë shumica e fëmijëve kanë një fjalor me disa mijë fjalë dhe zoterojnë rregullat gramatikore për biseda të thjeshta, sipas Colledge (2000). Të folurit e vazhdueshëm në të dy gjuhët i mundëson fëmijës të bëhet dygjuhësorë. (Woolfok, 2011: 53-55). Owens (2005) për përvetësimin e fjalorit shprehës (leksik ekspresiv) dhe aftësitë e kuptueshmërisë (leksik receptiv) thotë:

- *Fëmijët 2 vjeç kanë leksik ekspresiv të 450 fjalëve, kurse leksik receptiv më të madh.*
- *Fëmijët 3-4 vjeç kanë leksik ekspresiv të 1000 fjalëve, kurse leksik receptiv më të madh.*
- *Fëmijët 4-5vjeç kanë leksik ekspresiv të 1500 fjalëve, kurse leksik receptiv më të madh.*
- *Fëmijët 6 vjeç kanë leksik ekspresiv të 2600 fjalëve, kurse receptiv të 20 000 fjalë.*

2) *Mosha e fëmijës-nxënës*, kur fëmija arsimohet në disa gjuhë në mënyra të ndryshme:

- *Arsimim formal* (në institacione arsimore).
- *Arsimim joformal* (me organizime të veprimitarive organizative të shoqërisë civile).
- *Arsimimi informal* (arrihet në familje në shtëpi, në shëtitje turistike).
- *Të nxenit në largësi* me mjete teknike-teknologjike të informimit dhe komunikimit.

3) *Mosha e fëmijës adoleshentë* është periudha, kur fëmijët të përgatiten të bëhen brezi tjeter i të rriturve, që vazhdimesht e ndryshojnë zhargonin tinejxher për t'u dalluar nga adoleshentët e mëparshëm, ( Chambers, 1995:171), (Hudson. 2002:25-26).

4) *Mosha e rritur* është reflektohet qëndrimi pozitiv për të mësuarit e gjuhëve sipas vetëvlerësimit vetjak për arritjen e kompetencave arsimore dhe nevojës për zhvillimin e plurilinguizmit vetjak.

## KREU V

### 5.EDUKIMI PLURILINGUAL DHE PLURILINGUALIZMI

#### 5.1. Edukimi plurilingual

Edukimi plurilingual është kultura plurilinguale e arritur nga shumica e njerëzve në një shtet si meritë e politikave arsimore plurilinguale të zbatuara në institucionale arsimore. Edukimi plurilingual synon të rrisë pranimin e vlerës sociale dhe kulturore të diversitetit linguistik për të siguruar dashamirësinë linguistike dhe për të zhvilluar kompetencën ndërkulturore.

Edukimi plurilingual është nxitës për vetëdijesim të secilit individ për vlerën e repertorit gjuhësor dhe zgjerimin e tij me të mësuarit e gjuhëve më pak të mësuara. Edukimi plurilingual reflektohet edhe nëse individët nuk e zotërojnë mirë atë gjuhë, por ato vullnetarisht mundohen të komunikojnë me bashkëfolës të një gjuhe tjeter me përdorimin e mjeteve jogjuhësore komunikuese si *gjestet, mimikat, shprehjet e fytyrës*.

Qëllimi qendror i edukimit plurilingual është zhvillimi i kompetencës plurilinguale për:

- *Edukim për plurilingualizëm;*
- *Edukim për vetëdijesim plurilingual.*( [www.ibp-kosovo.org/](http://www.ibp-kosovo.org/) parë më 19.02.2015).

Edukimi për plurilingualizëm i individit arrihet me arsimimin institucional me anë të të mësuarit e disa gjuhëve, që i mundësojnë atij të veprojë në komunikim shoqëror *në mënyrë të vetëdijesuar, me ndërgjegjshmëri ndaj gjuhës së vet dhe gjuhës së tjereve, me përdorim të gjuhës me përgjegjshmëri ndaj punës, me vetëregullimin e përdorimit të gjuhës në situata të çdo veprimtarie, me vetëvlerësim gjatë përdorimit të gjuhëve dhe të mësuarit e gjuhëve me vetëdrejtë.*

Çdo shtet ka obligim shoqëror që qytetarëve të vet t'ju mundësojë të mësuarit e gjuhëve në mënyrë institucionale. Në atë mënyrë u ofron mundësi të gjithë individëve të një bashkësie shoqërore multikulturore të zhvillojnë kompetencat e plurilinguizmit të çdo gjuhe në norma standarde. Gjuhët që përdoren nga folësit e vet dhe të tjera, në vazhdimësi bëhen vitale nga përvojat komunikuese shoqërore. Ata nuk duhet të mësohen si gjuhë të veçanta dhe të izoluara, por si gjuhë plotësuese të repertorit gjuhësor, që u ndihmojnë individëve të bashkëveprojnë me të tjera.

Individët, që i përvetësojnë gjuhët e vendit në mënyrë institucionale më lehtë e kanë të komunikojnë me të tjera dhe ta transferojnë të folurit e tyre në gjuhën e nevojshme në drejtim të bashkëfolësit për komunikim pragmatik. Kultura e popullatës vendase në vazhdimësi duhet të ndryshojë në drejtim të respektimit të parimit të multikulturalizmit me

anë të informacioneve shoqërore, qofshin ato mediatike ose institucionale, si dhe me trajnime për edukimin plurilingual në çdo veprimitari shoqërore.

Multilinguizmi është i pranishëm në çdo shtet të Evropës, për shkak të demografisë së popullatës, që aktualisht vepron në ato shtete. (Shkurtaj, 2009:182). Në Evropë bashkësitetë multikulturore çmohen shumë, prandaj Politikat e Edukimit Gjuhësorë u mundësojnë nxënësve të mësojnë gjuhët e ndryshme në përshtatshmëri me vendin ku jetojnë.

Qëllimi i edukimit plurilingual mund të perceptohet në mënyra të ndryshme si :

- a) *Edukim i nxënësve për të kuptuar më mirë folësit e gjuhëve të tjera në shoqërinë e tyre.*
- b) *Mjet gjuhësorë për përvetësimin e njohurive të ndryshme përmes gjuhëve të tyre.*
- c) *Përvetësim i shkathtësive folëse të disa gjuhëve në shoqërinë vendase, që u mundëson folësve formimin e kompetenca gjuhësore të gatshme për komunikim edhe për vende tjera, për qëllime turistike ose për qëllime bashkëpunuese.*
- ç) *Parakusht për pjesëmarrje në rajon shumëgjuhësh lokal, rajonal, nacional dhe evropian si qytetar plurilingual.*

Në Kornizën e Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët u përcaktuan kriteret:

- Përvetësimi i gjuhës “kombëtare” në bazë të normave standarde në sistem arsimor.
- Gjuha e parë e folur sipas normave të rajonit apo brezit, që i takon ai individ, gjuha zyrtare e vendit (rajonale, minoritare), që flet dhe shkruan individi si gjuhë kombëtare.
- Zotërimi i fjalorit receptiv (kuptueshmëria) të një gjuhe apo më tepër gjuhëve, por jo edhe me aftësi ekspressive (të folurit dhe të shkruarit e gjuhëve standarde), por arritja e poliglotizmit si rrjedhim i edukimit medial apo turistik .
- Zotërimi i një gjuhe tjeter të huaj në nivel më të lartë, aftësi folëse dhe të shkrimit në norma standarde. (Nga DLEP nga K.E. 2007: 9). ([www.ibp-kosovo.org/](http://www.ibp-kosovo.org/) parë më 19.02.2015).

Politikat arsimore ndikojnë në vetëdijesimin e popullatës për vlerësimin e kulturës plurilinguale. Sistemi shoqëror-politik si qëllim e ka zhvillimin e individit, prandaj krijoi sistemin arsimor të përqendruar në objektivat:

- *Arsimore* (mundësi për t'i zhvilluar kompetencat kognitive shumëgjuhësore).
- *Edukuese* (mundësi për edukimin e të gjithë individëve).
- *Krijuese* (mundësi për zhvillim të të shprehurit *pragmatik me gojë dhe me shkrim*).
- *Socializuese* (mundësi për ndërveprim vetjak gjuhësor në bashkëveprim me të tjerët).
- *Vetëvlerësuese dhe vlerësuese* (vlerësim i të arriturave individuale dhe të tjerëve).

Arsimi është dritë rrezatuese e çdo sistemi shoqëror e përhapur në çdo vend të e territorit, që ndriçon rrugën për arsimim të gjithë individëve drejt një ardhme më të mirë. Arsimi i zbatuar në disa “*gjuhë të zemrës*” sjell kënaqësi dhe kuptueshmëri më të mirë për të

gjithë individët, por integrimi “*gjuhës së bukës*” ose “*të gjuhëve të vendit*” në kurrikulën mësimore në një bashkësi shoqërore multikulturore sjell zhvillim *koherent* dhe *koheziv* të gjithë individëve me reflektim të plurilinguizmit.

Integrimi në Evropë dhe në botë është qëllimi kryesor i shtetit tonë, prandaj sistemet arsimore në shkolla duhet të nxisin kulturën universale ose globale. Përmes mësimdhënies në lëndët e gjuhëve, nxënësit duhet të nxiten për vlerësimin pozitiv të vlerave të përbashkëta evropiane. Kjo arrihet me nxitjen e kureshtjes te nxënësit për të mësuar gjuhë të reja si përfitim vetjak me krijimin e plurilinguizmit dhe arritjen e respektimit të ndërsjellë multikulturore dhe multilinguale, sidomos në bashkësitetë shoqërore, ku reflektohen gjuhët në kontakt ose në fqinjësi.

Bernshtajni, (1962) në thënien e tij :“*Puna është se mendja zotëron aftësi shumë të pasura, por nevojiten disa mjedise stimuluese, që këto aftësi të funksionojnë*”. Kjo do të thotë se sistemet shoqërore politike janë ato, që ndikojnë në zhvillimin e individit, prandaj duhet fuqia e pushtetit shoqërор t'i kushtojë kujdes motivimit të individëve për arsimim, kjo duhet të ndikojë përmes stimulimeve psikologjike, pedagogjike, sociale dhe gjuhësore. Ai thekson se aftësitë e tillë nuk u mësohen fëmijëve, por ato funksionojnë në bazë të motivimit kur janë zhvilluar nga mjedisit nxitës plot dashuri. Çdo sistem i mirë, fëmijëve duhet t'u sigurojë mjedisit nxitës me plot dashuri, ku aftësitë e tyre natyrore do të janë në gjendje të lulëzojnë . (Shkurtaj , 2006:78).

Shkaqet për edukimin e popullatës të përcaktuar nga Këshilli Evropian, janë:

- *Shkaqet sociale*: Evoluimi i shoqërive shumëgjuhëshe, integrimi i vendeve në skenën evropiane dhe botërore kërkon qasje të reja ndaj mësimit të gjuhëve dhe koncepteve të identitetit.
- Shkaqet ekonomike dhe mjedisore: Nevoja e shoqërive bashkëkohore për kapital njerëzor me kompetenca plurilinguale në treg dhe rritja e cilësisë së jetës në mjediset shumëgjuhëshe.
- Shkaqet politike: Krijimi i mirëkuptimit dhe i respektit për gjuhën dhe të drejtat tjera njerëzore në Evropë dhe më larg dhe kushtet për pjesëmarrje në proceset demokratike dhe proceset tjera shoqërore në varësi të kompetencës plurilinguale; Plurilinguizmi si kusht për qytetari aktive në Evropë. ([www.ibp-kosovo.org/](http://www.ibp-kosovo.org/) parë më 19.02.2015).

Koncepti i edukimit për plurilinguizëm ndryshon nga multilinguizmi, për shkak se multilinguizmi lidhet me institucionalizimin e gjuhëve territoriale dhe me të mësuarit e tyre, kurse plurilinguizmi lidhet me të mësuarit e gjuhëve të ndryshme, që i përvetëson individit gjatë tërë jetës. Gjuhët mësohen në çdo moshë, por më mirë është të mësohen në shkolla filllore *pa pagesë*.

## 5.2. Plurilingualizmi

Plurilingualizmi si term nuk u referohet gjuhëve si objekte, por individit me kompetencë shumëgjuhësore komunikative me repertor të variacioneve gjuhësore të ndryshme. Plurilingualizmi është zgjerim i kompetencës individuale gjuhësore të individit, nga përvoja e gjuhës amtare ose bilinguale në atë të mjedisit multilinguale dhe përvetësimin e gjuhëve tjera.

Plurilingualizmi ( kompetenca plurilinguale ose reportori gjuhësor ) konsiderohet si pasuri individuale të folësit plurilingual, që arrihet gjatë procesit jetësor të çdo individi:

- me përvetësimin e njohurive gjuhësore të disa gjuhëve,
- duke i klasifikuar në memorien e vet si kompetenca gjuhësore komplekse dhe i përdor sipas nevojës për t'u kuptuar me të tjerët.
- duke i aktualizuar aftësitë e të menduarit kognitiv në procesin transformues gjuhësorë, ku i përzgjedh fjalët e njërsë gjuhë (kod) i transferon në gjuhë tjetër dhe i përdor në aktin e komunikimit në përshtatshmëri me situatën komunikuese.

Plurilingualizmi reflektohet me përdorimin e shkathtësive shprehëse të folësve në disa gjuhë me shkrim ose me gojë, me qëllim individual apo shoqëror. Shkathtësitë shprehëse janë riprodhim i thënieve si performancë gjuhësore të ndryshme, që krijohen nga kompetenca komplekse gjuhësore të folësit, të përvetësuar në moshë të ndryshme gjatë një procesi jetësor të tij, edhe atë nga *foshnjëria, fëmijëria e hershme, fëmijëria - nxënës, adoleshencë dhe në moshë të rritur*.

Plurilingualizmi arrihet me të mësuarit e gjuhëve të huaja të vendit dhe gjuhëve ndërkombëtare në sistem arsimor. Kjo u mundëson individëve një lehtësim për sigurimin e ekzistencës jetësore në tregun e konkurrencës së punës, qoftë brenda territorit ose jashtë tij. Plurilinguali arrin një kulturë qytetare për komunikime shoqërore të ndryshme me reflektim të shkathtësive shprehëse me gojë dhe me shkrim në disa gjuhë ose të emërtuara “*ndërkëmbime të shumëfishta*” . (Shkurtaj, 2007:70).

Gjuhët gjatë procesit të ligjërimit te një folës plurilingual, transformohen në vazhdimësi nga gjuha që flitet si gjuhë e parë (Gj 1) në riprodhim të thënieve në gjuhën tjetër të nevojshme (Gj2 ose Gj3 ose Gj4) duke i ndërlidhur me mjete jogjuhësore të komunikimit, në përshtatshmëri me situatën e aktit të komunikimit.

Folësit plurilingual zakonisht janë të motivuar të flasin në gjuhën e të tjerëve si meritë e edukimit plurilingual. Përdorimi i disa gjuhëve fisnikëron kulturën individuale të folësit edhe me pasurimin e fjalorit me fjalë të reja. Kuptueshmëria e vlerës së zotërimit të plurilingualizmit reflekton kulturën e individit.

Plurilingualizmi në vitet e fundit është mjaft tërheqës për shumicën e individëve, për shkak se kompetencat plurilinguale i mundësojnë folësit fleksibilitet momental kognitiv. Për

të arritur një komunikim efektiv me një bashkëbisedues të një gjuhë ( kod ) të ndryshme nga e tija, arrihet duke aktivizuar kompetencën gjuhësore të tij në përshtatshmëri me atë të bashkëfolësit.

Plurilingualizmi i një individi gjatë gjithë jetës vazhdimesh ndryshon. Ai me të nxenit e të mësuarit të gjuhëve mund të ndryshojë në çdo kohë dhe në çdo vend . Çdo individ gjatë jetës së tij bie në kontakt edhe me njerëz të tjerë, që flasin në gjuhë të ndryshme. Ai për t'u përshtatur në situata të përditshmërisë detyrohet me vullnet t'i mësojë gjuhët e tjera, por ndonjëherë edhe pa vullnet i mëson fjalët e gjuhëve tjera, nga nevoja për të komunikuar me të tjerët, që flasin gjuhë të ndryshme nga e tija.

Plurilingualizmi, për qëllime turistike apo për punë të ndryshme, lehtëson lëvizshmërinë ndërkontaktuale në Evropë dhe zhvillimin ekonomik të shtetit të tyre, por ndikon edhe në përmirësimin e jetës politike të gjithë evropianëve. Plurilingualizmi i mundëson çdo individi zhvillim të gjithanshëm në çdo kohë, në çdo vend dhe në çdo veprimtar.

Në Kornizën e Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët, plurilingualizmi definohet si aftësi e folësit për të përdorur disa gjuhë për qëllime të ndryshme komunikuese dhe për bashkëveprim ndërkulturor, duke u mbështetur në kompetencat (repertorin) plurilinguale dhe përvjetorë kulturore. ([www.ibp-kosovo.org/](http://www.ibp-kosovo.org/) parë më 19.02.2015).

*Repertori plurilingual individual* ose plurilinguizmi u mundëson folësve fisnikërim individual në shumë drejtime:

- *zhvillim të fushës kognitive me pasurim të kompetencave gjuhësore të ndryshme.*
- *zhvillimi të fushës afektive me respektimin e parimit empatik multikulturor në shoqëri.*
- *zhvillim të fushës psikomotore, zhvillimi i shkathtësive shprehëse verbale dhe me shkrim në çdo gjuhë. p.sh. të shkruaj, të diskutojë në tema të ndryshme, të zhvillojë biseda miqësore etj.*
- *zhvillim në fushën sociale, komunikim shoqëror me shkëmbim të mesazheve pragmatike.*
- *zhvillim në fushën ekonomike me të lehtësuarit e sigurimit të ekzistencës jetësore në sfidën e papunësisë së shekullit XXI.*

*Repertori gjuhësor shoqëror* është dukuria gjuhësore në disa gjuhë në një bashkësi shoqërore multilinguale, ku reflektohet tërësia e mjeteve gjuhësore të ndryshme, që janë në dispozicion të një bashkësie folëse. Kompetencat komplekse gjuhësore përdoren nga shumica e anëtarëve të bashkësisë shoqërore. Repertori gjuhësorë i folësit i jep mundësi folësit, që me gjuhën e përzgjedhur për komunikim të shprehë *identitetin vetjak të tij*, por nëse e përzgjedh ndonjë gjuhë tjetër ai shpreh edhe *identitetin kolektiv* të një grupei tjetër të njerëzve, që e flasin atë gjuhë.

Parimet për arritjen e plurilingualizmit të përcaktuara nga K. E. (2001:168 ) janë:

- Të drejtat gjuhësore janë pjesë e të drejtave të njeriut (njohja e të drejtave gjuhësore);
- Ushtrimi i demokracisë dhe përfshirjes sociale varet nga politika e edukimit gjuhësor.
- Plulingualizmi individual është faktor i rëndësishëm në zhvillimin e identitetit evropian.
- Në vendet e Evropës plurilingualizmi ndryshon në bazë të gjuhëve të kontaktit (është plural).

Plurilingualizmi mund të arrihet nëpërmjet teknikave dhe teknologjive (on-line) të ndryshme. Kjo mund të arrihet nëpërmjet materialeve të përgatitura në mënyrë profesionale nga Korniza e Përbashkët Evropiane e Referencës për Gjuhët, nëpërmjet Portfolios së Gjuhëve Evropiane të Këshillit të Evropës, që mund t'i vë në dispozicion çdo sistem edukativ i Evropës, për mësim gjatë tërë jetës. Edukimi plurilingual është praktik: ekzistojnë modele të programeve shkolllore dhe teknika mësimdhënie të gjuhëve të ndryshme në përshtatshmëri me gjuhën e parë (Gj1).

Në agjendën e Kongresit të 77 –PEN në Beograd të Serbisë, në shtator të vitit 2016 është miratuar dokumenti i veçantë për mbrojtjen e diversitetit gjuhësor “Manifesto Girona” e të Drejtave Gjuhësore, ku PEN International ua përcjell të gjithë shkrimtarëve të botës. Pesëmbëdhjetë vite më parë, Deklarata Universale e të Drejtave Gjuhësore ( DUDGJ ose angl. UDLR) u bë publike në Barcelonë nga Komiteti i Përkthimit dhe të Drejtave Gjuhësore - PEN International dhe nga Komiteti i të Drejtave Gjuhësore. Në Beograd, nga i njëjti Komitet i të Drejtave Gjuhësor, u shfaq Deklarata Universale e të Drejtave Gjuhësore – “Manifesto Girona” me dhjetë parime të miratuara më 13 maj 2011 në Gironë. Kjo është shfaqur në internet më janar 2017, ku thuhet:

- Diversiteti gjuhësor është një trashëgimi botërore, që duhet të vlerësohet dhe të mbrohet.
- Respektimi i të gjitha gjuhëve dhe kulturave është thelbësore për procesin e ndërtimit dhe ruajtjes së dialogut dhe paqes në botë.
- Të gjithë individët mësojnë të flasin në një komunitet, që u jep atyre jetën, gjuhën, kulturën dhe identitetin.
- Gjuhë të ndryshme dhe mënyra të ndryshme të të folurit nuk janë vetëm mjetet e komunikimit, por ato janë edhe të mjedisit, në të cilin njerëzit rriten dhe kulturat ndërtohen.
- Çdo komunitet gjuhësor ka të drejtë për gjuhën e tij, që do të përdoret si gjuhë zyrtare në territorin e vet.
- Shkollat duhet të kontribuojnë në prestigjin e gjuhës së folur nga komuniteti gjuhësor i territorit.

- Qytetarët të kenë një njoħuri tē pērgjithshme tē gjuhëve tē ndryshme, eshtë shumë e dëshirueshme, pēr shkak se ajo favorizon ndjeshmëri dhe hapje intelektuale, që kontribuon nē një njoħuri tē thellë tē gjuhës sē vet ose tē tjerit.
- Pērkthimi i teksteve, sidomos veprave tē mēdha tē kulturave tē ndryshme, pērbën një element shumë tē rēndēsishēm nē procesin e nevojshēm tē mirékuptimit dhe respektit mē tē madh mes njerēzve. Media eshtë një altoparlant i privilegjuar pēr tē bérë punēn gjuhësore diversitetin dhe kompetencēn nē ményrë rigoroze duke rritur prestigjin e saj.
- E drejta pēr tē pērdorur dhe pēr tē mbrojtur gjuhën amtare duhet tē njihet nga Kombet e Bashkuara, si një nga tē drejtat themelore tē njeriut. (<http://www.pen-international.org/> parē mē 28.09.2015 dhe 10.03.2017).

Vizioni i globalizimit nē shekullin XXI-njē si objektiv kryesore e ka ndryshimin e kulturës sē individit me ndryshim tē gjithanshēm pērmes procesit social nē drejtim tē qytetërimit individual dhe shoqëror. Globalizimi, nē çdo aspekt jetësor eshtë nxitës i zhvillimit tē kulturës njerëzore, por nē vazhdimësi eshtë i paarritshēm, pēr shkak se objektivat e tij nē vazhdimësi ndryshojnë sipas nevojave tē njerëzve duke u nisur prej nivelit lokal e deri nē nivel global.

Poliglotizmi (plurilingualizmi i papërsosur ose analitzmi) eshtë dukuri gjuhësore e shfaqur te individi, me kompetencë shumëgjuhësore e papërsosur me tē folurit sipëri-qësorë tē një gjuhe tē huaj, tē mësuar nga përvoja vetjake turistike ose pēr nevoja tregtare.

### **5.3. Lehtësimi i mësimit tē gjuhëve me korrelacion tē njësive gjuhësore**

Qëllimi i politikave arsimore tē sotme janë tē pērqendruar nē pesë objektiva, edhe atë: *arsimuese, edukuese, socializuese, krijuese dhe vlerësuese - vetëvlerësuese*.

Mësimdhënia moderne konceptohet si proces i tē mësuarit me arsimim tē dyanshēm, ku edhe arsimtari edhe nxenësi me vullnet i qasen procesit tē mësuarit pērmes bashkëveprimit pēr edukim shpirtëror dhe arsimim shkencor nē drejtim tē reflektimit tē shkathtësive tē punës. Arsimimi zhvillon nxenësit nē drejtim tē pranimit tē njoħurive, nē proces tē ndërtimit tē njoħurive dhe prodhimit tē dijeve.

Sistemi arsimor duhet t'i kushtojë rëndësi përcaktimit tē objektivave se *mbi çfarë baze do tē zgjidhet pērmbajtja e asaj që duhet tē mësohet*, si do tē *pērzgjidhet* ajo, që eshtë e rëndësishme nga sasia e madhe e informacionit, por dhe si *do tē realizohet strukturimi* i njoħurive, shprehive dhe vlerave pēr një qëllim tē vetëm. Informacionet e vjetruara dhe tē parëndësishme tē pērfshira nē pērmbajtjet e disciplinave tē ndryshme shkollore duhet tē mënjanohen duke u zëvendësuar shkallë - shkallë dhe nē ményrë tepér tē kujdeshme nga informacionet e reja

Worf (1940) në teorinë e marrëdhënies së gjuhës dhe mendimit, argumenton se perceptimi i njësive gjuhësore të çdo gjuhe bazohet në konceptimin e figurave të universit nga vëzhgues të ndryshëm dhe në bazë të ngashmërive, që ekzistojnë në faktet fizike. Të menduarit e individit *në çdo gjuhe* ndikohet nga *gramatika e gjuhës amtare*, për shkak se dallimet konceptuale gjuhësore ose gramatika e organizon të folurin sipas rregullave gramatikore. Sistemet gjuhësore të gjuhës amtare të mbështetura në norma standarde duhet të shërbejnë, si model për të shprehurit në çdo gjuhë si substancë gjuhësore ose përvojë gjuhësore, që aktivizon procesin e të menduarit në prodhim të thënieve pragmatike në çdo gjuhë. (Hudson, 2002:110; Shkurtaj, 2006:81).

Burenrs, Gudanao dhe Ostin (1956) në studimin e tyre argumentuan për rëndësinë e kategorizimit të informacioneve të ndryshme se:

- Kategorizimi zvogëlon kompleksitetin e perceptimeve të objekteve ose abstraksioneve. Nxënësit duhet t'i grupojnë nëpër klasa, që pastaj ato t'i përzgjedhin nga klasat sipas kategorizimeve të objekteve për të krijuar dije të reja, e jo t'i përdorin të gjithë ata si objekte.
- Kategorizimi lejon të identifikojmë objektet e botës duke i futur në klasa.
- Kategorizimi lejon individët të zvogëlojnë nevojën për të nxenit të qëndrueshëm duke i përdorur kategoritë për klasifikime të informacioneve të reja.
- Kategorizimi siguron këndvështrime për veprimtarit të drejtuara instrumentale (shenja).
- Kategorizimi nxit renditjen dhe lidhjen e klasave. (Musai, 1999:133).

Kategorizimi vlen edhe për fushën e gjuhës në morfologji, ku ka klasifikime të pjesëve të ligjërâtës në klasa dhe kategori, në sintaksë klasifikime të gjymtyrëve të fjalisë sipas kategorive sintaksore të funksionit të gjymtyrëve në fjalë të thjeshtë dhe në sintaksën e fjalisë së përbërë me klasifikime të fjalive sipas kategorive të varshmërisë dhe pavarshmërisë në fjalitë e përbëra. Korrelacioni i njësive gjuhësore të gjuhëve lehtëson të mësuarit e gjuhëve.

Gjuha shqipe është gjuha e parë (Gj-1) për nxënësit shqiptar, ku nxënësit i marrin njohuritë shkencore për gjuhën sipas disiplinave të ndryshme si nga fonetika, morfologjia, sintaksa, leksiku, drejtshkrimi, drejtshqiptimi, përdorimi i shenjave të pikësimit dhe historisë së zhvillimit të gjuhës. Përdorimi i drejtë i gjuhës letrare shqipe është në varshmëri nga përvetësimi i njësive gjuhësore të klasifikuara në kategorizime gjuhësore.

Piaget (1964) argumenton se të kuptuarit e vërtetë të informacionit të ri ndodh, vetëm kur fëmija të ketë fituar shprehitë e informacionit të grupimit nëpër klasa ose të kuptojë se një *kategori mund të përfshihet me të tjera*. Ndërtimi i dijeve me të nxenit zhvillohet me përdorimin e zhvillimit kognitiv, që është sistemuar në memorie në fazë parapërgëtitëse kategoriale, që vetaktualizohet në proces përzgjedhës për ndërtimin e dijeve të reja. Dijet ndërtohen sipas nevojës në përshtatshmëri të situatave komunikuese. (Woolfolk, 2011: 48).

Të mësuarit me përfitim për nxënësin arrihet me anë të mësuarit si *konstruktivizmi kognitiv* vetjak i Piaget (1964) ("formësimi individual i të kuptuarit" ose ndërveprimi individual kognitiv) dhe *konstruktivizmi social* Vigotskit (1978), kur bashkëvepron në grup me të tjerët, në klasë dhe jashtë saj në *hapësira shoqërore* të *ndryshme* ose "*ndërveprimi shoqëror, mjetet kulturore* dhe *aktiviteti formësojnë zhvillimin* dhe të *nxenit individual*", që reflektohet me riprodhim të dijeve të reja me krijimin e përvoja mësimore të *ndryshme*. (Woolfok, 2011: 310).

Konstruktivizmi është të mësuarit me përqendrim te *procesi* dhe jo te *produkti*, si mënyrë për të kërkuar rrugë më të efektshme të mësimdhënes dhe të nxenit. Mesazhet ose stimujt e jashtëm të drejtuara nga individi prej të tjerëve, asnëherë nuk janë kuptuar si transmetime, por ato individi me vetëpërpjekjen e tij i transferon i rindërton për të kuptuar më mirë dukuritë nga jeta reale. (Woolfok, 2011: 310-312). Prandaj mësimdhënësit e shekullit XXI duhet t'i kushtojnë shumë rëndësi procesit të ndërtimit të dijeve, e jo vetëm transmetimit të informacioneve të reja me mësimdhënie tradicionale.

Metodologja e re e mësimdhënes, mësimdhënësin e konsideron si *orientues, menaxhues, motivues, bashkëpunues, hulumtues, dhe vlerësues*, që në vazhdimësi në qendër të vëmendjes e vendos zhvillimin e nxenësit. Të përvetësuarit e gjuhës amtare në norma standarde ndikon në lehtësimin e të mësuarit të gjuhëve tjera, për shkak se individi gjatë përvetësimit të gjuhëve të reja mbështetet në njohuritë gjuhësore të gjuhës amtare. Mësimdhënësit e gjuhëve janë individët kryesor, që duhet t'i motivojnë nxenësit në të mësuarit e gjuhëve duke e demonstruar atë me shembullin vetjak të tyre, me respektimin e vlerave të multilinguizmit dhe plurilingualizmit.

Arsimimi në shekullin XXI duhet ta nxit kureshtjen e nxenësit për interesim të vazhdueshëm për shkencën dhe zhvillimin e saj, *por gjithnjë duhet të jetë më kritike ndaj njohurive të fituara, me shkathtësimin e nxenësve për t'i zbatuar ato njohuri në praktikë* dhe për të zgjidhur probleme të *ndryshme* në situatata të *ndryshme*. Një mësimdhënie e tillë arrihet me rritjen e frytshmërisë së të nxenit, që kërkon *korrelacion* të *njësive mësimore* *ndërmjet lëndëve* të *ndryshme* dhe *planifikime* të *përbashkëta* të *programeve mësimore*.

#### 5.4. Parimet e mësimdhënes së gjuhëve

Në bazë të Ligjit mbi Arsimin Fillor në Gazeten Zyrtare të RM –së Nr.103/08 të vitit 19.08.2008 janë krijuar edhe ligjet, nga të cilat dalin edhe parimet për të punësuarit arsimor në shkolla dhe vet nxenësit. Mjedisi arsimor mund të jetë faktor mbështetës dhe motivues nëse ka në themel vlerat dhe parimet, të cilat ky mjedis synon dhe tenton t'i rrënjosë. Parimet mësimore janë shqyrtuar nga shumë teori shkencore, si nga: Burns dhe Richards (2012: 3); Murati (2002: 104-107); Mustafa (2002:49-58); Zulfiu (2001:60-93); Poljak (1970 :192 -212).

Gjithashtu më 2007 janë miratuar 10 Parimet e Këshillit të Evropës për mësimdhënësit dhe politëkbërësit për zhvillimin e mësimdhënes së gjuhëve dhe vlerën e tyre për

pjesëmarrje në proceset demokratike dhe shoqërore.( [www.ibp-kosovo.org/](http://www.ibp-kosovo.org/) parë më 19.02.2015). Në vijim formuloj 6 parime të kombinuara nga parimet e lartpërmendura për mësimdhënie të suksesshme, ku mësimdhënësit e gjuhëve për të qenë efektiv dhe efikas në mësimdhënie duhet të udhëhiqen nga këto parime :

1. *Parimi i sistematizimit të tërësishëm* realizohet kur të gjithë gjuhët zhvillohen në korrelacion me njëra tjetrën, e jo si të veçanta, ku çdo informacion i ri të mbështet në gjuhën amtare (Gj1). Gjuha si substancë themelore, nxënësit duhet të bëjnë lidhjen e njojurive të çdo lënde mësimore sipas rregullave: *prej së lehtës nga më e rënda, prej të thjeshtës nga e komplikuara, prej të afërmes nga e largëta, prej të njojurës nga e panjohura dhe prej konkretës nga abstraktja.*
2. *Parimi i korrelacionit të mësimdhëniës së gjuhëve* lehtëson kuptueshmërinë e funksioneve gramatikore të çdo gjuhe duke nxitur zhvillimin e aftësive të menduarit *njoħës, kritik dhe krijues* të çdo nxënësi në korrelacion me:
  - *realizimin e njësive mësimore gjuhësore* sipas fushave, klasave dhe kategorive gjuhësore.
  - *analizë morfologjike, sintaksore* në çdo lëndë të gjuhëve.
  - *sintetizimin e njojurive gjuhësore* të çdo gjuhe me sjellje gjuhësore shprehëse në çdo gjuhë(me gojë dhe me shkrim) në përshtatshmëri pragmatike kontekstuale sipas situatave komunikuese, brenda dhe jashtë shkollës.
3. *Parimi i respektimit të autonomisë dhe personalitetit të nxënësit* për të mësuarit e pavarur me nxenie ndërvepruese në aktivitet social me të tjerët në klimë motivuese në klasë. Kusht themelor është grapi si mbështetës i nxënësve për të mësuarit e suksesshëm dhe respektimi i personalitetit të çdo nxënësi me drejtësi, paanësie, mosdiskriminim dhe barazi.
4. *Parimi i respektimit të diversitetit të nxënësve aktual*, që karakterizohet nga motivimet e tyre, nga nevojat, nga aftësitë, nga stilet e të mësuarit, nga historia e të mësuarit dhe trashëgimia kulturore. Procesi i të mësuarit në klasë të jetë hulumtues për mësimdhënie të suksesshme si eksperimentues, reflektues dhe zbulues i modeleve moderne më të efektshme dhe efikase të mësimdhëniës së gjuhëve, e jo të mësuarit uniformë.
5. *Parimi i përgjegjshmërisë së nxënësit* ndaj vlerësimeve të ndryshme si teste, ese, vëzhgime, intervista, portofolie, projekte, prezantime dhe vetëvlerësime.
6. *Parimi i partneritetit multikultural* reflektohet me bashkëpunim në mes mësimdhënësve të gjuhëve me shkëmbimin e përvoja mësimore gjuhësore me respekt të ndërsjellë empatik, që bëhet model për nxënësin me vlerësimin e vlerave të multilinguizmit dhe plurilingualizmit.

## KREU VI

### 6. KOMPETENCAT KOMUNIKATIVE

#### 6.1. Gjuhët përbërës themelorë të kompetencave komunikative

*Kompetenca komunikative* është aftësia e individëve ose anëtarëve të një bashkësie shoqërore të caktuar, për të komunikuar me njëri-tjetrin në kushte të përcaktuara sipas situatës dhe normës gjuhësore, shoqërore, pragmatike etj. (Shkurtaj, 2009:267). Ajo shërbën për funksionimin e kompetencave tjera si: kognitive ose me përvetësimin e normave gjuhësore të çdo për t'u përdorur për realizimin e performancës gjuhësore pragmatike (kujt i drejtohet ? ), ilokutive (çfarë thuhet ? ) ose të qartë, kumtuese e të qëllimshme dhe në përshtatshmëri kontekstuale të situatës komunikuese (ku? dhe kur? zhvillohet komunikimi).

Sipas Austin dhe Searle, kompetencat komunikative përfshijnë katër komponentë:

*Kompetenca gramatikore* (fjalët dhe rregullat).

- *Kompetenca sociolinguistike* (etnografia e të folurit).
- *Kompetenca bisedore* (kohezioni dhe koheranca).
- *Kompetenca strategjike* (riprodhim i thënieve pragmatike nga përvojat komunikuese për komunikim strategjik me përfitime individuale dhe shoqërore). (Shkurtaj, 2009:267).

Kompetenca komunikative vazhdimisht duhet të përceptohet nga tri pikëvështrime:

- *Kushti për përdorimin e çdo varieteti gjuhësor të jetë në përshtatshmëri sociolinguistike.*
- *Komunikimi çdo herë jetë i qëllimshëm me përfshirjen e lidhshmërisë së kompetencave referenciale gjuhësore, shoqërore, emotive, stilistike.*
- *Të njihet varieteti gjuhësor profesional për t'u përdorur funksionalisht në çdo veprimtari.*

Gjuha në aktin e komunikimit shpreh disa funksione:

- *Referencial apo shënjues* (përshtatja e gjuhës me referentin ose me realitetin e jashtëm)
- *Shprehës ose ekspresiv* (disponimi shpirtëror, vullneti dhe sjellja e folësit).
- *Mbartës ose konativ* (gjuha përdoret nga folësi në drejtim pragmatik të dëgjuesit).
- *Metalingusistik* (përdorimi i gjuhës bazuar në përvojat vetjake të folësit, metagjuhësore).
- *Poetik* (përmbytja e mesazhit, organizimin e brendshëm i thënieve në gjuhën që përdoret).
- *Fatik* (kontakti psiko-fiziologjik midis folësit dhe destinuesit përmes kanalit të komunikimit). (Shkurtaj, 2009:271; Poloska, 2007:177; Rrokaj, 2000:46; Jakobson, 1963:213).

## 6.2. Motivimi i individit për arritjen e kompetencave komunikative

Plurilinguizmi është nevojë e domosdoshme e individit modern për komunikim shoqëror. Modernizmi më shpejt arrihet me ndihmën e *plurilinguizmit*, që lehtëson të mësuarit e risteve të nevojshme në shekullin XXI, në çdo veprimtari shoqërore me:

- *Nxitje institucionale nga institucionet shoqërore në veprimtari të ndryshme.*
- *Nxitje nga faktorë jashtëgjuhësorë, si shoqërizimi e bashkëmoshatarë të bashkësive tjera.*
- *Përpjekje vetjake të individit për të qenë fleksibil në çdo veprimtari shoqërore.*
- *Qëndrim pozitiv të vullnetshëm për të mësuar çdo gjë të re në çdo kohë, në çdo vend dhe në mënyrë permanente në solidarizim me të gjithë të tjerët për fisnikërim kulturor vetjak.*
- *Gatishshmëri për të punuar me anëtarë të bashkësive gjuhësore të tjera në çdo veprimtari.*

Individ i sotëm në njëren anë ka liri për vendimmarrje në përzgjedhjen e të mësuarit diçka të re ose gjuhë të re, por në anën tjetër vazhdimesht ka pasiguri për të siguruar ekzistencën jetësore, prandaj në vazhdimeshi rikulturon veten me risi të pandërprera, duke krijuar “një biografi me thyerje”, për shkak se nuk mund të përparojë me modele të veprimtarive të trashëguara. (Beck, Giddens, Lash 1996:96). Në dhjetëvjeçarin e parë të shekullit XXI, orientimi i tregut ka gjetur një zhvillim të pëershpejtuar me zhvillimin e një tregut të ri “*të tregut vetjak të individit*”. (Fromm, 2009:64).

Risitë njëkohësisht bëhen edhe gjasë dhe ngarkesë për çdo njëri. Çdo personi të sotëm i nevojitet vetëdijesimi, vetëndërgjegjësimi, vetërregullimi, vetëvlerësimi dhe vetëdrejtimi për të mësuarit e gjuhëve të huaja si motivim për fisnikërim vetjak për të komunikuar me të tjerët pa pengesë dhe në mënyrë të pavarur me të shprehurit verbal dhe me shkrim për sigurimin e ekzistencës jetësore.

Të mësuarit e gjuhëve mund të ndodh në çdo moshë sipas nevojës, që i paraqitet për të mësuar ndonjë gjuhë të re. Një i rritur i motivuar për t'u bërë folës plurilingual, ka më tepër qëndrueshmëri në të mësuarit e gjuhës së re dhe më lehtë e mëson atë duke i lidhur njohuritë e reja gjuhësore të gjuhës së re (Gj 2), përmes strategjive e të nxënët në mbështetje të njohurive të gjuhës së parë (Gj1) ose të më tepër gjuhëve (Gj3 dhe Gj4).

Motivimi i individit për të mësuarit e gjuhëve gjatë tërë jetës është një objektiv kryesor i individit të shekullit XXI, për shkak se i lehtësohet gjindshmëria e tij në çdo vend, ku vepron dhe i lehtësohet sigurimi i ekzistencës jetësore në sfidën e papunësisë së shekullit XXI, sidomos ato, që futen në biznes.( Mears,1998) (Woolfok, 2011:55).

## II - PJESA DYTË

### KREU I

#### 1. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

##### 1.1. Objekti dhe qëllimi i hulumtimit

Ky hulumtim kishte si objekt shqyrтimi i vleresimit t  vlerave gjuh sore n  komunikim shoq ror n  bashk sin  shoq re multikulturore t  Gostivarit. Motivi p r ta realizuar k t  hulumtim *ishte personal dhe i q llimsh m p r studimet e doktorat s*.

*Q llimi i k tij hulumtimi* ishte t  konstatohet gjendja e multikulturalizmit, multilinguizmit dhe edukimit plurilingual n  qytetin e Gostivarit, prandaj u p rcaktova p r k to objektiva:

- Objektivi i par  ishte t  arrihet deri n  t  dh nat dyt sore relevante nga dokumente zyrtare p r numrin e nx n sve t  shkollave fillore dhe t  mesme n  qytetin e Gostivarit.
- Objektivi i dyt  ishte t  arrihet n  t  dh nat par sore, n  mbledhjen e opinioneve t  drejtor ve, m simdh n sve dhe nx n sve t  shkollave fillore dhe t  mesme p r vler n e t  m suarit t  gjuh ve.
- Objektivi i tret  ishte t  ndri cohет gjendja e nevoj s p r t  m suarit e gjuh ve si domosdoshm ri p r komunikim n  veprimtarit  e ndryshme t  qytetar ve t  Gostivarit.

P rcaktimi i llojeve t  bashk sive gjuh sore bazohej n  tre kritere:

- Statusi i nj  gjuhe n  bashk sin  gjuh sore.
- Statusi socio-ekonomik t  gjuh s s  subjektit anketues.
- Faktor t jasht  komunitetit gjuh sor.

##### 1.2. Zbatimi i hulumtimit

N  k t  hulumtim u respektuan t  gjith  normat etike, q  i jan  parapar  p r nj  hulumtim shkencor. N  fillim me an  t  parashtimit t  k rkess s me shkrim p r marrjen e t  dh nave dyt sore statistikore n  institucionet relevante t  Komun s s  Gostivarit - Sektori p r Veprimtari Publike ia arrita q llimit t  marr  t  dh nat statistikore p r numrin e nx n sve n  shkollat fillore dhe t  mesme publike p r tet  vitet e fundit 2007-2015.

Gjithashtu parashtrova k rkes  edhe n  Universitetin e Pun tor ve n  Gostivar p r t  marr  t  dh na statistikore p r vullnetin e qytetar ve t  Gostivarit, n  m simin e gjuh ve t  ndryshme, mir po fatkeq sish nuk mu mund sua t  arrij  deri n  marrjen e t  dh nave statistikore p r individ t, q  i kan  m suar gjuh t e huaja dhe t  etniteteve q  jetojn  n  k t  qytet.

Të dhënrat parësore u ndriçuan nga anketimi i realizuar me qytetarë të Gostivarit në prill-maj të vitit 2015, që u mundësua me lejen e drejtorëve (që ishin të informuar një ditë më parë) të shkollave fillore dhe të mesme në qytetin e Gostivarit. Gjithashtu u anketuan edhe disa të rritur, që aktualisht janë të punësuar në institucione të ndryshme publike ose private.

### **1.3. Hipoteza**

Gjatë studimit të disertacionit kemi pasur parasysh hipotezën kryesore dhe atë ndihmëse, të cilat i kemi studiuar dhe hulumtuar në mënyrë të detajuar, si në aspektin teorik ashtu edhe nëpërmjet studimit empirik me qëllim të vërtetimit apo jo të këtyre hipotezave

#### **1.3.1. Hipoteza kryesore**

Qyteti i Gostivarit është shembull i bashkëjetesës multikulturore si një nga qytetet më të mëdha multikulturore dhe multilinguale në Republikën e Maqedonisë, falë zotërimit të shumë gjuhëve nga shumica e qytetarëve të saj.

*Mësimi i gjuhës angleze ose “gjuha elitare botërore” është gjuha më e kërkuar nga nxënësit e tri komuniteteve, por gjuha më e zbatuar në komunikim shoqëror në Gostivar është gjuha shqipe. Të gjithë nxënësit dhe qytetarët e Gostivarit, pa marrë parasysh përkatësinë etnike i çmojnë lartë vlerat plurilinguale, që i posedojnë shumica e qytetarëve, si nevojë e domosdoshme për komunikim, karrierë dhe respekt të ndërsjellë midis tyre.*

#### **1.3.2. Hipoteza ndihmëse**

- Në qytetin e Gostivarit individët folës janë bilingual të dyanshëm, kryesisht midis komunitetit gjuhësor shqiptar dhe turk, kurse midis komunitetit maqedonas ka më pak individ folës bilingual, që zotërojnë dy gjuhët tjera.
- Folësit bilingual duhet të kenë përparësi në statusin e tyre socio-ekonomik edhe në atë që ne e quajmë prestigj shoqëror.
- Gjuha maqedonase më tepër zotërohet nga të dyja komunitetet gjuhësore, ajo shqipe dhe turke, si gjuhë kryesore dhe zyrtare nëpër institucionet shtetërore dhe lokale.
- Nxënësit, që e shohin ardhmërinë në vend dhe duan të punojnë në administratë, janë më të interesuar, që krahas përsosmërisë së gjuhës amtare, ta mësojnë edhe gjuhën e shumicës si dhe gjuhën e etniteteve tjera, përshkak se mendojnë se do t'u nevojitet në karrierë.
- Nxënësit, që karrierën e shohin jashtë shtetit, investojnë më tepër në mësimin e gjuhëve të huaja, sidomos në të mësuarit e anglishtes dhe gjermanishtes.

## 1.4. Variablat e hulumtimit

Hulumtimi do të përfshijë tri grupe të folësve bilingual. Grupin e parë të anketuesve bilingual (D1) do ta përbëjnë folësit e gjuhës shqipe dhe maqedonase, grupin e dytë e anketuesve bilingual (D2) do ta përbëjnë folësit të gjuhës shqipe dhe gjuhës turke grupin e tretë do ta bëjnë folësit një gjuhësor nga Gostivari (Nj). Gjithashtu në hulumtim me siguri do ndriçohen edhe të folësve plurilingual (Sh). Gjatë analizës nga variabla e parë e përcaktua gjuha e etnitetit, u paraqitën edhe mosha dhe gjinia e të anketuarve.

## 1.5. Metodat, teknikat dhe instrumentet e hulumtimit

Në këtë hulumtim u përdoren metoda deskriptive teorike shkencore, ku u shqyrtua literatura për plurilingualizmin, bilinguizmin, multilinguizmin. Gjithashtu në fushën praktike hulumtimi u realizua me metodën empirike me anë të anketimit, të bisedës në Fokus Grup, të bisedës me intervista, metoda krahasimtare, statistikore, e analizës sasiore dhe cilësore.

Në këtë hulumtim u përdoren pyetësorë me pyetje të hapura dhe të mbyllura, sipas modelit të zyrës së UNICEF-it dhe modelit të pyetësorit të paraqitur në librin “Metodat e Hulumtimit” (Matthews, B dhe Ross Liz 2010:208). Pyetësorëve iu shtuan edhe disa pyetje në lidhje me zbatueshmërinë e gjuhëve të huaja në kurrikulën mësimore të paraparë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë, që aktualisht zbatohet edhe në shkollat fillore të Gostivarit.

Për vlefshmërinë e hulumtimit u përdoren disa qasje me anë të pyetësorëve të ndryshëm për të arritur deri në të dhëna të besueshme dhe u zhvilluan edhe disa intervista. Anketimi u realizua me pyetësorë në të *tri gjuhët amtare të anketuarve* sipas përkatësisë etnike.

1. *Pyetësorë-A* për drejtorë të shkollave (12 pyetje të hapura në pritje të përgjigjeve alternative)
2. *Pyetësorë-B* për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme (20 pyetje të hapura në pritje të përgjigjeve alternative)
3. *Pyetësorë-C* orientues për diskutim në Fokus Grupe të vogla për arsimtarët / profesorë të shkollave fillore dhe të mesme (10 pyetje të hapura dhe gjysmë të strukturuara)
4. *Pyetësorë-D* për punëtorë administrativ, shitës, tregtarë ( 10 pyetje të strukturuara sipas shkallës Likert.)
5. *Intervista* me anëtarë të familjeve me martesa

## 1.6. Popullacioni dhe mostra

Popullacioni ynë në komunën e Gostivarit me rrëthinë ishte heterogen, për shkak se jetojnë tre komunitete gjuhësore: ai shqipe, maqedonase dhe turke, prandaj anketimi u zhvillua me mostër nga të tre komunitetet. Mostra jonë ishte e qëllimshme, e zgjedhur

rastësisht, ku u përfshin 206 qytetarë të Gostivarit. Anketimi u zhvillua në shkolla fillore me 4 drejtorë, 70 nxënës në klasave të VIII-ta dhe 30 arsimtarë të lëndëve të gjuhëve. Në shkolla të mesme u anketuan 2 drejtorë, 60 nxënës të viti të III-të dhe 10 profesorë të lëndëve të gjuhëve. Gjithashtu për të arritur në ndriçimin e opinionit e të rriturve u anketuan me pyetësorë 30 punonjës të administratës, shitës, tregtar, mjek, motra medicinale që përballen me sfidat jetësore të përditshmërisë për të siguar ekzistencën.

Gjatë hulumtimit na u nevojit të dëshmojmë se në qytetin e Gostivarit ka shumë martesa të përziera me individ të etniteteve të ndryshme, prandaj zhvilluan edhe 16 intervista me anëtarë të këtyre familjeve për të dëshmuar se të folurit bilingual dhe multilingual fillon në gjirin familjar.

### **1.7. Interpretimi, analiza, rezultatet, përfundimet dhe rekomandimet**

Gjetjet e këtij hulumtimi u interpretuan në tabelat statistikore, u analizuan, u diskutuan deri sa arritëm në ndriçimin e përfundimeve për përdorimin e dygjuhësisë ose të shumëgjuhësisë në institucionet shkollore dhe në zbulimin e vullnetit të qytetarëve për të mësuar më tepër gjuhë në bashkësinë shoqërore të Gostivarit. Analiza e të gjithë të dhënavë të përgjithësuara kontribuoi në arritjen e ndriçimit të përfundimeve dhe rekomandimeve. Rezultatet e hulumtimit mund të shfrytëzohen edhe për individ tjerë, MASH, BZHA, etj.

### III. PJESA EMPIRIKE

#### KREU I

##### **1. INTERPRETIMI STATISTIKOR I TË DHËNAVE DYTËSORE**

###### **1.1. Pozita e qytetit të Gostivarit**

Qyteti i Gostivarit ndodhet në Republikën e Maqedonisë, në jug të fushës së Pollogut dhe është i rrethuar nga dy male, Mali Sharr dhe Mali i Thatë. Në afërsi të qytetit ndodhet fshati Vërtok prej ku buron lumi Vardar, që e ndan qytetin në dy pjesë dhe vazhdon të rrjedh në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë deri në Greqi. Faktorët gjeografik e bëjnë këtë qytet të jetë i dëshirueshëm për ata, që e vizitojnë.


###### **1.2. Demografia e popullsisë në Gostivar**

Në bashkësinë shoqërore të Gostivarit reflektohen popuj me kultura të ndryshme si shqiptarë, maqedonas, turq, romë e të tjerë dhe reflektohen me bashkësi gjuhësore si gjuha shqipe, maqedonase, turke etj. Në këtë bashkësi shoqërore multikulturore të gjithë qytetarëve u mundësohet të arsimohen, të punësohen dhe të kryejnë veprimitari sipërmarrësie në qytetin e tyre. Në Gostivar funksionojnë 11 shkolla fillore me 20 shkolla periferike, 4 shkolla të mesme publike, 2 shkolla të mesme private dhe dy universitete private.

Të dhënat statistikore janë marrë nga publikimet e Entit Shtetëror të Statistikës i numrit të popullsisë sipas përkatësisë kombëtare. ([www.stat.gov.mk/14.04.2015](http://www.stat.gov.mk/14.04.2015)). Këto të dhëna pasqyrojnë aspektin multikulturor-multilingual dhe bashkëjetesën e qytetarëve në qytetin e Gostivarit.

**Tabela.1. Demografia në qytetin e Gostivarit sipas Regjistrimit të vitit 2002**

Klasifikimi i popullsisë sipas etniteteve në qytetin e Gostivarit në Regjistrimin e vitit 2002									Gjithsej
Etnitetet	Shqiptarë	Maqedonas	Turq	Romë	Vllez	Serb	Bosnjakë	Të tjerë	
Numri i popullsisë	54 038	15 877	7 991	2 237	15	160	39	685	81 042
Në %	66,60 %	19,50 %	9,80 %	3,80 %	0,01 %	0,19%	0,04 %	0,84 %	100,00 %
Klasifikimi i popullsisë sipas gjinisë në Regjistrimin e vitit 2002									
Gjinia	Femra			Meshkuj					Gjithsej
Numri	40 535			40 507					81 042
Në %	50.01%			49.99%					100%



**Figura nr.1.** Demografia në qytetin e Gostivarit sipas Regjistrimit të vitit 2002

Situata sociologjike e dygjuhësise paravendos përdorimin e njëhershëm dhe konkurrent të dy gjuhëve në të njëjtën hapësirë gjeografike, ekonomike ose politike. Aty janë të pranëvëna dy bashkësi gjuhësore të dallueshme dhe mund të shihet mjaft lehtë se statusi individual është dygjuhësia. Në një situatë politiko-shoqërore të dygjuhësise mund të jetohet, pa qenë të gjithë anëtarët e bashkësisë dygjuhëshe (bilinguale). Në trevat shqiptare të Republikës së Maqedonisë shumë qytetarë shqiptarë nuk dinë asnje fjalë sllavisht apo e kundërtë, por anëtarët e të dy etniteteve bashkëjetojnë, edhe pse statusi i gjuhëve në nivel lokal është i barabartë. Kjo duhet të ndodh edhe në nivel të tërë shtetit, për shkak se sjellë harmonizim te të dy etnitetet më të mëdha të popullsisë së Republikës së Maqedonisë.

### 1.3. Etimologjia e emërtimit të Gostivarit

Të gjithë legjendat për etimologjinë e fjalës Gostivar orientojnë drejt një bindjeje se ky qytet është emërtuar nga “veprimtaria e mikpritjes së mysafirëve të llojullojshëm nga vet vendasit”. Në këtë territor me pozitë gjeografike dhe klimë të përshtatshme për pushim, më parë janë ndalur të pushojnë udhëtarë të lodhur, që kanë ardhur nga vende të ndryshme.

Në bazë të legjendës “Gocës së Tivarit” flitet se një murgeschë nga Tivari është ndalur të pushojë disa ditë në një han të këtij vendi. Ajo pasi ka qëndruar disa ditë në këtë vend e vëren mikpritjen e vendasve dhe vendos t'i shpërblejë ato me ndërtimin e një manastiri. Sjellja e saj humane është përmendur shumë nga vendasit, ashtu që edhe qyteti emërohet sipas prejardhjes së saj “Goca e Tivarit”. (Kraja dhe Haruni 1995:9).

Në bazë të emërtimit të bërë nga goca e Tivarit, ofrojmë sqarimin e fjalës së përngjitur Gostivar, që në latinisht është “*Genstivi*” me domethënie në shqip “*vend multikulturor*” dhe tani Gostivar. Në versionin e kombinimit të fjalëve latine “*Gens*” dhe “*Varius*”, kjo fjalë do të thotë “*vend i popujve të ndryshëm*” ose “*vend me popullatë multikulturore*”. Në bazë të fjalorit të gjuhës angleze fjala e përngjitur domethënë “*vend i miqve të ndryshëm*” ose “*vend i mysafirëve të ndryshëm*”. Këtë e argumentojmë në bazë të fjalorëve të ndryshëm gjuhësorë:

- Fjala “Varius” në fjalorët latinisht do të thotë i ndryshueshmëm, i llojlojshmëm, larmi. (Batosova 2000 :173).
- Fjala “Gens” në fjalorët latinisht do të thotë popull, fis. (Batosova 2000:158).
- Fjala “guest” në fjalorin e gjuhës angleze do të thotë vizitues, mysafir, i ftuar, klient hoteli. (Çuçka, 2006:356: Dajkoviç, 1986:145; Stefanlari, 1996:306).
- Fjala “vary” ose sinonimi “ diversify” në fjalorin e gjuhës angleze do të thotë shumëllojshmëri, ndryshueshmëri, (Stefanlari, 1996:306; Dajkoviç, 1986:3838; Hysa, 2002).

Etimologjia e emrit të qytetit të Gostivarit , “*diversitate kulturore dhe gjuhësore*” është tregues i një periudhe të vonshme historike, për shkak se murgeshat janë paraqitur me krijimin e fesë krishtere dhe e kanë përhapur gjuhën *latine si superstrate mbi gjuhët tjera, saqë ka ndikuar edhe në emërtimin e qytetit Gostivar. Ky qytet me siguri, ka pasur ndonjë emër tjetër, edhe atë emër shqiptar, për shkak se popullsia shumicë autoktone e këtij qyteti ka qenë dhe akoma është shqiptare.* Në këtë territorë janë bërë edhe shumë mbishtresime gjuhësore të tjera si ato sllave, turke e më vonë gjermane, italiane, frëngje dhe angleze, por folësit e gjuhës shqipe ndikuan në ruajtjen e vitalitetit të saj. Kjo gjuhë *akoma reflektohet si degë e vetme në familjen e gjuhëve indoевropiane.*

#### **1.4. Ndkimi i faktorit ekonomik në zhvillimin e gjuhëve**

Komuna ofron kushte lehtësuese edhe për investime të llojlojshmës për të gjithë të interesuarit nga jashtë, që aktualisht reflektohet me zhvillimin ekonomik të vendit duke mundësuar hapjen e vendeve të reja të punës për të gjithë qytetarët. Sipërmarrësia është reflektuar te vendosit si meritë e kompetencave arsimore të arritura në universitet të ndryshme brenda dhe jashtë shtetit.

Vendasit kanë filluar të zhvillojnë turizmin, sidomos rreth Lumit Vardar, ku vazhdimisht vërehet prania e turistëve nga vende të tjera. Ky vend ka natyrë të mirë me male dhe fusha, që u mundëson qytetarëve të zhvillojnë veprimtarinë e blegtorisë dhe bujqësisë. Gjithashtu vendi ka resurse natyrore si drunj, gur mermeri, silicium, gëlqere etj.

Mjaft qytetarë të Gostivarit për shkaqe politike dhe ekonomike në të kaluarën janë larguar nga vendlindja e tyre duke u vendosur edhe në vende të ndryshme të botës. Mërgimtarët me vizitat e tyre të përkohshme sjellin në vendlindje edhe përvaja vetjake të arritura në vende të ndryshme, që ndoshta edhe fillojnë t'i zbatojnë në qytetin e tyre, kur rikthehen të banojnë. Gjithashtu ata paraqiten edhe si një urë lidhëse për kulturën e vendit tonë me kulturat e vendeve tjera.

#### **1.5. Diversiteti linguistik në bashkësinë shoqërore të Gostivarit**

*Në bashkësinë shoqërore të Gostivarit reflektohen disa bashkësi gjuhësore të ndryshme, me të cilat flasin grupe të caktuar individësh. Grupi i folësve të bashkësive gjuhësore shqiptare si mjet shprehës funksional e përdor gjuhën shqipe, grupi i folësve turq si mjet shprehës e përdorin gjuhën turke, kurse grupime tjera të bashkësive gjuhësore rome, bosnjake, Serbe, etj si mjet shprehës e përdorin gjuhën maqedonase, që është edhe gjuhë zyrtare në Republikën e Maqedonisë.*

Të gjitha këto gjuhë përdoren në qytetin e Gostivarit si pasojë e gjuhëve në kontakt me kryqëzimin e gjuhëve brenda territoriale dhe jashtë territoriale, për shkak të pozitës gjeografike dhe faktorëve historik. Në mbështetje në teorive gjuhësore të gjuhëtarëve (Poloska 2001: 27-41; Rrokaj 2000:166), pasqyrohet edhe klasifikimi e gjuhëve në familje, që përdoren në qytetin e Gostivarit, edhe atë të:

1) *Familjes indoevropiane:*

- a) *gjuha shqipe* flitet në familje si gjuhë amtare dhe përdoret në institucionë.
- b) *gjuhët sllave*: gjuha maqedonase, sllovene, sérbe, kroate.
- c) *të degës gjermane*: gjuha angleze dhe gjuha gjermane në institucionë arsimore.
- ç) *të degës rumune*: gjuha arumanishtja flitet në familje me martesa të përziera.
- d) *të degës indiane*: gjuha rome flitet në familje si gjuhë amtare.

2) *Familjes altaike*: gjuha turke

3) *Familjes semito-hamite*: *gjuha arabe* (e grupit semit), që mësohet në Medresen e Gostivarit.

*Gjuha shqipe u zhvillua në vazhdimësi si gjuhë kombëtare, ashtu që flitet tani edhe nga nga gjeneratat e sotme. Kjo gjuhë u përpunua në gjuhë standarde dhe filloj të institucionalizohet në sisteme arsimore. Nxënësit aktual, që mësojnë në sistemin arsimor fillor të 2015, në të ardhmen do të zotërojnë pesë gjuhë nga tri familjet e gjuhëve botërore.*

## 1.6. Varietet gjuhësore-gjeografike në Maqedoni

Varietetet gjeografike të gjuhës shqipe janë varietete dialektore gege dhe toske.

1) Varieteti dialektor i toskërishtes reflektohet me të folurit në territore të caktuara:

- *varietetet e toskërishtes veriore* (*varieteti i Beratit, i Fierit, i Skraparit, i Pogradecit, i Korçes, i Kolonjës, i Përmetit, i Tepelenës, i Vlorës*).
- *varietetet e toskërishtes jugore* të ndara në dy varietete:
  - a) *varieteti i labërishtes*, ku përfshihen të folmet e Labërisë dhe të të Gjirokastrës
  - b) *varieteti i çamërishtes*, ku përfshihen *varietetet e Konispolit, e Çamërisë deri te Gjiri i Prevezës* dhe *varietetet e Maqedonisë*, në fshatra të Prespës dhe të Strugës.

2) Varieteti dialektor i gegërishtes përfshin katër varietetet nëndialektore:

- *varietetet e gegërishtes veriperëndimore* (*varieteti i Shkodrës, i Krajës, i Malit të Zi* (i Ulqinit dhe Tivarit) dhe *varieteti i Dalmacisë* në Kroaci (fshati Arbanas, në afërsi të Zarës)).
- *varietetet e gegërishtes verilindore* (të folmet e Shqipërisë verilindore dhe të Kosovës).

- *varietetet e gegërishtes qendrore (varietetet e Shqipërisë, të Lurës, të Lumës, të rrëthit të Dibrës dhe varietetet e Maqedonisë Perëndimore si varieteti i Dibrës, i Kërçovës, i Tetovës, i Gostivarit, i Shkupit dhe i Kumanovës.*
- *varietetet e gegërishtes së Shqipërisë së Mesme* konsiderohet si e folmja më mirë e gjuhës shqipe, ku përfshihen varieteti i Tiranës, i Durrësit dhe i Elbasanit.

*Gjuha maqedonase* përbëhet nga 27 varietete të klasifikuara në tri grupe varietetesh dialektore, në varietete nëndialektore dhe krahinore. Varietet e gjuhës maqedonase janë:

1. *Varieteti verior* klasifikohet në dy grupe:

a) Grupi i varietetit perëndimor reflektohet në : varieteti i Pollugut të Poshtëm, varieteti i Shkupit – Malazezë, varieteti i Goranës.

b) Grupi i varietetit verior reflektohet në: varieteti i Kumanovës, varieteti i Kratovës, varieteti i Kriva-Pallankës, varieteti i Ovçepoles.

2) *Varieteti perëndimor dhe veriperëndimor i Maqedonisë*, që klasifikohet në dy grupe:

a) Grupi i varietetit qendrore reflektohet si: varieteti i Manastirit dhe Prilepit, varieteti i Kërçovës dhe Poreçit, varieteti i Shkupit dhe Velesit.

b) Grupi i varietetit perëndimor dhe veriperëndimore i Maqedonisë reflektohet në: varieteti i Pollogut të Epërm, varieteti i Rekës, varieteti i Galicnikut, varieteti i Dibrës , varieteti i Drimkopit dhe Golobërdos, varieteti i Vevçanit dhe Rodoshës, varieteti i Srugës, varieteti i Ohrid, varieteti i Prespës së Epërme, varieteti i Prespës së Poshtme.

3) *Varieteti Juglindor* reflektohet me të folurit në territorin e Maqedonisë Lindore, Maqedonisë Pirine dhe Maqedonisë së Egjeut. Ky varietet tani flitet më tepër jashtë kufijve të Republikës së Maqedonisë dhe klasifikohet në tri grupe: lindor, jugperëndimore dhe juglindor.

a) Grupi i varietetit lindor reflektohet në: *varietetet i Tikveshit – Mariovës, varietetet i Shtipit – Koçanit, varietetet i Strumicës dhe varietetet i Maleshevës – Pirinit.*

b) Grupi i varietetit jugperëndimor reflektohet në: *varietetet i Nestram-Kostenar, varietetet i Korçanit dhe varietetet i Kosturit.*

c) Grupi i varietetit juglindor reflektohet në: *varietetet i Selanikut-Vodenit dhe varietetet i Serës-Dramës-Lagadinës-Nevrokopës.*

*Gjuha turke* Gjuha turke ka shumë varietete gjuhësore, por varieteti i Stambollit është marrë si bazë për krijimin e gjuhës letrare turke. (<https://mk.wikipedia.org/wiki>).

## 1.7. Standardizimi i disa gjuhëve ballkanike

### 1.7.1. Standardizimi i gjuhës shqipe

Standardizimi i gjuhës shqipe: Iniciativa e parë për standardizimin e gjuhës shqipe ishte shprehur nga periudha e Rilindjes Kombëtare, mirëpo në vazhdimësi ishte kundërshtuar nga të tjerë, për shkak se disa në atë ishin mbështetës së gjuhës, turke, greke dhe më vonë gjuhës italiane. Kjo ide edhe pse ishte kundërshtuar me fanatizëm nga xhonturqit, fitoi mbështetjen e saj menjëherë pas krijimit të alfabetit të gjuhës shqipe në Kongresin e Manastirit më 14-22 nëntor 1908, ku ishin të pranishëm 160 delegatë shqiptarë.

Instituti i Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës (USHT) mori iniciativë për Standardizimin e Gjuhës Letrare Shqipe në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe më 20 tetor deri më 25 nëntor 1972 në Tiranë, ku ishin të pranishëm 87 delegatë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe arbëreshë nga Italia.

Më 15-17 dhjetor 2010 në Durrës u mbajt Konferenca Shkencore "Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit", ku morën pjesë 40 studiues dhe sollën 12 përfundime. Në pikën e 8 theksohet: "*të studiohet mundësia e integrimit të paskajores gege në standardin e shqipes*".

### 1.7.2. Standardizimi i gjuhës maqedonase

Standardizimi i gjuhës maqedonase është bërë më 1945, por ka pësuar disa ndryshime në 5 maj 1950 nga Blazhe Koneskit në bashkëpunim me Krume Toshev në formulimin e "Drejtshkrimin e Gjuhës Letrare Maqedonase", pastaj ka pësuar disa ndryshime edhe në vitin 1970 dhe në vitin 1988. ( shih: [mk.wikipedia.org/wiki](http://mk.wikipedia.org/wiki)).

### 1.7.3. Standardizimi i gjuhës turke

Standardizimi i gjuhës turke fillon më 1924, kur bëhet propozimi i parë për ndryshimin alfabetit turk, ku shkronjat arabe do të zëvendësohen me ato latine (Harf Devrimi). Parapërgatitja ka zgjatur katër vjet dhe më 1 nëntor 1928 realizohet me sukses "Fjalori i Drejtshkrimit (<http://eprints.ugd.edu.mk>). Ky drejtshkrim më 1941 pëson ndryshime më 12 korrik 1932, kur hartohet Fjalori dhe Drejtshkrimi i Parë Turk ( pa fjalë arabe). (Lewis, 1999: 45). Ky fjalor përdoret 24 vite dhe botohet 6 herë (1941, 1948, 1956, 1957, 1960, 1962). Më 1965 është vendosur të hartohet Drejtshkrim i Ri, që botohet më 1985, pëson ndryshime disa herë më 1987, 1988, 1990, 1996. Drejtshkrimi i ri pas përdorimit disavjeçar botohet më vitin 2000 dhe më vitin 2012. (<http://eprints.ugd.edu.mk>).

*Gjuha shqipe* në të folurit e shqiptarëve të Gostivarit reflektohet me *varietetin standard* dhe *varietetin nëndialektor* të *gëgërishtes qendrore*, por për shkak të martesave

monolinguale ose bilinguale me individ nga shumë vende të ndryshme, vërehen edhe varietete të tjera të krijuara nga ideolektet.

*Gjuha maqedonase në Gostivar përdoret sipas varietetit standard dhe varietet perëndimore me varietetin e Pollogut të Epërm.*

*Gjuha turke* në Gostivar flitet me varietetin standard dhe me varietetin e Rumelisë Perëndimore sipas Olivera Jashar (K.K.G-II-të 1970), kurse disa të dhëna nga tjera argumentojnë se në të folurit turk në Gostivar reflektohet varitetit *e Edrenes*, që në të kaluarën është shtresuar nga turqit e ardhur nga brigjet e lumit Evros në afërsi të Edrenes.

### **1.8. Zhvillimi i gjuhëve në institucione arsimore në qytetin e Gostivarit**

Në Gostivar në të kaluarën e hershme, *në periudhën ilire, shqiptarët janë dalluar për kulturën e vet, por në vazhdimësi kanë pasur presione greke, latine dhe më vonë edhe atyre sllave dhe turke u argumentua nga Petro Januara*. Nevoja për ekzistencializëm jetësor i ka detyruar shqiptarët dhe sllavët të komunikojnë në mes veti me gjuhët e kontaktit për t'i shkëmbyer përvojat e tyre. Shqiptarët ua kanë mësuar sllavëve kulturën blegtorale, kurse sllavët ua kanë mësuar shqiptarëve kulturën bujqësore. Kjo ka ndikuar në ngritjen ekonomike të dy popujve. (Janura, K.K.G II-të 1970:206).

Gjuha shqipe dhe maqedonase gjatë periudhës turke kanë qenë të rrezikuar nga mbishtresimit i superstratit turk. Në këtë periudhë gjuhët janë zhvilluar për komunikim shoqëror në mënyrë verbale për shkëmbimin e përvojave për mjeshtëritë e zejtarisë nga mjeshtërit kryesorë tek ato të rinj. Në shekullin XVIII-të janë vendosur në funksion shkollat e para fetare medresetë në Vrapçisht, kurse në të shekullin XIX-të janë hapur edhe disa sibjan-mejteb. Në vitin 1910 janë bërë përpjekje për hapjen e shkollës së parë shqipe në fshatin Negotinë, por edhe ajo ka dështuar për shkak të reagimeve të shumta të hoxhallarëve.

Më vitin 1912 disa përparimtarë përsëri janë përpjekur për hapjen e shkollës së mësuesve “Ruzhdija” në fshatin Vrapçisht, por edhe ajo ka dështuar, për shkak të bindjes fetare dominuese të asaj periudhe, që e ka penguar përparimin e arsimit, mirëpo edhe ato sibjan-mejtepe s’kanë funksionuar shumë gjatë së shpejti janë ndalur së funksionuari, për shkak të paraqitjes të sunduesve të rinj.

Populli i Maqedonisë si shqiptarë, maqedonas, turq dhe të tjerë, pas çlirimt nga sunduesi shumëshekullor turk dhe pas Luftës së Parë Botërore, nuk e kanë ndjerë veten të gëzuar, por të zhgënjer, për shkak se premtimi i bërë nga serbët para çlirimt bëhet “*shpresë mashtruese për liri*”. Premtimi i serbëve para luftës se në kornizën e bashkësisë së re “të gjithë do të arrijnë lirinë e vërtetë kombëtare dhe sociale me të drejtë të barabarta bëhet një mashtrim. Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve bëhet pushtues i ri. (Isovski, K.K.G I-rë 1970:298).

Pakënaqësia e popullatës së Maqedonisë është reflektuar, për shkak të mospranimi të asnjë vlere kombëtare të vendasve: *emrit, gjuhës, kulturës*, por është pranuar vetëm një gjë,

të gjithë të identifikoheshin *si popull serb, ndërsa territori i Maqedonisë të quhej Serbia Jugore.* (Isovski në K.K.G I-rë 1970:298). Më 1913 shumica e shqiptarëve janë larguar nga trojet e veta në drejtim të shteteve tjera, në fillim drejt Stambollit e më vonë në Rumani Bullgari, Çeki, Gjermani, Austri, Zvicër, Itali, Australi dhe SHBA. (Shabani 2015:203).

Në shekullin XX, më 1912 -1916 fillon arsimimi në gjuhën serbo-kroate për gjithë pupullin e Maqedonisë (pa dallim kombësie), por në kushte shumë të vështira. Pushtuesit serb si qëllim kryesor e kanë pasur mospërparimin e vendasve, nënçmimin e tyre, asimilimin e tyre, shkombëtarizimin e popullit dhe përhapjen e sllavizmit. Më 1918 hapen shkollat e para katërvjeçare në gjuhën serbe në Gostivar me mësues të përgatitur me kurse nga Serbia, Kroacia, Mal i Zi dhe Sllovenia, që kanë ngelur të jetojnë në Gostivar .(Veseli 2000:9).

Më 1920 shkollat serbe fillojnë të funksionojnë edhe për popullatën shqiptare dhe turke (në gjuhën serbe kuptohet) me mësim pesëvjeçar, ku vitin e parë është mësuar e gjuha serbe. Mësimi është zhvilluar në shtëpi private, xhamia, kisha, pa kushte të mira higjenike dhe pedagogjike. Në Shkup më 1925 ka funksionuar një shkollë mësuesie me kurse tremujore, gjashtëmuajore, tetëmbëdhjetëmuajore dhe dyvjeçare. Gjendja e tillë në Maqedoninë Perëndimore, Kosovë, Malit të Zi dhe Preshevë, ka zgjatur deri më 1941, kur ndodhi edhe kapitullimi i Mbretërisë së Serbëve Kroatëve dhe Sllovenëve, që nga mbreti Aleksandër ishte emërtuar *Mbretëria e Jugosllavisë* më 1 tetor 1929. Në Gostivar 1933/34 ka funksionuar një gjimnaz. (Isovski, K.K.G I-rë 1970:298).

### **1.9. Gjuha shqipe në shkollat fillore në nënprefekturën e Gostivarit (1941-1944)**

Në periudhën 1941-1944 edhe në rrethin e Gostivarit kanë funksionuar 35 shkolla fillore, por të gjitha në gjuhë serbe ( Veseli, 2000:12; Isovski, K. K. G. -I-rë 1970:302). Isovski thekson se në fillim kanë funksionuar 30 shkolla dhe më vonë janë hapur edhe 5 shkolla fillore, por të gjitha kanë funksionuar *në gjuhën serbe në këto vende:* Gostivar, Banjicë e Poshtme, Banjicë e Epërme, Llakavicë, Kunovë, Sërmnovë, Tërnovë, Lumi i Hekurt, Gjonovicë, Takmisht, Sretkovë, Cerovë, Sushicë, Belisht, Belindoll, Çajle, Forinë, Çegrane ,Tumçevisht, Dobri Dol, Toplicë, Pozharan, Galatë, Vrapçisht, Zubovcë, Debresh, Zdunjë, Jellovca e Poshtme, Jellovca e Epërme, Peçkovë, Raven, Vërtok, Reçan, Duf, Leunovë, Mavrovë, Niqiforov.

Në periudhën 1941-1944 Gostivari dhe Tetova historikisht janë dalluar si qendra më aktive kombëtare shqiptare. Gjatë periudhës së Mbretërisë Jugosllave fëmijët e këtij rrethi janë arsimuar në shkollat fillore, pastaj një pakicë e nxënësve arsimimin e tyre e kanë vazhduar në Medresen e Shkupit, Gjimnazin e Tetovës dhe Gjimnazin e Manastirit, por vazhdimisht të penguar për mospërparim intelektual, të diskriminuar në vlerësimin formativ nga profesorët serb. Ato nuk kanë arritur të përfundojnë arsimimin e vet me marrje të

diplomave nga institucionet e atëhershme. Shkollat serbe janë rikthyer me mësim në gjuhën shqipe në vitin 1941 sipas hulumtimeve të Veselit (2000:18):

1) Shkolla e parë shqipe "Naim Frashëri" më 29.11.1941 vendoset në ndërtesën e ndërtuar më vitin 1903, që është rinovuar dhe është zgjeruar në vitin 1908. Kjo shkollë është hapur me meritën e nënprefektit të atëhershëm të Gostivarit Xhevati Kallajxhiu nga Gjirokastra dhe ka pasur 400 nxënës. Nënprefekti i atëhershëm me punën e tij monitoruese është bërë nxitës dhe motivues i qytetarëve të Gostivarit për zhvillimin e arsimit. Në fund të vitit 1943/44 ka pasur 474 nxënës (386 meshkuj dhe 88 femra). Kjo shkollë në vitin 1983 është rrënuar nga udhëheqësia e atëhershme dhe në vendin e saj është ndërtuar objekt i elektro-ekonomisë dhe Pallati i Kulturës në Gostivar.



**Figura.1.9.1.**Fotografia e shkollës së parë shqipe pesëvjeçare në Gostivar

- 2) Shkolla Fillore "Agimi" në fshatin Dobridoll me 103 nxënës (87 meshkuj dhe 16 femra);
- 3) Shkolla Fillore "Seit Najdeni" në fshatin Vrapçisht 174 nxënës meshkuj;
- 4) Shkolla Fillore "Kristoforidhi" në fshatin Debresh me 118 nxënës (102 meshkuj dhe 16 femra);
- 5) Shkolla Fillore "Liria" në fshatin Reçan me 173 nxënës (162 meshkuj dhe 12 femra)
- 6) Shkolla Fillore "Ismail Qemali" në fshatin Banjicë të Epërme dhe Banjicë të Poshtme, me 94 nxënës (74 meshkuj dhe 20 femra);
- 7) Shkolla Fillore "Bajram Curri" në fshatin Banjicë e Poshtme ka filluar të funksionoë (1942/1943) me 148 nxënës, prej të cilëve 125 meshkuj dhe 23 femra;
- 8) Shkolla Fillore "Antin Matea" në fshatin Duf 55 nxënës (33 meshkuj dhe 22 femra) klasa e I-rë;
- 9) Shkolla Fillore "Gërmjeni" në fshatin Çajlë ka funksionuar më (1942/1943) me 54 meshkuj;
- 10) Shkolla Fillore "Avni Rustemi" në fshatin Çegran me 43 nxënës, të gjithë meshkuj;
- 11) Shkolla Fillore "Drita" në fshatin Forinë me 42 nxënës meshkuj; 12) Shkolla Fillore "Dud Karbunara" në fshatin Zdunjë me 46 nxënës, 38 meshkuj dhe 8 femra;
- 12) Shkolla Fillore "Hoxha Tahsini" në fshatin Llakavicë me 46 nxënës (29 meshkuj dhe 17

femra);

13) Shkolla Fillore “Anastas Pandeli ” në fshatin Vërtok ka funksionuar me 46 nxënës, 29 meshkuj dhe 17 femra;

14) Shkolla Fillore “Ali Agjah Beu”në fshatin Vërtok ka funksionuar 30 nxënës meshkuj (1942/1943); 16) Shkolla Fillore“Agimi”në fshatin Jellovcë ka funksionuar me 27 nxënës meshkuj(1942/19432). (Veseli 2000:18).

Gjuhët vendase të ishin zhvilluar me kohë në institucione arsimore me siguri tani do të reflekohej një përparim multikulturor dhe plurilingualizëm individual.

### **1.10. Familjet e përziera prodhues të bilinguizmit gjenetik në Gostivar**

Bilinguizmi në Gostivar është reflektuar nga lashtësia si bilinguizmin gjenetik ( biologjik), që lind bashkë me lindjen e foshnjës së prindërve me martesa të përziera si substancë dygjuhësore e gatshme për zhvillimin e plurilinguizmit. Janura (1970:256) kët e argumneton me thënien: “*Shqiptarët e Pollogut të Gostivarit, si edhe të gjithë të tjerët në Republikën e Maqedonisë, përveç gjuhës amtare flasin edhe gjuhën maqedonase, sidomos ato që jetojnë nëpër katunde me popullsi të përzier shqiptaro-maqedonase dhe ato të qytetit*”. Shqiptarët dhe maqedonasit gjuhën e njëri-tjetrit fillojnë ta mësojnë, prej kur kanë filluar të bashkëjetojnë për shkaqe shoqërore, ekonomike dhe politike. (K. K.G. II-të 1970:256).

Më vonë në periudhën e pushtimit otoman, kur gjuha turke përdoret si gjuhë zyrtare, në ushtri, në administratë, në gjykatë dhe në kulturë shumë shqiptarë të Gostivarit detyrohen ta mësojnë gjuhën turke lokale. Kjo gjuhë atëherë është mbështetur shumë nga fetarët e asaj kohe për interesat e xhamisë, pastaj me hapjen e mejtepeve një pjesë e qytetarëve e përvetësojnë me vetëdëshirë si gjuhë e klasës së lartë dhe fillojnë ta përdorin edhe në familje. Njohja e gjuhëve shqipe, maqedonase dhe turke, çdo herë ka qenë shenjë atrimi dhe solidarizimi për nevojat e komunikimit shoqëror të përditshmërisë. Asnjë pushtet nuk ka mundur ta ndalojë zhvillimin e gjuhëve, por ato janë zhvilluar me njohje reciproke përzbatime në praktikë.

Shqiptarët e Gostivarit janë bërë poliglot të vërtetë si pasojë e mërgimit në vende të ndryshme, ku i kanë mësuar gjuhët: serbe-kroate, rumune, bullgare, çeke ose sllovake. (K. K. G. II-të 1970:256 ). Mërgimi ka ndikuar në krijimin e disa martesave të përziera, ku nëna zakonisht ka qenë turke, vllëhe, serbe, kroate, boshnjake, hungareze, shumë pak edhe maqedonase, kurse babai ka qenë shqiptar ose turk ka dominuar “gjuha e babait” ose mjedisit familjar, ku është rritur fëmija. Këto fëmijë kanë pasur mundësi ta mësojnë gjuhën shqipe ose turke në mënyrë të njëjtë. (Shabani 2015:203).

Në fundin e shekullit XX dhe në fillim të shekullit XXI në qytetin e Gostivarit reflektohen martesa të shqiptarëve me gjermane, zvicerane, angleze, italiane shkaku i sigurimit të ekzistencës jetësore, që ka qenë dhe akoma është për disa qytetarë të Gostivarit. Në vitet

e fundit vërehen martesa të përziera edhe në mes të femrave shqiptare nga Shqipëria, që martohen me burra të vejë turk ose shqiptarë, por edhe shumë femra të reja shqiptare, që martohen me maqedonas. Gjyshet e reja fillojnë të ndikojnë tek anëtarët e familjes turke, me ekspozimin e gjuhës shqipe, veçanërisht te nipërit dhe mbesat e burrit, ku janë martuar. Femrat e reja shqiptare, që martohen me maqedonas gjuhën e tyre amtare e përcjellin te fëmijët e tyre, edhe pse ajo është minoritare në familje maqedonase ose në nivel shteti, por në *bashkësinë shoqërore të Gostivarit gjuha shqipe është gjuhë zyrtare*.

Martesat e përziera paraqesin nevojën për ndryshim në kurrikulat mësimore dhe në të mësuarit e gjuhëve të kontaktit. Kjo si nevojë për të vazhduar dhe zhvilluar bilinguizmin e lindur për t'u përshtatur në ekologjinë gjuhësore të vendit, por edhe për t'u përshtatur me gjuhën e mjedisit prej nga është nëna e tij. Të gjithë fëmijët bilingual zhvillojnë të folurit e gjuhëve sipas përshtatjes së tyre në mjedise “të babait”, “të nënës” ose “mjedisit etnik sundues”.

### **1.10.1. Raste të martesave të përziera**

Bazuar në shembujt e Shkurtaj (2009: 90) për martesat e përziera dhe të folurit në varietete të ndryshme ne paraqesim disa të dhëna për disa familje me martesa të përziera në qytetin e Gostivarit. Bilinguizmi i filluar në mjedis familjar i disa qytetarëve u bazua në disa intervista, që u zhvilluan me miq dhe anëtarë të familjeve me martesa të përziera:

**Rasti i I-rë:** Në martesën e përzier, ku burri Dervishi, I ishte nga Gostivari, kurse nëna Dervishi, A nga Osijeku i Kroacisë (tani të dy të ndjerë) kishin dy fëmijë. Fëmijët për shkak të martesës së përzier ishin detyruar të flasin në dy gjuhë, kroate dhe shqipe. Mirëpo fëmijët, kur kanë filluar të arsimohen prioritet i kanë dhënë gjuhës shqipe ose gjuhës së babait.

**Rasti i II-të:** Në martesën e përzier, ku burri Ismaili, M ishte nga Gostivari (tani i ndjerë), kurse gruaja Ismaili, S ishte nga Bosnja 78 vjeçë kishin tre fëmijë. Fëmijët për shkak të martesës së përzier të prindërve kanë qenë të detyruar të flasin në dy gjuhë boshnjake dhe shqipe. Mirëpo kur filluan të arsimohen, janë arsimuar në gjuhën e babait, pra shqipe.

**Rasti i III-të:** Në martesën e përzier, ku burri Preshova, S ishte nga Gostivari (tani i ndjerë), kurse nëna Preshova, M nga Bosnja 80 vjeçë kishin tre fëmijë. Fëmijët i kanë mësuar të dy gjuhët, por ka mbizotëruar gjuha e nënës. Janë arsimuar në gjuhën maqedonase.

**Rasti i IV-të:** Në martesën e përzier, ku të dy bashkëshortët ishin nga Gostivari, por dallonin nga etniteti burri Banjica, Q ishte shqiptar (tani i ndjerë), kurse gruaja Banjica, H 75 vjeçë turke. Të dy janë me bindje fetare myslimanë dhe kanë tre fëmijë. Fëmijët i kanë mësuar t'i flasin të dy gjuhët, por arsimimin e kanë vazhduar në gjuhën e babait pra shqip.

**Rasti i V-të:** Në martesën e përzier, ku të dy bashkëshortët ishin nga Gostivari, por dallojnë nga etniteti burri Tufai, M 68 vjeç është turk, kurse gruaja Tufai, SH 65 vjeçë shqiptare. Të dy janë me bindje fetare myslimanë dhe kanë tre fëmijë. Fëmijët kanë mësuar t'i flasin të dy gjuhët, por arsimimin e kanë vazhduar në gjuhën e babait ose në gjuhën turke.

**Rasti i VI-të:** Në martesën e përzier të dy bashkëshortët janë nga Gostivari, por dallojnë nga etniteti burri Halimi, R 82 vjeç është shqiptar, kurse gruaja Halimi, Z 75 vjeçë është

turke. Të dy janë me bindje fetare myslimane dhe kanë dy fëmijë. Fëmijët kanë mësuar t'i flasin të dy gjuhët, por arsimimin e kanë vazhduar në gjuhën e babait ose në gjuhën shqipe.

**Rasti i VII-të:** Në martesën e përzier, ku burri Bajraktar, XH (tani i ndjerë) ka qenë turk nga Gostivarit, kurse gruaja Bajraktar, M 72 vjeçë boshnjake nga Bihaç në Bosnjë kanë katër fëmijë. Fëmijët kanë mësuar t'i flasin të dy gjuhët, por arsimimin e kanë vazhduar në gjuhën e babait ose në gjuhën turke.

**Rasti i VIII-të:** Në martesën e përzier, ku burri Hasani, H ishte shqiptar nga Gostivari, kurse gruaja Hasani, S nga Vladiçki Han nga Serbia (tani të ndjerë) kishte tre fëmijë. Fëmijët i kishin mësuar të dy gjuhët, por ishin arsimuar në gjuhën maqedonase.

**Rasti i IX-të:** Në martesën e përzier, ku burri Sulejmani, D ishte shqiptar, kurse gruaja Sulejmani, M serbe (tani të ndjerë) kishte pasur katër fëmijë. Të gjithë fëmijët i kishin mësuar të dy gjuhët, por ishin arsimuar në gjuhën maqedonase.

**Rasti i X-të:** Në martesën e përzier, ku burri Karpuzi, H është shqiptar nga Gostivari, kurse gruaja Karpuzi, B 70 vjeçë serbe nga Beograd kishin një fëmijë. Djali i kishte mësuar të dy gjuhët, por ishte arsimuar në gjuhën serbe në Beograd ose gjuhën e nënës.

**Rasti i XI-të:** Në martesën e përzier, ku burri Smileski, S 50 vjeçë është maqedonas nga Gostivari, kurse gruaja Smileska, A 40 vjeçë shqiptare nga Shkodra e Shqipërisë kanë dy djem, që cilët i flasin të dy gjuhët, por arsimohen në gjuhën maqedonase.

**Rasti i XII-të:** Në martesën e përzier, ku burri Srezoski, D 53 vjeçë është maqedonas nga Gostivari, kurse gruaja Srezoska, S 42 vjeçë nga Shkodra e Shqipërisë kanë një djalë. Djali i flet të dy gjuhët, por arsimohet në gjuhën maqedonase ose në gjuhën e babait.

**Rasti i XIII-të:** Në martesën e përzier, ku burri Smilevski, M 52 vjeçë është maqedonas nga Gostivar, kurse gruaja Smilevska, Sh 40 vjeçë shqiptare nga Shkodra kanë dy fëmijë. Fëmijët flasin në të dy gjuhët, por arsimohen në gjuhën maqedonase.

**Rasti i XIV-të:** Në martesën e përzier, ku burri Zenku, I 55 vjeçë është shqiptar nga Gostivari, kurse gruaja Zenku, Z 52 vjeçë maqedonase nga Gostivari kanë tre fëmijë, që flasin në të dy gjuhët, por u arsimuan në gjuhën shqipe.

**Rasti i XV-të:** Në martesën e përzier, ku burri Demiri, N 59 vjeçë është shqiptar nga Gostivari, kurse nëna Demiri, S 54 vjeçë është turke nga Gostivari kanë pesë fëmijë. Fëmijët i flasin të dy gjuhët, kurse janë arsimuar në gjuhën shqipe.

**Rasti i XVI-të:** Në martesën e përzier, ku burri Ademi, Sh 59 vjeçë është turk nga Gostivarit, kurse gruaja Adem, B 45 vjeçë shqiptare nga Elbasani i Shqipërisë kanë dy vajza. Vajzat flasin në dy gjuhët, kurse arsimohen në gjuhën shqipe në gjuhën e nënës.

**Rasti i XVII-të:** Një martesë e përzier, ku burri Banjica, V është 32 vjeç (plurilingual, folës i katër gjuhëve shqipe, maqedonase, turke dhe angleze) dhe nëna Banjica, E 25 vjeçë (plurilinguale, folëse e katër gjuhëve turke, shqipe, angleze dhe suedeze), kanë një djalë 11 muajsh, i cili i percepton disa gjuhë nga mosha e foshnjërisë në dy mjedise familjare të babait dhe të nënës. Ai në të dy mjediset familjare në vazhdimësi është i shoqëruar edhe me mjete tekniko-teknologjike ekonomike, që artikulojnë gjuhën angleze.

Ky fëmijë qarkullon në dy mjedise shoqërore, por arsimimi plurilingual i tij është në varshmëri nga vullneti i prindërve të tij, për shkak se mjediset shoqërore të ndryshme i

ofrojnë mundësi të mësojë gjuhë të ndryshme. Në qytetin e Gostivarit në Maqedoni mund të vazhdojë ta zhvillojë gjuhën *shqipe, angleze, maqedonase dhe gjermane*, kurse nëse fillon të mësojë në Malme në Suedi mund të mësojë gjuhën *suedeze, angleze, gjermane, italiane, spanjolle, arabe dhe shqipe*. Shteti i Suedisë të gjithë emigrantëve u ofron mundësi ta zhvillojnë gjuhën amtare në arsimin fillor.



**Gjuhënshqipe,maqedonase,angleze,gjermane Gjuhën suedeze, angleze,italiane,spanjolle,shqipe,**

**Mjedisi shoqëror në arsim fillor në Gostivar**

**Mjedisi shoqëror në Malme, Suedi**

**Figura 1.5.** Plurilingualizmi përceptohet prej në moshë të foshnjërisë nga mjetet teknike teknologjike–ekonomike dhe zhvillohet në mjedise shoqërore arsimore

### 1.12. Ndikimi i medieve në ngritjen multikulturore të qytetarëve të Gostivarit

Kontekstet gjuhësore referuese, instrumentale dhe shoqërore ndikojnë në zhvillimin e bilinguizmit, multilinguizmit dhe në zhvillimin e plurilinguaëzimit të individëve. Në Gostivar vepron media elektronike për t'i informuar qytetarët për informacione të ndryshme në gjuhë të ndryshme dhe ndikon në zhvillimin e gjuhëve. TV media në qytetin e Gostivarit funksionon në tri shtëpi televizive: TV2, Zëri i Çegranit dhe Globi. Radio-Media funksionon në tri stacione: Radio PRO-FM, Radio Kometa, Radio Vala. Gjithashtu TV Alast-M i ka meritat e veta me programet multikulturore, që depërtan me rrezatimin e vet në çdo shtëpi. Interneti me famën e vet të madhe për dhënie dhe marrje të informatave e ka meritën më të madhe për përhapjen e çdo gjuhë në çdo vend të botës, ashtu që aktualisht edhe në Gostivar përdoret nga shumica e qytetarëve.

Një folës shumëgjuhësorë me identitet shqiptar (maqedonas ose turk ) i Gostivarit, mendon shqip (në gjuhën amtare), por mund të flas në gjuhë të ndryshme në gjuhën maqedonase, turke, angleze ose gjermane (ose ndonjë gjuhë tjetër). Ai mund të komunikoj me të tjerët duke përfaqësuar edhe çdo bashkësie gjuhësore tjetër, qytetin e Gostivarit, Republikën e Maqedonisë në nivel Evropian dhe Evropën në nivel global.

### 1.13. Ndikimi i faktorëve kombëtar dhe ndërkombëtar në përmirësimin e raporteve multikulturore të qytetarëve të Gostivarit

Mirënjojja dhe falënderimi u takon të gjithë individëve të Organizatave Kombëtare dhe Ndërkombejtare, që veprojnë për rikulturimin e individëve të Gostivarit në drejtim të qytetërimit universal. Çdo risi e ofruar ndikon në vetëdijesimin e qytetarëve për të vetëvlerësuar punën e tij, në atë mënyrë që së pari nxitet motivimi për të mësuarit gjatë tërë jetës duke ndikuar edhe në ngritjen e kulturës vetjake në qytetin e Gostivarit.

Në Komunën e Gostivarit veprojnë organizata kombëtare dhe ndërkombejtare, që në vazhdimësi japid kontributin e tyre për përmirësimin e standardeve jetësore duke ofruar ndihma për rikulturimin e të gjithë banorëve të qytetit për një bashkëjetësë më të mirë në drejtim të përparimit të vendit: BNJVL, EU Info Centre , i gostivari , IPARD, DEC-EGR , UN, Unicef- Early Child Development, QEMVP, EU Info Point, EEAS, EU Delegations' websites, UNDP. Veprimitaria e tyre ndikoi në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për rikulturim në vazhdimësi dhe për të konceptuar të drejtat e tyre njerëzore si individ, që i takojnë kësaj shoqërie. Gjithashtu me ngritjen e kulturës, ata u mësuan në vazhdimësi të kërkojnë të drejtat e veta, që u takojnë si qytetarë në qytetin e vet.

### 26 Shtator - Dita Evropiane e Gjuhëve



**Figura 1.12.** Plurilingualët në manifestim kulturor në qytetin e Gostivarit

Kjo shfaqje nëse është në gjuhën angleze deri-diku kuptohet nga të tri palët, por nëse është në gjuhët e vendit p.sh. *shqip nuk kuptohet nga maqedonasit dhe turqit* ose nëse është shfaqja në gjuhën turke nuk kuptohet nga shqiptarët bilingual shqip-maqedonisht. Në një tubim p.sh. nëse auditori është plurilingual atëherë folësi s'ka nevojë të flet në disa gjuhë ose të bëhet përkthim nga dikush tjeter, për shkak se kuptohet nga të gjithë të pranishmit, kjo ndikon edhe në kohëzgjatjen e manifestimeve të ndryshme. Kjo shfaqe nëse është në gjuhën maqedonase kuptohet edhe nga turqit edhe nga shqiptarët, për shkak se ata janë folës bilingual shqip-maqedonisht ose turqisht-maqedonisht, kurse maqedonasit nuk i dinë gjuhët e shqipe dhe turke, ashtu që nëse shfaqja është në gjuhën shqipe ose turqishte, ata nuk mund ta kuptojnë. Tërë kjo dukuri e "deficitit multigjuhësorë" është pasojë e mosinstitucionalizimit të gjuhëve në kurrikullën mësimore në kohën e duhur. Në Gostivar veprojnë disa shoqëri kulturore-artistike: Shoqëria Kulturore Artistike "Lulet e Malësisë" – Sërmnovë; Shoqëria Kulturore Artistike "Jani Hasani"-Çegran; Shoqëria Kulturore Artistike "Besa"- Gostivar; Shoqëria Kulturore Artistike "Braqa Gjinosci "- Gostivar

## **1.14. Ndikimi i faktorëve të brendshëm politik në zhvillimin e gjuhëve**

### ***1.14.1. Statusi dhe të drejtat e komuniteteve gjuhësore në nivel lokal dhe shtetëror në Republikën e Maqedonisë***

Nenin 7 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë, ligji për gjuhët, që u zëvendësua me **AMENDAMENTIN V** më 16 nëntor 2001 (Numër 07-3795/1) me Marrëveshjen e Ohrit më 13 gusht 2001, për shumicën është një dokument, që ktheu paqen në vend dhe i dha fund konfliktit të vitit 2001, ku u miratuan kornizat e bashkëjetesës ndëretnike dhe perspektivës euroatlantike të Maqedonisë. Gjithashtu u miratua për çështjen e dukurisë së shtrirjes gjuhësore të dy gjuhëve për të qenë me prestigj të njëjtë zyrtar, kur për gjuha shqipe bëhet gjuhë zyrtare në vendbanimet me shumicë shqiptare.

*Në paragrafin e parë theksohet: “Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik”.*

*Në paragrafin e dytë theksohet se gjuhë tjetër zyrtare është gjuha, që flitet mbi 20% të qytetarëve, ashtu që gjuha shqipe merr status zyrtar në vendbanime me shumicë shqiptare, ku dy gjuhët mund të përdoren si gjuhës zyrtare në nivel lokal dhe në njësi rajonale nga çdo qytetar. Gjithashtu të dy gjuhët mund të përdoren për kërkime të çdo dokumenti dhe marrje të çdo dokumenti në gjuhën e dëshirueshme. Qytetarët mund të drejtohen me të dy gjuhët edhe në ministri, por nga ministritë përgjigjet mund të merren vetëm në gjuhën zyrtare maqedonase, që është në nivel shtetëror. Kjo e drejtë mund të përdoret për të gjithë gjuhët në të gjithë vendet me shumicë mbi 20% të banorëve.*

*Në paragrafin e tretë theksohet se gjuha shqipe duhet të perceptohet si gjuhë, që flitet nga shumica e qytetarëve.*

*Në paragrafin e katërt theksohet se për përdorimin e gjuhëve dhe alfabeteve, në të cilat flasin së paku 20% të qytetarëve në njësitë e vëtadministrimit lokal, të vendosin organet e njësive të vëtadministrimit lokal. Ky paragraf i jep mundësi vëtadministrimit lokal të merr iniciativë për të mësuarit e gjuhëve të vendit në institucione arsimore si gjuhë për zhvillimin individual të qytetarëve, që ndikon në zhvillimin shoqëror.*

## KREU II

### 2. MULTILINGUIZMI NË KOMUNËN E GOSTIVARIT MË 2015

Në njësitë e vetadiministrimit lokal, ku jetojnë bashkësi gjuhësore të ndryshme, në përdorim zyrtar krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik, janë edhe gjuha dhe alfabeti i kombësive, në kushte dhe në mënyrë të përcaktuara me ligj. Perceptimi i zbatimit të multilinguizmit dhe respektimit të parimit të multikulturalizmit mund të vërehet në çdo institucion publik të qytetit të Gostivarit si tregues i marrëdhënieve të mira multikulturore.



**Figura 2.** Respektimi i katër gjuhëve zyrtare në mbishkrimin e komunës së Gostivarit

Në bashkësinë shoqërore të Gostivarit, në çdo veprimtari shoqërore gjuhët përdoren në mbështetje të normave standarde dhe reflektohen me sjellje gjuhësore të ndryshme në përshtatshmëri me kulturën e veprimitarisë të sferave të ndryshëm shoqërore.

#### 2.1. Sistemimi i nxënësve në shkollat filllore të Gostivarit 2015

Hulumtimi u realizua më *prill–maj të vitit 2015* në shkollat filllore në qytetin e Gostivarit. Gjatë planifikimit të hulumtimit u respektuan të gjithë normat etike, që i janë paraparë për një hulumtim shkencor. Me parashtrimin e kërkesës me shkrim në institucionet relevante të Komunës së Gostivarit-Sektori për Veprimitari Publike, u mor leja nga kryetari aktual z. Nevzat Bejta, me çka u arrit objektiva e parë e këtij qëllimi. Të dhënat statistikore u morën për numrin e nxënësve, që e ndjekin mësimin në shkollat filllore dhe të mesme publike në qytetin Gostivarit, prej periudhës së vitit 2007-2015 me Nr.Pr.27-695/2 , më 26.03.2015.

Numri i nxënësve u verifikua edhe në institucionet shkollore, ku kishte dallim shumë të vogël në disa shkolla, për shkak të lëvizjes së nxënësve prej shkolle në shkollë ose shpërnguljes së tyre në vende të tjera. Të gjithë të dhënat u llogariten në përqindje dhe u pasqyruan në tabelë statistikore. Të dhënat për numrin e nxënësve pasqyrohen në tabelë sipas shkurtesave të shënuara më poshtë.

**Tabela 2.1.** Shkurtesat e përdorura

Emri i shkollave fillore	Gjuha mësimore	Përkatësia etnike	Gjinia/seksi
Ismail Qemali-IQ	Shqipe-SH	Shqiptare-sh	Femër-F
Goce Delçev-GD	Maqedonase-M	Maqedonase-m	Mashkull-M
Bashkimi-B	Turke-T	Turke-t	
Mustafa Qemal Ataturk -MQA		Rome-r	
		Serbe-s	

Në tabelat në vijim pasqyrohet numri i nxënësve sipas etniteteve në shkollat fillore për periudhën 8 vjeçare, prej vitit 2007/2008 deri në vitin 2014/2015. Në qytetin e rrëthindës Gostivarit aktualisht mësimi zhvillohet në 10 shkolla fillore (me 20 shkolla periferike).

Të dhënët pasqyrojnë se në pjesën urbane të Gostivarit, të katër shkollat fillore janë multikulturore. Aty ka nxënës të përkatësive të ndryshme etnike dhe mësimi zhvillohet në gjuhë të ndryshme sipas nevojave të nxënësve në përshtatshmëri me gjuhën amtare të tyre, kurse në vendet rurale gati në të gjithë shkollat mësimi zhvillohet në një gjuhën shqipe sipas nevojës së nxënësve.

**Tabela 2.1.1. SH. F. “Ismail Qemali”-GOSTIVAR**

1. Numri i përgjithshëm i nxënësve dhe %, sipas etniteteve në SH. F. “Ismail Qemali”-GOSTIVAR(sh. p. Simnicë, Gjenovicë dhe Balindoll)																							
2007/2008			2008/2009			2009/2010			2010/2011			2011/2012			2012/2013			2013/2014					
1635			1523			1496			1429			1374			1350			1286					
sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t			
1482	/	153	1382	/	141	1358	/	138	1287	/	142	1229	/	145	1210	/	140	1121	/	165	1159	/	149
91%	0%	9%	91%	0%	9%	91%	0%	9%	90%	0%	10%	89%	0%	11%	90%	0%	10%	87%	0%	13%	89%	0%	11%

Shkolla fillore “Ismail Qemali” në vitin 2007 ka funksionuar me 1635, kurse më 2015 funksionon me 1308 nxënës. Kjo shkollë ndodhet në qendër të qytetit, por ka edhe tri shkolla periferike, në fshatin Simnicë, Gjenovicë dhe Balindoll. Numri i nxënësve në periudhë tetëvjeçare prej 2007-2015 është në rënie për 327 (20%) nxënës, te shqiptarët ka rënie prej 323 (22%) nxënës, kurse te turqit ka rënie prej 4 (3%) nxënës. Turqit mësojnë në këtë shkollë deri në klasë të V-të, kurse pastaj prej klasës së pestë (VI-të) deri në klasën e nëntë (IX-të) mësimin e vazhdojnë në Sh.F. “Mustafa Qemal Ata Turk”. Shqiptarët, që ngelin në këtë shkollë mësojnë në dy turne sipas viteve. Bilinguizmi kalon në monolinguizëm.

**Tabela 2.1.2. SH. F. “ Bashkimi ”- GOSTIVAR**

2. Numri i përgjithshëm i nxënësve dhe %, sipas etniteteve në SH. F. “Bashkimi ”-GOSTIVAR (sh.p.Cigllanë, Bellovisht, Llokovicë)																							
2007/2008			2008/2009			2009/2010			2010/2011			2011/2012			2012/2013			2013/2014					
1776			1702			1580			1568			1464			1396			1335					
sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t			
814	893	69	790	851	61	703	824	53	671	844	53	635	772	57	605	740	51	570	702	63	659	697	48
46%	50%	4%	46%	50%	4%	45%	52%	3%	43%	53%	4%	43%	53%	43%	43%	53%	4%	43%	53%	4%	47%	50%	3%

Shkolla Fillore “Bashkimi” ka tri shkolla periferike, në Cigllanë, Bellovisht dhe në Llokovicë. Kjo shkollë në vitin 2007 ka funksionuar me 1776 nxënës, kurse më 2015 funksionon me 1404 nxënës. Numri i nxënësve është në rënie për periudhën tetëvjeçare 2007-2015 për 372 (21%) nxënës, te shqiptarët për 155 (19%) nxënës, kurse te maqedonasit për 196 (22%) nxënës, ndërsa turqit kanë rritje për 21 (30%) nxënës në krahasim me vitin e kaluar. Në këtë shkollë zbatohet multilinguizmi, mësimi zhvillohet në tri gjuhë dhe punohet në dy turne, ku nxënësit shqiptar dhe maqedonas nuk takohen. Nxënësit turq në klasën e VI-të kalojnë në Sh. F. “Mustafa Qemal Ataturk”.

**Tabela 2.1.3. SH. F. "Goce Delçev "- GOSTIVAR**

3. Numri i përgjithshëm i nxënësve dhe %, sipas etniteteve në SH. F. "Goce Delçev "-GOSTIVAR (sh.p.Tumçevisht)																				
2007/2008			2008/2009			2009/2010			2010/2011			2011/2012			2012/2013			2013/2014		
1223			1167			1110			1066			1058			1061			1064		
sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t
505	718	/	483	684	/	433	677	/	402	664	/	388	670	/	371	690	/	374	690	/
41%	59%	0%	41%	59%	0%	40%	60%	0%	38%	62%	0%	37%	63%	0%	35%	65%	0%	35%	65%	0%
																		36%	64%	0%

Shkolla Fillore "Goce Delçev" ka një shkollë periferike në fshatin Tumçevisht. Në vitin 2007 ka funksionuar me 1223 nxënës, kurse më 2015 funksionon me 1048 nxënës. Numri i nxënësve është në rënje. Kështu në periudhën tetëvjeçare 2007-2015 për 175 nxënësve (14%), te etniteti shqiptar rënia reflektohet me 127 (25%) nxënës, kurse te etniteti maqedonas me 48 (7%) nxënës. Në strukturën e nxënësve maqedonas pjesëmarrës janë edhe 85 nxënës nga etnititetet tjera (62 nxënës torbeshë dhe 23 nxënës romë). Mësimi zhvillohet në dy gjuhë ose bilinguizmi, por mësimi zhvillohet në dy turne sipas etniteteve.

**Tabela 2.1.4. SH. F. "Mustafa Qemal Ataturk"- GOSTIVAR**

4. Numri i përgjithshëm i nxënësve dhe %, sipas etniteteve në SH. F. "Mustafa Qemal Ataturk "-GOSTIVAR (Banjicë e Epërme, Banjicë e Poshtme, Zdunjë)																				
2007/2008			2008/2009			2009/2010			2010/2011			2011/2012			2012/2013			2013/2014		
1439			1331			1317			1232			1199			1103			1180		
sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t
227	326	886	215	293	825	206	305	806	188	313	731	172	301	726	163	304	636	185	323	672
16%	23%	61%	16%	22%	62%	16%	23%	61%	15%	25%	60%	14%	25%	61%	15%	28%	57%	16%	27%	57%
																		15%	29%	56%

Shkolla Fillore "Mustafa Qemal Ata Turk" ka tri shkolla periferike në fshatin Banjicë e Epërme, në fshatin Banjicë e Poshtme dhe në fshatin Zdunjë. Në vitin 2007 ka funksionuar me 1439 nxënës, kurse tani funksionon me 1173 nxënës. Numri i nxënësve në periudhën tetëvjeçare prej 2007-2015 ka rënje për 266 (18%) nxënës, te shqiptarët për 54 (24%) nxënës, kurse te maqedonasit rrjite për 20 (6%) nxënës, ndërsa te turqit ka rënje për 232 (26%) nxënës. *Mësimi zhvillohet në tri turne dhe tri gjuhë, multilinguizmi.*

**TABELA 2.1.5. SH. F. "LIRIA"-fshati Vërtok, rrethi i GOSTIVARIT**

5. Numri i nxënësve në Gjithsej dhe në % sipas etniteteve në SH. F. "Liria"-fshati Vërtok, rrethi i GOSTIVARIT																				
2007/2008			2008/2009			2009/2010			2010/2011			2011/2012			2012/2013			2013/2014		
520			482			467			419			434			407			204		
sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t
485	35	/	440	42	/	438	29	/	391	28	/	396	38	/	366	41	/	219	21	/
93%	7%	0%	91%	9%	0%	94%	6%	0%	93%	7%	0%	91%	9%	0%	90%	10%	0%	91%	9%	0%
																		88%	12%	0%

Shkolla Fillore "Liria" ndodhet në fshatin Vërtok me shkollat periferike në: fshatin Raven, Reçan dhe Duf, ku mësojnë 241 nxënës. Numri i nxënësve në vitin 2008 ka qenë 520 nxënës, prej të cilëve shqiptarë kanë qenë 485, kurse maqedonas kanë qenë 38 nxënës. Në vitin 2015 numri i nxënësve është 241, prej të cilëve shqiptarë janë 213, kurse maqedonas janë 28. Numri i nxënësve ka rënë prej vitit 2007-2015, për 279 (46%) nxënës, (te shqiptarët ka rënë prej 272 (56%) nxënës, ndërsa te maqedonasin me 28 (20%) nxënës.

**TABELA 2.1.6. SH. F. " PËRPARIM"- fshati ÇEGRAN, rrethi i GOSTIVARIT**

6. Numri i përgjithshëm i nxënësve dhe në % , sipas etniteteve në SH. F. " Përparim"- fshati Çegran, rrethi i GOSTIVARIT																				
2007/2008			2008/2009			2009/2010			2010/2011			2011/2012			2012/2013			2013/2014		
1238			1224			1177			1082			1058			974			887		
sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t
1238	/	/	1224	/	/	1177	/	/	1082	/	/	1058	/	/	974	/	/	887	/	/
100%	0%	0%	100%	0%	0%	100%	0%	0%	100%	0%	0%	100%	0%	0%	100%	0%	0%	100%	0%	0%

Shkolla Fillore "Përparimi" ndodhet në fshatin Çegran me 551 nxënës shqiptarë me një shkollë periferike në fshatin Koritë. Numri i nxënësve në vitin 2008 ka qenë 1238, kurse më 2015 është 551 nxënës. Ka rënë në numrin e nxënësve prej vitit 2007-2015 për 687 (56%) nxënës.

**TABELA 2.1.7. SH. F. " ÇAJLË "- fshati ÇAJLË , rrethi i GOSTIVARIT**

7. Numri i përgjithshëm i nxënësve dhe në % sipas etniteteve në SH. F. " Çajlë "- fshati Çajlë , rrethi i GOSTIVARIT																				
2007/2008			2008/2009			2009/2010			2010/2011			2011/2012			2012/2013			2013/2014		
333			289			275			250			232			192			189		
sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t
333	/	/	289	/	/	275	/	/	250	/	/	232	/	/	192	/	/	189	/	/
100%	0%	0%	100%	0%	0%	100%	0%	0%	100%	0%	0%	100%	0%	0%	100%	0%	0%	100%	0%	0%

Shkolla Fillore "Çajlë" ndodhet në fshatin Çajlë me 182 nxënës. Numri i nxënësve në vitin 2008 ka qenë 333, kurse në vitin 2015 është 182 nxënës. Numri i nxënësve në vitin shkollor 2007-2015 ka rënë për 151 (45%) nxënës. Të gjithë nxënësit janë shqiptarë.

**TABELA 2.1.8. SH. F. “FAIK KONICA ”- fshati DEBRESH , rrethi i GOSTIVARIT**

8 . Numri i përgjithshëm i nxënësve dhe në % ,sipas etniteteve në SH. F. “ Faik Konica”- fshati Debresh rrethi i GOSTIVARIT																							
621			568			539			487			446			398			368			343		
sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t
621	/	/	568	/	/	539	/	/	487	/	/	446	/	/	398	/	/	368	/	/	343	/	/
100%	0%	0%	100%	0%	0%	100%	0%	0%	100%	0%	0%	100%	0%	%	100%	0%	0%	100%	0%	0%	100%	0%	0%

Shkolla Fillore “Faik Konica” ndodhet në fshatin Debresh me një shkollë periferike në fshatin Vranjovcë. Në vitin 2008 ka pasur 621 nxënës, kurse më 2015 ka 343 nxënës. Numri i nxënësve në periudhën 2007-2015 ka rënje për 278 (45 %) nxënës. Të gjithë janë shqiptarë.

**TABELA 2.1.9. SH. F. “GJON BUZUKU”- fshati SËRMNOVË , rrethi i GOSTIVARIT**

9. Numri i përgjithshëm i nxënësve dhe në % ,sipas etniteteve në SH. F. “ Gjon Buzuku ”- fshati Sërmnovë, rrethi i GOSTIVARIT																							
2007/2008			2008/2009			2009/2010			2010/2011			2011/2012			2012/2013			2013/2014			2014/2015		
313	223	207	205	175	187	156	143																
sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t
313	/	/	223	/	/	207	/	/	205	/	/	175	/	/	187	/	/	156	/	/	143	/	/
100%	0%	0%	100%	0%	0%	100%	0%	0%	100%	0%	0%	100%	0%	0%	100%	0%	0%	100%	0%	0%	100%	0%	0%

Shkolla Fillore “Gjon Buzuku” ndodhet në fshatin Sërmnovë me 143 nxënës shqiptarë. Ka pesë shkolla periferike, edhe atë në: Strajan- 9 vjeçare, Tërnovë -9 vjeçare, Grarovec-5 vjeçare, Rrafsh i Madh -5 vjeçare dhe Patalisht- 5 vjeçare. Në vitin 2008 ka pasur 313 nxënës, kurse më 2015 ka 143 nxënës. Numri i nxënësve në periudhën 2007-2015, ka rënje për 170 (54%). Të gjithë nxënësit janë të etnititetit shqiptar.

**TABELA 2.1.10. SH. F. “FORINË”- fshati FORINË , rrethi i GOSTIVARIT**

10. Numri i përgjithshëm i nxënësve dhe në % sipas etniteteve në SH. F. “ Forinë ”- fshati Forinë, rrethi i GOSTIVARIT																							
2007/2008			2008/2009			2009/2010			2010/2011			2011/2012			2012/2013			2013/2014			2014/2015		
313	223	207	205	175	187	156	143																
sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t
/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	291	/	/
/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	100%	0%	0%

Shkolla Fillore “Forinë” ndodhet në fshatin Forinë dhe funksionon prej vitit 2015 me 291 nxënës, ku të gjithë nxënësit janë të etnititetit shqiptar.

**TABELA 2.1.11. Numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollat fillore të Gostivarit 2014/2015**

Nxënës	Shkolla urbane	%	Shkolla rurale	%	Gjithsej	%
shqiptarë	2369	48 %	1751	98%	4120	61%
maqedonas	1713	35%	28	2%	1741	26%
turq	851	17%	/	/	851	13%
Gjithsej	4933	100%	1779	100%	6712	100%

Numri i përgjithshëm i nxënësve shqiptarë në vitin shkollor 2014/ 2015 në shkollat fillore të Gostivarit, në vendbanimet urbane është 2369 nxënës shqiptarë, që mësojnë në gjuhën shqipe, kurse në vendbanimet rurale 1751 nxënës shqiptarë. Gjithsej në shkollat fillore të Gostivarit ka 4120 nxënës shqiptarë, kurse në gjuhën maqedonase aktualisht e ndjekin mësimin gjithsej 1741 nxënës maqedonas (prej të cilëve në shkollat urbane janë

1713 nxënës dhe në shkollat rurale janë 28 nxënës), ndërsa të etnitetit turk janë 851 nxënës, që mësimin e ndjekin në shkollat filllore urbane. Në shkollat filllore të Gostivarit (2015) mësojnë Gjithsej 6712 nxënës.

Në Gostivar funksionon edhe një shkollë filllore e muzikës, ku nxënësve u ofrohet mundësia për zhvillimin e shkathtësive nga fusha e muzikës.

**TABELA 2.1.12. Numri i nxënësve në shkollën filllore të muzikës në Gostivar 2014/2015**

11. Numri i përgjithshëm i nxënësve dhe në % sipas etniteteve në SH. F. SH. F. "ENVER STAFAI" - GOSTIVAR																				
2007/2008			2008/2009			2009/2010			2010/2011			2011/2012			2012/2013			2013/2014		
86			154			175			153			191			210			179		
sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t
54	32	/	66	57	31	78	57	40	65	56	32	74	69	48	85	74	51	64	63	52
63%	37%	0%	43%	37%	20%	45%	32%	23%	42%	37%	21%	39%	36%	25%	40%	36%	24%	36%	35%	29%
																		80	57	51

Tabela 2.1.12. pasqyron të dhëna për pjesëmarrjen e nxënësve në shkollën filllore të muzikës në bazë të etniteteve të ndryshme, ku punohet në dy turne dhe nxënësi mund të jetë i pranishëm dy herë në javë. Në këtë shkollë në vitin 2008 ka pasur 86 nxënës, mirëpo në vitin 2015 numri i nxënësve është rritur në 188, që do të thotë është rritur për (118%). Në këtë shkollë punohet në dy turne dhe nxënësi mund të jetë i pranishëm dy herë në javë. Në këtë shkollë mund të regjistrohen të gjithë nxënësit e shkollave filllore për të marrë mësim nga fusha e muzikës dhe të zhvillojnë shkathtësitë muzikore individuale. Në fund pas realizimit të planprogramit mësimor, nxënësi pas vlerësimit e të arriturave merr dëftesë.

## 2.2 Sistemimi i nxënësve në shkollat e mesme të Gostivarit 2015

Në tabelat në vijim pasqyrohet numri i nxënësve sipas etniteteve në shkollat e mesme të gostivarit për periudhën 8 vjeçare, prej vitit 2007/2008 deri në vitin 2014/2015.

**Tabela 2.2.1. Numri i nxënësve në SH. M. K. "GOSTIVAR"-GOSTIVAR**

1. Numri i përgjithshëm i nxënësve dhe në %, sipas etniteteve në SH. M. K. "Gostivar"-GOSTIVAR																				
2007/2008			2008/2009			2009/2010			2010/2011			2011/2012			2012/2013			2013/2014		
2754			2832			2808			2858			2848			2949			2551		
sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t
1832	449	473	1912	452	468	1932	409	467	1966	383	508	1977	379	492	2020	431	498	1565	528	458
67%	16%	17%	67%	16%	17%	69%	14%	17%	69%	13%	18%	69%	14%	17%	68%	15%	17%	61%	21%	18%
																		959	237	263
																		66%	16%	18%

Në SHMK "Gostivar" numri i nxënësve gjatë periudhës tetëvjeçare prej 2007-2015 është në rerie për 1459 (53%) nxënës. Te etniteti shqiptar rënia është për 873 (48%) nxënës, kurse te etniteti maqedonas për 212 (47%) nxënës, ndërsa etniteti turk për 210 (52%) nxënës. Rënia e numrit të nxënësve është për shkak të fillimit së funksionuari edhe të një shkolle të mesme, SH. M. K. M. "Gostivar. Nxënësit janë regjistruar në shkollë tjetër ose në dy shkollat e mesme private. Vërehet se edhe në këtë shkollë respektohet multikulturalizmi dhe multilinguizmi.

**Tabela. 2.2.2. Numri i nxënësve në SH. M. K. M. "GOSTIVAR"-GOSTIVAR**

2. Numri i nxënësve në total dhe në % sipas etniteteve në SH. M. K. M. "Gostivar"-GOSTIVAR																				
2007/2008			2008/2009			2009/2010			2010/2011			2011/2012			2012/2013			2013/2014		
sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t
																		608	194	212
																		60%	9%	21%

Në SHMKM "Gostivar" gjithashtu ka nxënës nga të tri etnitetet dhe mësimi zhvillohet në dy turne me nxënës të përzier. Kjo përzierje e nxënësve ndikon pozitivisht në krijimin e raporteve multikulturore. Të dhënat dëshmojnë se procesi mësimor në këtë shkollë ka filluar të zhvillohet në vitin 2014/2015 si plotësim i nevojës aktuale të kuadrit mjekësor. Vërehet se edhe në këtë shkollë respektohet multikulturalizmi dhe multilinguizmi.

**Tabela. 2.2.3. Numri i nxënësve në SH. M. T. K. "GOSTIVAR"-GOSTIVAR**

3. Numri i nxënësve në total dhe në % sipas etniteteve në SH. M. T. K. "Gostivar"-GOSTIVAR																				
2007/2008			2008/2009			2009/2010			2010/2011			2011/2012			2012/2013			2013/2014		
1059			1048			1074			913			927			835			718		
sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t
644	282	133	679	248	124	692	265	117	565	247	101	577	265	85	531	223	81	458	183	77
61%	27%	12%	65%	24%	11%	64%	25%	11%	62%	27%	11%	62%	29%	9%	64%	27%	9%	64%	25%	11%
																		384	161	66
																		63%	26%	11%

Në SHMTK "Gostivar" numri i nxënësve dukshëm është në rënie gjatë periudhës tetëvjeçare prej 2007-2015 për 448 (42%) nxënës, edhe atë te etniteti shqiptar është në rënie për 260 (40%) nxënës, kurse të etnitetit maqedonas është në rënie për 121 (43%) nxënës, ndërsa te etniteti turk është në rënie për 67 (50%) nxënës. Procesi mësimor zhvillohet në dy turne, ku në njërin turn mësimin e ndjekin nxënës nga etniteti maqedonas dhe etniteti turk, kurse në turnin tjetër mësimin e ndjekin nxënësit e etnitetit shqiptar. Arsimimi i individëve në shkollën profesionale është shumë i nevojshëm për shkak se individëve u mundëson përgatitje profesionale për punë në vendin tonë. Në shkollë nuk reflektohet klimë multikulturore e harmonizuar, por e ndarë.

**Tabela. 2.2.4. Numri i nxënësve në SH.M. E. K. "GOSTIVAR"-GOSTIVAR**

4. Numri i nxënësve në total dhe në % sipas etniteteve në SH. M. E. K. "Gostivar"-GOSTIVAR																				
2007/2008			2008/2009			2009/2010			2010/2011			2011/2012			2012/2013			2013/2014		
1233			1284			1342			1262			1161			1099			1007		
sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t	sh	m	t
653	458	122	700	460	124	776	435	131	746	393	123	733	322	106	720	266	113	679	235	93
53%	37%	10%	54%	36%	10%	58%	32%	10%	60%	31%	9%	63%	28%	9%	66%	24%	10%	68%	23%	9%
																		601	208	86
																		67%	23%	10%

Në SHMEK "Gostivar" numri i nxënësve dukshëm është në rënie gjatë periudhës tetë-vjeçare 2007-2015 për 338 (27%) nxënës. Numri i nxënësve të etnitetit shqiptar është në rënie për 52 (8%) nxënës, kurse të etnitetit maqedonas është në rënie për 250 ( 55%) nxënës, ndërsa te etniteti turk është në rënie për 36 (29%) nxënës. Gjithashtu në këtë shkollë procesi mësimor realizohet në dy turne, ku nxënësit e etnitetit shqiptar mësojnë në një turn, kurse nxënësit të etnitetit maqedonas dhe të etnitetit turk e ndjekin procesin mësimor në një turn. Në përgjithësi në rënien e numrit të nxënësve ndikon nataliteti dhe migrimi i familjeve brenda ose jashtë Republikës së Maqedonisë. Miratimi i ligjit për arsimimin të mesëm të obligueshëm ndikoi pozitivisht në rritjen e numrit të nxënësve në etnitetin shqiptar dhe turk.

### **2.3. Arsimimi plurilingual fillor në Republikën e Maqedonisë 2014/2015**

Në kurrikulën mësimore janë planifikuar edhe gjuhët, *për shkak se ato janë më thelbësore për zhvillimin e çdo lënde mësimore dhe përfunksionimin e komunikimit shoqëror në mes njerëzve duke krijuar kulturën e edukimit plurilingual dhe plurilingualizimin individual*. Edukimi plurilingual arrihet me arsimimin institucional të individit me të mësuarit e disa gjuhëve në norma standarde, që i mundësojnë individit të komunikojë në disa gjuhë.

**Tabela.2.3.** Statusi i gjuhëve në kurrikullën mësimore të shqiptarëve, turqve dhe maqedonasve

Klasat	orari favor	Shqiptare dhe turke								Maqedonase								
		gj.shqipe		gj.angleze		gj.maqed.		gj.gjer/fren.		orari favor		gj.maqed.		gj.angleze		/	Gjerm/ /fran.	
		javë	vit	javë	vit	javë	në vit	javë	vit		ditë	vit	ditë	javë			ditë	javë
I-rë	23 orë	6	216	2	72	/	/	/	/	23 orë	6	216	2	72 orë	/	/	/	/
II-të	24 orë	6	216	2	72	/	/	/	/	24 orë	6	216	2	72 orë	/	/	/	/
III-të	27 orë	6	216	3	108	/	/	/	/	27 orë	6	216	3	108 orë	/	/	/	/
IV-të	28 orë	5	180	3	108	2 orë	72	/	/	28 orë	5	180	3	108 orë	/	/	/	/
V-të	30 orë	5	180	3	108	2 orë	72	/	/	28 orë	5	180	3	108 orë	/	/	/	/
VI-të	32 orë	4	144	3	108	3 orë	108	2	72	29 orë	4	144	3	108 orë	/	/	2	72 orë
VII-të	32 orë	4	144	3	108	3 orë	108	2	72	29 orë	4	144	3	108 orë	/	/	2	72 orë
VIII-të	34 orë	4	144	3	108	32 orë	72	2	72	32 orë	4	144	3	108 orë	/	/	2	72 orë
XIX-të	35 orë	4	144	3	108	33 orë	72	2	72	33 orë	4	144	3	108 orë	/	/	2	72 orë

Në tabelën 2.3. pasqyrohen të dhëna për të mësuarit e gjuhëve sipas kurrikulës mësimore 2014-2015 të shkollave fillore, ku gjuhët mësohen prej në klasë të I-rë deri në klasë IX-të. Të dhënat pasqyrojnë se nxënësit shqiptar dhe turq i mësojnë gjuhën amtare (Gj1) dhe si Gj-2 gjuhën angleze, gjuhën maqedonase Gj-3, gjuhën gjermane Gj- 4 ose gjuhën frëngje Gj-4. Te nxënësit maqedonas ndryshon gjendja e të mësuarit të gjuhëve, ku mësohen gjuha amtare (Gj1), gjuha angleze Gj-2, gjuha gjermane Gj-3 ose gjuha frëngje Gj-3, ndërsa nga gjuhët e kontaktit nuk mësohet asnjë gjuhë tjetër. *Kjo është një pabarazi dhe një*

*pengesë për zhvillimin e plurilinguizmit të individit me gjuhët e vendit, që është e nevojshme për çdo individ në qytetin Gostivarit, por edhe në Republikën e Maqedonisë.*

Në Shkollën Fillore “Bashkimi” gjuha shqipe (Gj 3) ka filluar të mësohet nga nxënësit maqedonas prej viti shkollor 2009/2010 edhe atë vetëm në klasën e VI-të si lëndë zgjedhore. Pabarazia është pengesë për zhvillimin e plurilinguizmit me gjuhët e vendit, që është e nevojshme për çdo individ në qytetin Gostivarit e më gjerë. Të mësuarit e gjuhës duhet të vazhdohet, për shkak se ajo zhvillohet në koherencë dhe në kohezion me gjuhët tjera.

#### **2.4. Arsimiti plurilingual në kurrikulat mësimore në Gostivar në Republikën e Maqedonisë**

Kultura për edukimin plurilingual e filluar në arsimin fillor vazhdon të mësohet në arsimin e mesëm, që është i obligueshëm në Republikën e Maqedonisë.

**Tabela. 2.4.1.** Statusi i gjuhëve në programet mësimore të mesme të shqiptarëve, turqve dhe maqedonasve në SHMK “GOSTIVAR” 2014/2014

SHMK “GOSTIVAR” 2014/2015																
Vitet	Shqiptarë dhe turq							Maqedonas								
	gj.shqipe	gj.angleze	gj.maqed.	gj.gjerm./fra	gj.shqipe	gj.angleze	gj.shqipe/turq	gj.gjerm./fre	javë	vit	javë	vit	/	/	javë	vit
I-rë	4	144	3	108	2	72	2	72	4	144	3	108	/	/	2	72
II-të	4	144	3	108	2	72	2	72	4	144	3	108	/	/	2	72
III-të	4	144	3	108	2	72	2	72	4	144	3	108	/	/	2	72
IV-të	4	144	3	108	2	72	2	72	4	144	3	108	/	/	2	72

Në tabelën 2.4.1. pasqyrohen të dhëna për të mësuarit e gjuhëve sipas kurrikulës mësimore 2014-2015 në shkollën e mesme SHMK “GOSTIVAR”, ku gjuhët mësohen prej viti të I-rë deri në vitin e IV-të. Të gjithë këto të dhëna pasqyrojnë se nxënësit shqiptar dhe turq i mësojnë gjuhën amtare (Gj-1), gjuhën angleze Gj-2, gjuhën maqedonase Gj-3, gjuhën gjermane Gj-4 ose gjuhën frënge Gj-4.

Te nxënësit maqedonas ndryshon gjendja e të mësuarit të gjuhëve, ku mësohen gjuha amtare (Gj1), gjuha angleze Gj-2, gjuha gjermane Gj-3 ose gjuha frënge Gj-3, ndërsa nga gjuhët e kontaktit nuk mësohet asnjë gjuhë tjetër, që janë shumë të nevojshme për përditshmërinë jetësore, por ata nuk i mësojnë asnjëren, as gjuhën shqipe dhe as gjuhën turke.

**Tabela. 2.4.2.** Statusi i gjuhëve në programet mësimore të mesme të shqiptarëve, turqe dhe maqedonasve në SHMTK “GOSTIVAR” 2014/2015

SHMTK “GOSTIVAR” 2014/2015																
Shqiptarë dhe turq										Maqedonas						
Vitet	gj.shqipe		gj.ang.		gj.maqed.		gj.gjerm./fren.		gj.shq.		gj.ang.		gj.shq./tur		gj.gjerm./frën.	
	javë	vit	javë	vit	javë	vit	javë	vit					/	/		
I-rë	4	144	3	108	2	72	2	72	4	144	3	108	/	/	/	/
II-të	4	144	3	108	2	72	2	72	4	144	3	108	/	/	/	/
III-të	4	144	3	108	2	72	2	72	4	144	3	108	/	/	/	/
IV-të	4	144	3	108	2	72	2	72	4	144	3	108	/	/	/	/

Në tabelën 2.4.1. pasqyrohet kurrikula mësimore e arsimimit plurilingual në Shkollën e Mesme Teknike Komunale Gostivar (SHMTKG). Nxënësit shqiptarë dhe turq mësojnë gjuhën amtare (Gj-1), gjuhën angleze Gj-2, gjuhën maqedonase Gj-3, gjuhën gjermane Gj-4 ose gjuhën frëngje Gj-4. Nxënësit maqedonas në këtë shkollë mësojnë vetëm dy gjuhë, *gjuhë maqedonase dhe gjuhë angleze*. Në këtë shkollë vërehet një padrejtësi për të mësuarit e gjuhëve në mes nxënësve shqiptarë, turq dhe maqedonas.

Nxënësve të SHMTKG, më së tepërmi u nevojiten gjuhët e kontaktit, për shkak se ato profesionalizohen për mjeshtri të ndryshme dhe më së tepërmi në të ardhmen do të jenë në kontakt me vendasit e tyre. Këtyre nxënësve duhet t'u mundësohet të mësojnë gjuhën shqipe ose gjuhën turke, varësisht sipas dëshirës së tyre, por më e arsyeshme është gjuha shqipe për shkak se shumica e klientëve të tyre janë shqiptarë (66,60 %) sipas regjistrimit të vitit 2002. Pabarazia është një pengesë për zhvillimin e plurilinguizmit me gjuhët e vendit, që është e nevojshme për çdo individ në qytetin Gostivarit.

## KREU III

### 3. HULUMTIME EMPIRIKE NËPËR SHKOLLA

#### 3.1. Shkollat ku u zhvilluan hulumtimet

Hulumtimi u zhvillua në katër shkolla fillore dhe të mesme në qytetin e Gostivarit, me 4 drejtorë të shkollave fillore dhe 2 drejtorë të shkollave të mesme, 30 arsimtarë dhe 10 profesorë të gjuhëve. Në hulumtim janë përfshirë edhe 70 nxënës të klasave të VIII-ta dhe 60 nxënës të shkollave të mesme të viteve të III-ta (nga dhjetë 10 nxënës të tri komuniteteve shqiptarë, maqedonas dhe turq), mirëpo në disa shkolla nuk patëm mundësi t'i anketojmë nxënësit e komuniteteve, që nuk i kishte shkolla.

Anketimi u zhvillua më 22-23.04.2015 në praninë e pedagogëve të shkollave me anë të pyetësorëve të parapërgatitur me 20 pyetje të hapura në pritje të përgjigjeve alternative për zbatimin e multilinguizmit dhe arsimimin plurilingual në shkolla, që ndikon në edukimin plurilingual të tyre.

Mirënjojja dhe Falënderimi për realizimin e këtij hulumtimi u takon drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme, që më lejuan ta realizojë anketimin në institucionet arsimore publike të qytetit të Gostivarit dhe pedagogëve, arsimtarëve, profesorëve dhe nxënësve, që ndan kohë për t'i plotësuar pyetësorët.


- *Objktivi i parë* ishte të anketohen drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme me pyetësorë të parapërgatitur me 12 pyetje të hapura me opsione alternative.
- *Objktivi i dytë* ishte të anketohen nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme me pyetësorë të parapërgatitur me 20 pyetje të hapura me opsione alternative.
- Objktivi i tretë ishte të realizohet anketim me 30 arsimtarë dhe 10 profesorë të gjuhëve me pyetësorë të parapërgatitur me 10 pyetje të hapura me opsione alternative.

### 3.1.2. Gjetjet në pyetësorët-a të drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme

**Tabela 3.1.2. A. Mostra-Të dhëna për drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme të Gostivarit më 2014/2015**

Shkollat dhe emrat e drejtorëve	Përvoja e punës si drejtor	Përvoja e punës si arsimtar	Mosha	Gjinia		Përkatësia etnike	Juhu amtare	Realizimi i anketimit
				F	M			
SHF“GD”- Sasho Sharevski	2 vite	5 vite	31 vjeç	/	1	Maqedonase	maqedonase	22.04.2015
SHF “B”- Mersel Sadiku	2 vite	16 vite	41 vjeç	/	1	Shqiptare	shqipe	3.04.2015
SHF “MQA”- Oktay Nuredin	4 vite	7 vite	34 vjeç	/	1	Turke	turke	3.04.2015
SHF “IQ”- Bejtulla Zaimi	2 vite	13 vite	38 vjeç	/	1	Shqiptare	shqipe	3.04.2015
<b>Të dhënat e drejtorëve të shkollave të mesme</b>								
SHMKG - Xhezi Kamberi	6 vite	20 vite	49 vjeç	1		Shqiptare	shqipe	27.04.2015
SHMTK-G- Ibrahim Asani	1 vit	20 vite	50 vjeç	/	1	Shqiptare	shqipe	7.04.2015


Të dhënati parësore të pasqyruara në tabelën 4.1.2. A janë tregues se dy drejtorë të shkollave fillore dhe të mesme kanë përvojë më të madhe në postin e drejtorit, kurse 4 të tjërët janë me përvojë më të vogël në ushtrimin e postit të drejtorit, mirëpo me përvojë arsimore janë të gjithë mbi pesë vite, që dëshmon se parimet arsimore i kanë zotëruar. Pyetësori ishte i strukturuar me 12 pyetje të hapura me përzgjedhje alternative.



**Figura A-1 Shkolla fillore dhe të mesme**

Të dhënati e pasqyruara janë tregues se në shkollat fillore të Gostivarit mësimi në dy shkolla zhvillohet në dy gjuhë IQ dhe GD, kurse në dy shkollat fillore B dhe MQA mësimi zhvillohet në tri gjuhë. Gjithashtu edhe në shkollat e mesme mësimi zhvillohet në tri gjuhë.


2. Aktualisht numri i nxënësve në krahasim me vitet e kaluara është:



**Figura A-2 Shkolla fillore dhe të mesme**

Të gjithë drejtorët janë shprehur se numri i nxënësve është më i ulët në krahasim me vitet e kaluara.


3. A zhvillohet mësimi për të gjithë nxënësit në kushte të njëjtë



**Figura A-3 Shkolla fillore dhe të mesme**


Të gjithë drejtorët janë shprehur se të gjithë nxënësit mësojnë në objekt të njëjtë dhe në hapësirë të përbashkëta.

4. Nëse vitet e fundit ka ndryshim të numrit të nxënësve çfarë ka ndikuar më tepër?




### Figura A-4 Shkolla fillore dhe të mesme

Në pyetjen e katërt, nëse në vitet e fundit ka ndryshime në numrin e nxënësve, na thoni çfarë ka ndikuar më tepër? Drejtorët e shkollave janë shprehur në disa opsione: a) Rënie në shtimin natyror të popullsisë, rënie të natalitetit janë deklaruar **4 drejtorë** të shkollave fillore dhe **1 drejtor i shkollës së mesme**, mirëpo një drejtor i shkollës së mesme ka theksuar se nën d). Kanë ndikuar vendimet nga MASH/Vetëqeverisja lokale për ndryshim të numrit të paraleleve. Opinionet e pesë (5) drejtorëve dëshmojnë se në vitet e fundit nataliteti në qytetin e Gostivarit ka ra dukshëm. Opioni i drejtorit të shkollës së mesme në opzionin e fundit është tregues se kërkesa aktuale e konsumit e ndryshon edhe qasjen arsimore në përshtatshmëri me nevojat e tregut.



### Figura A-5 Shkolla fillore dhe të mesme


Në këtë pyetje 5 (83%) drejtorët janë shprehur se mësimi zhvillohet në dy ndërrime, kurse vetëm drejtori i shkollës fillore Bashkimi është shprehur se mësimi zhvillohet në tri ndërrime.



### Figura A-6 Shkolla fillore dhe të mesme


Në këtë pyetje drejtorët janë përgjigjur në të tri opzionet: a) sipas viteve është shprehur drejtori i SHMKG dhe nën b) sipas gjuhës mësimore etnike janë shprehur 4 (66%)

drejtorë), prej të cilëve 3 (50%) drejtorët e shkollave fillore GD,B,MQA dhe 1 (15%) drejtori i SHMTKG, ndërsa nën c) sipas kombinimit të viteve dhe gjuhës mësimore etnike është shprehur 1 (1%) drejtor i IQ. Kjo dëshmon se nxënësit e etniteteve të ndryshme nuk kanë mundësi të takohen në shkollë fillore dhe të zhvillojnë raporte miqësore në mes tyre.




**Figura A-7 Shkolla fillore dhe të mesme**

Të gjithë drejtorët janë shprehur se zotërimi i më shumë gjuhëve, individit i sjell dobi, që reflektojnë edukimin plurilingual të tyre falë mjedisit familjar, bashkësisë shoqërore multikulturore dhe arritjes së edukimit plurilingual si meritë e të mësuarit e disa gjuhëve gjatë arsimimit të tyre.



**Figura A-8 Shkolla fillore dhe të mesme**


Drejtorët e shkollave janë folës bilingual , multilingual dhe plurilingual.

**Figura A-9 Shkolla fillore dhe të mesme**


Në këtë pyetje drejtorët janë shprehur për disa opsiione. Kështu, për opzionin:

- lehtësim për të marrë informacione janë shprehur 3 (50%) drejtorë,
- mundëson të mësuarit vetjak dhe të pavarur janë shprehur 2 (33%) drejtorë,
- mundëson largim të urrejtjes janë shprehur 2 (33%) drejtorë ,
- ç) fisnikeron shpirtin e njeriut për tolerancë dhe mirëkuptim janë shprehur 2 (33%) drejtorë
- mundëson lehtësim në sigurimin e ekzistencës jetësore janë shprehur 2 (33%) drejtorë.

Drejtorët aktual e dinë dobinë, që ua sjellë shumëgjuhësia individëve, por më tepër reflektohet te drejtori i SHMKG, ku edhe raportet multikulturore në mes nxënësve në shkollë reflektohen në nivel më të mirë.


**Figura A-10 Shkolla fillore dhe të mesme**

Këto të dhëna pasqyrojnë se drejtorët e kanë të qartë vlerën e gjuhës si nevojë për përshtatshmëri komunikuese aktuale në vend dhe jashtë vendit.



**Figura A-11 Shkolla fillore dhe të mesme**

Në këtë pyetje opioni i drejtorëve është i ndarë në të dy opsonet. Kjo dëshmon se ka gjasa, që në të ardhmen këto të rinj të qëndrojnë në vendin e tyre nëse u mundësohen vende pune dhe kushte më të mira jetësore.



**Figura A-12 Shkolla fillore dhe të mesme**

Në pyetjen për të mësuarit e gjuhëve në mënyrë të barabartë nga të gjithë nxënësit, të gjithë drejtorët janë shprehur në opsonin a) po. Këto opinione janë tregues për pabarazi të organizimit të procesit mësimore sipas kurrikulës mësimore në të mësuarit e gjuhëve, ku nxënësit shqiptar në klasë të VIII-të 2014-2015 mësojnë 35 orë në javë, ndërsa nxënësit maqedonas mësojnë 33 orë në javë.

#### 4.1.3. Përfundimet nga pyetësorët e drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme

Në shkollat fillore urbane mësimi zhvillohet në tri gjuhë dhe dy gjuhë, kurse në shkollat fillore rurale mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, përvèç në shkollën e fshatit Vërtok.

- Në të gjithë shkollat ka rënie në numrin e nxënësve.
- Procesi mësimore zhvillohet në kushte të njëjtë për të gjithë nxënësit.
- Rënie në numrin e nxënësve si pasojë e natalitetit dhe migrimit të njerëzve.
- Procesi mësimore zhvillohet në dy dhe tri ndërrime.
- Procesi mësimor zhvillohet në ndërrimet sipas gjuhës mësimore etnike.
- Të gjithë drejtorët reflektojnë edukim plurilingual.
- Të gjithë drejtorët janë folës plurilingual.
- Të gjithë drejtorët zotërimin e shumëgjuhësisë e konsiderojnë si pasuri individuale.
- Të gjithë drejtorët të gjithë për komunikim shoqëror në vendin e tyre i vlerësojnë të gjuhët e vendit, por edhe gjuhën angleze.
- Tre Drejtorë mendojnë se të rinxjtë në të ardhmen do të jetojnë në vendlindje, por tre drejtorë mendojnë se të rinxjtë do të largohen jashtë vendit, prandaj gjuha angleze u nevojitet.
- Të gjithë drejtorët mendojnë se nxënësit janë të diskriminuar për të mësuarit e gjuhëve të kontaktit.


#### 3.2. Pyetësori B-Gjetjet në pyetësorët e nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme

**Tabela 1. B – Mostra në shkolla fillore-** Numri i nxënësve të anketuar në shkolla fillore

Nxënësit	Numri i përgjithshëm i nxënësve sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike										Gjuha mësimore			Gjithsej :70
	F					M					SH	M	T	
Numri i përgjithshëm i nxënësve nga të gjithë shkollat fillore	Fsh	Fm	Ft	Fr	Fs	Msh	Mm	Mt	Mr	Ms	30	30	10	70
Gjithsej:70	36 (51%)					34 (49%)								70

**Tabela1.B-Mostra në shkolla të mesme**–Numri i nxënësve të anketuar në shkolla të mesme

Nxënësit	Numri i përgjithshëm i nxënësve sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike										Gjuha mësimore			Gjithsej:60
	F					M					SH	M	T	
Numri i përgjithshëm i nxënësve të shkollave të mesme	Fsh	Fm	Ft	Fr	Fs	Msh	Mm	Mt	Mr	Ms	/	/	/	
SHMKG	6	5	6	/	2	4	3	4	/	/	10	10	10	30
SHMTKG	5	/	/	2	1	5	7	10	/	/	10	10	10	30
Gjithsej: 60	27 femra					33 meshkuj								60




**Figura B-1 Shkolla fillore**

1. Nxënësit e shkollave fillore për shoqërimin e tyre brenda në shkollë me nxënës të etniteteve tjera e kanë shprehur në disa opsione:

- a) *me shqiptarë-maqedonas (maqedonas-shqiptarë ose turq-shqiptarë)* janë shprehur 14 (20%) nxënës nga 70 nxënës të anketuar, ku shqiptarë janë shprehur 9 (13%), 4 (6%) femra dhe 5 (7%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 3 (4%), 1 (1%) femër dhe 2 (3%) meshkuj dhe te turqit janë shprehur 2 (3%) turq , 1 (1%) femër dhe 1 (1%) mashkull.
- b) *me shokë të përkatësive tjera etnike* janë shprehur 25 (36%), ku është shprehur vetëm 1 (1%) femër shqiptare, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 22 (31%), 11 (16%) femra dhe 11 (16%) meshkuj dhe te turqit janë shprehur vetëm 2 (3%) meshkuj.
- c) *me asnjë shokë nga përkatësi tjera etnike* janë shprehur 28 (40%) të nxënësve të anketuar, ku shqiptarë janë shprehur 13 (19%) shqiptarë, 7 (10%) femra dhe 6 (9%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 9 (13%), 6 (9%) femra dhe 3 (4%) meshkuj , ndërsa te turqit janë shprehur 6 (9%) , 3 (4%) femra dhe 3 (4%) meshkuj.

Të dhënat janë tregues se në shkolla fillore nxënësit nuk shoqërohen brenda në shkollë me nxënës të përkatësive tjera etnike, për shkak se nuk mësojnë në një ndërrim.

**1. A shoqëroheni me shokë të përkatësive etnike tjera, që mësojnë në shkollën tuaj?**



**Figura B-1 Shkolla të mesme**


Nxënësit e shkollave të mesme për shoqërimin e nxënësve brenda në shkollë me nxënës të etniteteve tjera janë shprehur në disa opsione:

a) *me shqiptarë-maqedonas (maqedonas-shqiptarë ose turq-shqiptarë)* janë shprehur 22 (37%) nxënës nga 60 nxënës të anketuar, ku është shprehur vetëm 1 (2%) shqiptar, ndërsa te maqedonasinat janë shprehur 4 (7%), 2 (3%) femra dhe 2 (3%) meshkuj, ndërsa 17 (28%) te turqit janë shprehur 17 (28%), 4 (7%) femra dhe 13 (22%) meshkuj turk.

b) *me shokë tjetër me përkatësive tjera etnike* janë shprehur 33 (55%), ku shqiptarë janë shprehur 17 (28%), 9 (15%) femra dhe 8 (13%) meshkuj, ndërsa maqedonas 13 (22%), 9 (15%) femra dhe 4 (7%) meshkuj, ndërsa turq 3 (5%), 2 (3%) femra dhe 1 (2%) mashkull.

c) *me asnjë shokë tjetër me përkatësive tjera etnike* janë shprehur 3 (5%) të nxënësve të anketuar, prej tyre 2 (3%) shqiptarë, 1 (2%) femër dhe 1 (2%) mashkull, te maqedonasinat është shprehur vetëm 1 (2%) mashkull, ndërsa te etniteti turk nuk është shprehur asnjë.

Të dhënat janë tregues se në shkolla të mesme nxënësit shoqërohen brenda në shkollë me nxënës të përkatësive tjera etnike. Vetëm 2 (3%) nuk janë shprehur nga të anketuarit në këtë pyetje.



**Figura B-2 Shkolla fillore**

Nxënësit e shkollës fillore në pyetjen 2 janë shprehur në disa opsione:

- a) Po janë shprehur 60 (86%), ku shqiptarë janë shprehur 23 (33%), 13 (19%) femra dhe 10 (14%) meshkuj shqiptarë, ndërsa maqedonas janë 28 (40%), 13 (19%) femra dhe 15 (21%) meshkuj dhe te turqit janë 9 (13%), 3 (4%) femra dhe 6 (9%) meshkuj.

Jo janë shprehur vetëm 2 (3%) femra shqiptare, ndërsa maqedonasit dhe turqit aspak nuk janë shprehur. Të dhënat janë tregues se nxënësit e shkollave fillore, shoqërohen në mes veti me shokë të përkatësive tjera etnike vetëm kur ndodhen jashtë shkolle në qytet.




**Figura B-2 Shkolla të mesme**

Nxënësit e shkollave të mesme në pyetjen e dytë janë shprehur në disa opsione:

- a) Po janë shprehur 49 (82%), ku shqiptarë janë shprehur 15 (25%), 8 (13%) femra dhe 8 (13%) ndërsa maqedonas janë shprehur 16 (27%), 8 (13%) femra dhe 8 (13%) meshkuj, kurse turq janë shprehur 18 (13%), 4 (7%) femra dhe 14 (23%) meshkuj.
- b) Jo janë shprehur 7 (12%) nga të 60 të anketuarit, ku shqiptarë janë 6 (10%) janë, 3 (5%) femra dhe 3 (5%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit është shprehur vetëm 1 (2%) mashkull, kurse te turqit nuk është shprehur asnjë nxënës turk.

Të dhënat janë tregues se nxënësit e shkollave të mesme shoqërohen njëri me tjetrin pa dallim të përkatësisë etnike, kur ndodhen në qytet.

**Figura B-3 Shkolla fillore**

Nxënësit e shkollave fillore në pyetjen 3 janë përgjigjur në disa opsione:


a) *bashkë në ndonjë lokal për pije ose në disko* janë shprehur 3 (4%), ku është shprehur vetëm 1 (1%) femër shqiptare, ndërsa te maqedonasit është shprehur vetë 1 (1%) mashkull maqedonas, kurse te turqit është shprehur vetëm 1 (1%) femër turke.

b) *bashkë shkojmë në ahengje të përbashkëta* janë shprehur 2 (3%), nuk është shprehur asnjë shqiptarë, ndërsa te maqedonasit janë shprehur vetëm 2 (3%) femra dhe te turqit nuk është shprehur asnjë turk.

c) *bashkë shëtisim nëpër qytet* opinionin e vet e kanë shprehur 22 (31%) të nxënësve, prej të cilëve janë shprehur 12 (17%) shqiptarë, 7 (10%) femra dhe 5 (7%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 5 (7%) , 2 (3%) femra dhe 3 (4%) meshkuj dhe te turqit janë shprehur 5 (7%), 2 (3%) femra dhe 3 (4%) meshkuj turq.

ç) *asnijëherë nuk shoqërohem i jashtë shkollës* opinionin e vet e kanë shprehur 22 (31%), ku shqiptarë janë shprehur 10 (14%), 5 (7%) femra dhe 5 (7%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 12 (17%), 7 (10%) femra dhe 5 (7%) meshkuj dhe te turqit asnjë s'është shprehur.

d) opinionin e vet se takohen dhe shoqërohen në qytet e kanë shprehur 13 (19%), ku është shprehur vetëm 1 (2%) mashkull shqiptar, kurse te maqedonasit janë shprehur 9 (13%), 4 (6%) femra dhe 5 (7%) meshkuj maqedonas, ndërsa te turqit janë shprehur 3 (4%), 2 (3%) femra dhe 1 (1%) mashkull turk. Shoqërizimi i nxënësve me shokë të përkatësive tjera që ndodh në qytet, është si vijon: 22 (31%) të anketuarve shoqërohen, kurse 22 (31%) janë shprehur se aspak nuk shoqërohen për shkak se nuk njihen.



**Figura B-3 Shkolla të mesme**

Nxënësit e shkollave të mesme në pyetjen 3 janë përgjigjur në disa opsione:

a) *bashkë në ndonjë lokal përpjje ose në diskò* janë shprehur 17 (28%), prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 7 (12%), 2 (3%) femra dhe 1 (2%) meshkuj, ndërsa maqedonas asnjë nuk është shprehur, kurse turk 10 (17%) , 3 (5%) femra dhe 7 (12%) meshkuj turk


b) *bashkë shkojmë në ahengje të përbashkëta* janë shprehur 4 (7%), ku shqiptarë janë shprehur 3 (5%), 1 (2%) femër dhe 2 (3%) meshkuj, ndërsa maqedonas asnjë nuk është shprehur, kurse te turqit vetëm 1 (2%) femër turke.

c) *bashkë shëtisim nëpër qytet* opinionin e vet e kanë shprehur 7 (12%) të nxënësve , ku shqiptarë janë shprehur2 (3%), 1 (2%) femër dhe 1 (2%) mashkull, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 2 (3%)meshkuj, kurse te turqit janë shprehur 3 (5%), 1 (2%) femër dhe 2 (3%) meshkuj.

ç) *asnjëherë nuk shoqërohem ijashtë shkollës* opinionin e vet e kanë shprehur 21 (35%), prej të cilëve 10 (17%), 8 (13%) femra dhe 2 (3%) meshkuj, ndërsa maqedonas janë shprehur 11 (18%), 5 (8%) femra dhe 6 (10%) meshkuj, kurse te turqit asnjë nuk është shprehur.

d) Nëpër qytet opinionin e vet e kanë shprehur 11 (18%), 1 (2%) mashkull shqiptarë, kurse maqedonas janë shprehur 5 (8%), 2 (3%) femra dhe 3 (5%) meshkuj dhe te turqit janë shprehur 5 (8% ), 1 (2%) femër dhe 4 (7%) meshkuj turk.

**4. Nëse nuk shoqëroheni atëherë përse ndodh kjo?**



**Figura B-4 Shkolla fillore**

Nxënësit e shkollave në pyetjen 4 opinionin e vet e kanë shprehur në disa opsione

a) *s'kemi mundësi* janë shprehur 20 (29%), ku janë shprehur 3 (5%) shqiptarë, 1 (1%) femër dhe 2(3%)meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 14 (20%), 9 (13%)femra dhe 5(7%) meshkuj, kurse te turqit janë shprehur 3 (4%), 1 (1%)femër dhe 2 (3%)meshkuj.

b) *nuk mund të kuptohemi* janë shprehur 22 (31%), ku shqiptarë janë shprehur 9 (13%), 3(4%)femra dhe 6 (9%)meshkuj, ndërsa te turqit janë shprehur vetëm 5 (7%), 3 (4%) femra dhe 2(3%)meshkuj.


c) *ne nuk duam të shoqërohem i me ata* është shprehur vetëm 1 (1%) vetëm mashkull maqedonas.

ç) *ata nuk duan të shoqërohen me ne*, 2 (3%), janë shprehur nga 1 (1%) mashkull shqiptarë dhe 1 (1%) mashkull maqedonas, ndërsa te turqit nuk është shprehur asnjë.

d) *arsimtarët nuk i pëlqejnë ato* nuk është përgjigjur asnjë

dh) *prindërit nuk na lejojnë* është shprehur vetëm 1 (2%) mashkull turk

e) *tjetër* janë shprehur 16 (23%), ku nga shqiptarët janë shprehur 10 (14%) , 5 (7%) femra dhe 5 (7%) meshkuj, kurse te maqedonasit janë shprehur 6 (9%), prej tyre 4 (6%) femra dhe 2 (3%) meshkuj maqedonas , ndërsa te turqit asnjë nuk ka shtuar diçka tjetër.  
*Mosnjohja e gjuhës dhe mosnjohja e tyre janë pengesë për shoqërimin në mes nxënësve.*




**Figura B-4 Shkolla të mesme**

Nxënësit e shkollave të mesme në pyetjen 4 opinionin e vet e kanë shprehur në opzionet:

- e) *s'kemi mundësi* janë shprehur 14 (23%), ku janë shprehur vetëm 3 (5%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur vetëm 4 (7%) femra, kurse turq janë shprehur 6 (10%), 3 (5%) femra dhe 3 (5%) meshkuj.
- f) *nuk mund të kuptohemi* janë shprehur 22 (37%), ku shqiptarë janë shprehur 5 (8%), 3 (5%) femra dhe 2 (3%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur vetëm 4 (7%) femra maqedonase, ndërsa te turqit janë shprehur 13 (21%), 3 (5%) femra dhe 10 (17%) meshkuj.
- g) *ne nuk duam të shoqërohem me ata*, janë shprehur 5 (8%), ku janë shprehur vetëm 3 (5%) meshkuj shqiptarë, ndërsa te maqedonasit është shprehur vetëm 1 (2%) mashkull, kurse te turqit gjithashtu është shprehur vetëm 1 (2%) mashkull.
- ç) *ata nuk duan të shoqërohen me ne* janë shprehur 3 (5%) nxënës, prej tyre vetëm 2 (3%) meshkuj shqiptarë dhe 1 (2%) femër maqedonase, kurse te turqit asnjë s'është shprehur.
- d) *arsimtarët nuk i pëlqejnë ato* nuk është përgjigjur asnjë.
- dh) *prindërit nuk na lejojnë* është shprehur vetëm 1 (2%) mashkull turk .
- e) *tjetër* janë shprehur 9 (15%) nxënës, ku është shprehur vetëm 1 (2%) mashkull shqiptarë, kurse te maqedonasit janë shprehur 8 (13%), 4 (7%) femra dhe 4 (7%) meshkuj maqedonas, ndërsa te turqit asnjë.


**5. Çfarë aktivitetesh të përbashkëta bëni në shkollë, pa dallim të përkatësisë etnike?**



**Figura B-5 Shkolla fillore**

Nxënësit e shkollave fillore në pyetjen 5 janë shprehur në disa opsione:

- a) *kemi aktivitete të përbashkëta* në grupe të ndryshme janë shprehur 10 (14%) nxënës, prej tyre janë shprehur 3 (4%) shqiptarë, 2 (3%) femra dhe 1 (1%) mashkull, ndërsa maqedonas janë shprehur 6 (9%), 4 (6%) femra dhe 2 (3%) meshkuj, kurse te turqit është shprehur vetëm 1 (2%) femër turke.
- b) *kemi disa orë të përbashkëta* (*edukatë fizike, informatikë, gjuhë të huaj*) janë shprehur 10 (14%), ku shqiptarë janë shprehur vetëm 2 (3%) femra, ndërsa te maqedonasin
- c) janë shprehur 6 (9%), 3 (4%) femra dhe 3 (3%) meshkuj, kurse te turqit janë shprehur vetëm 2 (3%) femra.
- d) *bashkë marrim pjesë në gara sportive* në ekipe të përziera janë shprehur 9 (13%), ku janë shprehur 3 (4%) shqiptarë, 1 (1%) femër dhe 2 (3%) meshkuj, ndërsa te maqedonasin janë shprehur 5 (7%), 3 (4%) femra dhe 2 (3%) meshkuj, kurse te turqit është shprehur vetëm 1 (1%) mashkull.
- ç) *bashkë shkojnë në gara në mes shkollave* të ndryshme janë shprehur 9 (13%), ku janë shprehur vetëm 2 (3%) femra shqiptare, ndërsa te maqedonasin janë shprehur 4 (6%), 2 (3%) femra dhe 2 (3%) meshkuj, kurse te turqit janë shprehur 3 (4%), 2 (3%) femra dhe 1 (1%) mashkull turk.
- d) *bashkë festojnë festa* janë shprehur 4 (6%), ku janë shprehur vetëm 4 (6%) shqiptarë, 1 (1%) femër dhe 3 (4%) meshkuj shqiptarë, ndërsa te maqedonasin dhe turqit nuk janë shprehur.
- dh) *bashkë dalim në skenë nëpër shfaqje teatrale* dhe për manifestime janë shprehur 8 (11%), ku janë shprehur 2 (3%) shqiptarë, 1 (2%) femër dhe 1 (2%) mashkull, ndërsa maqedonas janë shprehur 6 (9%), 2 (3%) femra dhe 4 (6%) meshkuj, kurse te turqit nuk është shprehur asnjë. Të dhënat e reflektuara janë treguese se një pjesë e nxënësve 10 (14%) dëshmojnë se në shkolla fillore nxënësit zhvillojnë aktivitete të përbashkëta, kurse një pjesë 10 (14%) nxënësve dëshmojnë se në shkolla fillore asgjë nuk zhvillohet bashkë.



**Figura B-5 Shkolla të mesme**

Nxënësit e shkollave të mesme në pyetjen 5, opinionin e kanë shprehur në disa opsione:

a) *kemi aktivitete të përbashkëta në grupe të ndryshme* janë shprehur 20 (33%) nxënës, prej të cilëve 4 (7%) janë shqiptarë, 1 (3%) femër dhe 3 (5%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 6 (10%), 2 (3%) femra dhe 4 (7%) meshkuj dhe te turqit janë shprehur vetëm 10 (17%), 4 (7%) femra dhe 6 (10%) meshkuj.

b) *kemi disa orë të përbashkëta (edukatë fizike, informatikë, gjuhë të huaj)* janë shprehur 4 (7%), prej të cilëve 2 (3%) janë shqiptarë, 1 (1%) femra dhe 1 (1%) mashkull, ndërsa te maqedonasit janë shprehur vetëm 2 (3%) dhe te turqit nuk është shprehur asnjë.


c) *bashkë marrim pjesë në gara sportive në ekipe të përziera* janë shprehur 8 (13%), prej të cilëve është shprehur vetëm 1 (1%) shqiptar, ndërsa maqedonas nuk është shprehur asnjë dhe te turqit janë shprehur 7 (12%), 1 (1%) femër dhe 6 (10%) mashkull.

ç) *bashkë shkojnë në gara në mes shkollave të ndryshme* janë shprehur 2 (3%), prej të cilëve është shprehur vetëm 1 (1%) mashkull shqiptar dhe vetëm 1 (1%) mashkull maqedonas dhe te turqit asnjë nuk është shprehur.

d) *bashkë festojnë festa* janë shprehur 6 (10%) nxënës, prej të cilëve 5 (8%) janë shqiptarë, 4 (7%) femra dhe 1 (1%) mashkull, ndërsa maqedonas është shprehur vetëm 1 (1%) mashkull, kurse te turqit nuk është shprehur asnjë.

dh) *bashkë dalim në skenë nëpër shfaqje teatrale dhe për manifestime* janë shprehur 14 (23%) prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 2 (3%) edhe atë vetëm femra, ndërsa maqedonas janë shprehur 11 (18%), 7 (12%) femra dhe 4 (7%) meshkuj, ndërsa turq janë shprehur vetëm 1 (1%) edhe atë 1 (%) mashkull.


Të dhënat e reflektuara janë tregues se në shkolla të mesme nxënësit zhvillojnë aktivitete të përbashkëta dhe kanë raporte multikulturore janë të mira.

**Figura B-6 Shkolla fillore**

Nxënësit e shkollave fillore në pyetjen 6 opinionin e vet e kanë shprehur në opsonet:

- pasi që mësojmë në gjuhë të ndryshme janë shprehur 20 (29%) nga të 70 të anketuarit, prej tyre janë: 7 (10%) shqiptarë, 3 (4%) femra dhe 4 (6%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 9 (13%), 3 (4%) femra dhe 6 (9%) meshkuj dhe te turqit janë shprehur 4 (6%), 1 (1%) femër dhe 3 (4%), meshkuj.
- pasi që kemi arsimtarë të ndryshëm nuk është shprehur asnjë nxënës.
- pasi që mësojmë më ndërrime të ndryshme janë shprehur 21 (30%) nxënës, ku shqiptarë janë shprehur 6 (9%), 4 (6%) femra dhe 2 (3%)meshkuj , ndërsa te maqedonasit janë shprehur 12 (17%), 7 (10%) femra dhe 5 (7%)meshkuj dhe te turqit janë shprehur 3 (4%), 2 (3% )femra dhe 1 (1%) mashkull.
- pasi që nuk na interesojnë të njëjtat sende nuk është shprehur asnjë nxënës.
- pasi që ashtu jemi mësuar dhe na është bërë shprehi është shprehur vetëm 1 ( 1% ) mashkull shqiptar.
- nuk e di janë shprehur 24 (34%) nxënës, ku shqiptarë janë shprehur 10 (14%), 6 (9%) femra dhe 4 (6%) meshkuj shqiptarë, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 10 (14%), 5 (7%) femra dhe 5 (7%) meshkuj maqedonas dhe te turqit janë shprehur 4 (6%), 1 (1%) femër dhe 3 (4%)meshkuj.

Të dhënat e pasqyruara janë tregues se mosnjohja e gjuhës së tjetrit dhe të mësuarit në ndërrime të ndryshme janë shkaqet, që nuk organizohen aktivitetet përbashkëta,




**Figura B-6 Shkolla të mesme**

Nxënësit e shkollave të mesme në pyetjen e 6 opinionin e vet e kanë shprehur sipas këtyre opsiioneve:

- a) *pasi që mësojmë në gjuhë të ndryshme* janë shprehur 20 (33%) nga të 60 të anketuar, prej të cilëve janë 4 (7%) shqiptarë, 1 (2%) femër dhe 3 (7%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 6 (10%), 2 (3%) femra dhe 4 (7%) meshkuj dhe te turqit janë shprehur 10 (17%), 4 (7%) femra dhe 6 (10%) meshkuj.
- b) *pasi që kemi arsimtarë të ndryshëm* janë shprehur 4 (7%) nxënës, prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 2 (3%), 1 (2%) femër dhe 1 (2%) mashkull, ndërsa te maqedonasit janë shprehur vetëm 2 (3%) meshkuj, kurse te turqit s'është shprehur asnjë.
- c) *pasi që mësojmë më ndërrime të ndryshme* janë shprehur 8 (13%) nxënës, prej të cilëve është shprehur vetëm 1 (2%) shqiptar, ndërsa te maqedonasit nuk është shprehur asnjë dhe te turqit janë shprehur 7 (12%), 1 (2%)femër dhe 6 (10%)meshkuj.
- ç) *pasi që nuk na interesojnë të njëjtat sende* janë shprehur 2 (3%) nxënës, ku është shprehur vetëm 1 (2%) mashkull shqiptar dhe vetëm 1(2%) mashkull maqedonas, kurse te turqit nuk është shprehur asnjë.
- d) *pasi që ashtu jemi mësuar dhe na është bërë shprehi* janë shprehur 6 (10%) nxënës, prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 5 (8%), 4 (7%) femra dhe 1 (2%) mashkull , ndërsa te maqedonasit është shprehur vetëm 1 (2%) mashkull dhe te turqit nuk është shprehur asnjë.
- dh) *nuk e di* janë shprehur 14 (23%) nxënës, prej të cilëve janë shprehur vetëm 2 (3%) femra shqiptare, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 11 (18%) , 7 (12%) femra dhe 4 (7%) meshkuj maqedonas dhe te turqit është shprehur vetëm 1 (2%) mashkull.

*Të dhënat janë tregues se mosnjohja e gjuhës së tjetrit është pengesë për zhvillimin e aktivitatave të përbashkëta.*

**7. A dëshironi të organizohen aktivitete të përbashkëta për të gjithë nxënësit?**



**Figura B-7 Shkolla fillore**


Nxënësit e shkollës fillore në pyetjen e 7, opinionin e kanë shprehur në disa opzionet:

a) Po janë shprehur 61 (87%) nxënës, prej tyre shqiptarë janë shprehur 18 (40%), 13 (19%) femra dhe 15 (21%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 25 (35%), 14 (20%) femra dhe 11 (16%) meshkuj dhe te turqit janë shprehur 8 (11%), 4 (6%) femra dhe 1 (1%) mashkull.

a) jo janë shprehur 6 (9%) nxënës, ku është shprehur vetëm 1 (1%) femër shqiptare, ndërsa te maqedonasit nuk është shprehur asnjë nxënës dhe te turqit janë shprehur 5 (7%), 4 (6%) femra dhe 1 (1%) mashkull.

Të dhënat e pasqyruara janë tregues se nxënësit dëshirojnë të kenë aktivitete të përbashkëta, edhe atë më së tepërmë dëshirat për aktivitete të përbashkëta reflektohen tek maqedonasit nga 25 (35%) nxënës.

**7. A dëshironi të organizohen aktivitete të përbashkëta për të gjithë nxënësit?**




**Figura B-7 Shkolla të mesme**

Nxënësit e shkollave të mesme në pyetjen 7 opinionin e vet e kanë shprehur në opzionet:

a) po janë shprehur 42 (70%) nxënës, prej të cilëve nga shqiptarët janë shprehur 11 (18%) nxënës, 6 (10%) femra dhe 5 (8%) meshkuj, ndërsa nga maqedonasit janë shprehur 17 (28%) maqedonas, 7 (12%) femra dhe 10 (17%) dhe turqit 13 (22%), 3 (7%) femra dhe 7 (12%) meshkuj.

b) jo janë shprehur 14 (23%) nxënës, prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 8 (13%), 4 (7%) femra dhe 4 (7%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 2 (3%), 1 (2%) femër dhe 1 (2%) mashkull dhe te turqit janë shprehur 4 (7%), 1 (2%) femër dhe 3 (7%) meshkuj. Të dhënat e pasqyruara janë tregues se nxënësit dëshirojnë të kenë aktivitete të përbashkëta, edhe atë më së tepërmë dëshira për aktivitete të përbashkëta reflektohet te maqedonasit 17 (28%).



**Figura B-8 Shkolla fillore**


Në pyetjen 8-B *A mendoni se jeni të diskriminuar për të mësimin e ndonjë gjuhe në shkollë?* Nxënësit në shkollën tuaj si gjuhë amtare e mësojnë gjuhën shqipe (Gj 1) m 4 orë në javë ose 144 orë në vit, si gjuhë të dytë e mësojnë gjuhën angleze (Gj 2) nga tri orë në javë ose 108 orë në vit, si gjuhë të tretë e mësojnë gjuhën maqedonase (Gj 3) me 2 orë në javë ose 72 orë në vit dhe si gjuhë të katërt e mësojnë gjuhën gjermane (Gj-4 ) me 2 orë në javë ose 72 në vit dhe gjuhën frëngje (Gj 4) me 2 orë në javë ose 72 në vit. Nxënësit e shkollave fillore në pyetjen 8 opinionin e kanë shprehur në opzionet:

a) *po* janë shprehur 11 (18%) nxënës, ku asnjë shqiptarë nuk është shprehur, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 9 (15%), 4 (6%) femra dhe 5 (7%), kurse te turqit vetë 2 (3%) meshkuj turq.

b) *jo* janë shprehur 46 (77 %) nxënës, ku shqiptarë janë shprehur 17 (24%), 10(14%) femra dhe 7 (10%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 11 (16%), 5 (7%) femra dhe 6 (9%) meshkuj, kurse te turqit janë shprehur 18 (26%), 6 (9%) femra dhe 12 (17%) meshkuj turk.

*Të dhënat e pasqyruara janë tregues se nxënësit e shkollës fillore nuk e ndjejnë veten të diskriminuar për të mësimin e gjuhëve.*

**8. A mendoni se jeni të diskriminuar për të mësuarit e ndonjë gjuhe shkollë?**




**Figura B-8 Shkolla të mesme**

Nxënësit e shkollave të mesme në pyetjen e 8 opinionin e shprehin si vijon :

- a) po janë shprehur 11 (18%) nxënës, prej të cilëve shqiptarë nuk është shprehur asnjë, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 9 (15%) (me siguri janë rom), 4 (7%) femra dhe 5 (8%) dhe te turqit vetë 2 (3%) meshkuj turq.
- b) jo janë shprehur 46 (77 %) nxënës, prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 17 (28%), 10 (17%) femra dhe 7 (12%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 11 (18%), 5 (8%) femra dhe 6 (10%) meshkuj dhe te turqit janë shprehur 20 (33%), 6 (10%) femra dhe 12 (20%) meshkuj turq.

Opinionet e nxënësve të shkollave të mesme janë treguese se nuk e ndjenjë vetën të diskriminuar për të mësuarit e gjuhëve.




**Figura B-9 Shkolla fillore**

Në pyetjen 9 opinionin e vet e kanë 67 (96%) nxënës të shkollave fillore, kurse vetëm 3 (4%) nuk janë shprehur. Ata janë shprehur në disa opsione:

a) *po* janë shprehur 63 (90%) nxënës, prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 26 (37%) shqiptarë, 13 (19%) femra dhe 13 (19%) meshkuj, ndërsa maqedonas janë shprehur 28 (40%), 13 (19%) femra dhe 15 (21%) meshkuj dhe te turqit janë shprehur 9 (13%), 4 (6%) femra dhe 5 (7%) meshkuj turk.

b) *Jo* janë shprehur vetëm 2 (3%) shqiptarë dhe 2 (3%) maqedonas.

Të dhënët janë tregues se edukimi plurilingual ka arritur të vlerësohet nga të gjithë nxënësit e shkollës fillore, për shkak se janë një brez, prindërit e të cilëve me siguri e kanë parë dobinë nga përdorimi i shumëgjuhësë. Më së tepërm reflektohet te etniteti maqedonas me 28 (40%), kurse sipas gjinisë më së tepërm reflektohet te meshkujt, për shkak se ato janë më të lirë për të komunikuar me çdonjërin pa asnjë lloj pengese.




**Figura B-9 Shkolla të mesme**

Nxënësit e shkollave të mesme në pyetjen 14, opinionin e kanë shprehur në dy opsione:

a) *po* janë shprehur 57 (95%) nxënës, prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 19 (32%), 10 (17%) femra dhe 9 (15%) meshkuj, ndërsa maqedonas janë shprehur 19 (32%), 8 (13%) femra dhe 11 (18%) meshkuj, kurse te turqit janë shprehur 19 (32%), 6 (10%) femra dhe 13 (22%) meshkuj turk.

b) *jo* nuk është shprehur asnjë.

Të dhënët e pasqyruar janë tregues se të gjithë nxënësit e shkollave të mesme vlerën e gjuhëve e vlerësojnë si kompetencë kognitive, që u ndihmon në çdo pikëpamje jetësore.

**Figura B-10 Shkolla fillore**

Nxënësit e shkollave fillore në pyetjen e 10, opinionin e vet e shprehën në disa opsione:

a) *një gjuhë* janë shprehur gjithsej 21 (30%) nxënës nga të anketuarit, ku të etnititetit shqiptar janë 7 (10%) nxënës, prej tyre janë 1 (1%) femër dhe 6 (9%) meshkuj shqiptarë, ndërsa të etnititetit maqedonas janë shprehur 14 (20%) nxënës, prej tyre janë 4 (6%) femra dhe 10 (14%) meshkuj dhe te etniteti turk nuk është shprehur asnjë nxënës.


b) *dy gjuhë* janë shprehur gjithsej 15 (21%) nxënës nga nxënësit e anketuar, prej të cilëve të etniteti shqiptarë janë vetëm 3 (4%) femra, kurse nga meshkujt shqiptarë s'është shprehur asnjë, të etniteti maqedonas janë 7 nxënës ose (10%), prej tyre janë 6 (9%) femra dhe 1 (1%) mashkull, ndërsa te etniteti turk janë shprehur 5 (7%) nxënës, prej tyre janë 3 (4%) femra dhe 2 (3%) meshkuj turk.

c) *tri gjuhë* janë shprehur 16 (23%) nxënës nga të anketuarit, prej të cilëve të etnititetit shqiptarë janë 9 (13%), 8 (11%) femra dhe 1 (1%) mashkull, kurse të etnititetit maqedonas 4 (6%), 2(3%) femra dhe 2 (3%) meshkuj, kurse te etniteti turk janë shprehur 3 (4%) nga të anketuarit, ku janë 2 (3%) femra dhe 1 (1%)meshkuj.

ç) *katër gjuhë* janë shprehur gjithsej 13 (19%) nxënës nga të anketuarit, ku të etnititetit shqiptarë janë 6 (9%), 3 (4%) femra dhe 3 (4%)meshkuj, ndërsa te etniteti maqedonas janë shprehur 4 (6%) nga të anketuarit, 2 femra(3%) dhe 2 (3%)meshkuj dhe te etniteti turk janë shprehur 3 (4%) nga të anketuarit, ku janë 2 (3%) femra dhe 1 (1%) mashkull.

Të dhënat ndriçojnë gjendjen e plurilinguizmit të nxënësve të shkollave fillore, që ende janë në proces arsimor gjuhësorë e të mësuarit të disa gjuhëve. Këto të dhëna reflektojnë se folës njëgjuhësorë më tepër ka te etnititetit maqedonas 14 (20%) nxënës, kurse katër gjuhësorë ka te të tri etnitet, të etnititetit shqiptar 8 (11%), ndërsa të etnititetit maqedonas janë shprehur 4 (6%) dhe 3 (4%) turq.

*Të dhënat janë tregues se në Gostivar ka më tepër folës shumëgjuhësorë si shkak i pranisë së disa bashkësive gjuhësore dhe funksionimit të multilinguizmit dhe arsimimit plurilingual në institucionë arsimore, që reflekton një arritje të edukimit plurilingual te qytetarët e Gostivarit.*



**Figura B-10 Shkolla të mesme**

Nxënësit e shkollave të mesme në pyetjen e 10 opinioni, kanë shprehur këto opsione:


a) *një gjuhë* (gjuha amtare) janë shprehur 13 (22%), prej të cilëve nga shqiptarët janë shprehur 2 (3%) nxënës, prej tyre 1 (2%) femër dhe 1 (2%) mashkull, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 6 (10%) nxënës, prej tyre meshkuj (me siguri në shkollën profesionale), kurse te turqit janë shprehur vetëm 5 (8%) meshkuj.

b) *dy gjuhë* (gjuha amtare dhe gjuha maqedonase) janë shprehur 14 (23%), prej të cilëve te shqiptarët janë shprehur 3 (7%), 1 (2%) femër dhe 2 (3%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 3 (7%), 2 (3%) femër dhe 1 (2%) mashkull, kurse te turqit janë shprehur 8 (13%), 4 (7%) femra dhe 4 (7%) meshkuj turk.

c) *tri gjuhë* (gjuha amtare, gjuha maqedonase, gjuha angleze) janë shprehur 19 (32%) prej të cilëve te shqiptarët janë shprehur 8 (13%), 7 (12%) femra dhe 1 (2%) mashkull, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 8 (13%), 4 (7%) femra dhe 4 (7%) meshkuj ,kurse te turqit janë shprehur 3 (7%), 1 (2%) femër dhe 2 (3%) meshkuj turq.

ç) *katër gjuhë* (gjuha amtare, gjuha maqedonas, gjuha angleze, gjuha gjermane, gjuha turke) janë shprehur 12 (20%) nxënës, nga shqiptarë janë shprehur 7 (12%) nxënës, prej tyre 1 (2%) femër dhe 6 (10%) meshkuj, ndërsa maqedonasit janë shprehur 3 (7%) nxënës, prej tyre 2 (3%) femra dhe 1 (2%) mashkull, kurse te turqit janë shprehur 2 (3%) meshkuj turq.

Të dhënat e pasqyruara janë tregues se nxënësit e shkollave të mesme të Gostivarit janë më tepër folës të tri gjuhëve sipas normave standarde, për shkak se i mësojnë në shkollë.

**Figura B- 11 Shkolla fillore**

Nxënësit e shkollës fillore në pyetjen e 11 për konceptimin e plurilinguizmit si fisnikërim individual përfitime individuale, opinionin e vet e kanë shprehur në disa opsione:

a) *Zotërimi i shumëgjuhësisë* është lehtësim për të marrë informacione të ndryshme janë shprehur 43 (61%) nxënës, nga shqiptarë janë shprehur 22 (31%) nxënës, prej tyre 11 ( 16%) femra dhe 11 (16%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 20 (29%) nxënës, prej tyre 9 (13%) femra dhe 11 (16%) meshkuj dhe te turqit është shprehur vetëm 1 ( 1%) femër.


b) *Zotërimi i shumëgjuhësisë* mundëson mësim të pavarur individual, gjithsej janë shprehur 8 (11%) nxënës, nga shqiptarë janë shprehur 5 (7%) nxënës, prej tyre 3 (4%) femër dhe 2 (3%) meshkuj , ndërsa te maqedonasit është shprehur vetëm 1 (1%) mashkull, kurse te turqit janë shprehur 2 ( 3%) meshkuj.

c) *Zotërimi i shumëgjuhësisë* mundëson largim të urrejtjes, janë shprehur vetëm 3 (4%) nxënës, nga shqiptarë janë shprehur 3 (4%) nxënës, prej tyre 2 (3%) femra dhe 1 (1%) mashkull, kurse te turqit dhe maqedonasit nuk është shprehur asnjë.

c) *Zotërimi i shumëgjuhësisë* fisnikëron shpirtin e njeriut për tolerancë dhe mirëkuptim janë shprehur 19 (27%), nga shqiptarë janë shprehur 13 (19%) nxënës, prej tyre 6 (9%) janë femra dhe 7 (10%) janë meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur vetëm 3 (4%) femra dhe asnjë mashkull nuk është shprehur, kurse te etniteti turk 3 (4%) nxënës, 2 ( 3%) femra dhe 1 ( 1%) mashkull turk.

d) *Zotërimi i shumëgjuhësisë* mundëson lehtësim në sigurimin e ekzistencës jetësore janë shprehur 21 (30%) nxënës, prej të cilëve 10 (14%) shqiptarë, 6 (9%) femra dhe 4 (6%), ndërsa te maqedonasit janë shprehur 6 (9%), 5 (7%) femra dhe 1 (1%) mashkull, ndërsa te etniteti turk janë shprehur 5 (7%) nxënës, ku janë 3 (4%) femra dhe 2 (3%) meshkuj. Nxënësit e shkollës fillore zotërimin e shumëgjuhësisë e shohin si mjet funksional dhe lehtësues, që iu ndihmon për të marrë informacione në mënyrë të pavarur dhe si pasuri individuale.

**11. A e konsideroni si pasuri individuale zotërimin e shumëgjuhësisë?**



**Figura B-11 Shkolla të mesme**

Nxënësit e shkollave të mesme në pyetjen 11 opinionin e vet e kanë shprehur në opzionet:

a) *Zotërimi i shëmëgjuhësisë është lehtësim për të marrë informacione të ndryshme* janë shprehur 41 ( 68% ), prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 9 (15%), 3 (7%) femra dhe 6 (10%) meshkuj, ndërsa maqedonas janë shprehur 18 (13%), 8 (13%) femra dhe 10 (17%) meshkuj, kurse te turqit janë shprehur 14 ( 23%), 4 (7%) femra dhe 10 (17%) meshkuj.


b) *Zotërimi i shumëgjuhësisë mundëson të mësuarit vetjak dhe të pavarur* janë shprehur 10 (17%), prej shqiptarëve është shprehur 1 (2%) femër, kurse te maqedonasit janë shprehur 9 (15%), 5 (8%) femra dhe 4 (7%) meshkuj, ndërsa te turqit s'është shprehur asnjë.

c) *Zotërimi i shumëgjuhësisë mundëson largim të urrejtjes* janë shprehur 10 (17%) nxënës, ku shqiptarë janë shprehur 5 (8%), 2 (3%) femra dhe 3 (5%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 4 (7%), 3 (5%) femra dhe 1 (2%) mashkull, kurse te turqit vetëm 1 (2%) femër.

ç) *Zotërimi i shumëgjuhësisë fisnikérón shpirtin e njeriut për tolerancë dhe mirëkuptim* janë shprehur 7 (12%) nxënës, ku shqiptarë janë shprehur 5 (8%), 4 (7%) femra dhe 1 (2%) mashkull, ndërsa maqedonas janë shprehur 2 (3%), 1 (2%) femër dhe 1 (2%) mashkull, kurse te turqit nuk është shprehur asnjë.

d) *Zotërimi i shumëgjuhësisë mundëson lehtësim në sigurimin e ekzistencës jetësore* janë shprehur 11 (18%), nga shqiptarë janë shprehur 4 (7%), prej tyre 2 (3%) femra dhe 2 (3%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur vetëm 2 (3%) femra, kurse te turqit janë shprehur 5 (8%), 1 (2%) femër dhe 4 (7%) meshkuj turq.

*Të dhënat e pasqyruara janë tregues se nxënësit shkollave të mesme shumëgjuhësinë e konsiderojnë si vlerë përmarrje të informacioneve të shumta.*

**Figura B-12 Shkolla fillore**

Nxënësit e shkollave fillore në pyetjen B 12 opinionin e shprehin në opzionet:


a) *gjuha amtare ose Gj1* me 22 (31%) nxënës, prej të cilave shqiptarë janë 16 (23%) nxënës, 11 (16%) femra dhe 5 (7%) meshkuj, ndërsa maqedonas janë shprehur 5 (7%), 2 (3%) femra dhe 3 (4%) meshkuj, te turqit është shprehur vetëm 1 (1%) mashkull.

b) *gjuha maqedonase* janë shprehur 10 (14%) nxënës, prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 5 (7%) nxënës, 4 (6%) femra dhe 1 (1%) mashkull, ndërsa te maqedonasit nuk është shprehur asnjë nxënës, ndërsa te turqit janë shprehur 5 (7%), 2 (3%) femra dhe 3 (4%) meshkuj.

c) *gjuha angleze janë shprehur* 35 (50%) nxënës, prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 13 (19%) nxënës, prej tyre 6 (9%) femra dhe 7 (10%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 19 (27%) nxënës, ku janë 9 (13%) femra dhe 10 (14 %) meshkuj, kurse te turqit janë shprehur 6 (9%), 3 (4%) femra dhe 3 (4%) meshkuj.

ç) *për gjuhën gjermane janë shprehur* 15 (21%) nxënës, prej tyre shqiptarë janë shprehur 4 (6%) nxënës, 4 (6%) femra, kurse te maqedonasit janë shprehur 5 (7%), 4 (6%) femra dhe 1 (1%) mashkull, ndërsa turqit janë shprehur 6 (9%) nxënës, 3 (4%) femra dhe 3 (4%) meshkuj.

*Të dhënat e pasqyruara e mbështesin hipotezën kryesore se nxënësit e Gostivarit më së tepërmikanë dëshirë ta mësojnë gjuhën angleze 35 (50%), gjuha amtare (Gj1) 22 (31%), gjuha maqedonase janë shprehur 10 (14%), përgjuhën gjermane janë shprehur 15 (21%).*




**Figura B-12 Shkolla të mesme**

Nxënësit e shkollave të mesme në pyetjen 12 opinionin e vet e kanë shprehur në opsonet:

- a) *Gjuha amtare* (shqipe, maqedonase ose turke) janë shprehur 25 (42%) nxënës, ku shqiptarë janë shprehur 7 (12%) nxënës, prej tyre 3 (5%) femra dhe 4 (7%) meshkuj, ndërsa maqedonas janë shprehur 12 (20%) nxënës, 5 (8%) femra dhe 7 (12%) meshkuj, kurse turq janë shprehur 6 (10%) nxënës, 4 (7%) femra dhe 2 (3%) meshkuj turq.
- b) *Gjuha maqedonase* janë shprehur 14 (23%) nxënës, nga shqiptarët janë shprehur 7 (12%) nxënës, 3 (5%) femra dhe 4 (7%) meshkuj, ndërsa maqedonas janë shprehur 12 (20%) nxënës, 5 (8%) femra dhe 7 (12%) meshkuj, kurse te turqit janë shprehur 7 (12%), 4 (7%) femra dhe 3 (5%) meshkuj turk.
- c) *Gjuha angleze* janë shprehur 36 (60%) nxënës, ku shqiptarë janë shprehur 15 (25%) nxënës, 9 (15%) femra dhe 6 (10%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 6 (10%) nxënës, 3 (5%) femra dhe 3 (5%) meshkuj, kurse te turqit janë shprehur 15 (25%) nxënës, prej tyre 4 (7%) femra dhe 11 (18%) meshkuj turk.
- ç) *Gjuha gjermane* janë shprehur 4 (7%) nxënës, te shqiptarët janë shprehur 3 (5%) femra dhe 1 (2%) mashkull, kurse te maqedonasit dhe turqit nuk janë shprehur.

*Të dhënat e pasqyruara janë tregues se nxënësit e shkollës së mesme më së tepërmi kënaqen gjatë orës së gjuhës angleze 36 (60%), kurse më pak gjatë orës së gjuhës gjermane 4 (7%). Këto të dhëna e mbështesin hipotezën tonë se gjuha angleze është gjuha më e dëshiruar për të mësuar, si gjuhë universale “gjuhë elitare botërore”.*

**Figura B-13 Shkolla filllore**

Në pyetjen 13 janë shprehur 68 (97%) nxënës të shkollave filllore në opzionet:


a) për shkak se njësia mësimore është e organizuar më mirë dhe ora na kalon më shpejtë janë shprehur 20 (29%) nxënës, prej tyre janë shprehur 13 (19%) shqiptarë, 7 (10%) femra dhe 6 (9%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 4 (6%) nxënës, 3 (4%) femra dhe 1 (1%) mashkull, kurse te turqit janë shprehur 3 (4%), 1 (1%) femër dhe 2 (3%) meshkuj turq.

b) për shkak se mësojmë me aktivitete të ndryshme janë shprehur 25 (36%) nxënës, ku shqiptarë janë shprehur 11 (16%), 7 (10%) femra dhe 6 (9%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 11 (16%), 4 (6%) femra dhe 7 (10%) meshkuj, kurse te turqit janë shprehur 3 (4%), 1 (1%) femër dhe 2 (3%) meshkuj.

c) për shkak se vetëm lexojmë dhe ritregojmë është shprehur vetëm 1 (1%) mashkull.

ç) për shkak se është gjuhë, që flitet në tèrë botën janë shprehur 23 (33%) nxënës, prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 8 (11%), 2 (3%) femra dhe 6 (9%) meshkuj, ndërsa maqedonas janë shprehur 12 (17%) nxënës, 7 (10%) femra dhe 5 (7%) meshkuj, kurse te turqit janë shprehur 3 (4%), 1 (1%) femër dhe 2 (3%) meshkuj.

Të dhënat janë treguese se nxënësve më së tepërmë u pëlqen ora ku angazhohen në aktivitete të ndryshme, edhe atë në gjuhën angleze.



**Figura B-13 Shkolla të mesme**

Nxënësit e shkollës së mesme në pyetjen 13 opinionin e shprehin si vijon:


a) *për shkak se njësia mësimore është e organizuar më mirë dhe ora na kalon më shpejtë* janë shprehur 24 (40%), ku shqiptarë janë shprehur 11 (18%), 7 (12%) femra dhe 4 (7%) meshkuj, kurse te maqedonasit janë shprehur 6 (10%), 4 (7%) femra dhe 2 (3%) meshkuj, kurse te turqit janë shprehur 7 (12%), 2 (3%) femra dhe 5 (8%) meshkuj turq.

b) *për shkak se mësojmë me aktivitete të ndryshme* (lexim, dëgjim, diskutim, analiza morfolologjike - sintaksore, krijime të shkurtra me shkrim) janë shprehur 17 (28%), ku shqiptarë janë shprehur 5 (8%), 3 (5%) femra dhe 2 (3%) meshkuj, ndërsa maqedonas janë shprehur 11 (18%), 4 (7%) femra dhe 7 (12%) meshkuj, kurse te turqit është shprehur vetëm 1 (2%) mashkull.

c) *për shkak se vetëm lexojmë dhe ritregojmë* është shprehur 1 (2%) mashkull turk.

ç) *për shkak se është gjuhë që flitet në tërë botën* janë shprehur 18 (30%) nxënës, ku shqiptarë janë shprehur 6 (10%), 2 (3%) femra dhe 4 (7%) meshkuj, ndërsa maqedonas janë shprehur 2 (3%), 1 femër (2%) dhe 1 (2%) mashkull, kurse te turqit janë shprehur 10 (17%), 4 (7%) femra dhe 6 (10%) meshkuj turq.


Të dhënat e reflektuara nga nxënësit e shkollës së mesme janë tregues se nxënësve kënaqësi u sjell ora e gjuhës angleze, për shkak se është më mirë e organizuar dhe koha u kalon më shpejtë janë shprehur 24 (40%) nxënës, kurse 18 (30%) nxënës janë shprehur se gjuhën angleze e mësojnë me kënaqësi sepse e konsiderojnë si gjuhë botërore.

**Figura B-14 Shkolla fillore**

Në shkolla fillore në pyetjen 14 opinionin e vet e kanë shprehur 59 (84%) të nxënës nga 70 nxënës të anketuar, kurse 11 (16%) nxënës nuk e janë shprehur. Të gjithë janë shprehur sipas një opsioneve në vijim:

- a) gjuha amtare (Gj-1) janë shprehur gjithsej 11 (16%) nxënës, ku shqiptarë janë shprehur 2 (3%), 1 (1%) femër dhe 1 (1%) mashkull, të maqedonasit janë shprehur 8 (11%), 2 (3%) femra dhe 6 (9%) meshkuj, ndërsa te turqit është shprehur vetëm 1 (1%) femër .
- b) gjuha angleze (Gj-2) janë shprehur gjithsej 7 (10%) nga nxënësit e anketuar, ku prej shqiptarëve asnjë nuk është shprehur, kurse te maqedonasit janë shprehur 5 (7%) nxënës, 4 (6%) femra dhe 1 (1%) mashkull, ndërsa te turqit janë shprehur vetëm 2 (3%) femra.
- c) gjuhë maqedonase (GJ-3) janë shprehur gjithsej 24 (34% ) nxënës, ku shqiptarë janë shprehur 17 (24%), 7 (10%) femra dhe 10 (14%) meshkuj, te maqedonasit për gjuhën shqipe janë shprehur 2 (3%) femra, për shkak se mësohet vetëm në një shkollë, ndërsa te etniteti turk janë shprehur 5 ( 7% ) nxënës, 2 (3%) femra dhe 3 (4%) meshkuj turq.
- d) gjuhë gjermane ose frëngje (GJ-4) janë shprehur 17 (24%) të nxënësve, ku shqiptarë janë shprehur 8 (11% ), 4 (6%) femra dhe 4 (6%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 8 (11%), 2 (3%) femra dhe 6 (9%) meshkuj, kurse te turqit është shprehur 1 (1%) mashkull.

Të dhënët janë treguese se nxënësve më e mërzitshme Ju duket gjuha e dytë e vendit, ndoshta është si një reflektim i vorbullës kulturore gjuhësore, që vazhdimisht ka reflektohet në këtë vend me një dialog gjuhësore të pandërprerë për arritje të barazisë në nivel shtetëror. *Vorbulla historike kulturore është përdorur nga Morin (1990:38) për çrrregullimet dhe organizimet e pandërprera historike të kohëve moderne, zhvillime të përziera, konkurruese, kundërvënëse me vlime të vërteta historike, që në fakt nxisin zhvillimet ekonomike, shoqërore, politike, kulturore në drejtim të ndërtimit të një Evropë Moderne.*



**Figura B-14. Shkolla të mesme**

Nxënësit e shkollave të mesme në pyetjen e 14, opinionin e vet e shprehë si vijon:


a) gjuha amtare (Gj-1) janë shprehur 16 (27%), nga shqiptarët janë shprehur 6 (10%) nxënës, prej tyre 5 (8%) femra dhe 1 (2%) mashkull, kurse nga maqedonasit janë shprehur 5 nxënës ose (8%), prej tyre 2 (3%) femra dhe 3 (5%)meshkuj, dhe te turqit janë shprehur 5 nxënës ose (8%), 1 (2%) femër dhe 4 (7%) meshkuj.

b) gjuha angleze janë shprehur 6 (10%) nxënës, nga shqiptarët është shprehur 1 (2%) mashkull, ndërsa maqedonas janë shprehur 2 (3%) nxënës, 1 (2%) femër dhe 1 (2%) mashkull dhe te turqit janë shprehur 3 (5% nxënës, 1 (2%) femër dhe 2 (3%) meshkuj.

c) gjuha maqedonase ose gjuha shqipe nëse e mësoni janë shprehur 11 ( 18%) nxënës, nga shqiptarët janë shprehur 8 (13%) nxënës, 3 (5%) femra dhe 5 (8%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit nuk është shprehur asnjë, kurse te turqit janë shprehur 3 (5%) meshkuj .

ç) gjuha gjermane ose gjuha frënge janë shprehur 15 (25%) nxënës, prej tyre 2 (3%) nxënës janë shqiptarë, 1 (2%) femër dhe 1 (2%) mashkull, kurse te maqedonasit janë shprehur 5 ( 8% ) nxënës, 2 ( 3%) femra dhe 3 (5%) meshkuj, ndërsa te turqit janë shprehur 8 (13%) nxënës, 4 (7%) femra dhe 4 (7%) meshkuj turq.

*Të dhënat e pasqyruara janë tregues se nxënësit e shkollave të mesme gjuhën amtare dhe gjuhën gjermane ose frënge i konsiderojnë si më të mërzitshme.*

**Figura B-15 Shkolla fillore**


Në shkolla fillore në pyetjen 15 janë shprehur 50 (71%) nxënës, kurse 20 (29%) nxënës nuk janë shprehur. Ata janë shprehur në disa opsione:

*a) për shkak se mendojmë se dimë dhe nuk koncentrohem i janë shprehur 10 (14%) nxënës, prej shqiptarëve nuk është shprehur asnjë nxënës, kurse maqedonasit janë shprehur 8 (11%) nxënës, 4 (6%) femra dhe 4 (6%) meshkuj, ndërsa te etniteti turk janë shprehur vetëm 2 (3%) femra.*

*b) nuk është interesante janë shprehur gjithsej 39 (56%) nxënës, nga nxënësit e anketuar, ku nga shqiptarët janë shprehur 20 (29%) nxënës, prej tyre 4 (6%) femra dhe 16 (23%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 15 (21%) nxënës, 4 (6%) femra dhe 9 (13%)meshkuj, kurse te turqit janë shprehur 5 (7%) nxënës, prej tyre 4 (6%) femra dhe 1 (1%) mashkull.*

*c)nuk janë të integruar të gjithë fushat e gjuhës është shprehur 1 (1%) mashkull turk.*

Të dhënat e 39 (56%) nxënësve janë tregues se gjuha e dytë e vendit Gj-3, në vazhdimësi ju duket nxënësve e mërzitshme dhe jo interesante si pasojë e vorbullës historike kulturore dhe metodologjisë së procesit të mësimdhënies, i cili duhet të transformohet në një një proces mësimnxënje me strategji të reja pune.



**Figura B-15 Shkolla të mesme**


Nxënësit e shkollave të mesme në pyetjen 15 opinionin e vet e kanë shprehur si vijon:

a) për shkak se mendojmë se dimë dhe nuk koncentrohem janë shprehur 23 (38%) nxënës nga shqiptarët janë shprehur 10 (17%) nxënës, prej tyre 6 (10%) femra dhe 4 (7%) meshkuj, kurse maqedonas janë shprehur 8 (13%) nxënës, prej tyre 4 (7%) femra dhe 4 (7%) meshkuj dhe te turqit janë shprehur 5 (8%) nxënës, prej tyre 1 (2%) femër dhe 4 (7%) meshkuj turq.

b) për shkak se nuk është interesante janë shprehur 23 (38%) nxënës, nga shqiptarët janë shprehur 8 (13%) nxënës, prej tyre 3 (5%) femra dhe 5 (8%) meshkuj, ndërsa maqedonas janë shprehur 2 (3%) femra dhe 2 (3%) meshkuj, kurse te turqit janë shprehur 11 (18%), 5 (8%) femra dhe 6 (10%) meshkuj turk.

c) për shkak se nuk janë të integruar të gjithë fushat e gjuhës janë shprehur 3 (5%) nxënës, nga shqiptarët është shprehur vetëm 1 (2%) mashkull, gjithashtu edhe nga maqedonasit është shprehur vetëm 1 (2%) mashkull dhe te turqit vetëm 1 (2%) mashkull.

*Të dhënat e pasqyruara janë tregues se nxënësit gjuhën amtare e konsiderojnë si më të mërzitshme, për shkak se janë të bindur se e kanë përvetësuar, kurse për gjuha gjermane nuk ju duket interesante dhe nuk është tërheqëse.*

**Figura B-16 Shkolla fillore**

Nxënësit e shkollave fillore në pyetjen 16 janë shprehur në disa opsione:


a) nëse format gramatikore i mësoni në korrelacion në të gjithë gjuhët janë shprehur 37 (53%) të nxënësve, ku nga shqiptarët janë shprehur 22 (31%) nxënës, prej tyre 11 (16%) femra dhe 11 (16%) meshkuj, nga maqedonasit janë shprehur vetëm 2 (3%) meshkuj, kurse te turqit nuk është shprehur asnjë nxënës.

b) nëse format gramatikore i mësoni në të njëjtën ditë dhe në të njëjtën javë janë shprehur 10 (14%), ku shqiptarë janë shprehur 8 (11%), 6 (9%) femra dhe 2 (3%) meshkuj, ndërsa nga maqedonasit vetëm 2 (3%) femra, kurse te turqit s'është përgjigjur asnjë nxënës.

c) nëse arsimtarët e gjuhëve të huaj dinë më tepër gjuhë dhe na i sqarojnë ngjashmëritë e formave gramatikore në gjuhën amtare tek ne arrihet fleksibilitet kognitiv janë shprehur 16 (23%) nxënës, ku nga shqiptarët janë shprehur 11 (16%) nxënës, prej tyre 7 (10%) femra dhe 4 (6%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 4 (6%) nxënës, 3 (4%) femra dhe 1 (1%) meshkuj, kurse te turqit është shprehur 1 (1%) mashkull turk.

ç) nuk di janë shprehur 21 (30%) të nxënësve, ku shqiptarë janë shprehur vetëm 2 (3%) meshkuj, ndërsa nga maqedonasit janë shprehur 15 (21%) nxënës, prej tyre 6 (9%) femra dhe 9 (13%) meshkuj, ndërsa te turqit janë shprehur 4 (6%), 2 (3%) femra dhe 2 (3%) meshkuj.

Të dhënët janë tregues se nxënësit kërkojnë lehtësim për të mësuarit e disa gjuhëve sidomos ato nëse bëhen në vijimësi koherente dhe kohezive në të gjithë lëndët e gjuhëve.



**Figura B-16 Shkolla të mesme**

Nxënësit e shkollës së mesme në pyetjen 16 janë përgjigjur në disa opsione:

a) *nëse format gramatikore i mësoni në korrelacion në të gjithë gjuhët* (emrat, mbiemrat, përemrat, numërorët, foljet, ndajfolje, parafjalët, pjesëzat, lidhëzat dhe pasthirrmat) janë shprehur 21 (35%) nxënës, prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 8 (13%), 3 (5%) femra dhe 5 (8%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 4 (7%) , 2 (3%) femra dhe 2 (3%) meshkuj, kurse te turqit janë shprehur 9 (15%), 3 (5%) femra dhe 6 (10%) meshkuj.


b) *nëse format gramatikore i mësoni në të njëjtën ditë dhe në të njëjtën javë* janë shprehur 17 (28%) nxënës, nga shqiptarët është shprehur vetëm 1 (2%) femër, kurse nga maqedonasit janë shprehur 7 (12%) nxënës, prej tyre 4 (7%) femra dhe 3 (5%) meshkuj, kurse te turqit janë shprehur 9 (15%) nxënës, 2 (3%) femra dhe 7 (12%) meshkuj turq.

c) *nëse arsimtarët e gjuhëve të huaja dinë më tepër gjuhë dhe na i sqarojnë ngjashmëritë e formave gramatikore në gjuhën amtare tek ne arrihet fleksibilitet kognitiv* janë shprehur 10 (17%) nxënës, ku shqiptarë janë shprehur 3 (5%) nxënës, 1 (2%) femër dhe 3 (5%) meshkuj, kurse maqedonas janë shprehur 7 (12%), 2 (3%) femra dhe 5 (8%) meshkuj, kurse te turqit asnjë s'është shprehur.

ç) *nuk di* janë shprehur 9 (15%) nxënës, ku shqiptarë janë shprehur 8 (13%), 5 (8%) femra dhe 3 (5%) meshkuj, ndërsa maqedonas nuk është shprehur asnjë dhe te turqit është shprehur 1 (2%) femër.

Të dhënat e pasqyruara janë tregues se nxënësit janë të vetëdijshëm se nëse fusha e gjuhës zhvillohet në të gjithë gjuhët në vijimësi kohezion arrihet një rezultat më i mirë në të mësuarit e gjuhëve të huaja.

**17. Rrethoni gjuhën për të cilën mendoni se do t'ju nevojitet në të ardhmen nëse jetoni në vendlindjen tuaj ?**



**Figura B-17 Shkolla fillore**

Në pyetjen 17 nxënësit e shkollave fillore opinionin e vet për gjuhën më të nevojshme për komunikim në vendlindjen e tyre e kanë shprehur në disa opsione:

a) *gjuha shqipe*, janë shprehur gjithsej 42 (60%) nxënës, ku nga shqiptarët janë shprehur 29 (41%) nxënës, prej tyre 15 (21%) femra dhe 14 (20%) meshkuj, ndërsa nga maqedonasit janë shprehur 9 (13%) nxënës, 6 (9%) femra dhe 3 (4%), kurse nga turqit janë shprehur 4 (6%) nxënës, 2 (3%) femra dhe 2 (3%) meshkuj.

b) *gjuha maqedonase*, janë shprehur gjithsej 28 (40%) nxënës, nga shqiptarët janë shprehur 16 (23%) nxënës, prej tyre 5 (7%) femra dhe 16 (23%) meshkuj, ndërsa maqedonasit janë shprehur 9 (13%) nxënës, prej tyre 6 (9%) femra dhe 3 (4%), kurse turq janë shprehur 3 (4%) nxënës, 2 (3%) femra dhe 1 (3%) mashkull.

c) *gjuha turke janë shprehur* 24 (34%) nxënës, te shqiptarët janë shprehur 10 (14%) nxënës, 6 (9%) femra dhe 4 (6%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur vetëm 4 (6%) femra, kurse te turqit janë shprehur 10 (14%) nxënës, 5 (7%) femra dhe 5 (7%) meshkuj.

ç) *gjuha angleze* janë shprehur gjithsej 35 (50%) nxënës, ku shqiptarët janë shprehur 11 (16%), 6 (9%) femra dhe 5 (7%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 9 (13%), 8 (11%) femra dhe 11 (16%), kurse te turqit janë shprehur 5 (7%), 2 (3%) femra dhe 3 (4%).

d) *gjuha gjermane* janë shprehur gjithsej 16 (23%) nxënës, nga shqiptarët janë shprehur 5 (7%) nxënës, 2 (3%) femra dhe 3 (4%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 7 (10%) nxënës, 8 (11%) femra dhe 11 (16%), kurse turqit janë shprehur 5 (7%) nxënës, 2 (3%) femra dhe 3 (4%) meshkuj.

dh) *gjuha italiane* është shprehur vetëm 1 (1%) nxënës maqedonas.

Nxënësit, që procesin mësimor e ndjekin në shkollat fillore të Gostivarit në vitin 2014/2015 dëshmojnë një kulturë të lartë të edukimit plurilingual, edhe atë në vlerësimin e vlerave të gjuhëve të kontaktit (gjuha shqipe 42 ( 60% ) nxënës, gjuha maqedonase 28 ( 40% ) dhe gjuha turke 24 ( 34% ) nxënës, por gjithashtu shprehin dëshirë edhe për gjuhët të huaja, sidomos gjuhën angleze 35 (50%) nxënës .

Të mësuarit e gjuhës maqedonase është obligim i të gjithë banorëve në R. e Maqedonisë, prandaj ndoshta nuk e kanë parë të nevojshme ta rrrethojnë të gjithë nxënësit . Te nxënësit turq mësimi i gjuhës shqipe reflektohet me frekuencë më të ulët, për shkak se ato e mësojnë gjuhë maqedonase si gjuhë zyrtare dhe ndoshta u duket se nuk është e nevojshme, se duhet ta dinë edhe gjuhën shqipe.


Të dhënat e reflektuara në opsjonet e ndryshme të parashtruara në këtë pyetje e mbështesin hipotezën kryesore:

Vlerat plurilingusitike janë shumë të dëshiruara, nga të cilat si më e dëshirueshme është “gjuha angleze” si gjuhë “gjuhë elitare botërore”, por për sigurimin e ekzistencës jetësore më e nevojshme në Gostivar është gjuha shqipe.

Gjithashtu në këtë pyetje ndriçohet edhe mbështetja e dy hipotezave ndihmëse:

*Zotërimi i gjuhës maqedonase nga të dy komunitetet shqiptare dhe turke është reflektim i kompetencës gjuhësore nga të mësuarit të gjuhës zyrtare në institucion arsimore.*

*Individët, që karrierën nuk e shohin jashtë shtetit kënaqen vetëm me zotërimin e gjuhës amtare dhe të shumicës, për shkak se u mundëson punësim në vendin e vet.*



**Figura B-17 Shkolla të mesme**

Nxënësit e shkollave të mesme në pyetjen 17, opinionin e vet e shprehin në opsjonet:

a) gjuhë shqipe, janë shprehur 30(50%) nxënës, ku shqiptarë janë shprehur 10 (17%), 5 (8%) femra dhe 5 (8%) meshkuj, ndërsa maqedonas janë shprehur 10 (17%), 2 (3%) femra dhe 8 (13%) meshkuj, kurse turq janë shprehur 10 (17%), 5 (8%) femra dhe 5 (8%) meshkuj.

b) gjuhë maqedonase, janë shprehur 22 (37%), ku shqiptarë janë shprehur 4 (7%), 1 (2%) femër dhe 3 (5%) meshkuj, ndërsa maqedonas janë shprehur 8 (13%), 7 (12%) femra dhe 1 (2%) mashkull, kurse te turqit janë shprehur 10 (17%), 5 (8%) femra dhe 5 (8%) meshkuj.


c) gjuha turke janë shprehur 16 (27%) nxënës, ku është shprehur vetëm 1 (2%) mashkull shqiptar, ndërsa te maqedonasit janë shprehur vetëm 5 (8%) femra dhe te turqit janë shprehur 10 (17%), 5 (8%) femra dhe 5 (8%) meshkuj.

ç) gjuhë angleze janë shprehur 5 (8%), ku janë shprehur 3 (5%) shqiptarë, 1 (2%) femër dhe 2 (3%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit është shprehur 1 (2%) maqedonas, kurse te turqit është shprehur vetëm 1 (2%) mashkull.

d) gjuhë gjermane nuk është shprehur asnjë

dh) gjuhë italiane nuk është shprehur asnjë.

Të dhënat e pasqyruara janë tregues se nxënësit e kanë të qartë se *gjuha shqipe* më tepër do t'ju nevojitet në të ardhmen nëse qëndrojnë në qytetin e tyre.



**Figura B-F 18 Shkolla fillore**


Nxënësit e shkollave fillore në pyetjen 18 opinionin e vet e kanë shprehur në opzionet:

a) *po* janë shprehur 41 (59%) nxënës, prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 21 (30%), 7 (10%) femra dhe 14 (20%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 13 (19%), 5 (7%) femra dhe 8 (11%) meshkuj, kurse te turqit janë shprehur 7 (10%), 4 (6%) femra dhe 3 (4%) meshkuj.

b) *jo* janë shprehur 24 (34%) nxënës, ku shqiptarë janë shprehur 7 (10%), 6 (9%) femra dhe 1 (1%) mashkull, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 15 (21%), 8 (11%) femra dhe 7 (10%) meshkuj, kurse te turqit janë shprehur vetëm 2 (3%) meshkuj turq.

Të dhënat janë tregues se të nxënësit e Gostivarit mendojnë nga mosha e fëmijërisë ardhmërinë ta kalojnë jashtë vendit.

**18. A mendoni në të ardhmen të jetoni jashtë vendit ?**




**Figura B-18 Shkolla të mesme**

Nxënësit e shkollave të mesme në pyetjen 18 opinionin e tyre e kanë shprehur si vijon:

a) po janë shprehur 40 (67%) nxënës, ku shqiptarë janë shprehur 10 (17%), 5 (8%) femra dhe 5 (8%) meshkuj, ndërsa maqedonas janë shprehur 12 (20%), 3 (5%) femra dhe 9 (15%) meshkuj, kurse te turqit janë shprehur 18 (30%), 4 (6%) femra dhe 14 (20%) meshkuj.

b) jo janë shprehur 13 (22) nxënës, ku shqiptarë janë shprehur 7 (12%), 5 (8%) femra dhe 2 (3%) meshkuj, ndërsa maqedonas janë shprehur 6 (10%), 5 (8%) femra dhe 1 (2%) mashkull, kurse te turqit nuk është shprehur asnjë. Të dhënrat janë tregues se të rinjtë e Gostivarit mendojnë në të ardhmen të jetojnë jashtë vendit.

**19. Ju lutem rrethoni përgjigjen që i përgjigjet nivelit të arsimimit të prindërve tuaj!**




**Figura B-19 Shkolla fillore**

Në pyetjen 19 nxënësit e shkollave fillore për arsimimin e prindërve të tyre janë shprehur:

- a) *arsimim fillor* janë shprehur 12 (17%) nxënës, prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 6 (9%), ndërsa maqedonas janë shprehur 3 (4%) dhe 3 (4%) turq.
- b) *arsimim të mesëm* janë shprehur 26 (37%) nxënës, prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 8 (11%), ndërsa maqedonas janë shprehur 15 (21%), kurse te turqit janë shprehur 3 (4%) turq.
- c) *arsimim të lartë* janë shprehur 8 (11%) nxënës, prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 5 (7%), ndërsa maqedonas janë shprehur 3 (4%), kurse te turqit asnjë nxënës.
- ç) *arsimimi sipëror* janë shprehur 15 (21%) nxënës, prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 7 (9%), ndërsa maqedonas 7 (9%), kurse te turqit vetëm 1 (1%) nxënës.
- d) *arsimim pasuniversitar* janë shprehur 4 (6%) nxënës, prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 2 (3%), ndërsa maqedonas 2 (3%), kurse te turqit asnjë nxënës.
- dh) *studime të doktoratës* janë shprehur 5 (7%) nxënës, prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 3 (4%), ndërsa maqedonas 1 (1%) nxënës, kurse te turqit 1 (1%) nxënës.

Të dhënat e reflektuara janë tregues se prindërit e nxënësve të anketuar janë më së tepërm me arsimim të mesëm 26 (37%) nxënës, ndërsa ka edhe me arsimim fillor 12 (17%) nxënës, me arsimim të lartë 8 (11%) nxënës, me arsimim sipëror (fakultet) 15 (21%), arsimim pasuniversitar 4 (6%) nxënës dhe me studime të doktoratës 5 (7%) nxënës.

Prindërit janë ato, që i nxisin fëmijët e vet të mësojnë disa gjuhë ose nxitës të edukimit plurilingual për fëmijët e shkollave fillore nëse e kanë parë dobinë ose mungesën e tyre gjatë përdorimit funksional në veprimtaritë e tyre.




**Figura B-19 Shkolla të mesme**

Nxënësit e shkollave të mesme në pyetjen 19 janë shprehur në opsione:

- a) arsimim fillor janë shprehur 19 (32%) nxënës, ku shqiptarë janë shprehur 7 (12%), 2 (3%) femra dhe 5 (8%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit është shprehur 1 (2%) mashkull, kurse te turqit janë shprehur 11 (18%), 4 (7%) femra dhe 7 (12%) meshkuj.
- b) arsimim të mesëm janë shprehur 23 (38%) nxënës, ku shqiptarë janë shprehur 6 (10%), 2 (3%) femra dhe 4 (7%) meshkuj, ndërsa maqedonas janë shprehur 12 (20%), 6 (10%) femra dhe 6 (10%) meshkuj, kurse te turqit janë shprehur 5 (8%), 1 (2%) femër dhe 4 (7%) meshkuj.
- c) arsimim të lartë janë shprehur 7 (12%) nxënës, ku shqiptarë janë shprehur 3 (5%), 2 (3%) femra dhe 1 (2%) mashkull, ndërsa te maqedonasit janë shprehur vetëm 2 (3%) meshkuj dhe te turqit janë shprehur vetëm 2 (3%) meshkuj.
- d) studime pasuniversitare janë shprehur vetëm 2 (3%) shqiptarë, 1 (2%) femër dhe 1 (1%) mashkull, kurse maqedonas dhe turq nuk janë shprehur.
- dh) studime të doktoratës janë shprehur vetëm 2 (3%), 1 (2%) mashkull është shprehur te shqiptarët, kurse te maqedonasit nuk janë shprehur dhe te turqit është shprehur vetëm 1 (2%) mashkull.


Të dhënat janë tregues se prindërit e nxënësve të shkollave të mesme janë më tepër me arsim të mesëm 23 (38%) edhe atë më tepër janë maqedonas dhe shqiptarë, kurse me arsim fillor janë reflektuar 19 (32%) nxënës, ku më tepër janë turq, kurse te të gjithë më pak janë reflektuar me studime pasuniversitare.



**Figura B-20 Shkolla fillore**

Nxënësit e shkollave fillore në pyetjen e 20, kanë reflektuar pohimet e veta për gjuhët e ekspozuara nga prindërit e tyre, të cilët njëherit kanë qenë edhe burimi i parë për bilinguizmin biologjik të tyre. Në përzgjedhjen e gjuhëve u shënuan në pyetësorë vetëm disa gjuhë, që mund qytetarët tonë i flasin, mirëpo nxënësit kishin shtuar edhe disa kombinime të tjera të gjuhëve, në të cilën me siguri flasin prindërit e tyre, sigurisht me martesa të përziera.

- a) një gjuhë janë shprehur 16 (23%) nxënës nga 70 të anketuar, prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 6 (14%), ndërsa maqedonas 8 (11%), kurse turq janë shprehur 2 (3%) nxënës.
- b) dy gjuhë janë shprehur 48 (69%) nxënës, prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 22 (31%), ndërsa maqedonas 17 (24%), kurse turq janë shprehur 9 (13%) nxënës.
- c) tri gjuhë janë shprehur 23 (33%) nxënës, prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 14 (20%), ndërsa maqedonas janë shprehur 4 (7%) dhe turq janë shprehur 5 (13%) nxënës.
- ç) katër gjuhë janë shprehur 4 (6%) nxënës, prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 2 (3%), ndërsa maqedonas është shprehur vetëm 1 (1%) dhe te turqit është shprehur vetëm 1 (1%) turk.



**Figura B-20 Shkolla të mesme**

Nxënësit e shkollave të mesme në pyetjen 20 opinionin e vet e kanë shprehur si vijon:

a) një gjuhë: gjuhë shqipe ose gjuhë maqedonase ose gjuhë turke janë shprehur 10 (17%) nxënës, ku shqiptarë janë shprehur 3 (5%), 1 (2%) femër dhe 2 (3%) meshkuj, ndërsa maqedonas janë shprehur 3 (5%), 2 (3%) femra dhe 1 (2%) mashkull, kurse te turqit janë shprehur 4 (7%), 1 (2%) femër dhe 3 (5%) meshkuj.

b) dy gjuhë: gjuhë shqipe/turke-gjuhë maqedonase janë shprehur 41 (68%) nxënës, ku janë shprehur 18 (30%) shqiptarë, 10 (17%) femra dhe 8 (13%) meshkuj, ndërsa te

maqedonasit janë shprehur 10 (17%), 6 (10%) femra dhe 4 (7%) meshkuj, kurse te turqit janë shprehur 13 (22%), 7 (12%) femra dhe 6 (10%)meshkuj.

c) tri gjuhë: gjuhë shqipe-gjuhë turke- gjuhë angleze janë shprehur 19 (32%) nxënës, ku shqiptarë janë shprehur 5 (8%), 4 (7%)femra dhe 1 (2%) mashkull, ndërsa te maqedonasit janë shprehur 4 (7%) , 2 (3%) femra dhe 2 (3%) meshkuj, kurse te turqit janë shprehur 10 (17%), 5 (8%) femra dhe 5 (8%) meshkuj.

ç) katër gjuhë janë shprehur 2 (3%), 1 (2%), femër shqiptare dhe 1 (2%) femër maqedonase , kurse te turqit nuk është shprehur asnje.

Të dhënat e pasqyruara janë tregues se prindërit e nxënësve të shkollave të mesme janë më tepër folës dygjuhësorë 41 (68%) nxënës, prej të cilëve janë 18 (30%) shqiptarë dhe turqit 13 (21%), kurse folës trigjuhësorë janë 19 (32%), ku më tepër folës trigjuhësorë në qytetin e Gostivarit janë turqit me 10 (17%) dhe shqiptarët me 5 (8%).

Hipoteza e këtij punimi mbështetet nga ky tregues se folës dygjuhësorë janë më tepër shqiptarët dhe turqit, për shkak të mësuarit e gjuhës maqedonase në institucione arsimore si lëndë e obligueshme, duke ditur se maqedonishtja konsiderohet si gjuhë zyrtare në Republikën e Maqedonisë. Numri i folësve dygjuhësorë, që janë në strukturën e statusit shoqëror të rritur- prind janë faktorë motivues i të rinjve për të mësuar dhe folur më tepër gjuhë.

### **3. 3. 1. Përfundimet nga pyetësorët e nxënësve të shkollave fillore**

Në vijim i paraqesim përfundimet nga opinionet e nxënësve të shkollave fillore:

- 1) Nxënësit nuk shoqérohen brenda në shkollë sepse nuk mësojnë në një ndërrim.
- 2) Nxënësit, kur ndodhen jashtë shkolle shoqérohen me shokë të përkatësive tjera etnike.
- 3) Shoqërimi i nxënësve me shokë të përkatësive tjera ndodh në qytet.
- 4) Mosnjohja e gjuhës dhe midis tyre janë pengesë për shoqërimin në mes nxënësve.
- 5) Në shkolla fillore nuk mbahen aktivitete të përbashkëta.
- 6) Mosnjohja e gjuhës së tjetrit është pengesë për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta
- 7) Rreth 61 ose ( 87% ) shprehin dëshirë për të zhvilluar aktivitete të përbashkëta.
- 8) Rreth 46 ose ( 77 % ) nuk ndjehen të diskriminuar për të mësuarit e gjuhëve.
- 9) Edukimi plurilingual është vlerësuar nga të gjithë nxënësit e shkollës fillore.
- 10) Në Gostivar u reflektoan më tepër folës shumëgjuhësorë.
- 11) Shumëgjuhësia konceptohet si mjet funksional për të parë informacione.
- 12) Nxënësit e Gostivarit më së tepërmë dëshirojnë ta mësojnë gjuhën angleze 35 (50%).
- 13) Nxënësve kënaqësi u sjell gjuha ku angazhohen më tepër në aktivitete të ndryshme.
- 14) Gjuha më e mërzitshme është gjuha e dytë e vendit ose e kontaktit.
- 15) Nxënësve më e mërzitshme iu duket gjuha e dytë e vendit.
- 16) Nxënësit kërkojnë lehtësim për të mësuarit e disa gjuhëve.
- 17) Nxënësit, që procesin mësimor e ndjekin në shkollat fillore të Gostivarit në vitin 2014/2015 dëshmojnë për një kulturë të lartë të edukimit plurilingual, edhe atë në vlerësimin e vlerave të gjuhëve të kontaktit, por gjithashtu shprehin dëshirë edhe për gjuhët të huaja jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë, sidomos për gjuhën angleze.
- 18) Një pjesë e nxënësve në të ardhmen mendojnë të jetojnë jashtë vendlindjes.

- 19) Prindërit e arsimuar janë motivues të fëmijëve për të zhvilluar plurilinguizmin.
- 20) Prindërit e nxënësve të shkollave fillore janë më dygjuhësorë dhe shumëgjuhësorë.


### **3.3.2. Përfundime nga pyetësorët e nxënësve të shkollave të mesme**

Në vijim i paraqesim përfundimet nga pyetësorët e nxënësve të shkollave të mesme:

- 1) Nxënësit e shkollave të mesme shoqërohen brenda në shkollë pa dallim përkatësie etnike.
- 2) Nxënësit e shkollave të mesme shoqërohen në qytet pa dallim të përkatësisë etnike.
- 3) Shumica e nxënësve 21 (35%) janë shprehur se nuk shoqërohen jashtë shkollës, kurse një pjesë janë shprehur se shkojnë në ndonjë lokal për pije 17 (28%), ndërsa 22 (37%) nxënës mohojnë se shoqërohen me shokë të përkatësive tjera etnike.
- 4) Shumica e nxënësve 22 (37%) janë shprehur se shkaku i moshoqërimit të tyre me nxënës të përkatësive tjera etnike është mosnjohja e gjuhës së tjetrit.
- 5) Nxënësit e shkollave të mesme angazhohen në aktivitete të përbashkëta.
- 6) Mosnjohja e gjuhës së tjetrit është pengesë për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta.
- 7) Nxënësit e shkollave të mesme dëshirojnë të kenë aktivitete të përbashkëta.
- 8) Nxënësit e shkollave të mesme nuk e ndjejnë veten të diskriminuar për të mësuarit e gjuhëve.
- 9) Nxënësit e shkollave të mesme gjuhën e vlerësojnë si kompetencë kognitive, që u ndihmon në çdo pikëpamje jetësore.
- 10) Nxënësit e shkollave të mesme të Gostivarit janë më tepër folës të tri gjuhëve sipas normave standarde, për shkak se i mësojnë në shkollë.
- 11) Nxënësit shkollave të mesme shumëgjuhësinë e vlerësojnë lehtësues për marrje të informacioneve të shumta.
- 12) Nxënësit e shkollës së mesme më së tepërm kënaqen gjatë orës së gjuhës angleze 36 (60%), kurse më pak gjatë orës së gjuhës gjermane 4 (7%).
- 13) Nxënësve të shkollës së mesme më tepër kënaqësi u sjell ora e gjuhës angleze, për shkak se është më mirë e organizuar dhe koha u kalon më shpejt 24 nxënës ose (40%), ndërsa 18 nxënës ose (30%) gjuhën angleze e mësojnë me kënaqësi se është gjuhë botërore.
- 14) Nxënësve më e mërzitshme iu duket gjuha amtare dhe gjuha maqedonase.
- 15) Nxënësve më e mërzitshme iu duket gjuha amtare dhe maqedonase ose shqipe, përshkak se nuk iu duket interesante, kurse gjuha amtare përshkak se mendojnë se e dinë dhe nuk koncentrohen.
- 16) Nxënësit e shkollave të mesme mendojnë se nëse format gramatikore mësohen në korrelacion në të gjithë gjuhët atëherë të mësuarit e gjuhëve do të lehtësohet. Gjithashtu në të lehtësuarit e gjuhëve ndikon edhe orari fleksibil.
- 17) Nxënësit e shkollave të mesme si gjuhë më të nevojshme për komunikim e vlerësojnë gjuhën shqipe, maqedonase dhe turke në vendilindjen e tyre.
- 18) Nxënësit e shkollave të mesme mendojnë të largohen nga vendlindja e tyre.
- 19) Prindërit e nxënësve të shkollave të mesme janë më tepër me arsim të mesëm 23 (38%) edhe atë më tepër janë maqedonas, kurse me arsim fillor 19 (32%) edhe atë te turqit.
- 20) Prindërit e nxënësve të shkollave të mesme janë më dygjuhësorë dhe trigjuhësorë.

### 3.4. Pyetësori C- Gjetjet në pyetësorët e arsimtarëve

Në Fokus Grupe të vogla u zhvillua diskutimi në çdo shkollë lidhur me temën e përcaktuar. Në fillim, për shkak të kohës së kufizuar të tyre, gjatë pushimit të madh u shpërndan pyetësorët të parapërgatitur si lehtësues për mësimdhënësit. Pyetësori i orientoi mësimdhënësit në diskutim lidhur me temën e caktuar. Në këto diskutime u përfshinë 30 arsimtarë të gjuhëve në shkollat fillore dhe 10 profesorë të gjuhëve në shkolla të mesme.




**Figura C-1 Opinionet e arsimtarëve dhe profesorëve**

Në shkollat fillore opinionin e vetë e kanë shprehur 27 (90%) arsimtarë nga 30 arsimtarë e anketuar, kurse vetëm 3 (10%) arsimtarë nuk janë shprehur. Në shkollat e mesme opinionin e vet e kanë shprehur 10 profesorë. Të gjithë janë shprehur në disa opsiione:

- Përdorimi i gjuhës etnike dhe festimi i festave të njërsës bashkësi gjuhësore nga individ të bashkësive gjuhësore etnike në bashkësinë shoqërore, ku jetojnë janë shprehur 5 (17%) arsimtarë dhe 1 (10%) profesorë.
- Respektimi i festave të të gjithë bashkësive etnike, nga të gjithë palët e bashkësisë shoqërore janë shprehur 16 (53%) arsimtarë dhe 8 (80%) profesorë.
- Çdo bashkësi gjuhësore e feston festën e vet dhe e flet vetëm gjuhën e vet në bashkësinë shoqërore ku jeton, janë shprehur 6 (20%) arsimtarë dhe 1 (10%) profesorë.

Ky përcaktim më lenë përshtypjen se të gjithë mësimdhënësit u gëzohen festimit të festave qofshin të palëve të kundërtë, që reflekton një multikulturalizëm. Më pak janë shprehur për opzionin a) ku qartë vërehet se ende nuk janë të gatshëm të flasin në gjuhën e tjeterit me dëshirë dhe vullnet, por vetëm sipas nevojës së domosdoshmërisë për sigurim të ekzistencës jetësore.

**2. Si organizohen shfaqjet, manifestimet në shkollën tuaj?**




**Figura C-2 Opinionet e profesorëve dhe arsimtarëve**

Në figurën C-2 pasqyrohet shprehja e opinionit të mësimdhënësve për mënyrën e organizimit të shfaqjeve në shkollën e tyre. Ata janë shprehur në disa opsione:

- a) sipas viteve janë shprehur 4 (13%) arsimtarë dhe 3 (30%) profesorë
- b) sipas gjuhës mësimore etnike janë shprehur 14 (46%) arsimtarë dhe 7 (23%) profesorë
- c) sipas kombinimit të viteve dhe gjuhës janë 2 (7%) arsimtarë dhe 1 (10%) profesor.

Këto të dhëna dëshmojnë se nxënësve nuk u ofrohet mundësi, që ato të zhvillojnë multikulturalizmin dhe të krijojnë marrëdhënie të mira miqësore në mes tyre.

**3. Prej kur ndodh kjo?**




**Figura C-3 Opinionet e arsimtarëve dhe profesorëve**

Në figurën 3 pasqyrohet opinioni i mësimdhënësve për kohen e shfaqjes së kësaj dukurie të ndarjes së nxënësve sipas gjuhës mësimore etnike.

- a) prej kur funksionon shkolla janë shprehur 8 (27%) arsimtarë dhe 7 (70%) profesorë.
- b) më pak se pesë vite janë shprehur 7 (23%) arsimtarë dhe asnjë profesor.

- c) prej më tepër se pesë vite janë shprehur 16 (53%) arsimtarë dhe 4 (40%) profesorë.

Ndarja sipas etnive ka filluar qysh prej më tepër se pesë viteve. Kjo gjë është befasuese në sistem pluralist, kur promovohet e drejta demokratike, të keqkuptohet konceptimi i demokracisë me dhënien e të drejtës së palës dominuese me të konceptuarit e demokratitës. Kjo është karakteristikë e vendeve, që vazhdimisht kanë qenë në sundues të huaj dhe kur u jepet mundësia për të qeverisur si ato të duan e të veprojnë, sikur çdo gjë është pronë e tyre, si të duan ta organizojnë dhe ta realizojnë. Kjo është ai “vlimi kulturor” i Edgar Morin në “Evropa në mendje”, që vazhdimisht kërkon dialogë kulturore për zgjidhjen e problemeve etnike.



**Figura C-4 Opinionet e arsimtarëve dhe profesorëve**

Në Figurën C-4 pasqyrohet shprehja e opinionit të mësimdhënësve për organizimin e shfaqjeve të veçanta në shkollën, ku ata punojnë. Kanë dhënë disa opsione:

a) për shkak të kohëzgjatjes së programit janë përcaktuar 11 (37%) arsimtarë dhe 4 (40%) profesorë


b) për shkak të lehtësimit të kuptueshmërisë së shfaqjes janë përcaktuar 10 (33%) arsimtarë dhe 4 (40%) profesorë

c) për shkak të kërkesave të prindërve janë përcaktuar 3 (10%) arsimtarë dhe 3 (30%) profesorë.

ç) për shkak se ndërrimet janë të kundërtat dhe i organizojmë të veçanta janë përcaktuar 3 (10%) arsimtarë dhe asnjë profesor.

Nga këto të dhëna vërehet qartë dallimi i mospërdorimit të gjuhës së njëjtë, ajo shkakton problem për organizimin e shfaqjeve të përbashkëta dhe zgjatjen e programit nëse programi ose manifestimi bëhet në dy gjuhë, për shkak se bëhet i tejzgjatur dhe njerëzit nuk kanë kohë të tepërt ta kalojnë pranë një shfaqje të gjatë në këtë jetë sfiduese. Tani njerëzit duan pak, qartë dhe saktë.

**5. Sa gjuhë zotëroni Ju, me të cilat mund të komunikoni lirshëm në gjuhë letrare?**




**Figura C-5 Opinionet e arsimtarëve dhe profesorëve**

Në figurën 5 pasqyrohet opinioni i mësimdhënësve për përdorimin e më tepër gjuhëve:

- a) një gjuhë janë shprehur 6 (20%) arsimtarë, kurse asnje profesor.
- b) dy gjuhë janë shprehur 8 (27%) arsimtarë, kurse 4 (40%) profesorë.
- c) tri gjuhë janë shprehur 11 (37%) arsimtarë, kurse 4 (40%) profesorë.
- ç) katër gjuhë janë shprehur 7 (23%) arsimtarë, kurse 3 (30%) profesorë.

Shumica e mësimdhënësve të anketuar në qytetin e Gostivarit janë dygjuhësorë dhe shumëgjuhësorë.




**Figura C-6 Opinionet e arsimtarëve dhe profesorëve**

Në figurën e 6 pasqyrohet shprehja e opinionit të mësimdhënësve:

- a ) zotërimi i shumëgjuhësisë është lehtësim për të marrë informacione të ndryshme janë shprehur 11 (37%) arsimtarë, kurse 4 (40%) profesorë.
- b) zotërimi i shumëgjuhësisë mundëson të mësuarit vetjak dhe të pavarur nuk është shprehur asnjë arsimtarë, kurse 2 (20%) profesorë.
- c) zotërimi i shumëgjuhësisë mundëson largim të urrejtjes nuk është shprehur asnjëri.
- ç) zotërimi i shumëgjuhësisë fisnikëron shpirtin e njeriut për tolerancë dhe mirëkuptim janë shprehur 12 (40%) arsimtarë, kurse 3 (30%) profesorë.
- d) zotërimi i shumëgjuhësisë mundëson lehtësim në sigurimin e ekzistencës jetësore janë shprehur 10 (30%) arsimtarë, kurse 8 (80%) profesorë.

Nga të dhënat vërehet qartë se çdo mësimdhënës gjuhën e percepton si lehtësim për të siguruar ekzistencën jetësore.

**7.Rrethoni si planifikoni planprogramet mësimore të gjuhës, që e ligjëroni në përshtatshmëri me programet mësimore të përcaktuara nga BZHA të R. së Maqedonisë**




**Figura C-7 Opinionet e arsimtarëve dhe profesorëve**

Në figurën 7 pasqyrohet shprehja e opinionit të mësimdhënësve në opzionet:

- a) vet i përgatisin sipas librit, janë shprehur 22 (73%) arsimtarë, kurse 6 (60%) profesorë.
- b) i kemi të gatshëm janë shprehur 2 (7%) arsimtarë, kurse asnje profesor.
- c) i marrim nga kolegët janë shprehur 6 (20%) arsimtarë, kurse asnje profesor.
- ç) i përgatisim në përshtatshmëri me planet e gjuhëve tjetra nuk është shprehur asnje arsimtarë, kurse janë shprehur 4 (40%) profesorë.

Të dhënat e reflektuara janë tregues se mësimdhënësit më së tepërmë planprogramet mësimore të lëndëve i përgatisin në bazë të librave shkollor, prandaj duhet t'u kushtohet kujdes hartimit të librave, mirëpo gjithashtu reflektohet se mësimdhënësit e gjuhëve aspak s'kanë bashkëpunim për të hartuarit e planprogrameve mësimore, që të jenë në vijimësi koherente dhe kohezive për t'ua lehtësuar nxënësve të mësuarit e gjuhëve.

**8. A mbani ndonjë orë të përbashkët për të gjithë gjuhët?**




**Figura C-8 Opinionet e arsimtarëve dhe profesorëve**

Në pyetjen 8 pasqyrohet opinioni i mësimdhënësve për bashkëpunimin e tyre në opzionet:

- a) Po janë shprehur 9 (30%) arsimtarë, kurse 1 (10%) profesorë.
- b) Jo janë shprehur 18 (60%) arsimtarë, kurse 9 (90%) profesorë.

Shprehja e opinionit të mësimdhënësve është tregues se ata shumë pak bashkëpunojnë në mes tyre.



**Figura C-9 Opinionet e arsimtarëve dhe profesorëve**

Në figurën 9 pasqyrohet shprehja e opinionit të mësimdhënësve për përdorimin e gjuhës më të nevojshme në të ardhmen në disa opsione:

- a) Gjuha shqipe janë shprehur 12 (40%) arsimtarë, kurse 3 (30%) profesorë.
- b) Gjuha maqedonase janë shprehur 11 (37%) arsimtarë, kurse 1 (10%) profesor.
- c) Gjuha turke janë shprehur 7 (23%) arsimtarë, kurse 1 (10%) profesor.
- ç) Gjuha angleze janë shprehur 15 (50%) arsimtarë, kurse kurse asnje profesor.
- d) Gjuha gjermane janë shprehur 7 (23%) arsimtarë, kurse 1 (10%) profesor.
- dh) Gjuha italiane janë shprehur 2 (7%) arsimtarë, kurse asnje profesor.

#### **10. Në pyetjen e 10 janë shprehur ide për përmirësimin e të mësuarit e gjuhëve**

Diskutimi nxiti mësimdhënësit të eksplorojnë përvojat vetjake dhe të sfidojnë të tjerët të rrëfenjë përvojat e veta. Gjithashtu në një mjedis të organizuar të Fokus Grupit u reflektuan edhe disa sugjerime vetjake për përmirësimin e gjendjes së mësimdhënies në drejtim të arritjes së fleksibilitetit plurilingistik tek nxënësi, nga të cilat u përzgjodhën disa alternativa. Mësimdhënësit kanë shprehur disa sugjerime të tyre:

- Gjuhët mësohen dhe mund të harrohen, por ato zotërohen vetëm me komunikim.
- Gjuhët mësohen më mirë nëse arsimtari i gjuhës së huaj e zotëron edhe gjuhën amtare.
- Të organizohen më tepër projekte të përbashkëta në sport, lojëra shoqëruese
- Profesorët e shkollave të mesme shprehin sugjerime për sigurimin e mjeteve mësimore për të mësuarit e gjuhëve të huaja.
- Gjuha angleze e kaploj tërë botën.
- Mësimdhënësit kanë shprehur vullnetin për të mësuarit e disa gjuhëve tjera: gjuhën kineze, gjuhën ruse, gjuhën esperanto, gjuhën rome, gjuhën arabe, gjuhën osmanlie.

### **3.4.1. Përfundimet e përgjithësuara nga diskutimet në fokus grupe**

Diskutimi në Fokus Grup me mësimdhënës të gjuhëve reflektoi qëndrimet e tyre:

1. Perceptimi i kulturës multikulturore *europiane me respektimin e parimit të multikulturalizmit për përdorimin e gjuhëve të vendit ose të kontaktit reflektohet të një pjesë e mësimdhënësve, por ka edhe shumë simpatizues të monokulturës, që dëshmon se ende ekziston nacionalizëm te mësimdhënësit. Ato ende nuk janë të gatshëm të flasin në gjuhën e tjeterit me dëshirë dhe vullnet, por vetëm sipas nevojës të domosdoshmërisë për sigurim të ekzistencës jetësore*
2. Ndarje e nxënësve në bazë të etniteteve është plagë e vjetër, që mendoj se është bërë më shprehi ose sëmundje kronike, që kur nuk shërohet, por kur infektohet përsëri aktivizohet. Në shkolla ndërrimet duhet të jenë me nxënës të përzier nga të gjithë etnititet, që të krijohet klimë multikulturore dhe mundësi për bashkëpunim. Bashkësia shoqërore multikulturore dhe multilinguale e reflektuar në qytetin e Gostivarit është prodhues i folësve dygjuhësorë dhe shumëgjuhësorë, që u reflektua në pyetjen 2.
3. Mësimi në ndërrime të përziera ofron mundësi për organizim të shfaqjeve të përbashkëta
4. Shumica e mësimdhënësve në qytetin e Gostivarit janë plurilingual.
5. Shumica e mësimdhënësve shumëgjuhësinë e perceptojnë si si fisnikërim shpirtëror të njeriut për tolerancë dhe mirëkuptim, për të marrë informacione të shumta.
6. Shumica mësimdhënësve planprogramet mësimore të lëndëve i përgatisin në bazë të libra shkollor, prandaj duhet t'u kushtohet kujdes hartimit të librave për mësues. Arsimtarët e gjuhëve aspak s'kanë bashkëpunim për të hartuarit e planprogrameve mësimore, që mësimdhënia të jetë në vijimësi koherente dhe kohezive për t'ua lehtësuar nxënësve të mësuarit e gjuhëve.
7. Bashkësitë e të nxënët aspak nuk funksionojnë në shkolla, prandaj edhe mësimdhënësit e shprehin qartë mosbashkëpunimin e tyre. Ata shumë pak bashkëpunojnë në mes veti për t'ua lehtësuar të mësuarit e gjuhëve nxënësve të tyre.
8. Mësimdhënësit e kanë perceptuar se si gjuhë më të nevojshme në qytetin e Gostivarit gjuhën shqipe 20 (67%), gjuhën maqedonase 11 (37%), gjuhën turke 7 (23%), mirëpo edhe janë përcaktuar edhe për gjuhën angleze si gjuhë elitare botërore 15 (50%), edhe pse nuk përdoret në komunikim shoqëror të përditshmërisë.

### **3.5. Pyetësori D- Gjetjet në pyetësorët e të punësuarëve të veprimtarive të ndryshme**

Hulumtimi kishte për qëllim të zbulojë qëndrimin e të punësuarave për zbatueshmërinë e multilinguizmit (të gjuhëve të kontaktit) në veprimtarinë e tyre dhe arritjen e plurilinguizmit individual. Anketimi u zhvillua me pyetësorë në tri gjuhë prej më 11-16.04.2015 me qytetarë nga 10 qytetarë të tri etnititet : *shqipe, maqedonase dhe turke* në qytetin e Gostivarit.

Kjo mostër në bazë të popullatës shumicë shqiptare, që reflektohet me 66,60 % në nivel lokal të qytetit të Gostivarit, *nuk është e përcaktuar proporcionalisht drejtë, por kjo u bë qëllimisht për shkak të marrjes së qëndrimit nga më tepër individ të komuniteteve pakicë në nivel lokal (edhe pse në nivel shtetëror një pjesë janë shumicë)*, në lidhje me përdorimin e gjuhës më të nevojshme në veprimtarinë e tyre për të siguruar ekzistencën jetësore.

Për të ndriçuar përfitimet nga përdorimi i shumëgjuhësisë u zbatua anketim me tri grupime e ndryshme me status shoqërore të veprimitave të ndryshme edhe atë u anketuan punëtorë administrativ, shitës, tregtar, motra medicinale, stomatolog, ... për të vërejtur *sjelljen gjuhësore në sferat shoqërore me çiftëzim të roleve në veprimtarinë e tyre.*

Të dhënat e reflektuara në anketimin me të punësuar të veprimitave të ndryshme pasqyrohen në tabelën D, ku vërehen variablat e grupeve të etniteteve të ndryshme, grupmoshave, gjinive dhe profesioneve. Variablat reflektojnë opinionin e qytetarëve të Gostivarit për vlerën e shumëgjuhësisë, që u mundëson diversiteti linguistik në territorin e Gostivarit për të zhvilluar plurilinguizmin individual si vlerë fisnikërore. Vlera shumëgjuhësore (multilinguizmi) u ofron mundësi për të zhvilluar kompetencat komunikative në gjuhë të ndryshme dhe për të lehtësuar të vepruarit në veprimitari të ndryshme. *Sjellja gjuhësore e folësit kushtëzohet nga përshtatshmëria me mjedisin dhe audiencën.*

**Tabela D. Mostra - Të dhëna për të anketuarit e punësuar në qytetin e Gostivarit**

Shqiptarë					Maqedonas					Turq				
Profesioni	Gjuha më preferuar	Moshë	Përvaja	Gjinia	Profesioni	Gjuha më e preferuar	Moshë	Përvaja	Gjinia	Profesioni	Gjuha më preferuar	Moshë	Përvaja	Gjinia
drejtor	SHQ, TR, MQ	30	8	M	kontabiliste	SHQ, MQ	30	5	F	drejtor	SHQ, TR, MQ	40	15	M
kontabilist	SHQ, AN, MQ	25	1	F	shitëse	SHQ, TR, MQ	24	1	F	kontabilist	SHQ, TR, MQ	40	4	M
pun. e TIK	SHQ, AN, MQ	28	5	F	pun. TIK	SHQ, TR, MQ, AN	27	1	F	elektricist	SHQ, TR, MQ	37	17	M
auto-mekanik	SHQ,	57	30	M	shitëse	SHQ, TR, MQ	22	1	F	medicinale	SHQ, TR, MQ	28	5	F
psikologe	SHQ,	26	2	F	shitëse	SHQ, MQ	32	8	F	farmaciste	SHQ, MQ	52	22	F
ekonomiste	SHQ	25	2	F	shitëse	SHQ, TR, MQ	35	10	F	shitëse	SHQ, TR, MQ	40	10	F
frizere	SHQ	24	3	F	juriste	SHQ, MQ	24	4	F	shitëse	SHQ, TR, MQ	30	5	F
shitëse	SHQ	23	9	F	shitëse	shqipe	37	9	F	shitëse	SHQ, TR, MQ	23	9	F
mekanik	SHQ	21	2	M	elektricist	shqipe	27	3	M	ëmbëltor	SHQ, TR, MQ	50	20	M
kontabilist	SHQ, MQ	23	2	M	kontabilist	SHQ, MQ	30	3	M	kontabilist	SHQ, TR, MQ	23	2	M

Në tabelën D vërehet se sjellja gjuhësore e të punësuarve, që realizohet në veprimitari të ndryshme të sferës shoqërore. Sjellja gjuhësore e tyre duhet të jetë në përshtatshmëri me mjedisin biologjikisht si “*ekologji gjuhësore*” siç është emërtuar nga Shkurtaj (2009:65).

Të gjithë të anketuarit janë të moshës së rritur, me status shoqëror të punësuar të profesioneve të ndryshme, me përkatesi të etniteteve të ndryshme, të gjuhëve të ndryshme, me gjini të ndryshme, me moshë dhe përvojë pune të ndryshme. Qëndrimi i tyre shprehet se gjuhë më e preferuar për t'u përdorur në veprimitarin e tyre është gjuha shqipe, si gjuhë

shumicë në bashkësinë shoqërore të Gostivarit. Këto të dhëna janë tregues se gjuha shqipe duhet të mësohet nga të gjithë palët edhe pse *gjuha shqipe* aspak nuk është mësuar më parë nga asnjëra palë, *as nga maqedonasit* dhe *as turqit* në sistemin arsimore.

Vërehet se të anketuarit janë të lindur në shekullin e XX-të, por ende punojnë dhe veprojnë në shekullin e XXI-një dhe tanë e shprehin nevojën për të mësuarit e gjuhës shqipe, për shkak se kanë “*deficit të kompetencës shumëgjuhësore*” sipas të teorisë së Bazil Bernshtajnit (1958-1972) edhe atë deficit gjuhësorë të gjuhës, siç është *gjuha shqipe, e cila* është më e nevojshme për komunikim shoqëror në qytetin e Gostivarit.


*Të gjithë të anketuarit janë përfaqësuese të brezit, që duhet ta shqyrtojë këtë çështje dhe t'u mundësojë fëmijëve, që në të ardhmen të zotërojnë kompetencat shumëgjuhësor*

I/e nderuar,

Administrator, mjek, motër medicinale, stomatolog, shitës, tregtar, punëtorë etj. Ky pyetësor është përgatitur me qëllim për ta marrë në konsideratë qëndrimin tuaj për zbatueshmérinë e shumëgjuhësise në veprimitarinë tuaj dhe në aktivitetet tjera të përditshmërisë jetësore. Ju lutem të jeni të singertë në shprehjen e qëndrimit tuaj!

Ju faleminderit !

Gjinia: a) Mashkull b) Femër Përkatësia kombëtare: \_\_\_\_\_ Gjuha amtare:  
 \_\_\_\_\_ Profesioni: \_\_\_\_\_ Mosha: \_\_\_\_\_ Përvoja e punës: \_\_\_\_\_ Data: .04.2015  
 Qyteti: Gostivar



**Figura D-1. Opinion i të punësuarve për përdorimin e gjuhëve të huaja në Gostivar**


Në pyetjen D-1 të punësuarit qëndrimin e vet e kanë shprehur në opsonet:

a) *plotësisht pajtohem* janë shprehur gjithsej 22 (73%) nga 30 të anketuar, ku të etnititetit maqedonas janë shprehur 9 (30%), 8 (27%) femra dhe 1(3%) meshkuj, ndërsa të etnititetit turk janë shprehur 9 (30%), 4 (13%) femra dhe 5 (17%) meshkuj, kurse të etnititetit shqiptarë janë shprehur më pak 4 (13%) femra shqiptare, kurse meshkuj s'është shprehur asnjë.

b) *pajtohem* janë shprehur vetëm 5 (17% ) meshkuj shqiptarë.

c) *deri- diku pajtohem* janë shprehur 3 (10%), nga 1 (3%) shqiptar,1 (3%), maqedonas dhe 1 ( 3% ) turk.

Të dhënat e pasqyruara janë treguese se në qytetin e Gostivarit më së tepërmi nevojitet përdorimi i gjuhëve të huaja *të vendit, te pala maqedonase dhe turke* janë shprehur në opzionin plotësisht pajtohem, kurse nga pala shqiptare pohohet vetëm me 4 (13%) femra dhe në opzionin pajtohem 5 (17%) meshkuj. Gjuhët më të përdorura në komunikimin shoqëror janë gjuhët e vendit, nga të cilat dallohet gjuha shqipe, për shkak se strukturës shoqërore është me qytetarë të shumicës shqiptare, që njëherit janë klientët shumicë të tregut e vendit.



**Figura D-2. Opinion i të punësuarve për vlerësimin e gjuhëve për të mësuarit e pavarur**

Në pyetjen 2 të punësuarit qëndrimin e vet e kanë shprehur në opzionin *pajtohem* 5 (16%), kurse në opzionin *deri-diku pajtohem* 13 (43%) nga të anketuarit, prej të cilëve shqiptarë janë shprehur 5 (17%), 3 ( 10% ) femra dhe 2 (7%) meshkuj, ndërsa te etnititetit turk janë shprehur 5 (16%), 3 (10%), femra dhe 2 (7%) meshkuj, kurse te maqedonasit janë shprehur 3 (10%), 2 (7%) femra dhe 1 (3%) mashkull maqedonas. Gjuhët e huaja nga ky brez, që aktualisht janë të punësuar, nuk vlerësohen shumë.


Në periudhën kur këta qytetarë janë shkolluar gjatë procesit arsimor me siguri gjuhëve të huaja nuk i është kushtuar shumë rëndësi, mirëpo nxënësve aktual gjuhët u nevojiten shumë për të mësuarit e pavarur.



**Figura D-3. Opinion i të punësuarve për zbatueshmérinë e gjuhës angleze në Gostivar**

Në pyetjen 3 qëndrimin e vet e kanë shprehur 7 (23%) të anketuar në opzionin *aspak nuk pajtohem*, ku te etniteti turk janë shprehur 5 (17%), 3 (10%) femra dhe 2 (7%) meshkuj, ndërsa te etniteti maqedonas janë shprehur 2 (7%) maqedonas.

Të dhënat janë tregues se është arritur vetëdijesimi i popullatës për *pazbatueshmérinë e gjuhës angleze në praktikën vendore*, për shkak se kjo gjuhë nuk gjen zbatim në aktivitet e përditshmërisë në vendin e tyre, për shkak se *ajo pasivizohet në memorie ose fosilizohet tek individët*, që punësohen në vendlindje, kurse për ato që dalin jashtë është vetëm një parapërgatitje për komunikim me të tjera, kur ndodhen jashtë vendit.



Në pyetjen 3 shumica e të anketuarve se e kanë kuptuar se vlerë më të madhe të gjuhëve në vendin e tyre kanë gjuhët kontaktit: *gjuha shqipe, maqedonase dhe gjuha turke*.

a) *plotësisht pajtohem* janë shprehur 28 (93%) nga 30 të anketuarit, ku janë shprehur 10 (33%) shqiptarë, 5 (17%) femra dhe 5 (17%), maqedonas janë shprehur 8 (27%), 6 (20%) femra dhe 2 (7%) meshkuj, ndërsa turq janë shprehur 10 (33%), 5 (17%) femra dhe 5 (17%). Të gjithë janë të bindur se për komunikimi dhe punësim në vendin e tyre u nevojiten gjuhët vendore lokale.



**Figura D-5. Opinion i të punësuarëve për vlerësimin e gjuhëve si pasuri individuale**


Në pyetjen 5 të dhënët e pasqyrur janë tregues se qytetarët e Gostivarit kanë arritur kulturën për vlerësimin pozitiv të vlerave të shumëgjuhësë. Ata janë shprehur *në opionet*:

a) *plotësisht pajtohem* janë shprehur 20 (67%) nga 30 të anketuarit, ku shqiptarë janë shprehur 10 (33%), 5 (17%) femra dhe 5 (17%) meshkuj, maqedonas janë shprehur 4 (13%), 2 (7%) femra dhe 2 (7%) meshkuj, ndërsa të tuqit janë shprehur 6 (20%), 2 (7%) femra dhe 4 (13%) meshkuj.

b) *pajtohem* janë shprehur vetëm 2 (7%) femra maqedonase.

c) *deri-diku pajtohem* janë shprehur 2 (7%) femra maqedonase dhe 2 (7%) meshkuj maqedonas, ndërsa te turqit janë shprehur 2 (7%) femra turke, te shqiptarët nuk është shprehur asnjë.

Në të gjithë komunitetet e Gostivarit vlerat e shumëgjuhësë i konceptohen si pasuri individuale.




**Figura D-6. Opinion i të punësuarëve për të ardhmen, se të rintjtë do të qëndrojnë në Gostivar**

Në pyetjen 6 të punësuarit qëndrimin e vet e kanë shprehur në opzionin:

- a) *plotësisht pajtohem* janë shprehur 16 (58%) nga të anketuarit, ku shqiptarë janë shprehur 6 (20%), (13%) femra dhe 2 (7%) meshkuj, te maqedonasit janë shprehur 2 (7%) meshkuj, ndërsa te turqit janë shprehur 8 (27%), 4 (13%) femra dhe 4 (13%) meshkuj.
- b) *pajtohem* janë shprehur vetëm 2 (7%) femra maqedonase.
- c) *deri-diku pajtohem* janë shprehur 6 (20%) nga të anketuarit, ku shqiptarë janë shprehur vetëm 2 (7%) meshkuj, ndërsa te maqedonasit janë shprehur vetëm 2 (7%) femra, kurse te turqit janë shprehur vetëm 2 (7%) femra.

Këto të dhëna pasqyrojnë një bindje të brezit të punësuar (që aktualisht mund të jenë prind të gjeneratave të shkollave fillore dhe të mesme) se gjeneratat e ardhmen do të qëndrojnë në vendlindje dhe do të kontribuojnë me punën e tyre në dobi të qytetarëve të Gostivarit.




**Figura D-7. Opinion i të punësuarve për të ardhmen se të rintjtë do të largohen nga Gostivari**

Në pyetjen 7 qëndrimin e vet të punësuarit e kanë shprehur në opzionin:


*Deri diku pajtohem janë shprehur 25 (84 %) nga të gjithë etnititetet, të shqiptarët janë shprehur 9 (30%), 4 (13%) femra dhe 5 (17%) meshkuj, te maqedonasit janë shprehur 6 (20%), 4 (13%) femra dhe 2 (7%) meshkuj, ndërsa te turqit janë shprehur 10 (33%), 5 (17%) femra dhe 5 (17%) meshkuj.*

Të dhënat e pasqyruara janë tregues se gjendje ekonomike më e mirë dhe kushtet më të mira janë ato, që i motivojnë të rintjtë të largohen jashtë vendit dhe ta mësojnë me vullnet gjuhën angleze si parapërgatitje për gjindshmëri në çdo vend të botës.



**Figura D-8. Opinion i të punësuarve se përdorimi i më tepër gjuhëve zhduk urrejtjen**

Në pyetjen 8 janë shprehur 10 (33%) nga 30 të anketuarit. Kjo është tregues se urrejtja është plegë evjetër e shfaque edhe më parë, prandaj ata mendojnë se nëse e flasin gjuhën e njeri-tjetrit nuk do të largohet ajo urrejtje e mbjellë ndër shekuj. Deri-diku pajtohem janë shprehur 9 (30%) nga të anketuarit, që është treguese se një pjesë etë anketuarëve mendojnë të flasin në gjuhën e tjeterit. Mirëpo një pjesë e turqve 4 (13%) dhe maqedonsave 2 (7%) shpresojnë se urrejtja mund të zhduket, nëse nga të gjithë komunitetet flitet gjuha ekomunitetit tjetër.




**Figura D-9. Opinion i të punësuarve për gjuhën më të nevojshme për komunikim shoqëror në Gostivar**

Në figurën 9 pasqyrohet opinioni i të anketuarve nga Gostivari *për gjuhën më të nevojshme për komunikim me klientë të ndryshëm në veprimtarinë e tyre*. Çdo i rritur pasi arrin kompetencat arsimore të nevojshme punësohet, ku gjatë ushtrimit të detyrës fillon të vlerësojë çdo kompetencë vetjake, ashtu që fillon të vlerësojë *edhe vlerën e kompetencave shumëgjuhësore si pjesë e kompetencave të përgjithshme*.

Çdo i punësuar në çdo veprimtari të përditshmërisë jetësore, komunikon me të tjetër qoftë me gojë ose me shkrim *për të sigruar ekzistencën jetësore, ku gjuhët gjejnë zbatimin e tyre funksional*. *Opioni i tyre është shprehur në disa opsione*:

- a) gjuha shqipe janë shprehur 30 (100%), ku shqiptarë janë shprehur 10 (33%), 5 (17%) femra dhe 5 (17%) meshkuj, te maqedonasit janë shprehur 10 (33%), 8 (27%) dhe 2 (7%) meshkuj dhe te turqit janë shprehur 10 (33%), 5 (17%), femra dhe 5 (17%) meshkuj turq.
- b) gjuha maqedonase janë shprehur 22 (73%), ku janë shprehur 4 (13%) shqiptarë, 1 (3%) femër dhe 3 (10%) meshkuj, te maqedonasit janë shprehur 8 (27%), 7 (23%) femra dhe 1 (3%) mashkull maqedonas dhe te turqit janë shprehur 10 (33%), 5 (17%) femra dhe 5 (17%) meshkuj turq.
- ç) gjuha turke janë shprehur 18 (16%) nga të anketuarit, ku është shprehur vetëm 1 (3%) shqiptar, ndërsa maqedonas janë shprehur 7 (23%), 5 (17%) femra dhe 2 (7%) meshkuj, ndërsa te turqit janë shprehur 10 (33%), 5 (17%) femra dhe 5 (17%) meshkuj.
- ç) gjuha angleze janë shprehur 5 (17%), ku janë shprehur 3 (10%) shqiptarë, 1 (3%) femër dhe 2 (7%) meshkuj, te maqedonasit është shprehur 1 (3%) mashkull, ndërsa te turqit 1 (3%) mashkull.
- d) gjuhë gjermane nuk janë shprehur aspak nga të anketuarit.
- dh) gjuhë italiane nuk janë shprehur aspak nga të anketuarit.

Këto të dhëna mbështesin hipotezën e parashtruar se *gjuha angleze si "gjuhë elitare" është më dëshirueshme, por gjuha shqipe është më e zbatueshmja në territorin e Gostivarit*. Të gjithë individët e kanë shprehur opinionin e vet me bindshmëri se gjuha angleze edhe pse më tepër është mësuar në institucione arsimore gjatë arsimimit të tyre, kjo gjuhë nuk gjen zbatim në veprimtarinë e tyre, *por në veprimtarinë e tyre zbatohen gjuhët e kontaktit ose të vendit*. *Prandaj lind nevoja për institucionalizim të gjuhës shqipe si lëndë zgjedhore në sistemet arsimore fillore dhe të mesme te nxënësit maqedonas dhe turq*.



**Figura D-10. Opinion i të punësuarve për zotërimin e gjuhëve ose plurilinguizmin**

Në pyetjen 10 opinionet e të punësuarve janë reflektuar në disa opsione:

a) njëgjuhësorë ose gjuhë amtare janë shprehur 6 (20%), ku shqiptarë s'ka asnjë, kurse maqedonas janë shprehur 6 (20%), 4 (13%) femra dhe 2 (7%) meshkuj, ndërsa te turqit s'është shprehur asnjë.

b) dygjuhësorë janë shprehur gjithsej 10 (33%), ku shqiptarë janë shprehur 4 (13%), 2 (7%) femra dhe 2 (7%) meshkuj, ndërsa maqedonas janë shprehur vetëm 2 (7%) femra, kurse te turqit janë shprehur 4 (13%), 2 (7%) femra dhe 2 (7%) meshkuj.

b) trigjuhësorë janë shprehur 12 (40%), ku shqiptarë janë shprehur 4 (13%), 2 (7%) femra dhe 2 (7%) meshkuj, ndërsa maqedonas janë 2 (7%) femra dhe te turqit janë shprehur 6 (20%), 3 (10%) femra dhe 3 (10%) meshkuj turq.

d) katërgjuhësorë janë shprehur gjithsej 3 (10%), ku shqiptarë janë shprehur 2 (7%), 1 (3%) femër dhe 1 (3%) mashkull, ndërsa te maqedonasit nuk është shprehur asnjë, kurse te turqit është shprehur vetëm 1 (3%) mashkull turk.

Të dhënrat e pasqyruara janë tregues se në qytetin e Gostivarit ka më tepër trigjuhësorë se sa njëgjuhësorë.

### 35.1. Përfundime nga pyetësorët e të punësuarve

1. Në qytetin e Gostivarit më tepër nevojitet përdorimi i gjuhëve të huaja *vendore, edhe atë asaj maqedonase dhe turke u nevojitet gjuha shqipe*. Gjuha maqedonase flitet nga shqiptarët dhe turqit, që njëherazi ka ndikuar edhe në ruajtjen e vitalitetit gjuhësor të saj.

2. Ky brez, që aktualisht është i punësuar nuk ka krijuar qëndrimin pozitiv për vlerën e gjuhëve të huaja për të mësuar më tepër gjuhë ose zhvillimin e plurilinguizmit, edhe pse kjo dukuri është shumë e nevojshme në vizonin e globalizmit dhe misionin e tij.

3. Të dhënrat janë tregues se vetëdijesimi i popullatës është arritur për pazbatueshmërinë e gjuhës angleze në praktikën vendore, për shkak se kjo gjuhë nuk gjen zbatim në aktivitet e

përditshmërisë në Gostivar. Kjo gjuhë edhe pse mësohet vite të tërë në institucionë arsimore pasivizohet në memorie *ose fosilizohet te individët, që punësohen në vendlindje, kurse për ato që dalin jashtë është parapërgatitje për komunikim nëse shkojnë jashtë vendit.*

4. Të gjithë etnititetet e kanë kuptuar vlerën e përdorimit të gjuhëve në kontakt.
5. Çdo qytetar i Gostivarit vlerat e shumëgjuhësisë i percepton si pasuri individuale.
6. Të punësuarit 16 (53%) mendojnë se brezi i ardhshëm i Gostivarit nuk do të largohet nga vendlindja, por do të jetojë në vendin e tyre, që është një treguese jo bindës, por vetëm një shprehje prindërore ndaj dëshirës për qëndrueshmëri të të rinjve në vendin e tyre.
7. Të punësuarit 27 (90%) e Gostivarit mendojnë se gjendje ekonomike dhe kushtet janë ato, që i motivojnë të rinjtë të largohen jashtë vendit.
8. Të punësuarit e Gostivarit mendojnë se edhe nëse e flasin gjuhën e tjeterit urrejtja nuk do të zhduket, për shkak se është shtresuar shekuj më parë 10 (33%), mirëpo ka një pjesë nga etniteti turk 4 (13%) dhe maqedonas 2 (7%) shpresojnë se urrejtja mund të zhduket, nëse në të gjithë etnitet flasin gjuhën e njëri - tjeterit.
9. Gjuha shqipe është gjuha më zbatueshme në çdo sferë shoqërore në qytetin e Gostivarit e reflektuar me 30 (100%), prej të cilëve shqiptarë 10 (33%), kurse maqedonas 10 (33%) dhe turq janë shprehur 10 (33%). Të gjithë nga etnititet zbatueshmërinë e gjuhës shqipe e konsiderojnë si më të nevojshme gjatë ushtrimit të detyrës së tyre në çdo profesion. Qytetarët e Gostivarit janë më tepër shqiptar, që njëherit janë edhe klientët e tregut vendor.
10. Në qytetin e Gostivarit nga 30 të punësuarit rreth 12 (40%) janë folës trigjuhësorë, 10 (33%) janë folës dygjuhësorë, kurse folës njëgjuhësorë 6 (20%), por reflektohen edhe folës katërgjuhësorë 3 (10%) ose plurilingual.

### 3.6. Përdorimi i teksteve shkollore në arsimimin fillor në Gostivar

Në këtë hulumtim u zhvillua një anketim me nxënësit e shkollave fillore në qytetin e Gostivarit me pyetësor prej 20 pyetjeve. Në pyetjet 12,13,14,15 dhe 16 në pyetësorin B nxënësit ishin shprehur se për të mësuarit e gjuhëve nevojitet një lehtësim duke u zhvilluar në korrelacion njësítë mësimore nga fusha e gjuhës në të gjithë gjuhët. Prandaj vendosa të bëj një analizë të librave shkollor, që përdoren në klasë të VIII të shkollave fillore.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë me propozimin e Byrosë për Zhvillimin e Arsimit dhe miratimit të ministrit të atëhershëm, bazuar në Nenin 104 të Ligjit për Arsimin Fillor të gjithë librat kanë hyrë në përdorim me leje të MASH. Në Shkollën Fillore “Ismail Qemali” në Gostivar në vitin shkollor 2014/2015 në lëndët e gjuhëve në klasën e VIII-të punohej me këto libra:

- Gjuhë shqipe dhe leximi për klasën e VII”, Zihni Osmani dhe Fejzi Bojku (2010:145-201)
- Македонски Јазик за VII одделение во паралелките со настава на албански и турски јазик” (2008), Нада Николовска и Милица Петрушевска, Македонска Искра, Скопје.
- Messages Student’s book 3, Diana Goodey, Noel Goodey & Miles Craven (2006) - të Cambridge University Press -United Kingdom.
- Ligisch”Doutsch fur Jugedendeliche, Kusbuch A 2” nga Stefanie Dengler, Sarah Fleer, Paul Rusch dhe Cordula Schuring-(2010) Langenscheidt KG, Berlin und Munhen.
- Bien jouaé 2 (1999) Méthode de français, Carla Gilson; Maria Grazia Selle dhe Marie-Christine Jamet dhe Anne Gruneberg dhe avec ia collaboration de Monique Bazin -Hachette Livre 1999, 43 quai de Grenelle 75 905 Paris Cedex 15.

Mësimdhënia efektive dhe efikase është në varshmëri nga teksti lëndor, ku mbështetet arsimtari lëndor për ta organizuar materialin mësimor të lëndës në kurrikula globale, tematike ditore, të mësimit shtues dhe mësimit plotësues. Analiza e teksteve shkollore u zhvillua sipas meritës së arsimtarëve të gjuhëve ose kolegëve të mi, Shkëndije Zendeli (gjuha angleze), Nuredin Aliu (gjuha gjermane) dhe Fetie Dalipi (gjuha frëngje), të cilët më ndihuan me përkthimin e njësive mësimore, me çka më mundësuan ta pasqyroje edhe analizën cilësore të korrelacionit në tekstet shkollore, ku arsimtarët e gjuhëve e mbështesin procesin mësimore të tyre. Në tabelën 2. pasqyrojmë korrelacionin e plan-programeve mësimore të gjuhëve.

**Tabela3.6.1.** Tabela krahasimtare për realizimit të njësive mësimore të gjuhëve në klasën VIII/1 në SH.F. "Ismail Qemali" 2014/2015 parë nga e-ditari

Muajt	Gjuhë shqipe VIII/1	Gjuhë angleze	Gjuhë maqedon.	Gjuhë gjermane	Gjuhë franc. VIII/5
Shtator	1. Probleme te drejtshkrimit te zanoreve dhe bashketingelloreve 2. Rrokja, theksi, intonacioni 3. Shenjat e pikesimit	1. Present continuous and present simple.	1. Акценитски целости, срп.99.	Perfekt (I) regelmä Bige Verben I gem lieber, am lebste Perfekt(II): unregelma Bige Verben I Welch-? im Akkusativ I mein ,dein,...im Akkusativ	1. Le pluriel en x, les adjectives a 2 formes
Tetor	4. Emri, karakteristikat e per gjithshme 5. Gjinia dhe numri i emrit dhe mbiemrit 6. Shumesi i emrave dhe mbiemrave 7. Peremrat pronore dhe te pacaktuar 8. Numerori	2. Past events. 3. Verbs describing actions. 4. Past continuous and past simple. 5. Key grammar Comparatives and superlatives. 6. Key vocabulary: Adjectives describing personality.	2. Глаголи – категории кај глаголите: лице, број, време и вид, срп.100.	würde + Infinitiv I Perfekt (III): trenbare und untrennbare Vereben I Sätze mit wenn Modalverben im Präteritum : volte , konnte ,musste	2. Les verbes et les prépositions de lieu 3. Le passé compose
Nëntor	9. Foljet e parrregullta 10. Format veporre dhe joveprore te foljes	7. Key grammar (not) as.....as. 8. Key vocabulary: Places. 9. Key grammar Suggestions. 10. Key grammar Expressions of quantity	3. Сегашно време, срп.101. 4. Минамо определено несвршено и свршено време, срп.102.	Sätze mit weil I Vergleiche: schneller als , so schnell wie I Superlativ : am schnellsten.	4. Les verbes voir et savoir 5. Pas de, le passe compose negative
Dhjetor	11. Format pavetore dhe ushtrime gramatikore per foljet dhe format e tyre 12. Menyra lidhore dhe kohet e saj 13. Perdorimi i menyres lidhore	11. Module 2 Review: Comparatives 12. Key grammar: The future with the present continuous and going to and superlatives. 13. Key grammar The future with will and going to. 14. Word work Adjective/verb+preposition	5. Идно време, срп. 103.	Adjektive (I) mit dem bestimmten Artikel: der blau Pullover, den bluen Polluver Adjektiv (II) mit dem unbestimmten Artikel: ein arroganter Typ, einen großen Fehler I Frangen in der Vergangenheit	6. Les adverbes et les prépositions de lieu 7. Le passé compose du verbe être
Janar	Greva	Greva	Greva	Greva	Greva
Shkurt	14. Kryefjala dhe kallezuesi 15. Kundrinori i drejte 16. Kundrinori i zhdrejte	15. Module 3 : Review. The future with the present continuous, going to and will.	6. Заповеден и можен начин, срп.105-107.	Bestimmte Artikel im Dativ: dem /der/den/ I reflexive Verben: sich freuen Wechselpräpositionen: auf den Tisch stellen, auf dem Tisch stehen I indirekte Frage	8. La date, les numéraux

Mars	17.Rrethanori 18.Percaktori 19.Emri si një percaktor i nje emri berthame	16. Moduli 4: Your world Key grammar Present perfect. 17.Key grammar Present perfect+ever and never 18.Key expressions:Time expressions with for and since.	7.Серзници, сmp.108.	Modal verb dürfen, nicht dürfen I Adjektive im Dativ I Sätze mit denn Sondem I deshalb – darum und trotzdem I Vergleichssätze mit als und wie	9. L'imparfait des verbes aimer,être aller et avoir
Prill	20.Numërori si përcaktorë 21.Ushtrime gramtikore për përcaktorët 22.Fjalia e përbërë 23.Fjalia e përbërë me bashkërenditje	Moduli 5: The way it's done 19.Word work:Prepositions of time 20. Key grammar:Present perfect and past simple 21. Key grammar:have to, don't' have to 22. Key grammar: should, shouldn't	8.Независно сложени реченици,см р. 110.	Hauptsätze mit Konjunktionen I Nebensätze mit dass ,weil, wenn I Modal verb Zeitangaben mit Präpositionen I also I werden als Vollverb I Ortsangeben mit Präposition	10.Le future proche
Maj	24.Fjalite e përbera me nënrenditje	Moduli 6: The way we live 23. Key grammar:Present simple passive 24.Key grammar:Past simple 25.Key grammar: Reported speech		Modal verben im Präteritum I verben mit dativ und Akkustiv: Ich geb dir einen Tipp Zeitangaben mit Präpositionen I also I werden als Vollverb I Ortsangeben mit Präposition	11.Les verbes du 2eme groupe avec finir,le verbe dire
Qershor				Gramatik und Wortschatz wiederholen	

Në bazë të tabelës 3.6.1. vërehet qartë se në njësitë mësimore nga pjesa e gjuhës përshtatet deri diku në gjuhën angleze, mirëpo zhvillimi i njësive mësimore nuk janë në korrelacionin e duhur kohor. Nëse këto njësi mësimore zhvilloheshin në një periudhë kohore me siguri edhe për nxënësin do të ishte më mirë dhe më e kuptueshme që çdo pjesë e ligjëratës në të gjithë gjuhët të bëhet përdorimi i tyre në funksione të ndryshme në kontekst të fjalive.

Nëse i marrim t'i analizojmë të gjitha janë njëzet e katër (24) njësi mësimore, të cilëve pas çdo kapitulli u shtojmë edhe nga një orë për ushtrime gramatikore, krejtësisht gjashtë (6) orë dhe gjatë vitit mund të praktikohen tre ( 3 ) teste për të vlerësuar të arriturat e nxënësve dhe tre (3) hartime për të vlerësuar arritjet në fushën e zbatimit të drejtshkrimit në gjuhën shqipe. Gjuha shqipe është lënda e parë në ditar me status të detyrueshëm mësimor me 144 orë në vit, ku fusha e gjuhës realizohet 36 (25%) orë.

Në tabelën 3.6.1. vërehet qartë se në muajin shtator në gjuhën shqipe (Gj 1) zhvillohen njësi mësimore nga fusha e fonetikës dhe fonologjisë, kurse në gjuhën angleze (Gj 2) fillohet nga fusha e morfolgisë me foljet edhe atë me kohën e tashme të foljes. Gjuha shqipe (Gj1)

është pak në korrelacion me gjuhën maqedonase (Gj 3), kur zhvillohet njësia mësimore për theksin. Gjuha angleze (Gj 2) në një njësi mësimore në gjuhë frëngë (Gj 4) në ato paralele, ku ajo mësohet, kurse gjuha gjermane (Gj 4) me asnjërën nga gjuhët në mësimet e gramatikës, por vetëm zhvillohet një komunikim i thjeshtë.

Në *muajin tетор* në gjuhën shqipe (Gj 1) zhvillohen njësi mësimore nga fusha e morfologjisë për *emrat* dhe *kategoritë emrit*, për *mbiemrat*, për *përemrat* dhe *numërorët*, kurse në gjuhën angleze (Gj 2) *vazhdohet me foljet* në *kohën e tashme* të *vazhdueshme* të *foljes*, që në gjuhën shqipe ekziston, por aspak në librin e gjuhës shqipe nuk përmendet. Në gjuhën maqedonase (Gj 3) kemi pak korrelacion të kohëve të foljes, ashtu që mund të arrihet fleksibilitet kognitiv tek nxënësi dhe lehtësim për lidhshmëri të pjesëve të ligjëratës sipas klasave dhe kategorive të tyre me njësitë mësimore të gjuhës angleze (Gj 2) dhe gjuhës maqedonase (Gj 3) dhe me gjuhën frëngë (Gj 4), por gjuha gjermane (Gj 4), aspak këtë muaj nuk ka korrelacion të njësive mësimore me gjuhët tjera.

Në *muajin nëntor* në gjuhën shqipe (Gj 1) fillojnë të zhvillohen njësitë mësimore për *foljet* dhe *kategoritë e foljes* dhe janë në korrelacion vetëm me *kohën e ardhme* të *foljes* të *mënyrës dëftore* në gjuhën angleze (Gj 2), që zhvillohet në tri orë mësimore, më tepër se në gjuhën shqipe (Gj 1). Gjithashtu ka korrelacion edhe me gjuhën maqedonase (Gj 3). Foljet modale, që mësohen në gjuhën angleze deri-diku janë në lidhshmëri me ato të gjuhës shqipe, që përmenden vetëm si pjesë përbërëse (foljet modale: mund, duhet, dua, domosdo) të mënyrës lidhore, e jo si njësi mësimore e veçantë, por në gjuhën gjermane dhe frëngë (Gj 4) te foljet modale këtë muaj vërehet një korrelacion.

Në *muajin shkurt* në gjuhën shqipe (Gj 1) zhvillohen njësi mësimore nga fusha e sintaksës për gjymtyrët e fjalisë, *kryefjalë*, *kallëzues*, *kundrinor i drejtë* dhe *i zhdrojtë*, kurse në gjuhën angleze (Gj 2) ende vazhdohet *me kohën e ardhshme* të *foljes*, kurse në gjuhën maqedonase (Gj 3) *me mënyrën urdhërore* të *foljes*, që në gjuhën shqipe nuk u zhvillua si njësi mësimore e veçantë, por u përmend vetëm si mënyrë urdhërore e foljes. Në gjuhën gjermane (Gj 4) zhvillohet njësia mësimore për mbiemrat, kurse në gjuhën frëngë (Gj 4) për foljet në kohën e ardhshme.

Në *muajin mars* në gjuhën shqipe (Gj 1) vazhdohet me gjymtyrët plotësuese të fjalisë me rrethanorët, përcaktorët dhe ndajshtimi si lloj i përcaktorit, kurse në gjuhën angleze (Gj 2) me fjalët kyçe për kohën e tashme të foljes, pjesëzat pohuese dhe mohuese të foljes dhe përdorimi i tyre në fjali pohuese dhe mohuese dhe ndajfoljet e kohës si gjymtyrë plotësuese të foljes.

Fleksibiliteti kognitiv i nxënësve mund të arrihet, kur zhvillohet njësia mësimore përrethanorët. Në gjuhën maqedonase (Gj 3) zhvillohen njësitë mësimore për lidhëzat dhe fjalitë e përbëra të pavarura, që në gjuhën shqipe do të zhvillohen në muajin prill, kur do të zhvillohet njësia mësimore përfjalitë e përbëra. Në gjuhën gjermane (Gj 4) janë zhvilluar

njësi mësimore për komunikim, ku përfshihen edhe e fusha e gjuhës , kurse në gjuhën frëngje (Gj 4).

Analiza e realizimit të kurrikullës mësimore sidomos ato të gjuhëve është tregues se arsimtarët e lëndëve të gjuhëve nuk kanë bashkëpunim të duhur në planifikimin e kurrikulave mësimore të gjuhëve, ashtu që ata edhe nuk u ofrojnë një lehtësim kognitiv nxënësve në të mësuarit e gjuhëve. Në vijim ofrojmë sqarime me përkthime në gjuhën shqipe për korrelacionin në mes njësive gjuhësore të çdo gjuhe me gjuhën amtare, në rastin tonë gjuha shqipe.

### **3.6.1.1. Gjuhë angleze - Njësitë mësimore të përkthyera në gjuhën shqipe**

Në lëndën e gjuhës angleze në klasën e VIII-të në vitin shkollor 2014/2015 në shkollën fillore “Ismail Qemali” në Gostivar mësohet me librin “Messages Student’s book 3” nga Diana Goodey, Noel Goodey & Miles Craven (2006) - të Cambridge University Press -United Kingdom. Në këtë libër njësitë mësimore për të mësuarit e gjuhës standarde angleze zhvillohen gati në çdo orë. Tërë planprogrami është i ndarë në module, ku është e inkluadruar edhe pjesa e gjuhës standarde angleze-gramatika. Libri është i ndarë në gjashtë kapituj. Në këtë lëndë ka edhe libra për metodologjinë e mësimdhënieve, ku bazohet mësimdhënsi.

**Tabela 3.6.1.1.Tabela e materialit gjuhësorë në lëndët e gjuhës angleze**

Njësitë mësimore	Gramatikë në gjuhën angleze	Gramatikë në gjuhën shqipe	Muaj
<b>1. Present and past</b> <i>(E tashmja dhe e kaluara)</i>	Present continuous and present simple Past simple , Past continuons and past simple Expressions: giving and accepting an apology	Koha e tashme të vazhdueshme e foljes dhe koha e të thjeshtë të foljes , Koha e kryer e thjeshtë, Koha e kryer e thjeshtë e vazhdueshme dhe koha e thjeshtë Shembull shprehës: duke dhënë dhe duke pranuar një falje	Shtator
<b>2. Descriptions</b> <i>(Përshkrimet)</i>	Comparatives and superlatives not (as..as) Expressions:asking for description Suggestions Expressions of quantity: too much /many, (not) enought	Shkalla krahasore dhe sipërore jo (aq..aq) Shembull shprehës: pyesim për përshkrimë Sugjerime Shembull shprehës për sasi: Ndajfoljet e sasisë: shumë / tepër, (nuk) është majftueshmë	Tetor
<b>3. The future</b> <i>( E ardhmja)</i>	Present continuous used for the future The future with <i>gonig to</i> The future with <i>will</i> and <i>gonig to</i> The future with <i>will</i> and <i>might</i> <i>will/won't +probably</i> expressions : polite request	Koha e tashme përdoret në kuptimin e të ardhmes E ardhmja me kohën <i>shkoj për të</i> E ardhmja me do të dhe të <i>kem</i> shkuar e shoqëruar me forma të pashtjelluar të foljes në funksion të rrethanorëve: forma paskajore: për të punuar dhe forma përcjellore: duke punuar. E ardhmja e formuar <i>do të</i> + pjesëza mohuese <i>nuk</i> dhe pjesëza e pjesërishme: <i>do të/nuk do të +ndoshta</i> Shembull shprehës: shprehje për	Nëntor

		kërkesa	
4. <b>Your world</b> (Bota juaj)	Present perfect Present perfect and past simple The infinitive of purpose Expressions :	E tashmja e përkryer E tashmja e përkryer dhe koha e kryer thjeshtë Mohim i qëlimit i shprehur me pjesës përfocuese	Dhjetor
	I think so/I don't think so Present perfect : + ever, + just + for and since Expressions : time expressions with for and since	Shembull shprehës: (unë mendoj njëloj / unë nuk mendoj njëloj) E tashme e përkryer: ndonjëherë ose çdoherë, + vetëm + për të dhe që prej Shembull shprehës: shprehjet e rrëthanorit të kohës me të dhe që prej	
5. <b>The way it's done</b> (Kjo është bërë)	Have to, don't have to, mustn't Should, shouldn't Ekspressions : thanking people and responding to thanks Present simple passive Past simple passive Expressions : Expressing a reactions Pronuantwort :	Kanë për të, nuk kanë për të, nuk duhet të Duhet, nuk duhet Shembull shprehës: duke falenderuar njerëzit dhe reagimi i tyre ndaj Falënderimit Pasiv i pranishëm i thjeshtë Pasiv i shkuar i thjeshtë Shembull shprehës: Shprehje për reagime Ndajfoljet	Janar-Shkurt-Mars
6. <b>The way we live</b> (Mënyra se si ne jetojmë )	Reported speech Say and tell Questions tags Expressions: asking for clarifications Used to Second conditional Ekspressions :saying goodbay	Ligjeratë e drejtë dhe ligjeratë e zhdrojtë : Fol dhe ritrego! Fjalët pyetëse? Përdoren për t'u shprehur : për arsyetime Ekspressions: (asking for clarifications) përdoret për të kushtëzuar Shprehje përshtendetëse ndarëse nga komunikimit: kur përdoret: Mirupafshim!	Prill-Maj

**Moduli 1:** *Present and past*, në shqip *E pranishmja dhe e kaluara*, ku bëhet lidhshmëria në mes ngjarjeve të kaluara dhe rishikimi i tyre. Në këtë modul mësohet për kohën e tashme të vazhdueshme të foljes dhe për kohën e të thjeshtë të foljes, kurse në librin e gjuhës e shqipe kohën e tashme të vazhdueshme e të foljes as që përmendet. Në vijim me përdorimin e shprehjeve të ndryshme zhvillohen aftësitë e të lexuarit dhe të dëgjuarit dhe përforcohen dijet për kuptueshmërinë e foljeve, që përshkruajnë veprime dhe lidhshmërinë e tyre me fjalët të tjera duke formuar grupe follore në fjali.

**Moduli 2:** *Descriptions*, në shqip *Përshkrimet*, bëhet lidhshmëria e pjesëve të ligjëratës me përdorimin e shkallëve të ndajfoljeve në shkallën krahasore dhe shkallën sipërore duke përdorur ndajfoljet e sasisë me të cilat krijohet rrëthanori i sasisë p.sh. “*too much/many=shumë*”, “*a lot of – më pak*” nga fjala “*enought= mjaftueshëm*” etj. Në çdo modul të gjuhës angleze vërehet lidhshmëri të *morfologjisë dhe sintaksës*, që lehtësojnë të kuptuarit e pjesëve të ligjëratës dhe gjymtyrëve të fjalisë për përdorim komunikues. Sqarimi i foljeve dhe ndajfoljeve, sikur të ishte në korrelacion me njësitet mësimore të gjuhës shqipe (Gj1) me

siguri nxënësit do t'i bëhej një lehtësim në të mësuarit e të dy gjuhëve. Ky modul në gjuhën angleze zhvillohet në muajin dhjetor, kurse në gjuhën shqipe zhvillohen njësitë mësimore: *format veporre dhe joveprore, mënyra lidhore dhe kohet e saj dhe përdorimi i mënyrës lidhore.* (Osmani dhe Bojku, 2010:174).

**Moduli 3:** *The future*, në shqip *E ardhmja*, përdorimi i kohës së tashme të foljes në kuptim të së ardhmes. Kjo kohë formohet me “*going to*” në shqip “*duke shkuar*” (me formë të pashtjelluar përcjellore në funksion të rrethanorit) ose për të shkuar me formë të pashtjelluar në paskajore në funksion të rrethanorit. Formimi i lidhshmërisë morfologjike pjesëve të ligjërâtës në formimin e gjymtyrëve të fjalisë në grupe foljore në funksione të ndryshme rrethanore.

Gjithashtu sqarohet me përdorimin e foljes “*will*” dhe “*going to*”, në shqip “*do të shkojmë në*”, *ku vërehet lidhshmëri e pjesëve të ligjërâtës të foljes* në ardhmen me një parafjalë të grapi emëror duke formuar grup foljor. Në vazhdim sqarohet përdorimi i foljes në kohën e ardhme me “*will*” dhe “*might*”, që në shqip do të thotë sipas fuqisë së shkallëzimit. P.sh. “*will/won't*” dhe “*probably*”, që në shqip do të thotë “*do të / nuk do të*” dhe “*ndoshta*”, *kjo në shqip do të thotë përdorimi i pjesëza mohuese, të pjesërishme dhe pohuese për të përforcuar kuptimin e foljes. Të gjitha këto i ka edhe gjuha shqipe, mirëpo në librat e gjuhës shqipe të klasës së VIII-të, as që përmenden.*

*Parashtronhet pyetja: Si do të mësojnë nxënësit gjuhët e huaja pa mos i mësuar në gjuhën shqipe ose gjuhën amtare? Prej kësaj analize vërehet se gjuha angleze mund lirisht të rangohet me status të gjuhës së parë (Gj1) edhe në R e Maqedonisë. Ky modul zhvillohet në muajin shkurt dhe mars, kurse në gjuhën shqipe në këto muaj zhvillohen gjymtyrët e fjalisë, kryefjala dhe kallëzuesi, kundrinori i drejte dhe kundrinori i zhdrejtë.* (Osmani dhe Bojku, 2010:181).

**Moduli 4:** *Your world* në shqip *Bota juaj*, ku mësohet koha e tashme e foljes dhe koha e kryer e thjeshtë e foljes të përdorura në funksion të rrethanorit të qëllimit. Përdorimi i foljes mendoj njëloj dhe nuk mendoj njëloj, përdorimi i pjesëzës mohuese, që rikthen fjalinë në kuptim mohor. *Present perfect tense*, “*ever and never*”, “*just*”, “*for and since*” ose në shqip “*koha e tashme e pranishme*”, “*përherë dhe kurrë*”, “*vetëm ose sapo*”, “*për dhe që nga*”. Në formimin e kësaj kohe përdoren pjesëzat përforcuese, që sqarojnë kohën e foljes në kohën e tashme të përhershme ose të përsëritshme, që ekziston edhe në gjuhën e shqipe, *mirëpo në librat e gjuhës shqipe të klasës së VIII-të e as në librat tjerët të klasave tjera aspak nuk përmenden.* Ky modul zhvillohet në muajin mars në gjuhën angleze, kurse në gjuhën shqipe zhvillohen rrethanori, përcaktori, emri si një përcaktor i një emri bërthame. (Osmani dhe Bojku, 2010:192).

**Moduli 5:** *The way it's done* në shqip *Kjo është bërë përdoret folja “hav”* në shqip “*kam*”. Kjo folje në gjuhën shqipe përdoret në kuptim si folje në vete dhe si folje ndihmëse

për formimin e kohëve të përbëra të folje, mirëpo në librat e klasës së VIII-të (që punohet me librat e klasës së VII-të) përmendet vetëm si folje e parrregullt (Osmani dhe Bojku, 2010:173) dhe në kapitullin e mënyrës lidhore dhe kohët e saj (Osmani dhe Bojku, 2010:179) *me një fjali sqaruese si folje ndihmëse në kohët e përbëra të foljes.*

Në librat e anglishtes sqarohet formimi i kohës së foljes në “*present simple passive*”, në shqip “*koha e tashme e thjeshtë në pasiv ose forma joveprore*” dhe “*past simple passive*” në shqip “*koha e kryer e thjeshtë në pasive ose forma joveprore*”, që realizohet me ndihmën e përdorimit të foljeve modale “*mustn't, should, shouldn't*” në shqip “*duhet, nuk duhet të*”. Për foljet modale në librat e gjuhës shqipe ofrohen pak sqarime, edhe atë përmenden në njësinë mësimore të mënyrës lidhore si pjesë shoqëruese e foljeve të mënyrës lidhore foljet modale: “*mund*” për mundësi, “*duhet*” për domosdoshmëri dhe “*do*” për dëshirueshmëri dhe foljet gjysmëndihmëse, që përdoren për të treguar fillimin “*filloj, nis, zë*”, *vazhdimin “vazhdoj”* dhe *mbarimin e veprimit “mbaroj, pushoj”*. (Osmani dhe Bojku, 2010:180). Nëse folje modale mësoheshin si njësi në vete, me siguri do të ishin më të qarta.

*Në këtë modul* ofrohen sqarime edhe për lidhshmërinë e ndajfoljeve me fjalë të tjera në grupe foljore, që shprehin funksionin e rrethanorëve. Kjo njësi mësimore është pak në korrelacion me atë të gjuhës shqipe, ku ofrohen sqarime se mund të përdoren edhe në kuptime të rrethanorëve të qëllimit, të mënyrës, të kohës, të vendit dhe te fjalitë e përbëra me nënrenditje rrethanore. (Osmani dhe Bojku, 2010:189). Ky modul në gjuhën angleze zhvillohet në muajin prill, kurse në gjuhën shqipe në këtë muaj zhvillohen njësitë mësimore: *numërori si përcaktori, ushtrime gramatikore për përcaktorët, fjalia e përbërë dhe fjalia e përbërë me bashkërenditje.*

**Moduli 6:** *The way we live* në shqip *Mënyra se si ne jetojmë* në këtë kapitull jepen sqarime për përdorimin e shenjave të pikësimit gjatë drejtshkrimit në fjali të ndryshme dhe intonacionit të zërit gjatë drejtshqiptimit të fjalive të ndryshme. Kjo njësi mësimore në librat e gjuhës shqipe sqarohet në fillim të librit dhe zhvillohet në shtator. (Osmani dhe Bojku, 2010:155). Ky kapitull zhvillohet në muajin maj në gjuhën angleze, kurse në shqip mësohen fjalitë e përbera me nënrenditje.

### 3.6.1.2. Gjuhë maqedonase-Njësitë mësimore përkthyer në gjuhën shqipe

Në gjuhën maqedonase për klasat e teta përdoret libri “Македонски Јазик за VII одделение во паралелките со настава на албански и турски јазик” (2008)- Нада Николовска и Милица Петрушевска, Македонска Искра ,Скопје. Libri i gjuhës maqedonase, që përdoret për nxënësit shqiptar dhe turq përmban këto njësi mësimore nga fusha e gjuhës:

Në gjuhën maqedonase mësohen 14 njësi mësimore nga fusha e gjuhës edhe atë në fonetikë dhe fonologji, morfologji dhe sintaksë. Njësitë mësimore të gjuhës maqedonase (Gj 3) janë në korrelacion me ato të gjuhës shqipe (Gj 1) në fushën e fonetikës dhe sintaksës.

**Tabela 3.6.1.2.** Tabela e materialit gjuhësorë të gjuhës maqedonase

Gjuhë Maqedonase	Gjuhë Shqipe	Muaj
Акцентски целости (2008:99)	Theksi i shprehjes (fjalë proklitike=ma jep librin, fjalë enklitike=jepma librin)	Shtator
Категори кај глаголите, лице, број, време и вид (2008:100)	Kategoritë e foljes, mënyra(lloji), veta, numri dhe koha	Tetor
Сегашно време (2008:101)	Koha e tashme	Nëntor
Минато определено несвршено и свршено време(2008:102)	Koha e shkuar, koha e pakryer dhe kryer	Nëntor
Идно време (2008:103)	Koha e ardhme	Dhjetor
Заповеден начин (2008:104)	Mënyra urdhërore	Dhjetor
Можен начин(2008:107)	Mënyra lidhore me foljet modale	Shkurt
Сврзници (2008:108)	Lidhëzat	Shkurt
Незвисносложени реченици(2008:110)	Fjalitë e përbëra me bashkërenditje(të pavarura)	Mars
Составни незвисносложени реченици(2008:111)	Fjalitë e përbëra me bashkërenditje shtuese	Mars
Спротивни незвисносложени реченици(2008:112)	Fjalitë e përbëra me bashkërenditje kundërshtuese	Prill
Разделни незвисносложени реченици(2008:114)	Fjalitë e përbëra me bashkërenditje ndarëse	Prill
Исклучни незвисносложени реченици(2008:115)	Fjalitë e përbëra me bashkërenditje veçuese	Maj
Заклучни незвисносложени реченици(2008:116)	Fjalitë e përbëra me bashkërenditje përmbyllëse	Maj

### **3.6.1.3. Gjuhë gjermane - Njësitë mësimore përkthyer në gjuhën shqipe**

Në gjuhën gjermane përdoret libri "Ligisch" Doutsch fur Jugedendeliche, Kusbuch A 2" nga Stefanie Dengler, Sarah Fleer, Paul Rusch dhe Cordula Schuring- (2010) Langenscheidt KG, Berlin und Munhen. Në këtë libër njësitë mësimore për të mësuarit e gjuhës standarde gjermane zhvillohen gati në çdo orë me mësim i integruar. Tërë plan-programi është e ndarë në module, ku është e inkadruar edhe pjesa e gjuhësisë gjermane. Libri është i ndarë në 14 pjesë.

**Tabela 3.6.1.3.** Tabela e materialit gjuhësorë në lëndët e gjuhës gjermane-Nach den Ferien

Njësitë mësimore	Gramatikë në gjermanisht	Gramatikë në shqip	Muaji
1. Nach den Ferien	Perfekt (I) regelmä Bige Verben I gem lieber , am lebsten	Koha e kryer, foljet e rregullta, shkallët e mbiemrit	Shtator
2. In der Schule	Perfekt(II): unregelma Bige Verben I Welch-?im Akkusativ I mein ,dein,...im Akkusativ	Koha kryer e foljeve të parregullta. Përse përdoret përemri pyetës cili/cila Kallëzorja e përemrave dëftorë	Shtator

3. Freunde und Freizeit	würde + Infinitiv I Perfekt (III): trenbare und untrennbare Vereben I Sätze mit wenn	Koha e kryer e foljes në mënyrën kushtore. p.sh do+ koha lidhore në të pakryerën+paskajorja ose do të isha. Përdorimi i foljes në kohën e kryer në fjalitë kushtore.	Tetor
4. Unterwegs	Modalverben im Präteritum : volte , konnte ,musste	Foljet e kohës së kryer të thjeshtë: qëndroj, mund, kishte.	Tetor
5. Sport	Sätze mit weil I Vergleiche: schneller als , so schnell wie I Superlativ : am schnellsten	Fjalitë me well ose në shqip pra, Përdorimi në fjalitë shkakore, shkalla krahasore e mbiemrit: shpejt –më i shpejtë	Nëntor
6. Kleidung und Farben	Adjektive (I) mit dem bestimmten Artikel:der blau Pullover, den blauen Polluver	Mbiemrat e nyshëm: bluza e kaltër, bluzën e kaltër.Përdorimi i mbiemrit të nyshëm në funksion të përcaktorit në grupime emërore kryefjalë (GE –kryefjalë) dhe grupime emërore në funksion të kundrinës së drejtë (GE-Kundrinë e drejtë).	Nëntor
7. Freundschaften	Adjektiv (II) mite dem unbestimmten Artikel:ein arroganter Typ, einen großen Fehler I Frangen ind der Vergangenheit	Lakimi i mbiemrit të panyjshëm ose me emër në të pasqarën.	Dhjetor
8. Familien feste	Bestimmte Artikel im Dativ:dem /der/den/ I reflexive Verben: sich freuen	Nyja e shquar i / e / të në dhanore, te përemrat vettoret. Përdorimi i foljeve në joveprore në diatezën vettoret gëzohem-gëzohesh-gëzohet gëzohemi -gëzoheni – gëzohen.	Dhjetor
9. Mein Geld, meine Sachen	Sätze mit dass I dieser ,diese ,dieses im Nominativ und Akkusativ I ein ,eine im Dativ I mein ,dein ...imDativ	Fjalët ndihmëse, që lidhen me lidhëzën dass ose në shqip që dhe përemrat dëftorë në rasën kallëzore/ dhanore. Vendos që unë këtë, këtë, këtë, dhe në rasën emërore dhe në rasën kallëzore unë një, një minierë dhanore unë, tuajat ... imDativ	Shkurt
9. So wohne ich	Wechselpräpositionen: auf den Tisch stellen, auf dem Tisch stehen I indirekte Frage	Parafjalët: vendosura në tich, në qëndrimin që unë tich pyetje të tërthortë	Shkurt
10. Stadtgeschichten	Modal verb dürfen, nicht dürfen I Adjektive im Dativ I Sätze mit denn	Folja e mënyrës dëftore(lejoj /guxoj) mbiemrat në rasën dhanore /Fjalitë me lidhëzën (konjuktion)denn.	Mars
11. Raus in die Natur	Sondem I deshalb –darum und trotzdem I Vergleichssätze mit als und wie	Fjalitë shkakore me deshalb-darum-und trotzdem ose shqip pse-pse-për shkak se .Fjalitë krahasuese me als dhe wie ose shqip si ose siç	Mars
12. Cool und fit	Hauptsätze mit Konjunktionen I Nebensätze mit dass ,weil, wenn I Modal verb	Fjali kryesore me bashkime unë Nebensätze me atë, sepse kur unë Modal folje	Prill
13. Elektronische Freunde	Modal verben im Präteritum I verben mit dativ und Akkustiv: Ich geb dir einen Tipp	Foljet modale dhe foljet e mënyrës lidhore në të kryerën e thjeshtë . Foljet në dhanore dhe në kallëzore . Foljeve modale në të kaluarën foljeve tensionuara I me Akkustiv dhanore dhe: Unë do të ju jap një tip	Prill
14. Nach der Schule	Zeitangaben mit Präpositionen I also I werden als Vollverb I Ortsangeben mit Präposition	Rrethanorët e kohës me parafjalë,folje ndihmëse si dhe folje të plotë “werdon”. Rrethanorët e vendit me parafjalë. Parafjala përcakton vendndodhjen.	Maj
15. Finale	Gramatik und Wortschatz wiederholen	Gramatikë dhe thesari i fjalëve	Qershori

### 3.6.1.4. Gjuhë frënge - Njësitë mësimore të përkthyera në gjuhën shqipe

Në gjuhën frënge përdoret libri “ Bien joué 2 - Méthode de français ” nga Carla Gilson; Maria Grazia Selle dhe Marie-Christine Jamet dhe Anne Gruneberg dhe avec ia collaboration de Monique Bazin -Hachette Livre 1999, 43 quai de Grenelle 75 905 Paris Cedex 15.

**Tabela 3.6.1.3. Tabela e materialit gjuhësorë e gjuhës frënge**

Frënge	Shqip	Muaji
Unit1: les adjectifs a 2 formes le pluriel en –x les adverbes et les prépositions de lieu le passé compose les verbes savoir et voir	Mbiemri ne te dy format shumesin ne –x. Ndajfoljet dhe parafjalet e vendit, koha e kaluar. Foljet din dhe shoh	Shtator Tetor
Unit 2: pas de le passé compose négatif les adverbes et les prépositions de lieu (suite)oui et su les verbes pleuvoir et neiger le verbe être au passé compose	Koha e kaluar negative. Foljet dhe parafjalet e vendit. Po dhe po. Foljet bie shi dhe bore. Folja jam ne kohën e kaluar	Tetor Nëntor
Unit 3: le date l'imparfait des verbesaimer.être, aller et avoir le futur proche les verbes du 2 groupe avec finir le verbe dire	Data, forma e pakryer e foljevedua, jam, shkoj dhe kam, e ardhmja e afert. Folja e grupit 2 me foljet mbaroj dhe them	Nëntor Dhjetor
Unit 4: l'adjectif tout le pluriel en –aux la valeur des verbes faire et jouer l'emploi des auxiliaires les verbes nager, lancer et courir	Mbiemri Shumësi i parashtesës (aux). Vlera e foljeve të bëj dhe të luaj. Përdorimi i foljeve ndihmese foljet: notoj lëshoj, vrapoj.	Shkurt
Unit 5: les adverbes de quantité c'est/ce n'est pas en train de la forme négative (suite) il faut le verbeprendre	Shuma e ndajfoljeve eshte/ai eshte. Të jesh . forma negative (komplet) duhet. Folja të marrë	Mars
Unit 6: les pronoms personnels COD l'imperatif avec les pronoms penses que les verbes du 3 groupe (-re)	Peremrat vtorë, kundrina e drejtë Folja: mendoje dhe foljet e grupit të 3-të (re)	Prill
Unit 7: le pronom relatif qui la possession le pronom y les verbes suivis d'un infinitif les verbes connaître, envoyer et recevoir	Permat pyetës cili ? Peremrat pronorë . Foljet njoh, dërgoj dhe pranoj. Foljet te shoqëruar me paskajoret e foljeve.	Prill
Unit 8 : les pronoms personnels COI L'imperatif négatif le futur les verbes écrire et lire	Peremrat vtorë, kundrina e zhdrojte . Forma negative e urdhërore Koha e ardhme. Foljet shkruaj dhe lexoj	Maj-Qershori

### 3.6.1.4. Mungesa e pjesëve të ligjërâtës në librin e gjuhës shqipe VII-të ( i përdorur në klasë të VIII-të më 2015 )

Në librin e gjuhës shqipe për klasën e VII-të të Osmani dhe Bojku ( 2002 ), vërehen redukttime në sqarimin e njësive mësimore nga gjuhësia. Në bazë të shqyrtimeve analitike të librave shkollor të gjuhëve u vërejt se njësitë mësimore të gjuhës shqipe (amtare) me angleze, aspak nuk janë në korrelacion me njëra tjetrën. Këto dy gjuhë nxënësi fillon t'i mësojë prej në klasë të parë, prandaj njësitë gjuhësore duhet të jenë në korrelacion me

njëra-tjetrën, që nxënësit të mbështet në njohuritë e gjuhës amtare për të bërë lidhshmërinë e njohurive gjuhësore në të dy gjuhët. Në klasën e I-rë deri në klasë të V-të punohet me libra të Rita Petro dhe të tjerë (2009), ku materiali gjuhësor është më mirë i organizuar dhe i pasqyruar në organizues grafik.

Në librin "Gjuha shqipe dhe leximi për klasën e VII-të" (Osmani dhe Bojku, 2002) mungojnë njësitë mësimore e të gjithë mënyrat foljes, por është sqarimi vetëm për mënyrën lidhore. *Folja në mënyrën dëftore duhet çdo vit të përsëritet, për shkak se është trajta përfaqësuese, ku bazohet analiza e foljeve. Koha e tashme në gjuhën shqipe ka disa forma në kuptim kontekstual të kohës së tashme.* Në gjuhë angleze mësohet koha e tashme të vazhdueshme të foljes dhe për kohën e thjeshtë të foljes, kurse në librin e gjuhës shqipe kohën e tashme të vazhdueshme ose e tashmja e aktualitetit siç e quan Murati (2013 ), as që përmendet.

Në librin Gjuhë shqipe për klasën e VIII-të (Nesimi, Toska dhe Abdiu, 2003:165-166; Hysa, 2002:64; Beci, Bubani dhe Gurabardhi, 2001:123) janë bërë sqarimet për kohën e tashme të foljes në mënyrë më të qartë se sa në librin me, të cilin punojmë aktualisht. Më mirë janë të sqaruara edhe në Gramatikën e Gjuhës Shqipe (2002:307).

Foljet ndihmëse dhe gjysmëndihmëse në gjuhët e huaja angleze, gjermane dhe frëngë mësohen prej në klasë të VI-të, kurse *në gjuhën shqipe mësohen në klasë të IX-të*. Në bazë të parimeve të mësimdhëniec çdo gjë duket të konkretizohet, që të kuptohet më mirë, prandaj njësitë gjuhësore më parë duhet të mësohen në gjuhën amtare, Gj-1, e pastaj të mësohen në gjuhët tjera Gj-2, Gj-3dhe Gj-4. Këto folje më parë mësoheshin në klasë të VIII-të, që tani mund të punohet në klasë të IX-të nëntëvjeçare janë "Gjuhë shqipe për klasën e VIII-të" (Nesimi dhe të tjerët, 2003:177): (Karanfili dhe Osmani, 2010: 153); (G. Gj. Sh., 2002:307).

Mungojnë sqarime si njësi mësimore për parafjalët dhe klasifikimet e tyre sipas ndërtimit dhe rasave, që në gjuhën angleze përdoren shumë, që klasifikohen sipas strukturës ose ndërtimit : a) *të thjeshta : mbi, me, në, ndaj, ndër, nën, pa etj.* b) *të përngjitura: përmbi, në-për, përvëç, sipas, etj.* c) *shprehje parafjalore: bashkë me, me përjashtim etj.* (Hysa, 2002:78).

Klasifikimi i parafjalëve sipas rasave shumë i nevojshëm, për shkak se përdorimit të parafjalëve u kushtohet shumë kujdes në gjuhën angleze.

- *parafjalë të rasës emërore: nga dhe tek.*
- *parafjalë të rasës gjinore: me anë, me anën, në drejtim, për punë, në saje, për shkak*
- *parafjalë të rasës të rasës kallëzore: me, për, pa, më, mbi, nën, ndër, nëpër, në, etj.*
- *parafjalë të rasës të rasës rrjedhore: prej, andej, afër, përmes, krahas, larg, përvëç, sipas, etj. p.sh Autostrada kalon përmes Pollogut.*

Mungojnë sqarime si njësi mësimore për pjesëzat dhe klasifikimi i tyre, që në gjuhën angleze përdoren shumë. *Pjesëzat sipas strukturës ose ndërtimit dhe sipas domethënies.* Pjesëzat sipas strukturës janë: a) *fjalë të thjeshta* (bash, bile, ja, nuk, s', vallë, as, dot, nja; b)

*të përngjitura* (pale, posa, siç, thuajse, pothuajse, kushedi; c) *lokacione* ( as që, ja që, jo që jo, po se po, se mos, vetëm që, vetëm e vetëm etj.)

*Pjesëzat sipas domethënies ndahen në tri grupe:*

1) *Pjesëza që shprehin ngjyrime kuptimore të përgjithshme*: a) *dëftuese* (ja); *përcaktuese-saktësuese* ( bash, tamam, deri, mu, pikërisht, plot, po, porsa, posa, që, qysh, rrumbullak, sa, sapo; c) *përforcuese* (bile, dhe, edhe, madje, sidomos, veç, veçse, vetëm, veçanërisht etj); *përafruese* ( afërsisht, aty-aty, nja, si nja, gati, rreth, thuajse, pothuajse, desh, mend).

2) *Pjesëza modale*: a) *pohuese* (po, posa, po që po, po se po, si urdhëron etj) ; b) *mohuese* ( jo, mos, nuk, s', ja që jo, jo se jo, as që), *pyetëse* ( a dhe ë), c) *dyshuese* ( gjë, kushedi, mbase, ndoshta, sikur, vallë) dhe *zbutëse* ( pa, as, para, dot).

3) *Pjesëza emocionuese-shprehëse*: ç', de, pa, pale, pra, se, seç etj.

*Mungon sqarimi i njësive frazeologjike, që në gjuhën angleze përdoren shumë, kurse në librat e gjuhës shqipe, as që përmenden. Klasifikimi i njësive frazeologjike sipas kuptimit morfologjik: a) shprehje frazeologjike foljore, b) shprehje frazeologjike mbiemërore, c) shprehje frazeologjike ndajfoljore,* (Thomai, 2002: 211). Mungojnë edhe sqarime për sinonimet, antonimet, homonimet. (Nesim dhe Gega, 2001:80-83).

### **3.6.1.5. Përfundime nga analiza e teksteve shkollore**

Analiza e librave të gjuhës shqipe dhe gjuhëve të tjera reflektoi një moskorrelacion të programit mësimore të gjithë gjuhëve në fushën e gjuhësisë, sidomos te pjesët e ligjëratës. Në gjuhën angleze, kur zhvillohen njësítë mësimore përfoljen, në gjuhën shqipe zhvillohen zanoret dhe bashkëtingëlloret, kurse kur zhvillohen foljet në lëndën e gjuhës shqipe, atëherë në gjuhën angleze zhvillohet mbiemri dhe shkallët e tij. Kjo dukuri është si rezultat i mosbashkëpunimit të arsimtarëve të gjuhëve në përpilimin e plan-programeve mësimore, por edhe të hartuesve të librave.

Hartuesit e librave shkollor në të ardhmen duhet t'u kushtojnë më tepër kujdes hartimit të librave, ku do përfshihen të gjithë pjesët e ligjëratës. Më mirë do të ishte, që të kishte një libër unik nga pjesa e gjuhësisë përfshirë të gjithë nxënësit shiptarë të shkollave filllore, por materiali gjuhësor të jetë i organizuar si në gjuhën angleze dhe të ketë libra përfshirë mësimdhënësit përfshirë rrjetin e shkollave shkollorë duhet të jenë në bashkëpunim të ndërsjellë gjatë hartimit të librave, që do t'ua lehtësojnë nxënësve të mësuarit e gjuhëve të ndryshme, përfshirë shkak se gjuhët janë më se të nevojshme përfshirë jetuarit në shekullin XXI.

#### 4.PËRGJITHËSIME TË PËRFUNDIMEVE NË BAZË TË KORNIZAVE JURIDIKE

Në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë të miratuar më 17 nëntor 1991 në mbështetje të së kaluarës historike dhe vullnetit të lirë të shprehur, të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në Referendumin e 8 shtatorit 1991, si dhe faktit historik se Maqedonia është konstituuar si shtet nacional i popullit maqedonas, ngelet të *sigurohet barazia e plotë qytetare dhe bashkëjetesa e përhershme e popullit maqedonas me shqiptarët, turqit, vllahët, romët dhe kombësitë e tjera*, që jetojnë në Republikën e Maqedonisë.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë është hartuar në pajtueshmëri me Kornizën e *Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, ashtu që në pajtueshmëri me Nenin 1 dhe 2 të kësaj Deklarate* është përcaktuar qëllimi i Kushtetutës së Maqedonisë i ndarë në pesë objektiva:

- 1) Në objektivën e parë theksi vendoset në konstituimin e Republikës së Maqedonisë si shtet sovran, i pavarur dhe si shtet qytetar demokratik.
- 2) Në objektivën e dytë theksi vendoset mbi sundimin e së drejtës si sistem themelorë i pushtetit.
- 3) Në objektivën e tretë theksi vendoset në garantimin e të drejtave të njeriut, në lirinë qytetare dhe barazinë kombëtare.
- 4) Në objektivën e katërt theksi vendoset mbi sigurinë e paqes dhe bashkëjetesës së popullit maqedonas, me kombësitë që jetojnë në Republikën e Maqedonisë.
- 5) Në objektivën e pestë theksi vendoset mbi sigurinë për drejtësi sociale, për mirëqenie ekonomike dhe për përparim të jetës personale dhe të përbashkët për të gjithë popujt, që jetojnë në Republikën e Maqedonisë. Ligjet i ofrojnë mundësi për përparimin çdo individi.

Neni 26 i DUDNJ është miratuar Neni 44 në Kushtetutën e R. së Maqedonisë, ku theksohet "Secili ka të drejtë në arsimim. Arsimimi është i arritshëm për secilin në kushte të barabarta. Arsimimi fillor është i detyrueshëm dhe pa pagesë" dhe Neni 48, ku theksohet: "*Në shkollat në të cilat arsimimi zhvillohet në gjuhën e kombësisë, mësohet edhe gjuha maqedonase,*" por kjo duhet të funksionojë edhe në nivel lokal, ku arsimi zhvillohet në gjuhën e kombësisë shumicë, të mësohet gjuha e shumicës nga ana e komuniteteve pakicë në nivel lokal si nevojë për gjindshmërisë jetësore dhe komunikim efektiv në përditshmëri. Gjuhët janë shumë të nevojshme për bashkëjetesën, prandaj gjuhët duhet të mbështeten nga institucionet shtetërore dhe ato lokale, që të mësohen në institucione arsimore.

Nenin 7 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, ligji për gjuhët u zëvendësua me Amendamentin V më 16 nëntor 2001 (Numër 07-3795/1) *Marrëveshja e Ohrit më 13 gusht 2001*. Marrëveshja e Ohrit, për shumicën është një dokument, që ktheu paqen në vend dhe i dha fund konfliktit të vitit 2001, vendosi kornizat e bashkëjetesës ndëretnike dhe perspektivës Euroatlantike të Maqedonisë. Aty u vendos dukuria e shtrirjes gjuhësore e të dy gjuhëve me prestigj të njëjtë zyrtar, me ndryshimin e Nenit 7 me amendamentin e V-të, ku për gjuha shqipe bëhet gjuhë zyrtare në vendbanimet me shumicë shqiptare.

Në mbështetje të Neni 115 të Kushtetutës që pëson ndryshime më 16 nëntor 2001 (Numër 07-3795/1) me Amendamentin XVII miratohet më 25.01.2006 Statuti i Vetadministrimit lokal dhe në Nenin 87 shënohet: "**Këshilli për format e vetëvendosjes vendore jep iniciativa dhe propozime në organet kompetente të komunës për çështje nga sfera e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale dhe çështje të tjera me interes për qytetarët**". Gjithashtu edhe ligji për arsimi fillor nr. 103/2008,... 135/2014, në Nenin 25 në paragrafin 3 thekson "*Plani mësimor i shkollës filllore përmban lëndë obliguese dhe zgjedhore, mësim plotësues dhe mësim shtesë, si dhe orë për bashkësinë e klasës*".


Ky nen është me pajtueshmëri me qëllimin e pestë të Kushtetutës, ku theksohet: "**mirëgenia ekonomike dhe përparimi i jetës personale dhe të përbashkët**" i jep mundësi Këshillit për format e vetëvendosjes vendore të jep iniciativë dhe propozime në organet kompetente të komunës për çështje nga sfera e arsimit, ku mund të shqyrtohet çështja e inkadrimit të gjuhës shqipe në kurrikulën mësimore si gjuhë e nevojshme për të lehtësuarit e komunikimit shoqërore dhe si nevojë e domosdoshme për të gjithë qytetarët e Gostivarit sidomos qytetarëve maqedonas dhe atyre të etnitetit turk, për shkak se vet numri i popullsisë shumicë sipas Regjistrimit të popullsisë *në vitin 2002* është 66,60 %, janë më tepër shqiptarë. *Në mbështetje të ligjeve të lartpërmendura formulojmë përfundimet:*

*Së pari*, në mbështetje të Nenit 44 dhe 45 ( 3 ) të Ligjit për Arsim fillor: "Shkolla fillore është e obliguar t'i përfshijë nxënësit nga rajoni i vet, por mund të regjistrojë nxënës nga rajoni tjetër ose nga komuna tjetër vetëm nëse ka vende të lira për regjistrim". *Ky ligj*, është në varshmëri nga struktura e banoreve të lagjeve në afërsi të shkollave fillore, kurse në shkolla fillore mësimi zhvillohet në tri gjuhë.

*Së dyti*, nxënësit, që mësojnë në shkolla fillore nuk kontaktojnë me nxënës të etniteteve tjera për të kriuar raporte miqësie, pasi në çdo shkollë fillore mësimi zhvillohet në turne të ndara, kurse në shkolla të mesme gjendja është shumë e mirë mësimi zhvillohet me turne të përziera, respektohet parimi i multikulturalizmit për zhvillimin e raporteve multikulturore.

*Së treti, opinionet e qytetarëve të Gostivarit* janë tregues se gjuhët e kontaktit janë më të nevojshme për komunikim shoqëror, prej të cilave më e përdorshme është gjuha shqipe.

**Tabela 4.1-Tabela pasqyruese e 206 të anketuarit për gjuhën më të nevojshme në Gostivar**




*Së katërti, nxënësit e Gostivarit më së tepërmi kanë dëshirë ta mësojnë gjuhën angleze si "gjuhë elitare botërore", por më së tepërmi u pëlqen edhe metodologja e mësimdhënieς me mësimnxëniet.*

*Së pesti, opinionet e nxënësve, arsimtarëve dhe profesorëve janë tregues se plan-programet mësimore të lëndëve të gjuhëve nuk përgatiten në korrelacion në të gjithë.*

*Së gjashti, opinionet e arsimtarëve dhe profesorëve janë tregues se bashkëveprimi i arsimtarëve në aktivet gjuhësore aspak nuk funksionojnë në shkolla fillore dhe të mesme.*

*Së shtati, opinionet e qytetarëve të Gostivarit janë tregues për gjendjen e bilinguizmit dhe plurilinguizmit në Gostivar.*

**Tabela 4.2-Tabela pasqyruese për 206 të anketuarit për zotërimin e shumëgjuhësisë në Gostivar**



*Së teti, qytetarët e Gostivarit kanë nevojë për mbështetje institucionale të gjuhëve nga vet hartuesit e Politikave Gjuhësore të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Byrosë për Zhvillimin e Arsimit për integrimin e gjuhës shqipe në kurrikulën mësimore të nxënësve maqedonas, por edhe atyre turk si nevojë e pakontestueshme për komunikim shoqëror. Institucionalizim të gjuhëve të vendit në arsim, sidomos gjuha shqipe është shumë e nevojshme për të lehtësuar komunikimin brenda territorit dhe atë fqinjësor, pasi Republika e Maqedonisë ka shumicë të popullatës shqiptare dhe kufizohet edhe me dy shtete shqiptare si me Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë.*

## REKOMANDIME

- Multikulturalizmi dhe multilinguizmi reflektohen në të gjithë institucionet arsimore të Gostivarit, por në shkollat filllore nxënësit e etniteteve të ndryshme duhet të mësojnë në ndërrime të përziera për të komunikuar njëri me tjetrin. Në shkolla të mesme gjendja e multikulturalizmit është e mirë, sepse mësohet me ndërrime të përziera.
- Në shkolla filllore fëmijëve, që i kanë nënët shqiptare të martuara për maqedonas dhe turk, përveç bilinguizmit biologjik të filluar në familje duhet t'u ofrohet mundësia ta zhvillojnë bilinguizmin edhe në institacione arsimore. Mendojmë se kjo do të ndikonte edhe në zhvillimin kognitiv, afektiv, psikomotorik dhe social të individit, konstruktivizmin vetjak dhe konstruktivizmin social.
- Në shkollën e mesme profesionale në Gostivar, SHKTG, nxënësve maqedonas dhe turk duhet t'u mundësohet të mësojnë gjuhën shqipe si lëndë zgjedhore, pasi është gjuha më e nevojshme për të komunikuar me klientët e tyre, që janë të etnititetit shumicë në Gostivar.
- Mësimdhënësit e gjuhëve duhet të vëzhgojnë përvojat e njëri-tjetrit. Ata duhet të trajnohen për parimet e multikulturalizmit dhe multilinguizmit për të zhvilluar mësimdhënie në korrelacion gjuhësorë. Gjatë realizimit të procesit të mësimdhënieve të përdoren strategji moderne, organizues grafik, që përceptimi vizuel të ndikojë në qartësinë e koncepteve dhe kuptueshmërinë e tyre nga ana e nxënësve. Të përdoren përvojat e mësimit të gjuhëve sipas metodave on-line, që gjenden nëpër faqet e internetit, duke zbatuar disa metoda edhe në mësimin e gjuhëve lokale në Gostivar e më gjerë. Gjuhët janë më se të nevojshme për zhvillimin e karrierës në fillim të shekullit XXI.
- Hartuesit e librave shkollor në të ardhmen duhet t'u kushtojnë më tepër kujdes hartimit të librave me përfshirjen e të gjithë pjesëve të ligjëratës me klasifikime sipas fushave gjuhësore morfollogjike, sipas klasave dhe kategorive dhe klasifikim sintaksor sipas gjymtyrëve të fjalisë. Çdo gjë më parë duhet të mësohet në gjuhën amtare, pastaj të mësohet në gjuhët tjera. *Zgjidhja më e mirë është të ketë një libër i përgjithshëm nga pjesa e gjuhësisë për të gjithë nxënësit shqiptarë të shkollave filllore dhe të mesme.*
- Hartuesit e librave të gjuhës shqipe duhet të përgatisin doracakë për arsimtarë si orientues të mësimdhënieve si janë librat e gjuhës angleze. Ato gjatë hartimit të librave duhet të jenë në bashkëpunim të ndërsjellë me mësues me përvojë të e gjuhës shqipe.
- Në shtëpitë botuese të punësohen gjuhëtarë, për t'i vërejtur dhe korriguar lëshimet gjuhësore, që reflektohen në librat aktuale. Tekstet të mos shtypen mbi ilustrime, për shkak se vështirësojnë të lexuarit, të mos përsëriteren paragrafë të njejtë dhe prishje të strukturave të stofave të poezive.

## PËRFUNDIM

Qytetarët e Gostivarit jetuan bashkë dhe së bashku u përballën me shumë sfida dhe vështirësi të ndryshme në të kaluarën. Si armë kryesore patën bashkëjetesën, tolerancën dhe respektin në çdo aspekt, si në atë nacional ashtu edhe në atë fetar. Në këtë mënyrë veprojnë edhe sot dhe nga studimi ata shprehën se edhe brezave të ardhshëm duan t'ua përcjellin pikërisht këtë mesazh se bilingualizmi është përparësi për të jetuar bashkë dhe për t'i ofruar edhe më shumë.

Me mësimin e gjuhëve të njëri-tjetrit dhe respektimin e ndërsjellë të njëri-tjetrit në të gjitha sferat e jetës, e kanë siguruar ardhmërinë e tyre dhe fëmijëve të tyre duke u bazuar në përparësitë e shoqërive multikulturore dhe multilinguale si vlera të patjetërsueshme të paqes dhe mirëqenies. Ata janë të vendosur të jetojnë bashkë në të tashmen dhe do të jetojnë bashkë edhe në të ardhmen si qytetar të lirë duke u përshtatur me proceset e globalizmit ose “*të gjithë për të mirën e të gjithëve*” dhe do të bashkëveprojnë me të gjithë qytetarët në *Republikën e Maqedonisë multikultrurore*.

*Multilinguizmi duhet të kuptohet si proces, që ofron përparim dhe mirëkuptim e jo dështim dhe nënçmim të individëve. Çdo gjuhë e mësuar në fëmijëri është përfitim në ardhmëri, qoftë për zhvillimin e plurilingualizmit individual, qoftë për zhvillimin e shoqëror.*

## FJALORI

**Autonomi-a:** E drejta e një vendi (e një krahine, e një republike) për t'u qeverisur sipas ligjeve të veta brenda sistemit të administrimit të një shteti më të madh, vetëqeverisje p.sh. Autonomi krahinore. Fitoi autonominë. 2. Mundësia për të punuar a vepruar në mënyrë të pavarur; gjendje pavarësie. 3. (Autonomi në të mësuarit e nxënësit) lloj specifik i trajnimit, i propozuar shpesh në kuadër të kornizës për mësim të gjuhës, që synon të ndihmojë folësin që të bëhet i vetëdijshëm për mënyrat në të cilat ai apo ajo mund të marrë përsipër mësimin e gjuhës; synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe të tregojë si të zhvillohen strategjitë e mësimit. (shih: FSHS 1984 : 45).

**Autokton-e :** Banori (gjuha ose diçka tjetër), që banon në atë vend (ose përdoret në atë vend) ku kanë jetuar paraardhësit e tij nga kohët më të lashta; që është i atij vendi, që nuk është i ardhur, vendës, anas, rrënës, p.sh. Popullsi autoktone. Bimë autoktone. Gjuhë autoktone. (shih: FSHS 1984: 45).

**Dialekt-i :** Varianti i gjuhës së një populli, i cili përdoret nga një grup njerëzish që banojnë në një truall, pak a shumë të kufizuar ose që i takojnë një shtrese shoqërore të caktuar. Dialekt Territorial (shoqëror). Dialekti i veriut. Dialekti i Jugut. 2. Gjuhë dialekore pa një status zyrtar (apo me status të ulët), i përdorur rrallë apo asnjëherë në formë të shkruar, përshkruan variantet gjuhësore rajonale dhe/apo të minoriteteve, por që njihet se i takon territorit nacional apo federal. (shih:FSHS 1984 : 201).

**Diversitet linguistik:** 1. Prania e varianteve gjuhësore të ndryshme në zonat gjeografike të njëja (shih shumëgjuhësh, shumëgjuhësi) apo në repertorin linguistik të një folësi (shih plurilingual, plurilingualizëm, repertor). Ruajtja dhe rëndësia e diversitetit linguistik janë bërë vlera të përbashkëta në shoqëritë evropiane; mund të zbatohen përmes edukimit plurilingual. (shih: K.E 2007).

**Diversitet linguistik:** Shprehja diversitet linguistik është njësi gjuhësore e formuar nga dy fjalë me prejardhje latine “diversitet”, që në shqip do të thotë dallueshmëri, larmi, diversitet, shumëlojshmëri dhe “lingua”, që në shqip do të thotë “gjuhë” (shih: Batosava, L dhe Çadikovska, D 2000:173). Diversiteti linguistik është shkencë me karakter analistik, detyra e së cilës është të shqyrtoj e teorisë shkencore të filologjisë, analiza e gjithanshme për të vertetuar lidhjet e shkaqeve të tyre dhe të zbulojë ligjshmëritë e përgjithshme në jetë dhe për zhvillimin e gjuhës. (shih: Vujaklia,M 1972:222).

**Edukatë-a:** Tërësia e veticë shpirtërore e fizike (botëkuptimi, cilësitetë morale, tiparet e karakterit e të vullnetit, shijet , sjellja etj. ),që fiton njeriu nën ndikimin sistematik të shkollës, të familjes , të shoqërisë dhe nëpërmjet veprimtarisë së vet të vetëdijshme; formimi i përgjithshëm i veçantë i nejriut; p.sh. Edukatë komunitare. Edukatë e shëndoshë. Edukatë familjare. Edukatë e punës. (shih:FSHS 1984 : 254).

**Edukimi bilingual:** lloj i edukimit që përfshin të paktën dy gjuhë të instruksionit (për shembull, një gjuhë nga zona gjeografike përreth dhe një gjuhë e huaj, dy gjuhë nga zona gjeografike të njëja zyrtare), që përdoren për të mësuar përbajtjen edukative dhe për të transmetuar dijen. ( bazuar në sqarimin e fjalës edukatë në ( shih:FSHS 1984 : 254).

**Edukimi plurilingual:** Mënyra e mësimdhënies, jo domosdo e kufizuar në mësimin e gjuhës, që synon të rrisë ndërgjegjësimin për repertorin gjuhësor të secilit individ, për të theksuar vlerën e tij dhe për ta zgjeruar këtë repertor duke mësuar gjuhë më pak të mësuar apo të panjohura. Edukimi plurilingual synon gjithashtu të rrisë pranimin e vlerës sociale dhe kulturore të diversitetit linguistik

për të siguruar dashamirësinë linguistike dhe për të zhvilluar kompetencën ndërkulturore. (( bazuar në sqarimin e fjalës edukatë në (shih:FSHS 1984 : 254).

**Fis-i:** Grup njerëzish në shoqërinë primitive me lidhje të afërta gjaku me gjuhë të përbashkët e me zakone të njëjtë, që mbështetej në pronën e përbashkët dhe e cila ishte njësia bazë e organizimit të jetës e të prodhimit; në mesjetë; bashkësi njerëzish, që vetëqeverisen vet sipas të drejtës zakonore; etnografi: bashkësi njerëzish me gjuhë dhe zakone të përbashkëta, me një prijës në krye p.sh. fise ilire, fise shtegtare; 2. Grup njerëzish, që rrjedhin nga një stërgjyshër i përbashkët, njerëz të një gjaku p.sh. farefis, fisi i gruas (i burrit), 3. Kombësi, komb. 4. Familje e pasur në shoqërinë feudale. ( shih:FSHS 1984 : 292).

**Gjuhë-a:** 3. Gjuha është tërësia e mjeteve të shprehjes, që disponon një komb për t'i dhënë formë kumtimit, kurse stili është vetëm një aspekt i gjuhës, i cili si i tillë rrejdh nga zgjedhja, që bëhet midis këtyre mjeteve e mënyrave të shprehjes, në përputhje me fushë të caktuar të veprimtarisë, si dhe kushtet në të cilat realizohet komunikimi. (shih:FSHS 1984 : 391).

**Gjuhë dominuese:** (1) Varianti i gjuhës në të cilin folësi ka nivelin më të lartë të kompetencës; (2) varianti i gjuhës që gjëzon status ligjor, kulturor dhe shoqëror mbi variantet tjera. Gjuhë e parë: varianti gjuhësorë i përvetësuara në fëmijërinë e hershme (afërsisht para moshës dy apo tre vjeçare) në të cilat aftësia e gjuhës njerëzore është përvetësuar së pari. Ky term preferohet para atij gjuhë amtare, që është shpesh i pasaktë sepse gjuha e parë nuk është domosdo ajo vetëm e nënës. (shih:FSHS 1984 : 391).

**Gjuha e origjinës:** Varianti gjuhësor, shpesh gjuha e parë, e personave apo grupeve që kanë shkuar për të jetuar në vendet tjera. Këta folës duhet të përshtaten në aspektin linguistik me mjeshterin e ri, dhe duhet të mësojnë, të paktën pjesërisht, gjuhën (apo gjuhët) e vendit pritës. (shih:FSHS 1984 : 391).

**Komb-i:** Bashkësi e qëndrueshme njerëzish e formuar historikisht në bazë të bashkësisë së gjuhës, të territorit, të jetës ekonomike dhe formimit psiqik, që shfaqet në bashkësinë e kulturës p.sh. Kombi shqiptar, E drejta e kombeve për vetëvendosje. 2. Shtet, vend, p.sh. Organizata e Kombeve të Bashkuara. ( shih:FSHS 1984 : 536).

**Komunitet-i:** Koncepti i komunitetit ka të bëjë me një tërësi specifike marrëdhënie shociale të bazuar në diçka, që pjesëtarët e përfshirë në to e kanë të përbashkët–zakonisht një ndjenjë të përbashkët identiteti. ( FSO --- : 186 ). Një grup shoqëror i themeluar historikisht, me një histori të përbashkët dhe me karakteristika dalluese që i lidhin ata, sikur që është gjuha, religioni, praktikat kulturore dhe territori. Ky kombinim mund të kontribuojë madje edhe në krijimin e karakteristikave dalluese të grüpuit, por këto portretizohen si karakteristika origjinale apo që kanë ekzistuar më herët. (shih: FSO --- : 186 ).

**Kompetencë-a:** Njohuri të thella, të plota , të përpikta që ka dikush në një fushë të dijes. (shih: FSHS 1984 : 538)

**Kompetencë ndërkulturore:** Kombinimi i njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe sjelljeve që i mundësojnë folësit, në shkallë të ndryshme, të njohë, të kuptojë, të interpretojë dhe të pranojë mënyrat tjera të jetësës dhe të të menduarit jashtë kulturës së shtëpisë së tij apo saj. Kjo kompetencë është bazë e të kuptuarit ndërmjet njerëzve, dhe nuk limitohet vetëm në aftësitë gjuhësore. (shih:FSHS 1984 : 538).

**Kompetencë linguistike:** (1) Kapaciteti për shfrytëzim të një apo më tepër varianteve gjuhësore për komunikim (shih gjithashtu Plurilinguizmi); (2) kapaciteti për të analizuar një variant gjuhësor, për shembull, përmes kategorive përshkruese që bazohen në “gramatikën” e tij apo në gjuhësi (termi kompetencë metalinguistike përdoret gjithashtu në këtë kuptim). (shih:FSHS 1984 : 538).

**Krahinë-a:** Pjesë e një vendi, që dallohet prej të tjerave nga disa veçori gjeografike, gjuhësore, ekonomike, etnografike, etj; vend , që shtrihet larg nga qendra administrative p.sh. Krahinë bujqësore, Krahinë malore, Muzikë e valle nga krahinat. 2. Njësi territoriale-administartive brenda një shteti , e cila ka një kryeqendër (në disa vende të tjera(Krahinë autonome. (shih:FSHS 1984 : 551).

**Kultur-a:** 1) Fjala “kulturë” në leksikonin e fjalëve të huaja dhe të shprehjeve (Vujaklia,M 1972:493) sqarohet me fjalën latine “colere”, që domethënë të kultivosh, të kujdesesh, të përpunosh, zhvillim, arsimim, përsosje, përpunim, dituri, kulturë etike, ngritja e individit në shoqëri, që të zotërojë ideale: të drejtësisë, të sinqeritetit, të njerëzimit dhe respektit të ndërsjellë.

**Kultur-a:** Termi “Kulturë” është shumë vështirë të përkufizohet në mënyrë të saktë, sepse lidhur me këtë term ekzistojnë me qindra përkufizime. Antropologët amerikanë Alfred Krouber dhe Klajd Klakhon, në studimin e tyre që nga viti 1952 për kulturën kishin analizuar dhe klasifikuar thuaj 164 përkufizime të përfshira në literaturën antropologjike dhe sociologjike duke filluar nga viti 1871 (Ibrahim 2016:14). Fjala kulturë është me orgjinë latine “cultus” (Basatova,L dhe Çadikovska,D 2000:155), që shqip domethënë “mënyra e të jetuarit, respektim i ndërsjellë”. Kjo fjalë konceptohet si reflektim i sjelljes së individit ose reflektimi i respektimit të ndërsjellë në mes individëve në shoqëri multikulturore.

**Lingua franca lat. gjuh.** Përdoret për gjuhët që shërbejnë për komunikim ndërkombëtar. Termi ka të bëje me përdorimin e frëngjishtes në Detin Mesdhe gjatë mesjetës, kur për komunikim mes popujsh të ndryshëm është përdorur frëngjishtja (*gjuha frënge*). Mendohet se ilirishtja ka qenë dikur *lingua franca* për vendet e Ballkanit. Sot *lingua franca* e nivelit botëror është anglishtja., ndërsa në regjione të ndryshme është edhe gjermanishtja, frëngjishtja, bislama, krio, rusishtja. 2. Tip gjuhe territorialisht më i përhapur, që përdoret përdoret për komunikim më të gjerë ndërmjet folësve të gjuhëve të ndryshme (sipas varietetit të përzier mesjetar me bazë të dialektit franko-provincial, me anën e së cilës kuptoheshin përfaqësuesit e luftërave të Kryqezatave). (Kçiku 2009:2015)

**Popull-i:** Tërësia e njerëzve, që jetojnë si një bashkësi shoqërore në një vend; banorët e një vendi a të një krahine; tërësia e shtresave shoqërore ose e punonjësve të një vendi, klasat e shtresat e gjëra punonjëse që e përbëjnë themelin e shoqërisë e të zhvillimit të saj në një etapë të caktuar; masat e gjëra punonjëse, vegjëlia. P.sh. Populli shqiptar, popull i thjeshtë etj, 2. Kombësi, komb:popull liridashës, Popull i shtypur; 3. bised.Njerëzit në përgjithësi, gjednja. p.sh. Kishte shumë popull. Foli para popullit. 4. Përdoret si gjymtyrë e dytë e disa emërtimeve të përbëra që shënojnë tituj nderi p.sh. Hero i popullit. Mësues i popullit. Artist i popullit. (shih:FSHS 1984 : 942).

**Plurilingual (kompetenca e disa gjuhëve):** Kapaciteti për përvetësim të njëpasnjëshëm dhe për shfrytëzim të kompetencave të ndryshme në gjuhët e ndryshme, në nivele të ndryshme të zotësisë dhe për funksione të ndryshme. Qëllim qendror i edukimit plurilingual është zhvillimi i kësaj kompetencë. (shih: K.E 2007).

**Repertor linguistik:** Grup i varianteve gjuhësore (gjuha e parë, gjuha rajonale, gjuhët e mësuara në shkollë apo në vizitat jashtë vendit), të zotëruara nga folësi i njëjtë në shkallë të ndryshme të aftësisë dhe për qëllime të ndryshme. Repertori individual ndryshon gjatë jetës së individit (mësimi i gjuhëve të reja, “harrimi” i gjuhëve të mësuara). (shih: K.E 2007).

**Stil-i :** 1. Tërësia e veçorive themelore ideoartistike e mjeteve, mënyrave të shprehjes, që bien në sy në krijimtarinë e një shkrimitari , të një artisti, të një rryme apo të një epoke. Stil romantik. Stil gotik. Stil i arkitekturës populllore. 2. Zgjedhja e ndërthurur e mjeteve të gjuhës (kryesisht e mjeteve sintaksore e leksikore) në përputhej me një fushë të veprimtarisë ,me përbajtjen ose me metodën artistike dhe me qëllimet e shkrimitarit;shtresimi i mjeteve të gjuhës sipas funksioneve që kryen në ligjërim. Stilet funksionale. Stili bisedor (libror, zyrtar, shkencor). (shih:FSHS 1984 : 1113).

**Stil-i :** Fjala stil si term i gjuhësisë shënon një varietet a variant të gjuhës të lidhur me një sferë të caktuar të përdorimi dhe ka disa veçori kryesisht në nivelin e leksikut e të sintaksës. (shih:Shkurtaj 2009:225).

**Variacion-i:** Ndryshim i diçkaje në anët e dorës së dytë a në tipare jo të qenësishme; luhatje brenda një mase të caktuar; ndërrim nga një gjendje në një tjetër; ndërrim i mënyrës së jetesës të përditshme për të larguar mërzinë, p.sh variacioni i reliefit. Variacioni i temperaturës. Shkoi në fshat për variacion. (FSHS 1984 : 1314). Në rastin tonë Variacione gjuhësore.

**Variitet-i:** larmi. (shih:FSHS 1984 : 1314). Në rastin tonë larmi gjuhësore. Varietete funksionale-kontekstuale: Varietetet e gjuhës janë fryte të përdorimit të kodit (gjuhës) funksionalisht, që do të thotë të diferencuara sipas funksionit të tyre dhe në varësi të dukshme nga roli, që duhet ta luaj gjuha si dhe nga situata, në të cilën përdoret ajo. (Shkurtaj 2009:224)

**Varianti gjuhësor:** Termi i përdorur në udhërrëfyes është një term neutral, i përgjithësuar, kur është konsideruar e dobishme të shmanget termi gjuhë, duke shmangur kështu gjykimet për vlerën (gjuha = gjuha reale). Cilido definicion i variantit gjuhësor si përcaktues ose jo i gjuhës reale, bazohet në faktorët e jashtëm dhe jo në ndonjë karakteristikë të brendshme të vet variantit. Etiketimi i një varianti gjuhësor përfshin elementet sociale për folësit individual dhe grupime (shih gjithashtu, për shembull, dialekti, gjuha rajonale, gjuha autoktone, gjuha amtare). (shih: K.E 2007).

**Shumëgjuhësh (multilingual):** Termi shumëgjuhësh përdoret për të pëershruar situatën në një zonë gjeografike ku përdoren disa variante gjuhësore; folësit në këtë zonë gjeografike mund të mos jenë kompetent në secilin nga variantet e ndryshme të përfaqësuara. (shih: K.E 200).

## LITERATURA

### Tekste profesionale

- AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË, Instituti i Gjuhës dhe Letërsisë (2002) Gramatika e Gjuhës Shqipe –Vëllimi I-rë, Morfologji
- BUGARSKI, R (1997a) *Jezici*. Beograd: Čigoja štampa. [XX vek].
- BANJICA, Merita. (2016). *Linguistic diversity and the advantages of bilingualism and multilingualism in municipality of Gostivar, Macedonia*. European Journal of Foreign Language Teaching. Volume1, Issues 1, 2016.
- <http://oapub.org/edu/index.php/ejfl/article/view/338>
- BANJICA, Merita. (2016). *Interracial marriages a product of bilingualism*. European Journal of Social Sciences Studies. Volume1, Issues 2, 2016.
- <http://oapub.org/soc/index.php/EJSSS/article/view/45/>
- BANJICA, Merita. (2014). *Formative assessment diagnostician achievements of the pupil and the reflection of teacher's work*, ICRAE2014 Conference Proceedings ISSN: 2308-0825
- [http://konferanca.unishk.edu.al/icrae2014/cd/pdfdoc/578.pdf/ 2015](http://konferanca.unishk.edu.al/icrae2014/cd/pdfdoc/578.pdf)
- BANJICA, Merita. (2015). *“Current principals attitude on leadership and modern management in elementary schools.” 2nd Albania International Conference on Education (AICE)*. European dimension within national context. Tirana, Albania.
- BURNS,A dhe RICHARDS, J. C. (2012 ) Pedagogy and practise in second language teaching,Cambridge University Press,New York,NY10013-2473,USA
- CRYSTAL, D (1997) *English as a Global Language*. Cambridge: Cambridge University press.
- FISHMAN, A. Joshua, ur. (1968) *Reading in the Sociology of Language*. The Hague: Mouton De Gruyter.
- FROMM, E (2009) Man for himself, Njeriu për veten, Fan Noli, Tiranë
- FUKUJAMA, F (1992) Krajot na istorijata i posledniot çovek, Pening Books
- FULLAN, M (2010 a) Forcat e ndryshimit, Depërtim në thellësitetë e reformës arsimore dhe vazhdimi, QAD-Tiranë
- FULLAN, M (2010 b) Kuptimi i ri i ndryshimit në arsim, QAD-Tiranë
- GARTENSCJLAGER,U DHE HINZEN,H (2000) Perspektiva dhe prirje në arsimimin e të rriturve, Instituti për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Shoqatës Gjermane të Shkollave të Larta Popullore, IIZ?DVV dhe PARSH, Tiranë
- GJINARI,J DHE SHKURTAJ,GJ (2003 )Dialektologjia, P.S.H.2015-Tiranë
- GRADDOL, D (1997) *The Future of English*. London: The British Council.
- GRBIĆ, J (2004) *Jezični procesi, identitet i globalizacija*, Narodna umjetnost, 41/2. Zagreb.
- HARUNI, S ( 1999) Problemet Themelore Didaktike për gjuhën dhe letërsinë shqipe në shkollat filllore të Maqedonisë 1974-1994,AZA-Sesoft,Tetovë
- HUDSON, A.R (1980) Sociolinguistica,Universiteti i Kembrixhit, në shqip Dituria (2002)-Tiranë
- HUNTINGTON,P.S (1993) Përleshja e civilizimeve dhe ribërtja e rendit botëror, Refereing Affairs
- IBRAHIMI, M (2005) *Multilingualism as the Main Segment of Multiculturalism*. Soros, Skopje

- IBRAHIMI, M (2011) *Status and Prospects of the Albanian Language in State and Local Institutions od RM.* 10 Years Ohrid Framework Agreement, SEE-University, Tetovo, Macedonia, 2011:206-213.
- IBRAHIMI, M (2011) *The influence of Globalization on National Languages without International Status.* In Globalisation, Europeanization and Other Transnational Phenomena. College of Communication and Business:(Budapest 06 –07.05.2011) Budapest 2011:471-477 ISBN 978-615-5164-033.
- IBRAHIMI, M (2012) *Tema sociolinguistike dhe etnolinguistike.* Interlingua. Shkup.
- IBRAHIMI ,M (2014) Multikulturalizmi si proces verbaL, INSTITUTI ALB-SHKENCA,SHKUP
- IBRAHIMI, M (2015) *Aspektet pozitive dhe negative të shumëgjuhësisë,* Konferenca vjetore e shkencës "Java e Shkencës" 2014. Botuar në Kumtesat I : 179-184. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Prishtinë, 2015.
- IBRAHIMI, M (2016) *Gjuhë dhe kulturë.* Interlingua, Shkup.
- INSTITUTI NACIONAL– QENDRA PËR KONSERVIM GOSTIVAR (2014) Trashëgimia Kulturore në Qytetin e Gostivarit,Vinsent Grafika,Shkup
- JASHARI,H (2005) Sociologja e arsimit, Interlingua - Shkup
- JOVANOSKI, K (2000) Filozofska antropoligja, Marida, Kumanovo
- KOMUNA E GOSTIVARIT (2015) Profili i Komunës së Gostivarit
- KRAJA, M DHE HARUNI,S ( 1999) Gostivari dhe Abdylhaqim Dogani,Luma,Tetovë
- KUVENDI I KOMUNËS SË GOSTIVARIT (1970) Rrethi i Gostivari-II-të, Shtypi Universitar,Shkup  
përgatitur për shtyp nga Mitko Panov dhe Jakim Sinadinoski
- KUVENDI I KOMUNËS SË GOSTIVARIT (1970) Rrethi i Gostivarit –I-rë, Shtypi Universitar,Shkup  
përgatitur për shtyp nga Mitko Panov dhe Jakim Sinadinoski
- MARTINE,A (2002) *Elemente të gjuhësisë së përgjithshme*,Dituria-Tiranë
- MATTHEWES,B dhe ROSS,L (2010) Metodat e Hulumtimit-Udhëzues praktik për shkencat
- MAURAIS, J (2004) "Towards a new linguistic world order". U *Languages in a Globalising World.* J. Maurais i M. A. Morris, ur. Cambridge: Cambridge University Press, 13-36.
- MILARDOVIĆ, A (1999) *Globalizacija*, Pan Liber, Osijek-Zagreb-Split.
- MORIN,E (1990 ) *Evropa në mendje*, Projekti Shtëpia e Librit dhe Komunikimit-Ora-Tiranë
- MURATI,Q (2013) *Gjuha shqipe në komunikimet publike*,Instituti Albanologjik-Prishtinë
- MUSAI,B (1999) Psikologji e edukimit, Pegi-Tiranë
- MUSTAFA,A (2002) Didaktika e gjuhës shqipe, Fokus-Shkup
- NOVAK,K (2012) Vishejeziçnost i kolektivni identiteti iliraca,Srednja Europa-Zagreb
- NUSHI, P (2002 ) *Psikologji e përgjithshme.* Libri Shkollor,Prishtinë
- PAREKH,B (2000) Rethinking multikulturalism, Published by PALGRAVE, Hounds-mills, Basingstoke, Hampshire RG 216 x 5 and 175 Fifth Aveny, New York ,N.Y.10010 Companies and representatives throughout th world -with Copyright Desings and Patents Act 1998, or unrer the terms of any licence permeting limited copying issued by the Copyright Licesing Agensy,90 Tottenham Court Road, London W 1P OLP
- POLJAK,V (1970) Didaktika, Shkolska Knjiga-Zagreb
- POLOSKA, A (2001) Mozaiku gjuhësor, Menora, Shkup
- POLOSKA, A (2002) Interpretive linguistique, Menora, Shkup
- POSHKA,A (2008) Evaluating The Kultural Element In The Foreing Language Methodology, Research projekt 2008, QHSH e FGJKK,UEJL
- QAHILI,R ( 2002 ) Antropologjia, Çabej-Tetovë
- RROKAJ, SH (2000) *Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*, Dajti, Tiranë
- RROKAJ, SH (2010) *Filozofi e gjuhës prej antikititetit deri në kohën e sotme*,Arbëria-Tiranë

- SAUSSURE, De F (2002) *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*, Dituria—Tiranë
- SEMPRINI, A (1999). *Multikulturalizam*. Clio: Beograd.
- SHABANI, F (2015) Reçani i Pollogut të Epërm, Iris, Strugë
- SHKURTAJ, Gj (2009) *Sociolinguistikë e shqipes*, Morava, Tiranë
- SHKURTAJ, Gj. & MEMUSHAJ, R. (1998). *Shkolla dhe shqipja letrare "Gjuha jonë"*, Tiranë
- SKUTNAB, B & KANGAS, Tove (2001) "The Globalisation of (Educational) Language rights".  
*International Review of Education* 47/3-4:201-219.
- SPAHIU,B (1999) Psikologji, Sh.L.P-Prishtinë
- SPEAKING ...(1997) "Speaking in Tongues". *Time Magazine*. July 7:52-58.
- UÇI,A (2000) Universi estetik i Antikititetit, Dita-Tiranë
- VESELI, A (2000) Shkollat dhe arsimi shqip në Maqedoni gjatë periudhës 1941-1944, Çabej, Tetovë
- WATSON, K (1999) "Language, power, development and geopolitical Changes: conflicting pressures facing plurilingual societies". *Compare* 29/1:5-22.
- WOOLFOK, A (2011) Psikologji edukimi, Universiteti Shtetëror i Ohajës, QAD,Tiranë.
- ZAJAZI,T (2003) Metodologji e mësimdhënies dhe të mësimnxënies,VINSENT GRAPHIC, Shkup

### Fjalor dhe leksikone gjuhësore

- AGAI, K DHE AGAI, A (1996) FJALORI SHQIP-MAQEDONISHT, MESHARI, SHKUP
- AGAI, K DHE AGAI, A (1999) FJALORI MAQEDONISHT-SHQIP, MESHARI, SHKUP
- BATOSOVA, L dhe ÇADIKOVSKA, D(2000) Gjuha latine për vitin e I-rë, Prosvetno Delo, Shkup
- ÇUÇKA, SH (2006:356) Fjalor anglisht shqip, Toena,Tiranë
- DAJKOVIĆ, J (1986:447) Engleski-srbskohrvatski i srpskohrvatsko-engleski, Reçnik sinonim i antonima,  
Privredni pregled, Beograd
- HYSA,R (2002) Fjalor anglisht shqip, EDFA, Tiranë
- KOSTALLARI, A dhe të tjerë (1974) Drejtshkrimi i gjuhës shqiper Botimi i IAP,Prishtinë.
- KOSTALLARI, A dhe të tjerë (1984) Fjalorin e Shqipes së Sotme, ASHRPSSH-IGHL, Tiranë.
- KÇIKU, Ragip (2009). Fjalor i gjuhësisë. EDUCA, Ferizaj.
- MARSHALL,G (.....) Fjalori Sociologjik i Oksfordit, IDK ,Tiranë. (i blerë më 2014).
- MLADINSKA KNJIGA BEOGRAD (2011) SOVA- Veliki porodiçi leksikon, Rotografika, Subotica.
- STEFANLARI, I (1996:306) Fjalor anglisht shqip dhe shqip-anglisht, SHBE, Edlora,Tiranë.
- VUJAKLIA, M (1972) Leksikonin stranih reçi i izraza, Prosveta, Beograd.

### Tekstet shkollore të gjuhëve në arsimin fillor 2015-2016

- Hamiti, Asllan dhe Hamiti, Ismail (2010) Gjuhë shqipe për klasën e VI të arsimit fillor nëntëvjeçar,  
MASH e R së M , Qendra Grafike shpkpv, Shkup
- Beci,B; Bubaani,L dhe Gurabrdhi, Z (2001)Gjuha Shqipe 7-Libri Shkollor, Prishtinë
- Carla Gilson ; Maria Grazia Selle dhe Marie-Christine Jamet dhe Anne Gruneberg avec ia  
collaboration de Monique Bazin -Hachette Livre (1999)“ Bien joué 2 - Méthode de français ”,  
1999, 43 quai de Grenelle 75 905 Paris Cedex 15
- Husa,M dhe Idrizi,XH (2002) Gjuhë shqipe për klasën e VII-të,Prosvetno Dello, Shkup:64- 78
- Islam Karafili dhe Zihni Osmani (2010) Gjuhë shqipe dhe leximi për klasën e VIII, MASH e R së M,  
Prosvetno Delo- Qendra Grafike, Shkup : 123-211

Messages Student's book 3 (2006) - Diana Goodey, Noel Goodey & Miles Craven - të Cambridge University Press -United Kingdom

Nada Nikolovska dhe Milica Petrushevska(2008) Македонски Јазик за VII одделение во паралелките со настава на албански и турски јазик, Makedonska Iskra, Skopje

Nesimi,R dhe Gega,Xh(2001) Gjuha shqipe -5 (GRAMATIKË), Prosvetno Dello, Shkup:80-83

Nesimi,R;Toska,V dhe Abdiu,M(2003) Gjuhë shqipe për klasën e VIII-të Prosvetno Dello,Shkup:165-166

Stefanie Dengler, Sarah Fleer, Paul Rusch dhe Cordula Schuring (2010) "Ligisch" Dutsch fur Jugedendeliche, Kusbuch A 2, Langenscheidt KG, Berlin und Munhen

Zihni Osmani dhe Fejzi Bojku (2010) Gjuhë shqipe dhe leximi për klasën e VI, MASH e R së M, Prosvetno Delo- Qendra Grafike, Shkup : 155-249 përdoret në klasën e shtatë

Zihni Osmani dhe Fejzi Bojku (2010) Gjuhë shqipe dhe leximi për klasën e VII, MASH e R së M, Prosvetno Delo- Qendra Grafike, Shkup : 145-201

## Dokumente zyrtare

Komuna e Gostivarit –Sektori për Veprimtari Publike, Rr. "Bul.B. Gjinot" nr.61,1230 Gostivar, RM dokumente zyrtare të arkivuara më 26.03.2015 me Nr.Pr.27-695/2,Më.Ha 26.03.2015-Gostivar.

## Literaturë dhe të dhëna zyrtare të shfrytëzuara nga interneti

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë me Numër 08-4642/1 miratuar më 17 nëntor 1991, parë në 14. 04. 2015 dhe 28.09.2015: <http://www.sobranie.mk/kushtetuta-e-rm-s.nspx>

Komuna Gostivarit parë më 14.04.2015 në:

(<http://www.gostivari.gov.mk/web/index.php/sq/arsimi>)

Koncepti për Edukim dhe Arsim Fillor Nëntëvjeçar, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Byroja e Zhvillimit të Arsimit, Shkurt, 2007 parë më 26.03.2015 në : <http://bro.gov.mk/docs/Binder2.pdf>

Statuti i Komunës së Gostivarit **25.01.2006** parë më 14.04.2015 në:

<http://www.gostivari.gov.mk/web/index.php/sq/statuti-i-komunes>

Liqj për arsimin fillor ("Gazeta Zyrare e Republikës së Maqedonisë" nr. 103/2008, 33/2010,

116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014,

116/2014 dhe 135/2014) parë më 14. 04. 2015 në :

([http://www.mon.gov.mk/images/documents/zakoni/Zakoni\\_albanski/Liq%20p%C3%ABr%20arsimin%20fillor.pdf](http://www.mon.gov.mk/images/documents/zakoni/Zakoni_albanski/Liq%20p%C3%ABr%20arsimin%20fillor.pdf))

E-editari i shkollës Ismail Qemali-Gostivar parë më 8.06.2015 :

<https://ednevnik.edu.mk/al/start;jsessionid=98B4F63DC40AD51F769166DE3A0030CE.app6ednevnik>  
Arsimi dhe decentralizimi, OSBE/ Departamenti për Ndërtimin e Mirëbesimit/Njësia për Zhvillimin e Arsimit, Shkup, 2006 parë më 14.04.2015 në:

<http://www.osce.org/sq/skopje/19361?download=true>)

PEN, Universal Declaration of Linguistik Rights (UDLR) , The Girona Manifesto: Encapsulating the Universal Declaration of Linguistic Rights –parë më 28.09.2015 dhe më 10.03.2017 në :

<http://www.pen-international.org/newsitems/the-girona-manifesto-encapsulating-the-universal-declaration-of-linguistic-rights/>

Deklarata e Pergjithshme mbi te Drejtat e Njeriut më 28.09.2015 në:

[http://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR\\_Translations/aln.pdf](http://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/aln.pdf)

Bashkimi Evropian, parë më 28.09.2015 në:

[https://sq.wikipedia.org/wiki/Bashkimi\\_Evropian](https://sq.wikipedia.org/wiki/Bashkimi_Evropian)

Përparimi i dialogut ndëretnik në komuna-Aspekte teorike dhe praktike(2010)Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar(QMEQ);CIVICA Mobilitas ; CIR(Qendra për Zhvillim Institucional); SDS-

Agjensia Zvicrane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Shkup parë më 26. 03. 2015 .

[http://www.civicamobilitas.org.mk/al/attachments/article/23/MCGO\\_Megjuetnichki%20dijalog%20ALB.pdf](http://www.civicamobilitas.org.mk/al/attachments/article/23/MCGO_Megjuetnichki%20dijalog%20ALB.pdf)

Programi Nacional për Zhvillimin e Arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005-2015 me Dokumentet Shoqëruese Programore, Republika e Maqedonisë - Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Fondacioni Instituti Shoqëria e Hapur-Maqedoni parë më 19.02.2015 në :

([http://www.academia.edu/7973919/PROGRAMI\\_NACIONAL\\_P%C3%8BR\\_ZHVILLIMIN\\_E\\_ARSIM\\_IT\\_N%C3%8B\\_REPUBLIK%C3%8BN\\_E\\_MAQEDONIS%C3%8B\\_2005\\_2015\\_ME\\_DOKUMENTET](http://www.academia.edu/7973919/PROGRAMI_NACIONAL_P%C3%8BR_ZHVILLIMIN_E_ARSIM_IT_N%C3%8B_REPUBLIK%C3%8BN_E_MAQEDONIS%C3%8B_2005_2015_ME_DOKUMENTET)

Council of Europe , Strasburg, 5 korrik 2012, ACFC/44DOC(2002)001 rev Komiteti Këshillimor i Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare-Komentar Tematik nr.3-Të drejtat gjuhësore të personave që u përkasin pakicave kombëtare sipas Konventës Kuadër, miratuar më 24 maj 2012 parë më 14.04.2015 në :

[http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/minorities/3\\_fcnmdocs/PDF\\_CommentaryLanguage\\_sq.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/minorities/3_fcnmdocs/PDF_CommentaryLanguage_sq.pdf)

Council of Europe, Strasburg, 2007 parë më 26.03.2015 në:

[http://www.ibpkosovo.org/repository/docs/Guide07\\_Executive\\_20Aug\\_ALB.pdf](http://www.ibpkosovo.org/repository/docs/Guide07_Executive_20Aug_ALB.pdf)

Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Romë më 4.XI.1950)

Sekretariati i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut amenduar sipas Protokollit n° 11 shoqëruar nga Protokolli shtojcë dhe Protokollet n° 4, 6 e 7 (1 nëntor 1998) Neni 9 Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë dhe Neni 10 Liria e shprehjes parë më 19.02.2015 në:

<http://prison.eu.org/IMG/pdf/AlbanianAlbanais.pdf>

Komponenta *multikulturore* në procesin mësimor –Qendra Algoritam –Qendra e Edukimit -2010-

Ministria e Arsimit dhe Shkencës; Byroja e Zhvillimi të Arsimit; Projekti për Modernizimin e Arsimit , Shkup R e Maqedonisë parë më 26.03.2015 në :

<http://www.algoritamcentar.edu.mk/programi/priracnik.pdf>

COMMON EUROPEAN FRAMEWORK OF REFERENCE FOR LANGUAGES: LEARNING, TEACHING, ASSE parë më 06.11.2016 në:

[http://www.coe.int/t/dg4/linguistic/Source/Framework\\_EN.pdf](http://www.coe.int/t/dg4/linguistic/Source/Framework_EN.pdf)

Council of Europe , Education and Languages,Langauage Policy, parë më: 28.09.2015 dhe 16.03.2017  
në : ([www.coe.int/t/dg4/linguistic/Division\\_en.asp/](http://www.coe.int/t/dg4/linguistic/Division_en.asp/))

Politikat Gjuhësore Evropiane parë më 28.09.2015 në :

<http://eurospeak.al/sociale/312-politikat-gjuhesore>

Dita Evropiane e Gjuhëve parë më 09.03.2017 në:

<http://edl.ecml.at/LanguageFun/LanguageFacts/tabid/1859/language/sq-AL/Default.aspx>

GJUHËT NË BASHKIMIN EVROPIAN parë më 25.03.2017:

[https://sq.wikipedia.org/wiki/Gjuh%C3%A9t\\_e\\_Bashkimit\\_Europian](https://sq.wikipedia.org/wiki/Gjuh%C3%A9t_e_Bashkimit_Europian)

Multikulturalizmin dhe Marrëdhënet Ndëretnike në Arsim, Zyra e UNICEF, Nëntor 2009, Shkup parë më 19.02.2015 në:

[http://www.unicef.org/tfymacedonia/New\\_ALBVersion-gg1.pdf](http://www.unicef.org/tfymacedonia/New_ALBVersion-gg1.pdf)

Nga Diversiteti linguistik në edukimin plurilingual : Udhërrfëfyes për zhvillimin e politikave të edukimit gjuhësorë në Evropë -Divizioni i politikave gjuhësore, DGIV, Këshilli i Evropës, Strasburg, Council of Europe, 2007 parë më 26.03.2015 në:

[http://www.ibp-kosovo.org/repository/docs/Guide07\\_Executive\\_20Aug\\_ALB.pdf](http://www.ibp-kosovo.org/repository/docs/Guide07_Executive_20Aug_ALB.pdf)

Globalizimi, Dimensionet e globalizimit parë më 26.03.2015 në:

[http://www.dadalos.org/globalisierung\\_alb/grundkurs\\_2.htm](http://www.dadalos.org/globalisierung_alb/grundkurs_2.htm)

Društvenojezični utjecaj na dvojezičnost — hrvatske dvojezične zajednice u Istri i Beču.

(parë më 13.06.2015 në shih:

[file:///C:/Users/User00014/Downloads/polin%20\(5\).pdf](file:///C:/Users/User00014/Downloads/polin%20(5).pdf)

da@dalos , International UNESCO Education Sever for Democracy ,Peace and Human Rightst

Education, Online learning and teaching materials/ prill 2000 parë më 26.03.2015 në:

<http://www.dadalos.org/>

Milanović, Dzh, A (2010) Multikulturalizam i religijski pluralizam: rumuni nazareni kao manjina manjine u Vojvodini-Religija i tolerancija, Vol.VIII,Nr.14,Jul-Decembar,2010.35 parë më 19.02.2015 në:

([http://www.academia.edu/381606/Multikulturalizam\\_i\\_religijski\\_pluralizam\\_Rumuni\\_nazareni\\_kao\\_manjina\\_manjine\\_u\\_Vojvodini](http://www.academia.edu/381606/Multikulturalizam_i_religijski_pluralizam_Rumuni_nazareni_kao_manjina_manjine_u_Vojvodini)).

Hržica,G, Radovan, N dhe Kovačević, M (2011) *Društvenojezični utjecaj na dvojezičnost — hrvatske dvojezične zajednice u Istri i Beču.* (parë më 13.06.2015 në shih:

<file:///C:/Users/User00014/Downloads/polin.pdf>

ДИЈАЛЕКТИ НА МАКЕДОНСКИОТ ЈАЗИК parë më 04.01.2017 në:

[https://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%94%D0%B8%D1%98%D0%B0%D0%BB%D0%B5%D0%BA%D1%82%D0%B8\\_%D0%BD%D0%B0\\_%D0%BC%D0%B0%D0%BA%D0%B5%D0%B4%D0%BE%D0%BD%D1%81%D0%BA%D0%B8%D0%BE%D1%82\\_%D1%98%D0%B0%D0%B7%D0%B8%D0%BA](https://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%94%D0%B8%D1%98%D0%B0%D0%BB%D0%B5%D0%BA%D1%82%D0%B8_%D0%BD%D0%B0_%D0%BC%D0%B0%D0%BA%D0%B5%D0%B4%D0%BE%D0%BD%D1%81%D0%BA%D0%B8%D0%BE%D1%82_%D1%98%D0%B0%D0%B7%D0%B8%D0%BA)

PITANJA PRAVOPISA SAVREMENOG TURSKOG JEZIKA parë më 21.01.2017 në:

<http://www.komunikacijaikultura.org/KK6/KK6RisticBojanic.pdf>

TURK DIL KURUMU parë më 21.01.2017 në:

[https://tr.wikipedia.org/wiki/T%C3%BCrk\\_Dil\\_Kurumu](https://tr.wikipedia.org/wiki/T%C3%BCrk_Dil_Kurumu)

[http://www.tdk.gov.tr/index.php?option=com\\_content&view=article&id=77](http://www.tdk.gov.tr/index.php?option=com_content&view=article&id=77)

[www.komunikacijaikultura.org/KK6/KK6RisticBojanic.pdf](http://www.komunikacijaikultura.org/KK6/KK6RisticBojanic.pdf)

АТАТУРК, ТУРСКИОТ ЈАЗИК И АЛФАБЕТСКАТА РЕФОРМА parë më 27.01.2017

<http://eprints.udg.edu.mk/8511/1/2012-%D0%A3%D0%93%D0%94-%D0%97%D0%91%D0%9E%D0%A0%D0%9D%D0%98%D0%9A.pdf>.

## SHTOJCA

KOMUNA E GOSTIVARIT  
ОПШТИНА ГОСТИВАР  
GOSTIVAR BELEDİYESİ



www.gostivari.gov.mk  
info@gostivari.gov.mk  
tel. +389 (0) 42 213 511  
fax. +389 (0) 42 214 406

Nr.Br 27-695/2  
Më,Ha 26.03.2015  
Gostivar-Гостивар

Deri te : Merita Banjica

До : Мерита Бањица

Lënda: Dorëzim të dhenash

Предмет: Доставување на податоци

Të nderuar,

Bazuar në kërkesën Tuaj të dt.26.03.2015,  
Komuna e Gostivarit Ju dorëzon Pasqyrat me  
të dhëna për numrin e nxënësve për shkollat  
fillore dhe të mesme në tetë vitet e fundit.

Почитувани,

Врз основа на Ваше барање од 26.03.2015 год.  
Општина Гостивар Ви доставува Прегледи со  
податоци за бројот на ученици во основните и  
средните училишта во последните осум  
години.

### Në shtojcë:

- Pasqyrat me të dhëna për numrin e nxënësve
- Прегледи со податоци за бројот на ученици

Me respekt,

Со почит,



**TË DHËNA PËR NUMRIN E NXËNËSVE NË SHKOLLAT E MESME DHE FILLORE NË 8 VITET E FUNDIT**

SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME			2007/2008			2008/2009			2009/2010			2010/2011			2011/2012			2012/2013			2013/2014			
1	<b>SHF "Ismail Qemali"</b>	1635	1523	1496	1430	1375	1340	1286	1330															
2	<b>SHF "Bashkimi"</b>	1778	1702	1580	1538	1464	1396	1270	1353															
3	<b>SHF "Goce Delçev"</b>	1223	1167	1110	1066	1058	1062	1064	1049															
4	<b>SHF "Mustafa K. Ataturk"</b>	1439	1333	1317	1232	1199	1103	1180	1153															
5	<b>SHFM "Enver Stafai"</b>	86	154	175	153	191	210	178	188															
6	<b>SHF "Liria"</b>	520	482	467	419	434	407	240	241															
7	<b>SHF "Përparimi"</b>	1238	1224	1177	1082	1058	974	887	551															
8	<b>SHF "Forina"</b>	//////	//////	//////	//////	//////	//////	//////	291															
9	<b>SHF "Çajla"</b>	333	289	275	250	232	192	189	182															
10	<b>SHF "Faik Konica"</b>	621	568	539	487	446	398	368	343															
11	<b>SHF "Gjon Buzuku"</b>	313	223	207	205	176	187	156	143															
12	<b>SHMEK "Gostivar"</b>	1233	1284	1342	1262	1161	1099	1007	909															
13	<b>SHMTK "Goastivar"</b>	1059	1048	1074	913	927	835	718	634															
14	<b>SHMK "Gostivar"</b>	2754	2832	2808	2858	2848	2949	2551	1459															
15	<b>SHMKM "Gostivar"</b>	//////	//////	//////	//////	//////	//////	1014																

**TË DHËNA PËR NUMRIN E NACIONALITETEVE NË SHKOLLAT E MESME DHE FILLORE NË 8 VITET E FUNDIT**

SHKOL LAT FILLOR E DHE TË MESME	2007/2008			2008/2009			2009/2010			2010/2011			2011/2012			2012/2013			2013/2014			2014/2015			
	shq	maq	tur	shq	maq	tur	shq	maq	tur	shq	maq	tur	shq	maq	tur	shq	ma	tur	shq	ma	tur	shq	ma	tur	
"Ismail Qemali"	1482	///	153	1382	///	141	1358	///	138	1287	///	143	1229	///	146	1215	///	151	1121	///	165	///			
"Bashkimi"	814	895	69	790	851	61	703	824	53	671	814	53	635	772	57	605	740	51	570	702	63				
"Goce Delçev"	505	718	///	483	684	///	433	677	///	402	664	///	388	670	///	371	690	///	374	690	///	///	///		
"Mustafa K. Ataturk"	227	326	886	215	293	825	206	305	806	188	313	731	172	301	726	163	304	636	185	323	672				
"Enver Stafai"	54	32	///	66	57	31	78	57	40	65	56	32	74	69	48	85	74	51	64	63	52				
"Liria"	485	35	///	440	42	//	438	29	///	391	28	///	396	38	///	366	41	///	219	21	///	///	///		
"Përparimi"	1238	///	///	1224	///	///	1177	///	///	1082	///	///	1058	///	///	974	///	///	887	///	///	///	///		
"Forina"	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///		
"Çajle"	333	///	///	289	///	///	275	///	///	250	///	///	232	///	///	192	///	///	189	///	///	///	///		
"Faik Konica"	621	///	///	568	///	///	539	///	///	487	///	///	446	///	///	398	///	///	368	///	///	///	///		
"Gjon Buzuku"	313	///	///	223	///	///	207	///	///	205	///	///	175	///	///	187	///	///	156	///	///	///	///		
<b>SHMEK "Gostivar"</b>	653	458	122	700	460	124	776	435	131	746	393	123	733	322	106	720	266	113	679	235	93				
<b>SHMTK "Goastiva r"</b>	644	282	133	676	248	124	692	265	117	565	247	101	577	265	85	531	223	81	458	183	77				
<b>SHMK "Gostivar"</b>	1832	449	473	1912	452	468	1932	409	467	1966	383	508	1977	379	492	2020	431	498	1565	528	458	959	237	263	
<b>SHMKM "Gostivar"</b>	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	///	608	194	212	